

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-32-82
L 53

NASI
LERA

DITË
NGA KY
SHEKULL

*tregime
e novela*

-32-52
-53

NASI
LERA

DITË
NGA KY
SHEKULL

*tregime
e novela*



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

KAMBANAT E MUZGUT

Kundër të gjitha parashikimeve, në atë zonë të themillë dhe të ashpër malore nuk zuri dëborë por një shi i ftohtë, i imtë, që nuk kishte ndërmend të pushonte. Kishte nisur aty nga dreka, krejt papritur. Komandanti i ushtrisë së huaj ngriti kokën dhe mbajti vesh. Nga thellësia e grykave vinte një zhurmë e mbytur, si një lëngim i egër. Doli para çadrës dhe ndjeu mbi fytyrë pikat e ftohta të shiut. Malet përreth ishin veshur me një cipë të hollë gri, dhe nën shi, ashtu siç ishin të rëndë dhe të zymtë, komandantit iu dukën si komplotistë që ngrinë në vend për ta mashtruar. Cipa e hollë rrëshqiste faqeve të tyre e humbiste në mugëtirën e parakokhshme. Komandanti i ushtrisë së huaj kujtoi humbjet e mëdha që kishte pësuar ato ditë dhe u drodh.

Vinte pér herë tē parë këtyre anëve dhe toka e huaj kësaj buzëmbrëmjeje tē shpejtuar nga shiu, i shkaktoi një rrëqethje dhe i futi në shpirt një pikëllim tē rëndë si plumbi. Hyri brenda në çadër, por aty pikëllimi iu dyfishua. Mbi mushamanië e tendosur tē çadrës shiu bënnte një zhurmë tē tillë që ia shtonte akoma më shumë dëshpërimin. «Dhe ata nuk janë më, — tha me vete komandanti i ushtrisë së huaj. — Ata janë tē padukshëm dhe shpierti i tyre rrotullohet mbi çadër si shi, duke ngulur këmbë që unë t'u marr hakun. Hakun!» Sado që e theksoi dhe ngriti zërin që ta dëgjonte mirë këtë fjalë, ajo u shua jashtë dhe u plandos si një ogur i zi, i quullur dhe i pafuqishëm. Iu duk silkur diçka lëvizi jashtë çadrës prandaj u ngrit dhe doli. Malet heshtnin. Lëvizte vetëm cipa e hollë gri e shiut. «Ta marrë dreqi, — shau ai, — në këtë kohë këtu duhej tē binte dëborë dhe jo shi». Sepse dëbora i dukej më ngushëlluese dhe më e natyrshme. Ndërsa shiu i ftohtë kishte digka tē pabesë dhe kërcënuese në këmbënguljen e tij tē padukshme. Adjutanti i hodhi në sup pelerinën. Ai e falënderoi me kokë. Pelerina silkur e ngrohu, megjithëse pas palk zhurma e shiut mbi tē filloj t'i gërricte nervat. Kishte diçka tē përbashkët zhurma e shiut me gërricjen e thonjve tē maces. «Po nuk pushoi ky i mallkuar shi, kushedi si do tē më fantakset natën në gjumë... Si nuk po vijnë, ta marrë djalli ta marrë, — shifryu pas palk dhe vështroi andej nga duhej tē vinin ata që priste. — Duhej tē kishim ardhur dhe tanë duhej tē ishim duke bërë planin e sulmit pér nesër. Ai duhet tē jetë i llahtarshëm, më i llahtarshëm se zgjimi i xhindeve kur dikush u ka përmjerrë mbi varr. Të ulërijnë e tē ulërijnë si tē djegur me katram, si...» Ai i përfytyroi ata tek vinin tē veshur me cipën gri tē shiut. Komandantin e huaj e thithi aq tepër përfytyrimi, sa iu morën mendtë. Pesha e pikave tē shiut iu bë e rëndë, si goditje grushti. Vështroi edhe një herë andej nga duhej tē vinin ata që priste dhe, si nuk shqoi gjë përvèc humbëtirës së atij muzgu tē parakohshëm, hyri brenda e u shtri mbi krevatin portativ, mbi tē

cilin kishte fjetur aq herë triumfues. «Do të mundohem të mos mendoj gjë dhe të bëj një sy gjumë», tha. Ishte në një gjendje gjysmëdremitjeje, kur në çadër hyri tërë druajtje adjutanti. Komandanti i huaj e vështroi në sy dhe ai njeri, që ishte hija e tij, iu duk i lodhur. U mat t'i thoshte që të rruhej, se ndoshata ashtu do t'i ndërronte çehrja, por iu kujtua shiu dhe kjo këshillë iu dukt e kotë. Nën shi përsëri adjutanti do të ngjante i lodhur dhe i dërrmuar, pavarësisht se mund të ishte i rruar.

- Erdhën? — pyeti.
- Të katërqindët jo, por prifti.
- Ku është?
- Po pret jashtë, nën shi.
- Fute brenda.

Prifti hyri tërë druajtje. «S'paska hyrë në ndonjë çadër ushtaraku», mendoi komandanti. Druajtja e tij do të jetë më e madhe kur të marrë vesh se ç'do të thuret pas pak në këtë çadër, kur të vijnë të katërqindët. Prifti rrinte në këmbë. Komandanti pa se sa shpejt u qull^l toka nën këmbët e priftit. Sa shumë shi rënka!

— Uluni, — i tha priftit dhe bëri me kokë nga stoli. — Të thirra, i shtyrë më shumë nga ndjenja e një besniku të zotit sesa e një besniku të mbretit. Rebelët kanë vendosur të mos e lëshojnë grykën. Nuk dua të ta fsheh, ajo grykë na ka sjellë mjaft të vrarë. Ata tani prehen nën tokë. Dhe shiko në ç'mot të keq!

Prifti lëvizi buzët dhe tha pa zë një lutje. Ishte i ri dhe i zellshëm në misionin e tij. Komandanti e kuptoi këtë gjë nga sytë e tij. Ata ishin sytë e një njeriu të devotshëm për të kryer qdo mision.

— Po të ishin katolikë, do t'ju lutesha të bënit një përshpirtje për ta. Por ishin ortodokse të ndershëm. Jemi në luftë dhe nuk ua kemi bërë dot tërë ceremonitë që meritojnë. Po lagen nën shi, — tha komandanti i huaj pa vetëdije dhe u drodh, sikur shiu të binte ëdhe mbi të. Ndihej i sfilitur. Komandanti men-

doi se mos këtë gjë e vuri re edhe prifti, por u qetë-sua. Prifti kishte mbyllur sytë dhe pëshpëriste vazhdimisht lutje. Komandanti u mat t'i thoshte mjaft, por e la të qetë. Priti sa tjetri mbaroi lutjen dhe vazhdoi:

Unë do të hakmerrem pér të gjithë. Është e natyrshme dhe brenda detyrës sime, apo jo?

Prifti nuk u përgjigj.

— Ju pyeta a është e natyrshme që unë të hakmerrem, apo jo?

— Në këtë botë zoti u jep të drejtë të gjithëve, në botën tjetër...

— Mjaft, — e ndërpreu komandanti me nervozizëm, — bota tjetër është e tija dhe atje nuk i ndërhyr askush. Dëgjo. Pas pak këtu do të vijnë katërqind ushtarë ndëshkimore. Janë të specializuar dhe e dinë mirë zanatin e tyre. Nesër në mëngjes fillojnë me tri fshatrat pranë. Nulk të urdhëroj që gjatë kohës që ata kryejnë detyrën e tyre ti të dalësh jashtë në rrugë. Janë skena që ty, si njeri paqësor, do të të fantaksen natën dhe do të të prishin gjumin. Dil vetëm atëherë kur të të thérresin pér të kryer detyrën.

Prifti tundi kokën i hutuar.

— Do të kesh pak punë, por... Tani përse të thirra. Do të shkosh në tri fshatrat pranë dhe do t'u thuash që çdo shtëpi e krishtere të shkruajë me gëlqere në derë një kryq. Ata ne nuk do t'i trazojmë. Do të hakmerremi vetëm kundër myslimanëve. Më kuptoni. Kryq në dyert e të krishterëve!

— Mirë, — tha prifti.

— Kjo punë duhet kryer edhe pse jashtë bie shiqë të hyn deri në palcë. Keni ftohtë?

— Jo.

— Edhe kjo ditë po ngryset e errët.

— S'ka gjë. Do ta kryej këtë detyrë të shenjtë. Në mesnatë kam mbaruar. Do t'i mbledh në kishë. Ju mos u shqetësoni nga kambanat.

«Sa ogurzeza do të tingëllojnë nën këtë shi dhe natën, — mendoi komandanti i huaj. — Sa mirë që nuk bien pér ne!»

- Kush ka mbetur në fshat?
- Pleqtë, gratë dhe djepet femër.
- Çfarë??!
- Djepet femër.
- Nuk u kuptoj, at.
- Djepet meshkuj i kanë çuar thellë në mal.
- Ç'do të thotë kjo?
- Ata nuk duan që të mbetet jetime pushka. Dhe mashikulli është për ta simboli i pushikës.
- Sa larg i kanë çuar këto djepe meshkuj?
- Shumë. Atje ju nuk vini dot dhe unë nuk e di mirë se ku ndodhen. Jam i ri në këto vise edhe këtë zaikon e mësova dje, kur shkova në disa shtëpi.
- Dhe asnje djep mashikull nuk pe?
- Asnjë.
- Je i sigurt?
- Po. Ata më thanë se ky ishte një zaikon shumë i lashtë dhe se ai i ka mbrojtur nga shuarja dhe gaçllëku i pushkëve. Pushka memece për ta është gjëma në shtëpi.
- Mirë, mirë, — tha komandanti. — Dhe tani nisu! Prifti doli nga çadra pa zhurmë. Komandanti u bë kureshtar të shihte se si dukej ai prift në shiu që s'pushonte. Doli. Po prifti ishte zhdukur. Ishte errur. Shiu ishte bërë edhe më i frikshëm tani. «Nata para hakmarrjes, — tha komandanti. — Nga djepet meshkuj, vetëm nga djepet meshkuj ata nuk mund të shitojen. — Vështroi edhe një herë malet, që nuk dallo-heshin më dhe hyri në çadër. — Tani do të pres të katërqindët dhe kambanat. Sa mirë që ato nuk bien për ne», tha përsëri i lehtësuar dhe u shtri në krevat.
- Ndëshkimorët erdhën duke sjellë me vete erën e thartuar të djersës. Në çadër hynë vetëm katër. Komandanti i priti i ftohtë dhe sikur u vra nga pamja e lodhur dhe uniforma e përbaltur e ndëshkimorëve. Ata u ulën dhe hoqën kapelat e zhubrosura. Dikush u mbush me frymë. Në çadër mbizotëroi era e të porsa-ardhurve. Komandanti nuk diinte si të fillonte. Sepse në sjelljet e të katërve ai shqoi përbuzje përzier me tall-

je. Ata ishim ngatërruar bashkë si balta me lëkurën e këpucëve. Por ai ishte alkoma komandant qe alkoma nuk kishte dëshuar. Ushtarët e tij flinin pranë zjarrve, mbi të cilat kërciste shiu. Tri ditë më parë kështu thaheshin pranë zjarreve edhe ata që s'ishin më. «Tani ata nuk kanë nevojë më pér zjarr». Diikush nga të porsaardhurit po shante me zë. Ai nuk e dëgjoi mirë.

— C'sham ashtu? — pyeti.

— Baltën, — tha tjetri. — Nuk ma merrte mendja se mund të kishte kaq baltë edhe në mal. Ishte një baltë rrëshqitëse, që na këputi nga këmbët. Edhe dy mushka na humbën. Rrëshqitën dhe ranë në humnerë.

— Léri, ç'na i kujton tani!

— Nuk më shqitet ulërima e tyre. Ajo sikur përpjui dheun. Më buqasim veshët.

— Mirë de, mjaft na u qave.

— Nuk po qahem, por ende më oshëtin në vesh ulërima e tyre. Sikur e nxori toka.

— Po qahesh. Ke tërë rrugën që qahesh.

— Nuk është e vërtetë. Nuk më besohej që edhe pér kafshën vdekja të ishte aq e dhimbshme.

— Na e the një herë.

— Ashtu!?

— Po.

— Ku?

— Se mos e di si quhen këto gërxhe të nëmura.

— Nuk ta kam thënë, por edhe ti ke menduar si unë, prandaj të duket sikur e ke dëgjuar nga unë.

— Ou, — u mërzit tjetri. — Mjaft na çave veshët tan!

— Nesër do të hakmerrem edhe pér mushkat.

— Edhe këtë na e ke thënë me qindra herë.

— Nuk jua kam thënë. Por edhe ti do që të hakmërrresh pér mushkat, prandaj të duket sikur e kam thënë unë.

— As që çaj kokën pér mushkat!

Komandanti kishte filluar të nervozohej nga kjo bisedë pa kuptim dhe e zvargur. Donte t'i ndërprioste

por sepse ndihej i pafuqishëm, i dëri muar. Një pjesë e ushtrisë së tij tani qullej nën tokë. «A derdhen rrëkera atje ku i varrosëm», mendoi dhe nuk e përfytyroi dot reliefin e tokës. Ajo ishte një lirishte, si një gropë dhe me siguri që aty kullonte uji i shpateve përballë. Por aty toka ishte më e butë dhe hapej pa u lodhur shumë. Tani është vonë dhe ata do të mben ten atje, nën rrjedhën e rrëkerave. Dhe gati sa nuk thirri se përse s'kishte nisur ende të binte dëbora. «Tani në këto vise duhej të binte dëborë dhe jo shi». Në çadër u bë heshtje. Shshshtt! Mbi mushamanë e çadrës trokiste shiu. Komandanti ndezi llambën dhe pa orën. «Kur duhet të bjerë kambana e parë? Kaq ngadalë edkërnka prifti! Tani më mirë të dëgjoja kambanën sesa shiun. Ajo nuk bie pér mua, kurse ky shi më duket sikur më është vardisur keq, si një qen».

— Ku do të rregullohemi të flemë? — e pyetën.

— Çadrat i keni gati. Dhe ushqimin e ngrohtë.

— Po shkojmë të ndërrrohemi dhe si të vëmë diçka në gojë po vijmë pér të biseduar pér nesër.

Ata ishin të qetë. Komandanti mbeti përsëri vetëm. Ata lanë në çadër erën e rëndë të djersës. Atij po i merrej fryma. Hapi pak fletën e çadrës të ndërrrohej ajri dhe dëgjoi si binte dallgë-dallgë, si e shurdhuar dhe thithur nga diçka poroze, kambana. Ai dëgjoi tingëllimën e saj të dobësuar, si të squallur nga shiu. «Kjo kambanë nuk bie pér mua. Kjo kambanë bie pér gjëmën e sotme, të nesërmen dhe pér vitet që do të vijnë. Këtë kambanë nuk keni pér ta harruar! Ajo do të vërtitet te ju si nata. Dhe netët që mbjell kjo kambanë janë të pafundme». Tring! Tring! Lëkundej kambana. Tring! Tring! Kjo është kambana e parë. E dyta vjen më pas. E treta në mesnatë. Tring! Këmbana heshti. Komandanti priti më kot që ajo të binte përsëri. «Kur nuk i thashë priftit që t'u binte kambanave tërë natën e natës. Edhe gjumin do ta bëja më të rehatshëm. Sa larg është fshati i dytë? Ishallah nuk vonohej rrugës». Kudo heshtje. Ndëshkimorët po hanin. Dëgjohej kërcitja e lugëve pas gavetave. Pas zhurmës

së kambanave ajo kërcitje ngjante e varfër dhe të shtinte në shpirt një zynti të rëndë. Dikush po afrohej dulke tundur fenerin.

— Ç'e tund ashtu, se na qorrove, — tha komandananti.

— Ç'qe ajo kambanë?

— Jua shpjegoj brenda në çadër.

Kur hynë përsëri të katër, ai tha:

— Ajo ishte kambana e përçarjes. Ajo sapo filloj të bjerë dhe nuk ka për të pushuar kurrë.

Drita e llambës krijonte hije të çuditshme mbi ftyrat e komandantëve të kompanive ndëshkimore. Ata ishin të habitur dhe kishin të drejtë, se nuk dinin gjë.

— Nuk po ju marrim vesh.

Komandanti heshti. Duhej të heshtte një copë herë, që më pas ta dëgjonin me vëmendje. Heshtja prishej nga ndonjë hingëllimë e trembur mushike ose nga ndonjë thirrje ushtarësh.

— Para se të vinit ju, pilkërisht aty ku je ulur ti kishte zënë vend prifti i këtyre anëve. E thirra dhe e urdhërova të mblidhët të krishterët e tri fshatrave dhe t'i urdhëronte që të bënin nga një kryq në derë të shtëpisë. Kështu që ju, shtëpitë që kanë kryq nuk do t'i ngitni. Ndërsa shtëpive që nuk kanë kryq të mos u lini as nam e as nishan. Hakmarrja mbi shtëpitë që nuk kanë kryq duhet të jetë më e tmerrshmja që keni bërë deri më sot. Hakmarrja duhet të jetë e tillë, që të kujtohet dhjetë breza. Sidomos kundër meshkujve dhe fëmijëve djem. Dhjetë breza të llahtariset fëmija që në bark të nënës. Llahtara duhet të jetë si kordoni që mbyt fëmijën që po lind. Më kuptioni? Kaq kisha. Ka njeri pyetje?

— Unë, — u ngrit njeri prej komandantëve. — Përse të ndëshkojmë vetëm myslymanët, kur dihet se na kanë vrarë edhe të krishterët?

— Që pas hakmarrjes sonë ata të fillojnë të vrasin njëri-tjetrin. Prandaj ju thashë se ajo që binte ishte zhurma e kambanës së përçarjes. Myslymanët nuk do t'u falim kurrë braktisjen. Dhe kjo do të vazhdojë nga

brezi në brez. Dhe ata nuk do të luftojnë kundër nesh por kundër njëri-tjetrit. Dhe ne do të pushtojmë grykat.

— Po sikur të krishterët të mos pranojnë të vënë kryq?

— Do të pranojnë! — ai ndihej i sigurt në atë që thoshte. Bile i shihte që tami kryqet e bardha, të mëdha, si njerëz që u kanë prerë kokën e u kanë mbërthyer duart pa gishtërinj mbi dyer. Mos i fshijë shiu?! Ata do t'i bëjnë përsëri. Bile mund të rrinë tërë natën duke bërë e ribërë kryqe. Sepse ai nuk ishte një kryq i thjeshtë. Ai ishte jeta. Dhe ajo është e dhimbur. Pas pak do të bjerë kambana e dytë. Të tretën, vallë, a do ta dëgjoj, apo do të më ketë marrë gjumi?!

— Shkoni flini! Natën do të bien edhe dy kambana, por ju mos u bëni merak. Ato nuk bien pér ne. Natën e mirë! — tha ai me një ton të prerë.

Komandantët e kompanive u shpërndanë nëpër çadra të këputur pér gjumë. Komandanti hoqi këpucët dhe u shtri. «Do të rri zgjuar derisa të bjerë kambana e dytë», tha.

Asgjë nuk pipëtinte. Gjithçka kishte ngrirë në pritje të së nesërmes. Vetëm me një heshtje të tillë mund të pritet një ditë si e nesërmja. Komandanti mbajti vesh. «Paska pushuar edhe shiu apo më bëjnë mua veshët?» Qeshi, iu duk një shenjë e mirë që nuk dëgjonte. Ai nuk duhej të dëgjonate asgjë, përveç kambanës. «Edhe ndëshkimorët nuk duhet të dëgjojnë dhe të shohim nesër. Ata duhet të janë shurdhmemecë. Shurdhmemecët e vdekjes. Se edhe vetë vdekja është shurdhmemecë. Edhe unë jam një shurdhmemec. Edhe ata mbi të cilët tani kullon toka dhe kanë filluar të dekompozohen janë shurdhmemecë, vegse ata nuk janë të aftë të mendojnë si unë dhe nuk e presin ditën e nesërmë si unë. Ata nuk presin më asgjë». Heshtje. Herë pas here vinte ndonjë klithmë e vetmuar shpendi. Klithma ishte e trembur dhe shuhej menjëherë. Ai priste kambanën e dytë, që nuk po binte aksoma. Vallë, a do të bjerë para se të më zërë gjumi, kambana

e dytë? Sepse jam një shurdhmemec? Jo. Ato që më përkasin mua do t'i dëgjoj. Po kambana po ia zgjaste shumë rrjedhën e minutave. Ato sïkur kishin ngecur diku. Po afronte mesnata dhe kambana e dytë nuk po binte aksoma. Po komandanti priste kampanën e dytë. «Mos u është tharë gjuha,» — tha dhe iu kujtua një mallikim i lashtë, që e kishte hasur në disa vende. T'u thaftë gjuha! Gjuhët e thara të kampanave të asaj qate do të ishin më të frikshme sesa gjuhët e nxjerra jashtë të të varurve. Ato kishin shoqëruar gati tërë karrierën e tij si disa dëshmitarë indiferentë dhe të pazotët për të pohuar apo mohuar diçka. Kush mund t'i thante gjuhët e kampanave? Kush? Askush. E ato po heshtnin atë natë. Njëra ra! E dyta jo. Bjer! Komandanti e pa veten gjysmë të ngritur mbi shtrat. U tremb. Iu duik sïkur po hiqte shpirt dhe ai po priste kampanat që do të binin për të lajmëruar vdekjen e tij. «Jo, jo, ato nuk bien për mua! E megjithatë sonte nuk ka njeri që t'i presë ato më me ankth sesa unë. Sïkur ato bien për mua!» Gjumi i ilku fare dhe ai do ta gdhinte zgjuar. Nervat i ishim acaruar deri në shkatërrim. Vetëm zëri i kampanave mund ta qetësonte. Ai nuk mund t'i përfytyronte gjuhët e kampanave vegce si gjuhë të varurish, që nuk i detyronte më dot askush që të flisnin.

Kambana e dytë ra afér mesnatës. Në fillim ajo u dëgjua si e lodhur, e zbehtë. Pastaj erdhi duke u inatosur. Sado që fshati i kampanës së dytë ishte më thellë se fshati i kampanës së parë, ajo dëgjohej më fort. Komandanti nuk u gëzohej dot veshëve. Tingujt e kampanës përhapeshin nëpër hapësirë dulke trembur natën. Ato binin dhe nuk donin të heshtnin, sïkur i gëzoheshin zërit të tyre. Kështu duhej të gëzohej edhe një gjuhë e vdekur po të ngjalje përsëri. Do të llomotiste gjersa t'i mbushej mendja se nuk ishte më e vdekur. Kambana binte dhe binte. Kampi flinte. Zgjimi i tij do të bëhej pas katër orësh. Dhe ai do të ishte zgjimi i njerëzve që do të mbillnin përcarjen dhe tmerrin atyre anëve. Trang! Trang! Kambana e dytë

kishte një tingëllim më të ashpër sesa kambana e parë. Tang! Tang! Ato fluturonin si disa zogj pa pendë. Ato qëndronin mbi pishat, pullazot e shtëpive, mbi skërkat, guvat, humnerat, gurët. Zogjtë e padukshëm të vdekjes dhe përçarjes. Trang! Trang! Komandantin nuk po e çlodhmin më tingujt e kambanës, si çdo gjë që zgjatet shumë dhe pa kuptim. «Mos harroi ai djall t'i pushojë? Apo e dehu tingëllimi i tyre, sikur nuk do t'i dëgjojë tërë jetën?» Trang! Trang! «Mjaft», gati sa nuk ulëriti komandanti. Traaaannggg! Zëri i kambanave erdhi duke u shuar. Qetësia që mbretëroi më pas ishte më aca-ruese se zhurma e tyre. Komandantit i bugitnin veshët. Nesër do të hakmerrej edhe për këtë. Tani duhej të flinte me çdo kusht.

Atë e mposhti gjumi i nervave të dërrmuara. Kambanën e tretë e dëgjoi turbull. Por nuk provoi asgjë. Ai vetëm tha përgjumësh se ajo ishte kambana e fundit e muzgut të një fisi, të një kombi, që ishte i destinuar të vritej për dhjetë breza me radhë njëri me tjetrim. Komandanti pa në ëndërr djepet meshkuj që tundeshin e tundeshin dhe çdo lëkundje e rriste një vit mashkullin. Djepet lëkundeshin shpejt dhe meshkujt kërcenin prej andej të veshur për luftë. Ting!Tung! Ishte lëkundje e djepeve. Bashkë me ta po lëkundeshin edhe malet. Nga lëkundja e tyre komandantit iu mor mendja dhe iu duk sikur meshkujt e djepeve sapo kërcenin prej tyre niseshin me furi drejt çadrës së tij. U zgjua i lodhur. Po agonte. Shiu vazhdonte të binte. Ai kishte rënë pa pushim tërë natën. Edhe kambanat kishin rënë nën shi. Komandantin nuk i bëhej të dilte jashtë. Ishte në prehjen e një zgjumi të lodhshëm, kur drita e zbehtë e mëngjesit reflektohej lehtë nëpër pikat e shiut. Komandanti dëgjonte zérat e ndëshkimoreve dhe i dukej sikur kishte një jetë të të tërë që i dëgjonte se si ata lageshin nën shi. Ushtarët duhej të kishin ngrënë dhe mezi po prisin të niseshin. Në filim do të ecnin ngadalë. Pastaj, sa të ndienin erën e tymit që lëshojnë zakonisht fshatrat mëngjeseve, do t'u ndizej gjalku. Dhe do të nxitonin. Komandanti e dinte

mirë se ç'do të thoshte ai nxitim. Tani le të prisnin dhe pak. Vonimi i urdhrave gjithmonë i acaron ushtarët. Do të jepte urdhër që të rrështoheshin. Dhe të rrështuar le të prisnin nën shi. Shiu do t'i bënte më të padurueshëm dhe më nevrikë.

Hyri adjutanti dhe ai i dha urdhër që ndëshkimorët të rrështoheshin. Pastaj piu kafen. Ndërsa rrufiste me ëndje lëngun e zi, dëgjonte zërat e mërzitur të ndëshkimorëve. «Pas një ore ata nuk do të dinë të flasin. E folura e tyre do të zëvendësohet nga klithmat. Edhe sytë e tyre, që tani dallojnë çdo ngjyrë, pas një ore do të dallojnë vetëm ngjyrën e kuqe të flakëve. Ajo i ndez ata. Dhe vetë toka e ngopur me lagështirë nuk ka për ta thithur gjakun por ka për ta përhapur. Dhe ata, pas një ore, nuk do të dinë të flasin, por të ullërijnë dhe sytë e tyre, me bebe të zmadhuara, nuk do të kenë asgjë të përbashkët me sytë e njeriut, ashtu si zëri i tyre nuk kishte asgjë të përbashkët me zërin e njeriut. Komandanti dëgjoi zërat e ndëshkimorëve. Akoma nuk janë acaruar aq sa duhet. La mënjanë filxhanin e kafes dhe vendosi të rruhej. Dhe këtë punë e kreu ngadalë, si një rit. Kur doli nga çadra sytë e ndëshkimorëve u mbërthyen te sytë e tij. Ai u buzëqeshi. Vështroi orën pastaj faqen e malit përballë. Mbi të rrëshqitnin avuj. Shiu kishte pushuar. Nën këmbët e ndëshkimorëve toka ishte bërë baltë. Ai e kuptoi se atyre u kishte hipur gjaku në kokë. U tha të ishin të pamëshirshëm me shtëpitë që nuk do të kishin të shënuar kryq te dera. Kaq. Dhe u nis i pari. Pas tij u dëgjuua zhurma e hapave të ndëshkimorëve, që e kthenin menjëherë në baltë tokën e ngopur me shi. Fshati ndodhej pranë, i fshetur pas drurëve të drejtë të pishave. Ata i dolën fshatit nga ana veriore, që ishte dhe pjesa më imbizotëruese. Prej andej komandanti pa çatitë e hirta dhe rrugët. Askush nuk lëvizte. «Një fshat që pret vdekjen e vet, — mendoi komandanti, — nuk mund të jetë veçse kështu». Fshati ishte i mbledhur në dy lagje. Kisha ndodhej në skajin verior kurse xhamia në atë jugor. Ai e kuptoi se skaji jugor ishte skaji i myslimanëve. Ai mund ta fillo-

nte që andej ndëshkimin, por donte njëherë të shihët kryqet mbi dyer. Pilkërisht ai kryq i bërë me gëlqere ishte heshtja dhe turpi i atij fshati. Turpi dhe heshtja e fshatit të parë, pastaj i të dytit, i të tretit... Komandanti i ra kalit me një ngazëllim që nuk e kishte provuar prej kohësh. Kali nguli këmbët e para në baltën rrëshqitëse. Dhe pas tij filluan të zbrisnin të gjithë. Kur iu afrua fundit të së tatëpjetës komandanti i huaj ktheu kokën pas. Katërqind ndëshkimorët kishin bërë një vragë të thellë. Ajo vragë nuk do të shlyhej aq lehtë nga sipërfaqja e tokës. Ajo ishte shenja nga zbriti ushtria e ndëshkimorëve që kishte vendosur të linte pas heshtjen, turpin dhe përcarjen e një fisi, një krahine... Nuk e dinte, bile as që i interesonte ta dinte, se ç'shenja kishin lënë mbi baltën e kësaj toke ata që kishin ardhur kështu si ai vite më parë. «Për sa kohë nuk do të mbijë bari atje ku shkelën ndëshkimorët?» Ku shkel ndëshkimori mbijnë trarët e zinj të gërmadhave. Midis kodrës nga zbritën dhe fshatit rridhët një përrua i vogël. Kiali uli kolkën dhe piu ujë. Pastaj zgjodhi cektinën dhe ai u fut në teritorin e fshatit. Të tjerët kaluan nga një urë e vogël me parmakë druri. Ishte një urë mjaft piktoreske dhe tipikë alpine. Dërrasat rënkomin nën peshën e atyre që kalonin. Një herë u hepuar aq shumë, se komandanti mendoi se u thye, por pejzat e padukshme të drurëve drejtuan trupin e tyre dhe ura qëndroi. Komandanti pa nga larg derën e shtëpisë së parë dhe nulk i durohej sa të shihët të shënuar kryqin. I ra kalit dhe iu afrua tërë anëkth. Dera ishte e mbyllur nga brenda me lloz. Komandanti zuri të kërkonte kryqin. Iu faneps një kryq i çuditshëm, tërë vezullime guresh të ngjitur në trupin e tij. Ai kërkonte të shikonte kryq gëlqereje. «Ku e kam parë këtë kryq kaq të bukur, — tha ai. — Ku?» Me vonesë i erdhi në kujtesë, e largët, kupola madhështore e kishës së kryeqytetit të tij. «Ç'do ai kryq këtu, në këtë vdekësi?» Kupola e kishës u zhduk dhe ai tanë ndodhej para derës, një dere të vjetër, të shtrembëruar nga koha dhe gjysmë të nxirë nga shirat, dëborërat dhe era. Kanatet e

puthitura me zor heshtnin. Edhe dera heshtte. Sepse kryqi në gji të saj do të ishte gjuhëlutësja e tërë shtëpisë. Tani ajo shtëpi kishte mbetur pa gojë.

- Në ç'lagje kemi hyrë? — pyeti komandanti.
- Në atë të krishterë, — foli përgjegjësi i pararojës.
- Përse nuk kanë vënë kryq në derë?
- Nuk pranuan.
- Përse nuk pranuan? — Ai e kuptoi se kjo pyetje nuk i përkiste pararojës.
- A ka njeri te kjo shtëpi?
- Nuk e dimë.
- Digjeni! — tha prerë.
- Ta kontrollojmë njëherë.
- Jo, digjeni!

Dhe ndëshkimorët nisën zanatin e tyre. Shtëpia mori zjarr menjëherë. Komandanti rrinte mbi kalë dhe shikonte se si atë shtëpi po e pushton te shkatërrimi. Atë shtëpi, që ndoshta për më shumë se një shekull nuk i kishte bërë gjë as tufani më i tèrbuar alpin, tanë po e shfaroste vëtëm mosvënia e një kryqi të thjeshtë prej gëlgereje mbi derë. Ai vendoi të qëndronte aty, gjersa shtëpia të bëhej njësh me tokën.

- Të digjet tërë fshati! — tha.

Ndëshkimorët u përhapën sakqaq nëpër lagjen e vogël. Nuk kaloi shumë e tërë atmosferën e mbyti tymi dhe kudo dëgjohej kërcitja e zjarrit. Ai rrinte mbi kalë dhe shikonte. Flakët lëpinin ajrin e ndezur. Nga shtëpia nuk vinte asnje zë.


— Le të rrinë grykave, — i tha adjutantit që vuri buzën në gaz me zor, — kur të kthehen as edhe një thëngjill të ndezur të mos gjejnë. Si të ketë pushuar zjarri do të urdhëroj ta shuanë prushin me shurrë! — Dhe qeshi. Iu duk se kishte shprehur diçka që i shikonte fare mirë atij mëngjesi. Kur ra tavani, u dëgjuua një zhurmë e llahtarshme si të ishte zëri i tokës. Pas hesh-tjes së saj komandanti nuk i dëgjonte më zhurmat e tjera.

Erdhëн dy ndëshkimorë dhe ai pa vetëm lëvizjet e buzëve të tyre sepse zërat nuk ua dëgjonte dot. Dhe ata u larguan përsëri. Priti mos nga hiri i asaj shtëpie dilit digka, midis bubullimës dhe ngashërimit, midis lutjes dhe... Po shtëpia digjej si një dru i vëtmuar pylli i goditur nga rrufeja. Ai qëndroi aty gjersa shtëpisë i mbetën muret e zeza. Dhe kaloi për herë të parë pragun prej guri të rëndë që kishte mbetur pa u dëmtuar nga zjarri. Kush mund ta prishë këtë prag? Ndëshkimorët jo. Atyre do t'u duhet të qëndrojnë tërë ditën për ta thërrmuar atë prag. Sa keq që nuk ka pragprishës. Të kishim skuadra, kompani, batalione. Të armatosura me vare, qysqi, baromina, dinamit. Atëherë, po, ushtria ime do të qe ushtria e shfarosjes... Sepse në ato çaste veglat e zakonshme të gurthyesve i dukeshim më të tmerrshme se armët e ndëshkimorëve. Heshtje. Ktheu kalin dhe pragu i ngjau më një rrasë varri që i rëndonte në shpinë. Ngau kalin me shpejtësi, por persekucioni i pragjeve e ndoqi derisa ai arriti në skajin tjetër të fshatit. Kokën nuk e ktheu asnjëherë pas, e megjithatë persekucioni i pragjeve të shtëpive të djegura ishte pas tij, si një varg i gjatë, i rreshtuar për të marshuar bashkë me të dhe për të pushuar po bashkë me të. Pragjet kishin forma të ndryshme, gjatësi të ndryshme, ngjyra të ndryshme. Të përbashkët kishin materialet; tërë pragjet ishin prej guri. Fshati nuk duhej të ishte shumë i madh, sepse të katërgind ndëshkimorët u mblodhën shpejt dhe ishin gati të niseshin drejt fshatit të dytë. «Ndofta ai do të jetojë, ndërsa ky kaq e pati». Dhe dha urdhër të niseshin sa më shpejt drejt fshatit të dytë. Por që të vijë tek ai fshat duhej të kaloje nëpër një grykë dhe grykën e kishin zënë «rebelët». Kur ndëshkimorët iu afroan grykës komandanti thirri:

— Digjeni!

Kjo fjalë e trembi dhe e solli në vete. U përpoq të shtonte digka tjetër, po gjuha nuk iu urdhërua. Por ajo fjalë tek ndëshkimorët bëri efektin e tërbimit.

Dhe filloi lufta. Ajo zgjatej dhe zgjatej. Kaluan dy muzgje dhe gryka nuk jepej. Ndëshkimorët po rra-



lloheshin. Muzgum e tretë sulmoi vetë. Kur hyri në mes të grykës dhe pa dy shkëmbinjtë e zinj që ngriheshin të frikshém dhe të ftohtë, iu duk sikur kishte hyrë në gojën e vdekjes. Ajo po mbyllej dhe po mbyllej me një ngathtësi rrëqethëse. Të parafundit përpiu adjutantin. Ai mbeti i fundit. Në agun e vdekjes iu duk se dëgjoi kamabanat. «Përse po i bie prifti? Mos po urdhëron fshatra të tjera të vënë kryqe mbi dyert e tyre?» Dhe në grahmën e fundit të vdekjes ai pa se si njerëzit shuanin gëlqere, e rrëmibenin kur ajo filluskonte akoma dhe vraponim nën tingujt e kamabanave të bënин sa më parë kryqin e bardhë mbi dyert e vajisura — «Bëni sa më shumë kryqe! Bëni...» Por në çastim e kthjellësisë së fundit e kuptoi se nuk po binte asnje kambanë. Ato i kishte pjellë muzgu i jetës së tij. I erdhi për të qarë, por në vend të ngashërimit i doli një zë i mbytur që ishte aq i mekur, sa gryka e përpiu dhe e shoi në heshtjen e saj të rëndë.

KODRAT E GJELBRA TË FSHATIT OLIMPIK

Mbylla hartën turistike të atij qyteti dhe e hodha në sedilien e prapme të makinës. Ndjeja dhimbje koke. Nuk e di po gjidet dhe hartat turistike kishin filluar të më mërzitnin. Ato, me një farë vetëkënaqësie transparente shpesh fyeze për të huajt, me pikat e shumta piktoreske, me katedralet e shekujve të shikuar, me shtëpitë e kompozitorëve dhe të shkrimtarëve të mëdhenj, me urat dhe rrugët, me stilin gotik, barok dhe ngandonjëherë edhe me stilin rokokó të ndonjë fasade shtëpie, sikur ishin bërë për të çorientuar njerëzit. Të krijohej përshtypja sikur ai qytet gjithçka e kishte interesante dhe që duhej vizituar me çdo kusht, sikur të sakrificoje edhe disa ditë të paplanifiikuara. Shoqëruesi im ktheu kokën nga unë dhe nuk e mora vesh përsë vuri buzën në gaz.

— Qyteti ynë ka shumë gjëra interesante, — tha ai.

— Po, — i thashë, — shumë. Kjo duket dhe nga harta, aq sa një i huaj do ta kishte më lehtë të orientohej sïkcur ato dhe qidet turistike të shënonin vendet pa interes. Ato me siguri janë pak dhe kanë një të mirë që nuk të hutojnë.

Ai m'i nguli sytë për të parë nëse po tallesha apo e kisha seriozisht dhe mblodhi supet, me një lëvizje të tillë, si të thoshte: «nuk kuptova asgjë nga ato që the».

Kur dolëm nga qyteti po binte muzgu. «Sa keq që në hartat e sinoptikës nuk shënohet edhe rënja e muzgut». Muzgu ishte indiferent dhe nuk shqetësohej që errësira e tij mbulonte pilkat turistike dhe mbyllte dyert e tërë muzeve, pavarësisht nga vlera dhe rëndësia e tyre. Makina jonë filloj të parakalojë veturat me targa nga më të ndryshmet. Nxitonim. Pas dy orësh do të largohesha nga ai qytet me avionin e orës 18 e 15 minuta. Megjithëse nuk isha i sigurt nëse do të zbatohej ky orar, sepse ëngë dy aeroportet e fundit avionet ishin nisur me vonesë nga një deri në dy orë. Shoqëruesi, si e futi makinën në një dalje nga autostrada, e cila ishte më e qetë, u kthye nga unë.

— Më falni, — tha, — nuk e di në arritët të blinjt ndonjë suvenir nga qyteti ynë?

— Bleva dikë, — iu përgjigja.

— Çfarë? — tha shoqëruesi im dhe për herë të parë e humbi atë përbajtje karakteristike të njerëzve të atij kombi, sidomos me të huajt. Në qdo gjë ata përpinqeshin të ishin të përpiktë, aq sa të dukej sïkcur përpiktmëria ishte kulti i tyre.

Unë nuk iu përgjigja menjëherë dhe u bëra kureshtar nëse do të pyeste përsëri. Po shoqëruesi nuk kishte ndër mend të pyeste. Ndofta ishte penduar dhe për aq.

— Bleva një kukull, — i thashë paq me vonesë.

— Një kukull! — u habit shoqëruesi im dhe pastaj buzëqeshi. — Një kukull kudo është një kukull.

— E keni gabim, një kukull s'ka mundësi të jetë kudo një kukull. Kukulla që bleva te Sheshi i Pëllumbave është me kostumin kombëtar të krahinës suaj.

— A, atëherë ndryshoka puna. Megjithatë, më falmi, po të isha në vendin tuaj do të kisha zgjedhur diçka tjetër.

— Çfarë për shembull?

Shoqëruesi lëpiu buzën e sipërme me të poshtmen, hapi pak më tepër se zakonisht sytë dhe lëshoi vetëtimi-thi timonin, si të më jepte të drejtë se në një qytet të tillë, të madh, ku të prishet mendja dhe s'di ç'të zgjedhësh për suvenir, më e arsyeshme është ta blesh një kukull te ndonjë shitës ambulant sesa... sesa... Gjesti i shoqëruesit më kujtoi hartën turistike, që sapo e kisha hedhur në sedilien e prapme. Veturat kishin ndezur sinjalet e pasme. Shoqëruesi shikoi orën. Lëpiu përsëri buzën e sipërme me të poshtmen, bëri një lëvizje të lehtë të supeve dhe tha:

— U vonuam dhe më vjen keq, se nuk do të arrish ta shohësh tërë Fshatin Olimpik. Po, të paktën stadiumin, kullën dhe kodrat e gjelbra kemi kohë t'i sotdim.

Në hariat turistike dhe gjendet stadiumi dhe kulla, si shenja konvencionale të Fshatit Olimpik, nuk kishin më shumë se dhjetë vjet që figuronin. Po ato figuronin po aq krenare dhe dinjitoze, sa edhe objektet e tjera, që mburreshin me lashtësinë e tyre herë-herë edhe mijëravjeçare. Plus kësaj, jo në çdo shtet të Evropës gjen Fshat Olimpik. Ai ngrihet ngadalë, duke rivalizuar në heshtje Fshatin paraardhës. Vetëm diçka nuk ndryshonte. Pista kishte kudo tetë korsi, fusha e futbolit dimensionet e caktuara rigorozisht dhe publiku që dilte nga stadiumi me një gjendje shpirtërore të ndërvarur nga rezultati i skuadrës së tyre. Kjo ishte e lashtë dhe e përbashkët për tërë Fshatrat Olimpike, që nga Olimpiada e Parë e deri tek Olimpiada e... Nuk po më kujtohej e sata Olimpiadë ishte zhvilluar në Fshatin drejt të cilit po shikonim. Jehona e lojërave ishte shuar dhe unë isha kureshtar të shihja sa më parë se si dukej një Fshat

Olimpiik, i heshtur, pa zhurmë dhe i kthyer në një vend turistik. Nuk e di, po kisha mendimin se duhej të dukej i trishtuar, si duken stadiumet e lashta, të zbuluara nga arkeologët, pas qindra vjet errësire dhe ku shpesh sheshet e lojërave merren me mend...

...Këtu zhvillohej hedhja e diskut, këtu mundja greko-romake, këtu duhej të ishte tribuna e patricëve, këtu e plebejve, pjesa tjetër nuk mund të restaurohet dot nga shembja ters e tokës. Dilku këtu pranë duhej të jetë edhe hipodromi, por, hëpërhë, bashkia ndodhet në krizë dhe ka urdhëruar ndërprerjen e fundit arkeologjik. Për sa kohë? Nuk dihet, por, nga heshtja, duket që kjo ndërprerje do të jetë e gjatë. Dhe tanë kalojmë në aneksin tjetër. Më falni, se edhe ai nuk është restauruar plotësisht, por, e pse jo, vendet e lashtësisë tërë bulkurinë e tyre e kanë se gjithmonë fshehin diçka që të nxit imagjinatën. Si puna e...

Kurse Fshati Olimpik, drejt të cilit shkonim, nuk fshihte gjë, përkundrazi, ai përpinqej të vinte në duikje gjithqka, jo vetëm konstruksionin madhështor të stadiumin, por dhe qdo rekord, qdo ngjarje, Fshati Olimpik i kishte regjistruar me saktësinë më të paqortueshme në-për albumet, gazetat dhe revistat.

Ne u futëm nga rruga numër dy. Në vendin e parkimit pashë përsëri vetura me targa shtetesh të ndryshme, autobusë turistësh me mbishkrimin gjatë tërë karrocerisë «Mini Ekxpress», e sepse më ngjanë të lodhur dhe të trishtuar. Kushedi sa kilometra kanë bërë pér t'u parkuar këtu nga dy orë dhe pér t'u nisur pastaj më-për natë dhe pér të riardhur përsëri pas dy ditësh apo të nesërmen (kjo varej nga itinerari) dhe pér t'u nisur përsëri mëpër shi, mjegull, dëborë, natë, derisa të përfundonin në varrezat e makinave. Ndërsa tanë rrinin në parkim të lodhur, të trishtuar dhe indiferentë. Netët kishin filluar të ftohen në zonat alpine pritej të kishte reshje dëbore. Vjeshta në Evropën Qendrore po rrëzonte gjethet e fundit të drurëve.

— Nga dëshironi t'ia nisim? — më pyeti shoqëruesi.

— Nga të doni, — iu përgjigja.

— Nga pishina apo nga stadiumi? Në të dyja u thyen rekorde botërore dhe kombëtare, që, për fat të keq, u thyen përsëri në Olimpiadën tjetër. Ato patën vetëm katër vjet jetë, disa edhe më pak. S'ke ç'i bën, asgjë nuk është e qëndrueshme në këtë botë. Rekordet e këtush-me kujtohen vetëm në albume dhe në bilance. Më shumë, kuptohet, nga specialistët.

Vizita në Fshatin Olimpik po fillonte me nostal gjji, ndjenjë, e cila më pëlqente më pak. Ndofta kjo ishte e pashmangshme. Ndoqa pas shoqërueshin dhe e lashë të më çonte ku të donte. Më dukej sikur po kryenim një ceremoni të domosdoshme, po pak të bezdisshme. «Mos vallë edhe unë rashë viktimi e gideve dhe hartave turistike?» Shoqëruesi kishte nisur rolin e ciceronit. Dukej që ky rol i pëlqente dhe e zotëronte mirë.

— Kullën donim ta bënim edhe një herë më të lartë nga sa është, po nuk na lejuan shoqëritë ajrore. Kulla mund të kthehej në një kërcënëm serioz, sidomos në dimër, kur mjegullat dhe retë dendësohen, për avionët e linjave të ndryshme. Aeroporti i qytetit tonë është mjaft i madh, le që do ta shihni edhe vetë.

Po ecnim nëpër disa rrugina të ngushta, ku era rrokulliste aty-këtu gjethet të zverdhura. Një grup turistësh na kaloi pranë dulke folur me duar e këmbë. Dulkeshin të kënaqur nga vizita. Shoqëruesi i ndoqi me sy i lumtur. «Në qoftë se nuk tregohem edhe unë kaq entuziast sa edhe turistët, ai ka për t'u mërzitur», mendova dhe s'di sepse më erdhi keq për të. U përpoqa të tregoheshë më i vëmendshëm dhe tundja kokën në shenjë aprovimi, shpesh kot fare.

Hymë më stadium. Shkallët ishim bosh. Skuadra e atij qyteti sapo kishte mbaruar stërvitjen. Në një stadium bosh, të mbuluar nga një mugëtirë e hollë, s'mund të jesh i gjëzuar. Heshtja e tij është e rëndë, lodhëse dhe mposht qđo ndjenjë tjetër.

— Stadiumi merr gati njëqind mijë spektatorë, — tha shoqëruesi. — Kur mbushet plot, thirrja e spektatorëve dëgjohet deri në kryeqytetin e shtetit fqinj.

- Sigurisht nuk thërresin të gjithë, — thashë.
- Po, vetëm ata, skuadra e të cilëve shënon gol, thërrresin. Ata që humbasin heshtin.
- Heshtja e tij, — thashë unë duke bërë me kokë nga fusha e gjelbër, — duhet të jetë shumë e rëndë, sidomos kur humbet ekipi juaj kombëtar. Të paktën kështu më është dukur në televizor, para tre muajsh.
- O, atëherë humbëm për faj të tranierit. Tani kemi një tranier të ri e shumë premtues.
- Po i vjetri ku vajti?
- Ka marrë një ekip të kategorisë së dytë.
- Ah! Para se të humbisnit shtypi dhe televizioni juaj e ngrinte lart, si reformator.
- S'ke ç'i bën, shtypi dhe televizioni atë punë kanë.

Dolëm nga stadiumi dhe do të shkonim të hipnëm në kullën përballë, që do të qe edhe një herë më e lartë sikur ta kishin lejuar shoqëritë ajrore. Ajo edhe tani dukej sikur rebolejë karshi avionëve që fluturonin mbi të të qetë. Kulla dhe stadiumi ishin rrëthuar nga disa kodra të vogla uniforme e me bar jeshjl. Aty-këtu kishin mbjellë pemë. Ishin disa kodra glodhëse. Mes tyre kishte basenë me mjellma dhe zogj që më ngjanë me nositet e Liqenit të Pogradecit. Disa familjarë, me fëmijët e tyre, u hidhnin ushqim. Por ata nuk e preknin më ushqimin. Bile ngjanin si të nervozuar. Donin të pushonin. Ishin lodhur së ngrëni dhe së argëtuari vizitorët e ndryshëm dhe të shumtë të Fshatit Olimpik. Ata çoheshin lart me disa klithma të ngjirura, vërtiteshin fushës së futbollit dhe përsëri vinin e uleshin mbi ujin e basenit. Edhe para se të preknin ujin me këmbët që i lëshonin tërë kujdes, sikur provonin temperaturën e tij, klithnin ngjirur. Vetëm klithma e tyre griste heshtjen që kishte rënë. Ngadalësova hapat. Nuk e di, por sepse kodrat, ndoshta ngaqë ishin uniforme, kishin dikça që të kujtonte ftohtësinë e manekinëve apo butaforinë e një spektakli të dështuar. Po habitesha edhe vetë me mendimet që më shkrepnin në kokë. Por s'mund të mendoja ndryshe. «Skeptik», qortova veten dhe më

erdhi për të qeshur. Buzëqeshjen e vuri re edhe shoqëruesi im, i cili tha:

— Të pëlqejnë kodrat?

— Po, — i thashë dhe kur u bëra gati të shtoja se ato se ç'kishin një bukuri të ftohtë, shoqëruesi, sikur ta parandiente këtë, ndërhyri:

— Po ta dish se ato janë artificiale do të të pëlqejnë edhe më tepër.

«S'paskam gabuar, kur mendova se m'u dukën si manekinë dhe butafori.»

— Ato janë artificiale, përvèç barit dhe drurëve. E dini me se janë ngritur kodrat?

— Jo.

— Me mbeturinat e shtëpive të shkatërruara gjatë luftës së fundit. Kështu këto kodra vërtetojnë se edhe shkatërrimi nuk shkon ikot, —tha ai dhe vuri buzën në gaz për të nënkuptuar se ato që thoshte kishin diçka edhe nga shakaja. — Këto kodra kanë edhe një të mirë. Kanë zhdukur kujtimin e hidhur të luftës së fundit.

— E megjithatë ajo është nën to, — thashë unë.

— E ç'rëndësi ka kjo! Nën tokë janë të tëra luftrat. Edhe e fundit është përzier me to. Këto kodra të gjelbra e kanë larguar luftën e fundit aq shumë, sikur të mos ketë ekzistuar kurrë. Dhe një luftë që harrohet, sado e tmerrshme të ketë qenë, është më e mirë se një luftë që në qdo hap të tregon pasojat e saj.

— Në mos gabohem, jo shumë larg prej këtej, ka qenë një kamp i madh përqendrimi. A ruhen krematoriumet?

— Unë nuk kam qenë kurrë aty, — tha shpejt e shpejt shoqëruesi.

— Si ka mundësi, — i thashë.

— Po në vendin tuaj ka pasur kampe përqendrimi?

— Po, — i thashë. — Po bashkatdhatarët e mi kanë qenë në kampin këtu pranë. I sollën dhe shumica nuk u kthyen. Mibetën atje, — dhe bëra me dorë andej nga duhej të ndodhej kampi i përqendrimit.

— Mua nuk më pëlqen të mendoj se dikur njerëzit

janë djegur nëpër krematoriume. Mua më pëlqen të shëtis nëpër këto kodra.

— Dhe nuk jua prish kënaqësinë e shëtitjes ideja se po eoni mbi plagët e luftës, e cila nuk duhet harruar kurrë. Sepse luftërat kanë plasur pikërisht atëherë kur janë harruar.

— Përsa i përket konceptit të harrimit, ne kemi mendime të ndryshme. Ndërsa për mua, një gjë që është harruar nuk ka ekzistuar kurrë... ju nuk harroni asgjë që ka ndodhur dikur.

— E, pavarësisht nga dëshira jonë, ajo që ka ekzistuar nuk mund të harrohet. Prania e saj është kudo. Edhe te këto kodra të gjelbra.

Shoqëruesi heshti dhe mua m'u duk sikur ai po i shihte për herë të parë kodrat, megjithëse mund të kish te ardhur këtu me qindra herë.

Papritur m'u kujtua një episod, para Harkut të Triumfit. Makina jonë qëndroi për të pritur sinjalin jeshil të semaforit, kur u dëgjua kambana e ahqetësuar e tramvajit dhe klithja e frenave. Një burrë, me këmbën e majtë të prerë, nuk e kishte vënë re atrimin e tramvajit dhe po kalonte kryqëzimin e rrugëve mbi shina. Burri mezi mundi të largohej. Do të kishte qenë një skenë e rëndë. Një invalid i shtypur nga tramvaji, nën Harkun e Triumfit. Edhe kur u larguam, ai burrë m'u kujtua përsëri, sidomos këmba e humbur. Sepse isha i sigurt, ndoshta nga mosha e burrit, që ai e kishte humbur atë në luftën e fundit. Edhe shoqëruesi im u shqetësua, po ndoshta atij këmba e humbur nuk i kujtoi luftën. Nuk e pyeta dhe u zhyta në sedilie i menduar.

Kisha filluar të mos e duroja dot gjelbërimin e koderave artificiale. Ai po më dukej tragjik. Dhe qetësia e atij muzgu po më dukej tragjike. Ishte dita e tretë në atë shtet dhe nuk e pata të vështirë të vërej se si u imponohej njërzëve të thjeshtë e sidomos rinisë, harri mi i luftës së fundit. Ishte një imponim me anën e librave, filmave, revistave. Në to nuk flitej për pasojat. Pasojat ishin mbuluar nga heshtja... ose nga bari uni-

form i Fshatit Olimpik, i cili më dulkej si një dekor për tragjedi, dhe shoqëruesi, që nuk e kuptonte se padashur që bërë aktor i kësaj tragjedie. Ai nxori paketën e cigareve dhe ma zgjati. E ndezëm.

Na kanë mbetur vetëm pesëmbëdhjetë minuta kohë. Keq, shumë keq. Kullën nuk do ta shohim dot, si mendoja.

— S'ka gjë, — i thashë.

— Mbi këto kodra, gjatë Lojërave Olimpike ka mbretuar dhe qetësia. Dikush edhe mund të jetë dashuruar. Edhe sonte me siguri do të vijnë të dashuruarit. Kurse ne jemi të martuar dhe me fëmijë, — deshi të bënte shaka.

Përsëri na kaluan pranë një grup turistësh. Ndoferta grupei i fundit, sepse në vendin e parkimit kishte mbetur tani vetëm një autobus. Era po bëhej më e ftohtë. Zogjtë klithnin më rrallë. Fletët e rëna, që rrokullise-shin nëpër rruginat e Fshatit Olimpik, u shpeshuan. Ne pinim cigare pa lëvizur nga vendi, si për të kaluar edhe minutat e mbetura në Fshatin Olimpik, sipas programit. Edhe shoqëruesit i iku çdo dëshirë për t'u bërë ciceron. Ai mezi po priste t'i thosha të niseshim për në aeroport. Aty mbaronte edhe detyra e tij, që ai e kishte kryer me përpikmëri. Ai ishte një nëpunës i rregullt dhe me siguri e kishte mirë me eprorët. Ai rruhej dy herë në ditë pa qenë nevoja, mbasi ishte biond. Pashë orën. Aeroporti ndodhej në anën e kundërt të qytetit. Duhej të niseshim.

— Më vjen shumë keq që nuk e zbatuam pikë për pikë planin, — tha shoqëruesi. — Po në aeroport duhet të jemi, sipas rregullit një orë para.

— Shkojmë, — i thashë.

Rreth e rrotull ishte gjysmerrësirë. Dritat nuk ishin ndezur.

— Përse nuk i ndezin? — pyeta.

Shoqëruesi, pas tërë asaj bisede mbi kodrat e gjelbra të Fshatit Olimpik, vuri buzën në gaz.

— Kriza e energjisë, — tha.

— Po, — përsërita, — kriza.

- Dhe ajo që të nervozon më shumë është se nuk merret vesh se kur do të mbarojë.
— Kush? Heshtja e neoneve apo kriza?
— Kriza, — tha shoqëruesi dhe nxori çelësat e makinës.

Sepse atë çast m'u kujtua kriza e viteve tridhjetë.

Shoqëruesi nuk u përgjigj. Ai ma hapi derën e makinës jo me shkathtësinë e parë. Në hyrje të Fshatit Olimpik më zuri syri një llandon. Kjo ishte befasia më e çuditshme. Një llandon para Fshatit Olimpik! Menjëherë m'u kujtua një lajm televiziv, ku tregohej se si nëpër rrugët e qyteteve kishin filluar të shfaqeshin llandonet. Ato ecnin kryelartë se nuk donin t'ia dinin nga kriza. Shoqëruesi im bëri sikur nuk e vuri re. Por s'kishim bëre as disa metra rrugë, kur ai u detyrua të ndezë dhe të fikë dritat për t'i hapur rrugën një llandon tjetër. Karrrocieri nuk e prishi gjakun, si të thoshte se nuk i njihte ato sinjale. Ai kishte sinjalët e tij. Makina jonë ecte tani rrëzë kodrave të gjelbra të Fshatit Olimpik. Ashtu të zhytura në errësirë ato më dukeshin si tumula.

M I L I T A N T I

Ai po na priste që herët në sallën e panairit dhe sa po na pa që larg, erdhi dhe na përqafoi sikur të njiheshim prej ikohësh. «Më kanë ngarkuar shokët e Shoqatës t'ju ndihmoj për gjithçka keni nevojë», — na tha. Atëherë përgjegjësi im iu lut që të na ndihmonte për të gjetur ndonjë hotel. «Për gjë tjetër keni nevojë?» — tha militanti, duke buzëqeshur. Kishte dy sy të kaltër dhe të pastër. Përgjegjësi më një shok tjetër qëndruan t'i jepnin dorën e fundit pavionit tonë, kurse unë së bashku me militantin u nisëm të kërkonim hotel. Dhe kishim gati dy orë që po i binim kryq e tërthor atij qyteti të madh i cili, ngaqë nuk po gjenim dot një dhomë, më dukej dy herë më i huaj.

Të gjitha hotelet ishin të zëna. Në fillim thashë se isha ters, por militanti që më shoqëronte më qetësoi duke më thënë se kjo ishte e zakonshme. Ai ishte i sigurt

se diiku do të hasnim në ndonjë hotel që nuk ishte zë-në akoma. Ishte një djalë me trup atleti, me flokë bojë gruri, të derdhur dhe me mustaqe të pjekura nga dielli i verës.

Rrija në sedilien e prapme të veturës dhe ia mbër-theja sytë çdo tabele që na dilte përpara, mos kalonim pa parë ndonjë hotel, i cili ndoshta kishte ndonjë dhomë të lirë. Qyteti ishte i vjetër. Dicka dija për të. Për shembull aty ishte aeroporti më i madh i atij shteti perëndimor, kopshti zoologjik, që disa gide e cilësonin si një nga gjashtë kopshtet më të mëdha dhe më të pasura të botës. Dija gjithashtu se qyteti ngrihej mbi degën e një lumi, se bursa e tij ishte barometri më i përpiktë i kursit të dollarit dhe se ai ishte vendlindja e njërit prej shkrimitarëve më të mëdhenj të botës, veprën kryesore të të cilit e kishim bërë koment letrar në shkollën e mesme. Gidet dhe hartat shënonin dhe shumë vende të tjera, të cilat me siguri s'i kisha vënë re nga meraku për hotel. Sportelistët na përcillnin me të njëjtat fjalë dhe me të njëjtat gjeste, thua se ato fjalë dhe ato gjeste ishin të vetmet që ata dinin. «Kishim një dhomë të lirë, po sapo na telefonuan». Dhe pas këtyre fjalëve vinin menjëherë gjestet. Ne hipnim në makinë dhe niseshim nëpër rrugët e atij qyteti, i cili po më dukej monoton, i ftohtë, i largët.

Militanti e futi makinën në një rrugë të qetë dhe të ngushtë. Shtëpitë ishin ngjitur me njëra-tjetren. Katet e para ishin zakonisht dyqane të vogla këpucësh, zarzavatesh, trikosh ose berberhane. Aty-këtu të zinte syri ndonjë birrari apo restorant të ndriçuar zbehtë. Vetëm hotele nuk më zuri syri. Militanti ndaloi pranë një ndërtese ku ishte shkruar «Oborri i luanëve».

— Më prit këtu, — më tha dhe hyri brenda.

U ngjesha pas sedilies dhe prita. Militanti zbriti pas pak.

— Ka një dhomë treshe, — tha.

— Në rregull, — thashë ngaqë isha lodhur prej mendimit se ndoshta atë natë ne nuk do të gjenim dot një dhomë të lirë në tërë atë qytet.

— Megjithatë eja t'i hedhim një sy.

Zbrita. Ajo ndërtesë nuk kishte as arkitekturën më elementare pér një hotel. Dukej që, pasi kishte shërbyer disa vite si diçka tjetër, nga halli qe kthyer në hotel. Dhoma ishte e bollshme dhe ajo që kishte rëndësi ishin tre shtretër, aq sa na duheshin.

— Dakord.

Shkuam në sportel pér t'u regjistruar. Pronar i hotelit ishte një grua që mua m'u tipos se duhej të ishte e ve që prej luftës së fundit. Nuk e di përse mendova kështu, por këtë përshtypje e pata edhe pér disa pronare pensionesh, ku kishim shkuar më parë. Gratë ishin të shëndosha dhe të gjitha, pa përjashtim, kishin pranë sportelit qen të mëdhenj, me sy dyshues ngulur të zonjës, të gatshëm dhe të bindur pér të plotësuar qdo urdhër të saj. Kur ajo i qetësonte, ata mbyllnin sytë pér të dremitur sado pak.

— Mund të ktheheni kur të doni, — tha pronarja dhe mbylli regjistrin e madh. — Hoteli është i hapur gjatë tërë natës.

— Mund të marr pak në telefon? — i thashë.

— Posi, — tha ajo dhe më afroi telefonin.

Formova numrin e panairit dhe kërkova të më lidhni me pavionin tonë. Përgjegjësi im doli pas pak. I thashë se më së fundi, pasi mundëm të zinim një dhomë treshe, po nisesha pér tek ata.

— Përgjegjësi m'u përgjigj: «Pothuajse mbaruan punë, s'është nevoja të vish. Takohemi në hotel:»

— E, — më pyeti militanti, — ç'do të bëjmë?

— Jam në dispozicionin tuaj, — i thashë duke qeshur.

— Shumë mirë, — u gëzua ai, — po ju tregoj qyten tim.

Dolëm nga ndërtesa — hotel.

— Ecim në këmbë?

— Ecim.

Ai u mat të më falënderonte, por sepse ngeci dhe vetëm më buzëqeshi. Ishte i lumtur që unë pranova të

shëtisnim më këmbë qytetin e tij, aq sa mund të shëtitet më këmbë një qytet aq i madh. Nuk e fshihte lumburinë e tij. Metrat e parë i bëmë pa folur. Shqetësimi për hotel na kishte lodhur të dy. Tani të dy po përpinqeshim ta harronim. Dita po thyhej dhe rrezet e fundit të diellit reflektoheshin të zbehita mbi kupolat e kisha-ve dhe në xhamillëqet e bankave dhe shoqërive ajrore. Ai qytet, që për shekuj e kishte ruajtur me fanatzëm arkitekturën e vet, kishte filluar t'a prishtë atë. Nuk ia thashë këtë militantit. Ai e donte qytetin e tij. Këtë e kuptova më mirë kur vura re se ai u shmangej qiell-gërvishëseve dhe më fuste nëpër rrugët karakteristike. Pastaj më nxori buzë lumit. Rrjedhja e tij ishte e lash-të. Ai rrëshqiste i qetë nën urat e shumta dhe atje ku shkrihej me horizontin kishte filluar të binte një mjegull e lehtë, e bardhë. Nuk e di po një mjegull e bardhë, e lehtë dhe një lumë që rrjedh i qetë dhe i turbullt, janë dy gjëra që e bëjnë një qytet ndofta më të lashtë sesa është në të vërtetë. Militanti nuk fliste, sikur donte që të mos shkëputesh për asnjë çast nga soditja.

Ecnim buzë lumit. Në stolat e drunjtë nuk kishte njeri. Frynte një erë e ftohtë. Gjethet rrökulliseshin mbi asfaltbetonin ngadalë e disa mbeteshin mbi bar, disa uleshin mbi stolat, disa i merrete rryma e ujit. Vjeshtë. Tërë lagjja ku po ecnim ishte nën pushtetin e vjeshtës. Dhe mbrëmja që po binte, ishte një nga mbrëmjet e rralla, të bukura të vjeshtës, pa shi dhe lagështirë. Në atë qytet vjeshta ishte me shira të vazhdueshme. Pashë nga larg, futur mes drurëve, një kioskë. Ç'libra dhe revista mund të shiten në një kioskë buzë një lumi tani në vjeshtë? Militanti më ndoqi pas. Kioska ishte e mbyllur. Kyçet e saj mos i kishte marrë vera që shkoi? Sepse isha në një gjendje për të poetizuar. Ndofta nga që pranë kisha militantin, i cili e donte me tërë shpirt qytetin e tij.

— Nuk ka ndonjë gjë interesante, — më tha ai.

— Mbështetë, — i thashë me një farë keqardhjeje. As **Ndofta** diçka nga poezia e atij qyteti, që kishte nxje-

rrë një prej shkrimtarëve të mëdhenj të botës. Një vëllim të tij do ta kisha blerë më me qejf në atë kioskë, sesa në ndonjë librari të madhe në qendër të qytetit. Dhe në faqen e parë të vëllimit do të kisha autografin e militantit.

Kur po afrohesha më zuri syri një libër mbi Hitlerin. Reklamin e atij libri e kisha parë në disa shtylla dhe në disa banderola të hapura nga njëri skaj i tro-tuareve te tjetri rrugëve të qytetit. «Hitler — të dhëna të reja biografike». Në atë kioskë të mbyllur nga vjeshta, të vëtmuar, të mbuluar me gjethë të rrëzuara, të trishtuar, ai libër dukej sikur ishte futur rastësish. Hitleri, mes romaneve me dashuri sentimentale, revistave pornografike dhe dedektivave, me flokët e tij të sertë dhe kthimin nervoz të kokës pak nga e majta, dukje i kënaqur. Ngjitur me të ishin kujtimet e Hümllerit, Gebellsit, Geringut. Të tre vështronin në drejtime të ndryshme, si të mos e kishin njojur kurrrë njëri tjetrin dhe sikur në atë kioskë i kishëte hedhur rastësia.

— Ke lexuar ndonjërin prej tyre? — më pyeti militanti, me gjithë përpjekjet e mia për të mos i rënë në sy se ato tre libra kishin tërhequr vëmendjen time.

— Jo, — i thashë.

— Ato po botohen me tirazh pérherë e më të madh. Dhe reklamohen kudo. E në ta ka vetëm eufori. Brezi i pasluftës nuk ka as të dhënat më elementare për pa-sojat që i solli popullit tim lufta e fundit. Ato janë lënë në harresë.

Në zërin e tij ndihej qartë dhimbja dhe revolta, ndonëse përpiqej ta mposhtte. U larguan nga kioska dhe, si ngjitëm disa shkallë, hymë në një rrugë pa shumë lëvizje.

— Ti ke dëgjuar se Partinë tonë duan ta nxjerrin jashtë ligjit?

— Po, kam lexuar për këtë.

— Duan të na mbyllin edhe shtypshkronjën tonë. Na quajnë «terroristë», — tha militanti dhe vuri buzën në gaz me mllef. — Duan të përsërisin vitet tridhjetë. Dhe synimi i tyre është Partia jonë. Por ne nu k jepemi.

Sepse nuk duam të përsëritet tragjedia e atyre vitezave.

— Militanti heshti. Po ecnim nga na çonin këmbët.

— Arrestimi i komunistëve është kënkuar nga të gjitha Partitë. Edhe emri im është në listat e policisë. Edhe fotografia ime përballë dhe në profil. Megjithatë unë nuk heq dorë nga ideali im. As unë, as Partia ime. Por për ne asgjë nuk është e papritur. Ne e dinim se në mos sot, nesër dikush do të propozonte ndalimin e Partisë sonë. Ne e dinim që kjo do të ndodhë një ditë. Por, edhe në qoftë se ky propozim aprovohet, ne jemi të përgatitur. Në do të hidhemi në ilegalitet. Dhe ata i tmerron ilegaliteti. Pse ilegalitet do të thotë popull.

Ai heshti dhe ndaloi për të parë se ku ndodheshim. Ne takoheshim për herë të parë dhe nuk e di përsë na dulkej sikur kishim kohë që njiheshim. Dhe asnjëri prej nesh nuk kishte për ta harruar atë bisedë nëpër rrugët e atij qyteti, që tani nuk më dukej i huaj, i ftohtë dhe i largët.

Kthyem qoshen dhe u ndodhëm para një sheshi të madh, të ndriçuar nga të katër anët. Ishte një ndriçim artistik, që nxirrte në pah vlerat arkitekturale të një katedraleje dhe monumentin e një kleriku. Në sheshin para katedrales një cirk shëtitës po ngrinte çadrën e tij. Elektricistët po mowntonin llambat shumëngjyrëshe. Kleriku dukej sikur habitej. U kaluam pranë dhe vazhduam rrugën.

— Kisha ndër mend të të çoja në shtëpinë — muze të shkrimitarit, por jemi larguar shumë. Më fal. Nuk mërzitësh të të çoj nesër.

— Aspak, — i thashë.

— Doja të të tregoja qytetin tim dhe ndoshta padashur hapa një bisedë që mund ta bënim një ditë tjetër dhe jo sot.

— Më vjen keq që mendon kështu.

Ai qeshi dhe më zuri për krahun.

Po kalonim nëpër një lulishtë të shkretë. Edhe këtu vjeshtë. Në mes të lulishtes ngrihej një shatërvan. Cu-

rrillat e tij ishim të hollë, të pafuqishëm. Rrotull shatervanit vërtiteshin disa pëllumbë të uritur. Përtej ngrihej ndërtesa shumëkatëshe e një shoqërie ajrore e një shteti aziatik. Militanti u shkëput prej meje, u mbështet te kangjellat e shatervanit dhe vështroi tej, në mënyrë të papërcaktuar. Papritur nga një kthesë kaluan tërë zhurmë disa makina të rënda ushtarake tërë baltë.

— Po kthehen nga stërvitja. Janë trupat e NATO-s. Dhe flasin për ulje tensioni. Ka vite që në OKB flitet për ulje tensioni. Ka vite që në OKB supershtetet përgjërohen për shtetet e vogla. Para disa ditësh lexova një përgjërim të tillë. Më erди për të qeshur. Përfaqësuesi i supershtetit m'u duk si një magjistar që donte të hipnotizonte popujt me mitet dhe perandoritë. Na ishte dikur një perandori e madhe, e madhe, që një ditë na u zemërua me një shtet të vogël dhe na i shpalli luftë. Ushtria e saj zuri qielin me shigjeta, kuajt e saj shtrenë ujin e ligeneve, zhurma e topave të saj dëgjohtej në të pesë kontinentet. Popujt pyesnin: «Ç'ka bërë vaki?» «Katakлизмо!», — thoshin. Nga hiri i supershtetit u ngjallën shpirrat e perandorëve, carëve, knjazëve, mbretërve, diktatorëve. Përkuluni para triumfit të tyre. Ashtu! Thyeje edhe pak shtyllën kurzore ti, popull, aty. Mos i zemërojmë perandorët dhe mitet. Ashtu! Perandori dhe miti janë të kënaqur. Ashtu! Popujt janë urtësuar dhe janë bërë më të logjikshëm. Shpirti i perandorëve dhe i miteve vërtitet mbi kokat e popujve të vegjël përherë si një deklaratë. Ulja e tensionit! Çarmatimi! E ç'ka mbetur nga deklarata e Helsinkit? Asgjë! Përveç nostaljisë së pjesëmarrësve për rrugët dhe mëngjeset e kryeqytetit finlandez.

Militanti vuri buzën në gaz dhe tundi kokën hidhur. Atë çast m'u kujtua Beogradit.

...Treni ynë po futej në Beograd pas një udhëtimi të lodhshëm për tërë natën. Në kabinë të gjithë ishim të këputur për gjumë. As era që frynte nga Sava nuuk po na i lehtësonte qepallat që na rëndonin sikur mbanin tërë peshen e mëngjesit. Më tërhoqi vëmendjen zbulurimi i një rruge dhe një pallat, mbushur tërë flamuj. Fla-

mujt ishin të ndryshëm dhe të qullur nga lagëشتia e natës dhe e luginës së Savës. Atëherë m'u kujtua një lajm i lexuar në gazetë, mbi mbledhjen e Beogradit. Ndoshita ajo kishte filluar. Fqinji im, që kishte hipur në Maribor, uli xhamin dhe zuri të vështronë policët që ruanin urat dhe pallatin, të cilit treni ynë po i afrohej duke e ngadalësuar shpejtësinë. Pastaj ngriti xhamin dhe u përplas në sedilie me sytë nga pallati.

— Në atë sallë janë personalitetet më të mëdha të të gjitha shteteve të Evropës pa përjashtim. Ata janë tmerri i luftës. Në çantat e tyre janë çarmatimi dhe paqja. Sepse si lufta dhe paqja fillojnë nga një çantë e zezë e hedhur si pa kujdes mbi tavolinë.

— Ashtu?! — i thashë.

— Po, — tha fqinji. — Përfaqësuesit në atë sallë kanë diçka nga perënditë klasike.

Nuk po e kuptoja nëse e kishte seriozisht apo tallej.

— E ç'bëjnë perënditë klasike në atë sallë?

— Ndërhyrja në punët e perëndive është mëkat. Por ata kanë edhe diçka nga njerëzit, sepse si bisedojnë disa orë dalin dhe shëtisin. Beograzi është qytet i bukur.

— Edhe Helsinki është i bukur, — thashë jo pa qëllim.

— Epo nuk mund të kuptohet një konferencë e tillë në një qytet të humbur dhe jo të bukur. Perënditë klasike gjithmonë kanë ditur t'i zgjedhin vendet për të ngritur selitë e tyre.

Ai u çua dhe hoqi nga vendbagazhi një çantë të zezë. E vuri mbi gjunjë dhe e hapi.

— Unë mendoj se tanë duhet të hamë diçka. Tani dhe pikërisht tanë.

Vura buzën në gaz. Kishim më shumë se shtatë orë që udhëtonim bashkë në një kabinë dhe ai gjer në atë çast nuk më kishte lënë as përshtypjen më të vogël të një njeriu me humor. Bile ai më që dukur më tepër serioz sesa duhet të jetë një njeri që ka vendosur të udhëtojë me tren për orë të tera.

— Merre! — tha e më zgjati një copë kek. — Është

e vetmjaëmbëlsirë që gruaja ime e bën të mirë. Pastaj, në këtë orë, edhe personalitetet duhet të jenë duke zbritur për të ngrënë mëngjesin. E si të duket keku?

— pyeti pas pašk.

— I shijshëm, — i thashë.

— Sa do të gjëzohej gruaja sikur të ishte këtu. Po sikur ta dërgoj, po gjeta rastin, në ndonjë konferencë të tillë t'u gatuajë kek personaliteteve? E? Apo nuk e hanë kekun personalitetet?

Ai nuk m'u drejtua mua, por kopertinave të revistave. Prej andej ia kishin ngulur sytë qentë e raccave të ndryshme. Me sa dukej ai ishte amator qensh, sepse sa hyri në kabinë hodhi mbi sedilie një grumbull revistash, në kopertinat e të cilave kishte turinj qensh. Ishin disa turinj komikë dhe tragjikë, të zgjuar dhe të shastisur. Kishte turigjatë dhe turishkurtër, kishte buzëtrashë dhe pa buzë. Treni i ra sirenës. Po hynim në stacionin e Beogradit.

— Udhëtimi ynë më duket se po merr fund, kurse konferanca vazhdon punimet, — tha fqinji im.

Zbriti valixhen, rrugulloi me gishtin tregues kapelen prej gjuetari, duke e ngritur pak strehën e saj, dhe më tha:

— Mirupafshim! Duhej të zbrisja në Vinkovci për të hipur në trenin që shkon për në Novi Sad, por e humba mendjen. Tani duhet të pres edhe disa orë të mira dhe njëkohësisht të shtoj shpenzimet e rrugës. Edhe një herë mirupafshim!

E përsyhndeta me buzën në gaz, kurse ai u largua serioz. Në kabinë harroi një revistë, në kopertinën e së cilës ishte portreti i një qeni të rëndë që duket sikur qante dhe angullinte vâzhdimisht. Dola me rrëmbim, por në korridorin e ngushtë të vagonit nuk ma zuri syri. Ai ishte zhdukur. E hodha revistën në sedilie i sigurt se ajo, të paktën, do t'i merrte një copë kohë pasagjerit që do të ulej në atë kabinë...

Ia tregova këtë militantit dhe ai qeshi me gjithë zemër. Në drurët e lulishtes u ulën një tufë zogj. Në një qytet si ai asgjë nuk të duket më e habitshme sesa

një tufë zogj. Ishin disa zogj dimrakë, me pendë të ndritshme dhe të bukura. Ku i kisha parë këta zogj? Dhe m'u kujtuan menjëherë. Ata vinin në qytetin tonë sapo nisin ciknat dhe dëbora e parë.

— A bie shumë dëborë në dimër? — pyeta militantin.

— Bie, por nuk qëndron gjatë. Më shumë ka mje-gull dhe shi. Një shi që s'di të pushojë. Po në qytetin tënd?

— Qyteti im dimrin e ka ndoshta stinën më të bukur. Pranë nesh currilat e shatërvanit shushurinin lehtë.

— Ecim?

— Ecim.

Doja të vazhdoja bisedën për qytetin tim. Nga dëshira e madhe që kisha e kuptova se më kishte marrë malli...

— Kur isha i vogël, mezi prisja sa të vinte dimri dhe të niste dëbora. Militanti më dëgjonte sikur edhe atë ta kishte marrë malli për qytetin tim. Dhe sa po bëhesha gati t'i tregojë për gëzimin që ndieja kur shikoja në mëngjes dëborën e parë, në një shtyllë afishesh filmash dhe koncertesh na doli përpëra portreti i Hitlerit. Militanti ma bëri me kokë nga afishja.

— Përsëri, — thashë.

Ai mbloodi supet. Unë lexova titullin e filmit. «Hitler, historia e një idoli».

Dhe këtu, në shtyllë, Hitleri ishte rrëthuar nga një kompleks amerikan dhe nga fytyna tragjiko-komike e një kllouni cirku në turne, nga buzët e trasha të një aktoreje që ftonte për dashuri dhe nga reklama e një produkti ushqimor që jepte superforcë. Superforca demonstrohet nga katër burra, njëri më muskuloz se tjetri. Dhe, megjithëse afishet kishin kufijtë e tyre, ato i bashkonte diçka në një të vetme. Mbështetje e shtyllës, mbështetje mbarimi i asaj dite.

— Kam frikë se Hitleri nuk do të na ndahet kudo që të shkojmë, — i thashë me shaka militantit.

— Po, — tha ai seriozisht. — Në mos në ndonjë kioskë apo shtyllë, do ta kesh në ndonjë vitrinë. A mund të kalosh pa e parë?

— Jo, — i thashë.

— Edhe unë kam kohë që nuk kaloj i qetë nëpër rrugët e qytetit tim. Përherë më duket sikur shoh diçka që ka ardhur nga vitet tridhjetë, — tha militanti dhe, si heshti, shtoi: — Po ne nuk do të lejojmë të përsëriten vitet tridhjetë!

Njerëzit na ecnin përballë apo në krah duke nxituar. Të ngeshëm ishin vetëm turistët. Ata shkrepnin blicat herë pas here. Edhe ne nuk nxitonim si më parë. Militanti diçka kërkonte me sy. Nuk e pyeta.

— Vitin e ardhshëm kam dëshirë të vij në Atdheun tuaj, — tha.

— Shumë mirë, — i thashë. — Atëherë edhe unë do të të shëtis nëpër Tiranë. Mbrëmjet janë shumë të bukura, sidomos kur vjen vjeshta.

— Më ka thënë një shoku im. Besoj se do të takoheni.

— As mos dysho.

— Të falemnderit.

— Ndoshfa ti do të shkosh edhe në qytetin tim, në Korçë.

— Korçë?

— Po. Ndodhet në juglindje. Në vjeshtë aty ka shumë mollë, kurse në dimër bie dëborë. Është nga ato qytetet e pakta ku dëbora nuk shkrin menjëherë. Në pjesën e më të madhe të Atdheut tim ndikojnë erërat mesdhetare dhe klima është e butë.

— Ju e doni shumë Atdheun tuaj.

— Nga e kuptoni këtë? — e pyeta, duke qeshur.

— Sepse ju dridhet zëri, — m'u përgjigj edhe ai duke qeshur.

Nga një dyqan disqesh u dëgjua zëri i një këngëtarit të njohur amerikan. Në të gjitha shtetet nga kisha kaluar për të ardhur këtu, sikur të kishin lidhur ndonjë marrëveshje dyqanet e disqeve, vinin vetëm këngë të atij këngëtarit. Kënga që dilte nga dera e hapur e dyqanit ishte një këngë melançolike dhe e trishtuar. Ajo sikur tkurrej nga kontakti me ajrin e ftoshtë. Kur iu afroam vitrinës pamë një sërë disqesh me portretin e këngëtarit.

gëtarit bërë në vite të ndryshme. Ishte një djalë simpatik. Tani nuk ishte më. Kishte një muaj që kishte vdekur. Për vdekjen dhe ceremoninë e tij të varrimit folën dhe transmetuan gjithë radiot dhe televizorët e botës. Këngëtarë kishte qenë harruar për disa vite, ndërsa tani vdekja e kishte populuar përsëri.

— Ata duan të shfrytëzojnë vdekjen e tij për të shitur disqet stoqe. Nganjëherë vdekja qenka më me leverdi sesa jeta.

Këtë e kisha vënë re edhe vetë. Gati shumica e mbështjellësve të disqeve ishin të vjetra dhe të grisura o në cep o diku tjetër. Nga depot ato i kishte nxjerrë vetëm vdekja e këngëtarit.

— U lodhe? — më pyeti militanti.

— Jo, — i thashë. — Më pëlqen të ec nëpër rrugët e qyteteve të panjohura. Mund të ecnim për tërë natën sikur mos të na prisnin shokët.

Ne ecnim gjatë rrjedhjes së lumit. Era kishte nisur të vërvshëllente. Nëpër errësirë dëgjohej përplasja e gje-theve. Shumica e tyre binte mbi lumë. Dhe lumi i çonte në det duke i larguar nga qyteti i tyre. Në krahun e djathë tonin dritat nxirrin në pah vlerat artistike të një katedraleje të lashtë tërë kolona. Derdhja e tyre të kujtonte stalaktitet dhe stalakmitet e një shpelle.

— S'ka mbaruar akoma sesioni turistik, — tha militanti duke treguar nga katedralja e, si heshti pak, më vështroi në sy dhe shtoi: — Të lutem, si e shqiptoj fjalën «shok»? Dua të jem sa më i saktë në shqiptimin e saj.

Ai e kishte pak të vështirë shqiptimin e gërmës «sh», të cilën e zgjatte pak më tepër sesa duhej. Por edhe ai gabim i pranueshëm fonetik i jepte asaj fjale një forcë të veçantë. Kishte digka të vendosur tek ajo «sh» e zgjatur dhe e fortë. Militanti po priste mendimin tim.

— Ju e shqiptoni shumë mirë fjalën «shok», — i thashë.

— Nuk më bëni qejfin?

— Aspak.

— Është fjala e parë që kam mësuar në gjuhën e huaj. Mendoj që ajo të jetë pseudonimi im.

— Shumë mirë, — i thashë.

Kaluam një urë, e cila ishte në meremetim e sipër dhe u futëm në një rrugë plot drita dhe reklama. Shumica e tyre ishin emrat e pronarëve. Emrat ndizeshin dhe shuheshin sikur nuk e duronin praninë e njëri-tjetrit. Reklamat e firmave të vogla kishin një dridhje të lehtë, si mornica, sikur druheshin të binin në sy më tepër sesa duhej. Përsëri në vitrinën e një antikuari portreti i Hitlerit që vështronte nervoz reklamin e një firme të madhe prodhimesh kimike. Kur i kaluam pranë mua m'u duk sikur ai na shoqëroi me kokë. Pak më tej portreti i qetë i njërit prej kandidatëve për kryetar bashkë që premtonte për rregullimin e shërbimeve komunale.

Papritur, duke u rrokullisur erdhi dhe u ngjit në këmbët tonë një copë e grisur, ndoshta pankarta. Nuk e di si më vajtën sytë dhe lexova «Bota e tretë». Nganjëherë pata ndjesinë e besdissime sikur nëpër këmbë më ishte ngatërruar një qen i sqallur dhe i pistë. E godita fort e copa e pankartës shkoi dhe ra mbi karrocerinë e një veture.

— «Teoria e tri botëve», — i thashë militantit duke treguar pankartën.

— Do të ketë qenë ndonjë pankartë e oportunistëve, që e ka shkulur era, — tha ai.

Pastaj ne morëm djathtas dhe unë dallova nga larg dritat e hotelit.

— Sonte do të hamë bashkë darkë, — i thashë.

— Sonte jo, — tha ai, — më duhet të ndodhem pa tjetër në orën njëzet e një në shtëpi, — dhe, si më shtrëngoi fort krahun, shtoi:

— Domethënë edhe ty të pëlqeu pseudonimi im?

— Po, më pëlqeu.

— Dhe unë e shqiptoj mirë fjalën «shok»?

— Shumë mirë.

— Nuk më bën qejfin?

— Aspak.

— Falemnderit. Unë do të kem përherë me vete diç-ka nga vendi juaj.

Shokët më prisnin. Militanti u dha dorën dhe me gjithë këmbënguljen e tyre nuk pranoi të vinte me ne të hante darkë. Na dha dorën dhe u largua. Prita gjersa ai u kthye në qoshen e parë të rrugës. Para se të hyja në hotel m'u duk sikur era po rrokullite nëpër rrugë diçka, ndoshta ndonjë pankartë të grisur.

Shtyva derën e rëndë të hotelit dhe hyra brenda.

G L A U K O M A

Dëbora e fundit e vitit 1944 po vononte të binte mbi atë qytet. Po afronte Viti i Ri dhe asnjëherë nuk kishte ndodhur që ai të vinte pa dëborë. Prandaj banorët e atij qyteti e prisin me padurim rënien e saj.

Edhe për Norën, e cila kishte kaluar dimrat e ashpër të luftës në malet plot dëborë, pritja kishte diçka ngazëlluese dhe të paprovuar ndonjëherë. Ajo e dinte se dëbora fillonte zakonisht ndaj të ngrysur, prandaj, gjithmonë në atë orë, kur dielli perëndonte mes turbullirës së reve, mbështetëj pas dritares dhe priste. Ndonjë flok i shkëputur rebelisht nga retë rrrotullohej në ajér dhe era nuk e linte të zinte vend. Nora e ndiqte me sy dhe trishtohej kur filoku nuk pasohej nga të tjerë, por mbe-tej i vetmuar në hapësirën e dhjetorit. Si do të ishte ky dimër dhe ajo dëborë? Dhe Nora tha se dëbora e këtij dimri do të ishte ndryshe nga dëborërat e rëna viteve të

tjera. Ajo nuk e kishte parë këtë dëborë. Ajo e ndiente atë. Edhe qyteti nuk e kishte parë ndonjëherë këtë dëborë. Prandaj dhe pritja nuk ishte e zakonshme. Dhe, megjithëse dëbora që do të binte atë vit do të ishte ajo dëborë e zakonshme, si kishte qenë shekujve. Nora tha se dëbora e atij viti do të ishte dëbora e parë. Prandaj askush nuk e dinte si do të ishte ajo. Të gjithë vetëm e ndienin.

Nora qe matur të pyeste edhe atë mëngjes Nimetin, komisarin, por qe druajtur. Që kur mbaroi lufta ajo druhej të pyeste Nimetin. Habitej përsë ndodhëtë kështu. Asnjëherë nuk qe druajtur. Si femër, e kishte nuhatur se edhe Nimeti druhej para saj. Kur mbeteshin vetëm në zyrën e madhe dhe të ftohtë, ai nuk dinte ç'të bënte dhe mezi priste të gjente rastin për ta nisur me ndonjë punë. Ajo vinte buzën në gaz, kurse Nimeti skuqej. Pikërisht në zyrë, Nora vuri re se Nimeti ishte i ri, si një çunak. Ajo u turbullua kur mendoi kështu. Deri atëherë nuk e kishte vrarë mendjen të gjente se sa vjeç ishte Nimeti. Në luftë për të ai ishte komisar. Kurse tani ishte edhe një djalë njzetedyvjeçar. Ajo ngulte këmbë që ta shihte vetëm si komisar, por ishte e pamundur. Dhe përpiquej të sillej si në luftë. Dhe papritur humbiste në ëndërrime. Ishte nëntëmbëdhjetë vjeçe.

Kur u kthye Nimeti dita kishte zënë të thyhej. Ata dolën nga zyra ndaj të ngrysur. Qyteti nuk kishte dritë. Centrali i hedhur në erë nga gjermanët nuk ishte rregulluar akoma. Specialisti i vetëm punonte gjer vonë nën dritën e llambës me vajguri. Ai thoshte se do ta rregullonte centralin para Vtit të Ri. Edhe buka munconte e radha te dyqani i bukës bëhej e gjatë. Nimeti ngulte këmbë se ajo fshihej diku. «Diku» ishte një vend i zi. Kështu e përfytyronte Nora.

Rrugët po boshatiseshin. Njerëzit e rrallë që kalonin ecnin me nxitim. Dita thyhej shpejt. Nimeti ndezi një cigare. «Kur kishte filluar ta pinte duhanin Nimeti? Gjatë luftës?» Nora nuk e kishte parë ndonjëherë që ai të pinte duhan. Dhe asaj i erdhi keq që ai po e fillonte aq i ri. «Thonë se duhani i bën keq njeriut.»

— Ku humbe që në mëngjes? — e pyeti ajo Nimetin.
— Arrestuam një kriminel, që fshihej në disa gërmadha. Nuk dante të dorëzohej dhe plagosi Refikun në dorë.

— Po përse fshihej?

— Si përse fshihej?!

— Nuk e kishte marë vesh se lufta mbaroi?

— Ajo që do të mbarojë e fundit është lufta, — tha Nimeti i menduar dhe thithi cigaren.

— Ç'flet kështu? Po ne nuk u çliruam?

— E megjithatë prapë jemi në luftë. Krimineli kishte ndenjur dy javë i fshehur. «Do të rrija derisa të më harronit dhe pastaj do të dilja, — tha. — Pastaj e dija vetë se ç'duhej bërë.

— Po kush e mbante me bukë?

Nimetin mblodhi supet.

— Nuk na e tregoi. Hante bukë dëborë të bardhë.

Norës iu kujtuat dëbora që nuk po binte, por e hoqi menjëherë mendjen prej saj. Rruga ishte e errët. Ishte një rrugë e shkurtër, tërë vila dykatëshe. Dritaret nxinë dhe brenda vilave s'regëtinte asnje fije dritë. Njerëzit e tyre po flinin. Asaj nuk i pëlqeu që ato vila kishin rënë të flinin aq herët. Nuk i pëlqyen edhe grilat e ulura. Ato se ç'kishin diçka nga fshihja dhe pritja, diçka nga shtrëngimi i dhëmbëve. Nxitoi hapat.

Nimetin nuk e pyeti më gjatë. Kapota i ishte ngrënë te bërrylat, kurse mbi shpatull kishte një shenjë dje-gjeje nga ndonjë plumb i shkrehur pranë. E djegura ishte e re dhe kapota nuk e kishte pasur më parë. Nora vinte re edhe ndryshimin më të vogël që mund të pësonte Nimeti, që nga veshja e deri te rrudhat që shpesh i dilnin mbi ballë.

— Kthehu nga unë të të arnoj kapotën, — i tha Nora.

— Jo, — kundërshtoi butë Nimeti, — sonte kam punë.

Ajo nuk e pyeti se ku do të shkonte. Në këto raste ajo e shihte si komisar, megjithëse i duhej të mposhtte një shqetësim të çuditshëm, që nuk ishte kureshtje. Ai e përcollti deri te shtëpia ku flinte.

— Natën e mirë, — i tha dhe u largua me nxitim, si të fitonte kohën që i kishte marrë përcjellja.

Nora qëndroi te dera derisa Nimeti u zhduk në qoshen e rrugës. Ai ecte duke kërrusur pak shpatullat. Me rënien e natës temperatura ulej shumë dhe jashtë bënte ftohtë. Nora hyri në dhomën e saj. E zonja e shtëpisë i kishte vënë një mangall të ndezur në mes të dhomës. Nora piu një gotë çaj dhe u shtri. Era futej nëpër hatullat e shtëpisë dhe për tërë natën vërtitej aty dhe në rrugën e shkretë e të heshtur. Asaj i u kujtuan krimineli, buka e bardhë dhe vilat që flinin të zhytura në errësirë, si të donin të mbulonin diçka.

2

Të nesërmen Nora u çua herët dhe nuk nxitoi, si zaikonisht, drejt dritares, për të parë nëse kishte rënë dëborë gjatë natës. Mendimi i parë që i lindi ishte se Nimeti mund të ishte vrarë. Ajo nuk po mësohej dot me idenë se lufta nuk kishte mbaruar. Nora lau sytë te tulumbi. Uji ishte i ngrohtë dhe si i rëndë. Piu përsëri çaj dhe u nis për në punë.

Rrugët mezi zgjoheshin. Shtëpitë dremisnin akoma. Mëngjesi ishte i vrenjtur, por i butë. Nora kaloi përsëri nga rruga e shkurtër me vila. Kangjellat e lyera me bojë vaji ngjyrë hiri e bënin edhe më të ftohtë dhe më të fshehtë jetën e vilave. Gati të gjitha grilat ishin të ulura. Një dorë e padukshme ngriti grilën e dritares në skaj të shtëpisë. Ajo kërciti vajtueshëm dhe Norës iu duk sikur vilës i kërcitën kockat e kafazit të krahorrit. Ndaloj dhe pa e kuptuar u bë kureshtare të shih-te dorën që e ngriti. Për një të dhjetën e sekondës, gati me shpejtësinë e ëndrrës vështrimi i saj ndeshi në vësltrimin e errët të një vajze flokëverdhë. Dhe iu duk sikur u ndesh për herë të parë me urrejtjen. Nuk e

mendonte se pas luftës, një mëngjes dhjetori, do të haste vështrimin e errët dhe përbuzës të një vajze flokëverdhë. Vajza lëshoi perdet e rënda dhe vetëm lëkundja e tyre tregonë se pas tyre fshihej një njeri.

Norës iu kujtua beteja e parë... Në pauzën midis të shtënave ajo kishte hasur në vështrimin e një ushtari gjerman të plagosur. «I njëjti vështrim», mendoi Nora dhe u largua. Megjithatë vështrimi i vajzës e ndoqi pas e nuk e la të qetë edhe në punë.

As Nimetit nuk i tregoi gjë. Ai e pyeti disa herë se ç'kishte që rrinte ashtu, por Nora i tha se natën e kishte lënë pa gjumë era që vërtitej hatullave. Nimeti hëngri bukë në këmbë dhe u mis për në një fshat, ku do të kalonte dhe natën. Ngriti jakën e kapotës dhe, kur pa se Nora ia kishte mbërthyer sytë supit të grisur, qeshi dhe i tha se do të gjente kohë për ta arnuar.

Në darkë Nora u kthye vetëm në shtëpi. Rruga e shkurtër me vila flinte me grilat e puthitura mirë, si të donin të vinin në dulkje indiferentizmin dhe neutralitetin e tyre karshi gjithçkaje që ndodhje jashtë në rrugë, përtëj kangjellave të lyera me bojë vaji gri. Rreth e rrotull ishte aq qetë, sa Norës iu duk sikur po ecte në një ambient të izoluar nga zhurmërat dhe era. Vetëm këpucët e saj të rënda prishnin heshtjen e rrugës si tiktaku i një ore të madhe muri. Askush nuk lëvizi grilat. Dhe Nora mendoi se vështrimi i mëngjesit mund të ishte një fanitje e shkaktuar nga nata.

— E zonja e shtëpisë ku flinte e priti, si zakonisht, me dhembshurinë e nënës. Mangalli përhapte nxehësinë e tij dhe Nora nuk donte të flinte aq shpejt.

— Po rri pak me ju, — i tha së zonjës së shtëpisë.

E zonja e shtëpisë ishte e vetme. I shoqi i kishte vdekur në Australi, në kurbet, kurse i biri kishte kaluar me brigadën e tij në Jugosllavi.

— A kemi ndonjë lajm nga djemtë? — pyeti ajo Norën.

— Luftojnë akoma.

— Si nuk po mbaron edhe andej lufta! Si shumë zgjati!

- Do të mbarojë. Nika, do të mbarojë.
- Ashtu është, po ku na durohet neve nënave.
- Sa të vijë, me siguri që do ta fejosh?

Nika tundi kokën dhe ajo tundje koke shprehte më mirë se çdo fjalë lumturinë e saj të thjeshtë. Dhe Nora mendoi se nënati mund t'i prekësh shumë shpejt, mjafton t'u kujtosh dasmën e fëmijëve. Pastaj mendoi se edhe ajo vetë e kishte kohën për t'u martuar. Dhe pranë Nikës nuk i erdhi rëndë që po mendonte për martesën e saj. Tërë qenia e asaj gruaje përhapte në dhomë qetësinë dhe shtytjen për të menduar për vetveten. Përtej dritares nuk dulkej gjë. Ora e tavolinës punonte në një ritëm me zhurmën e zjarrit. Qetësinë e bënte edhe më të thëllë ideja se lufta s'kishte as një muaj që kishte mbaruar. Dhe, apo mendoi këtë, Norës iu shfaq si në një montazh të shpejtë, hapja e grilave si skeleti i kafazit të krahaporit, vështrimi i errët i një koke bionde, kapota e çarë nga plumbi në sup e Nimetit dhe ecja e tij rrugëve të fshatit të largët dhe të panjohur. Asaj iu duk sikur ecjen e tij e përgjonte diçkush dhe instinktivisht ktheu kokën nga dritarja. Edhe nata përtej dritares dukej si e habitur me atë qetësi që kishte rënë, pas tërë atyre netve të mbushura me shqetësimë, pritje dhe krisma.

3

Dita po fekste e zbehtë përtej perdeve prej pambuku të punuara me grep nga Nika qëkur ishte vajzë, xhamat ishin veshur me avull. Nora hapi sytë dhe iu duk sikur brenda në dhomë ishin dyndur mjegullat e dhjetorit. Ferkoi sytë. Mjegulla mbeti e dendur në dhomë dhe sikur u mblozh shtëllunga-shtëllunga. Nuk e mbajti mend sa vazhdoi kjo gjendje, po më pas gjithçka iu qartësua. Në dhomë regëtinte zbehtë drita e mëngjesit. Nora nuk e kuptoi dot se ç'ndodhi ashtu më të.

Nuk kishte ndier ndonjë shqetësim nga sytë deri atëherë. Bile ajo shquante shtegtimin e dallëndysheve aq larg, gjer kur treteshin dhe bëheshin pjesë e horizontit.

Nika, si zakonisht, ishte çuar herët dhe po mbushte ujë te tullumbi. Gërvishtja e tij e çjerrë qe bërë e njo-hur për Norën dhe ishte mësuar ta priste ditën e re me të. Pastaj Nora dëgjoi ndjelljen e pëllumbave dhe përplasjen e krahëve të tyre, që i përkëdheleshin lehtë diellit të asaj dite të ftohtë dimri. Ajo donte të rrinte sa më gjatë shtrirë, në çarçafët që kishin thithur nxeh-tësinë e trupit të saj. Vuri duart nën qafë dhe zuri të luante me një tufë flokësh që i binte mbi sy. Dhe iu kujtua Nimeti. Në cilin fshat do të shkonte? S'e kishte dëgjuar herë tjetër emrin e fshatit. Prandaj ai iu duk i largët, i panjohur, i mbuluar nga një dëborë krejt ndryshe nga e zakonshmjë. Ai ecte mes rrugëve që të sillnin drejt qytetit dhe, sado që kapota e tregonte më të madh sesa ishte, Nora shihte sytë e tij të kaltër që s'e fshihnin dot moshën e tij. Bile Norës i dukej sikur vetëm ajo ishte në gjendje ta kuptonte këtë gjë. Kjo i gudulisi gjoksin dhe vështroi rreth e rrrotull mos e pa ndokush...

Kur filloj punën e harroi mjegullën që i rëndoi sytë dhe i errësoi shikimin. Edhe ylberëve rreth flakës së drurëve që digjeshin në sobë muk'u vuri rëndësi. Në drekë, së bashku me një skuadër partizanësh shkoi dhe arrestoi në shtëpinë e tij një bashkëpunëtor të gjermanëve. Kur i hodhën prangat në duar, ai u drodh dhe iu prenë fuqitë. Nuk mundi të lëvizte këmbët për të kapërcyer pragun e shtëpisë. E ndihmuani dy partizanë. Njerëzit e shtëpisë e vështruan me përbuzje Norën. Rrugës i ndoqi prapa një tufë fëmijësh. Në zyrë po i priste Nimeti. Sytë i kishte të skuqur nga pagjumësia dhe lodhja. Norën e preku çehrja e tij.

— Nuk po pushon asnjë minutë, — i tha me zë të ulët. — Në mal ishe më pak i zënë.

Nimeti qeshi.

— Ke filluar të arrestosh njerëz, — i tha.

— S'është ndonjë trimëri e madhe, — iu përgjigj Nora.

— Si duket e patët lehtë?

— Po. As që kundërshtoi. Megjithatë mua nuk më pëlqeu qetësia e tij dhe e njerëzve të shtëpisë.

— Përse nuk të pëlqeu?

Nora mblohdhi supet. Nimeti, si të mos e kishte pyetur pak më parë, u përgjigj vetë:

— Ata shpresojnë se kjo është e pënkohshme dhe nuk do të vazhdojë gjatë. Dhe deri sa ata shpresojnë kjo do të thotë se ne jemi në luftë. — Nora heshti dhe i hodhi dru sobës. Kur ato u ndezën, Nora ia mbërtheu sytë flakës. Nimeti u shqetësua kur e pa ashtu të përqëndruar.

— C'shikon ashtu? — e pyeti.

— Ylberët mbi flakë.

— Ylberë?!

— Pse, ti nuk i shikon?

Nimetë përvëç flakës së zakonshme nuk dallonte gjë tjetër. Ai mendoi se Nora duhej ta kishte nga lodhja ose nga emocioni i arrestimit.

— Po, po, tani i shoh. Qenkan me të vërtetë të bukur.

Por Nora e kuptoi se ai gënjente dhe për herë të parë i dha rëndësi mjegullës që iu shfaq në mëngjes.

4

Nora priti që mjegulla të shkaktohej edhe mëngjesin tjetër, por nuk ndodhi asgjë. Përkundrazi, ishte aq e qetë dhe vështrimin e kishte aq të pastër, sa pa edhe pikat e shiut në xham, që rrëshqisnin duke lënë një vijë të gjatë, të hollë dhe të shtrembër. Kur doli në rrugë shiu ishte kthyer në llohë. «Me siguri që sot do të bjerë dëborë», mendoi. Rruga ishte pa njerëz. Ajo e përfytyroi të zbardhur nga dëbora. Po afronte Viti

i Ri. E për herë të parë ndarja e viteve e mbushi me një gëzim të prekshëm. Dhe Nora mendoi se kjo vinte nga prania e asaj ndjenje të fuqishme, Lirisë. Ishte një ndjenjë që, po lindi një herë te njëriu që, po e jetoi një herë, zor se i ndahet. Kjo nuk ishte thjesht përvoja e saj. Dhe ajo ndjenjë kishte ende antipodin e saj. Kapota e Nimetit, e grisur në sup nga plumbi, vrasja e partizanit Vexhi kur ruante fabrikën e vogël të mëllit, mugesa e bulkës, fshehja e mallit, vështrimet e egër, kërcenimet e ndrydhura nga frika, ishin copërat e saj, thërrimet e saj, që ajo donte t'i mblidhte shuk. Por prania e tyre theksonte akoma më shumë Lirinë, që Nora i gjëzohej me gjithë zemër.

Ajo nuk vuri re fare se si u ndodh në zyrë. Kur shikoi dorën mbi flokë, pa se ata ishin të qullur. Soba ishte e ndezur dhe ajo afroi kokën të thante flokët. Pastaj pa zjarrin dhe i erdhi keq që nuk u shfaqën përsëri ylberët e vegjël mbi gjuhët e flakëve.

Shiu me llohë përzier nuk vazhdoi gjatë. Retë u ngriten akoma më lart mbi qytet dhe aty qëndruan tërë pasditen. Banorët e atij qyteti, që e nuhatnin dëborën ditë më parë, nuk ishin të sigurt për ngarkesën e reve.

Të nesërmen Nora përvëç mjegullës pati dhimbje të forta në sy, aq sa kërceu shpejt nga shtrati sepse i erdhi për të vjellë. Qëndroi ashtu pa lëvizur disa çaste pastaj, duke kërkuar me hamendje murin, zuri të ecte. Eci deri te dera dhe thirri Nikën. Nika u tremb kur e pa ashtu, të hutuar dhe me vështrim të papërcaktuar, si një të venbër. E kapi për dore dhe e shtriu në shtrat. Mjegulla filloi t'i davaritej. Kështu davaritej edhe mjegulla e pranverës luginave, maleve. Nora nuk do t'i haronte kurrë mëngjeset e maleve. Në fillim shfaqeshin majat, pastaj shpatet, pastaj përenjtë e bardhë. Tutje pylli me pisha derdhët vesën nga dremitja e tij. Në cep të pyllit bari i përkulur ngrinte sqepin e tij sikur donte të ngopej me dritën e diellit. Në ajër dëgjohej një muzikë e lehtë, që sa më shumë ta dëgjoje aq më e pakapshme bëhej ajo. Nora vinte veshin por, përvëç rrahjeve të zemrës së saj, nuk dëgjonte gjë tjetër. Dhe

përséri ishte e bindur që, pavarësisht nëse e dëgjonte apo jo muzikën e fyellit, ajo ishte e pranishme kudo.

Dhembjë e kokës po i lichtësohej, por vështrimi sikur i mbeti shtrënguar pranë fillimit të hundës. Nga kjo i dukej sikur ishte në një grykë të ngushtë mali. Në cilën grykë? Në Skrapar? Në Kurvelesh? Jo, gryka e Mezhgoranit është më e gjerë. Në Ostrovicë apo në Tomorr? Gryka ishte aq e ngushtë, sa mjaftonte një copë shkëmb i dalë si sqep apo ndonjë dru i mbirë në shkëmb që të pengonte dritën e diellit. Ja, gryka u errësua krejt. Kush e zuri diellin? Ajo ndjeu të dridhura sikur ndodhej në një grykë tërë korrente erë-rash.

— Po të hipën prapë të nxehjtët, — tha e shqetësuar Nikë dhe hoqi dorën nga balli i Norës.

Megjithëse Norës iu duk sikur mbi grykën e ngushtë, ra përséri dielli, kjo nuk ia lehtësoi vështrimin që i mblidhej e i mblidhej pranë hundës. U çua me nxitim, hapi dritaren dhe volli.

— Bobo, do të ftohesh! — tha Nikë dhe i hodhi supeve një triko të trashë leshi. — Mbylle shpejt dritaren, se e more plevitin.

Po Nora e ndiente veten më të lehtë dhe nuk lëvizi nga dritarja.

— Dëgjon, apo u shurdhove?! — bëri sikur u nxeh Nikë.

Nora ktheu kokën nga ajo dhe i buzëqeshi. Pastaj u kthye nga dritarja dhe nuk ngopej së mbushuri gjoksin me frymë. Asaj i bëri përshtypje dëbora që kishte mbuluar oborrin dhe çatitë, kurse Nikës ngjyra e kuqe e syve të Norës.

nuk ia tregoi këtë gjë Nikës dhe aq më pak kishte ndër mend t'ia tregonte Nimetit. U përpoq të ishte sa më e qetë ndonëse, kur pa që Nimeti nuk ia ndante sytë, u trondit.

— Përse më shikon kështu? — tha ajo dhe u përpoq të buzëqeshte.

— Ti nuk je mirë, — tha Nimeti.

— Ka vjellë dy herë, — tha Nika.

— Përse nuk më lajmërove? — tha Nimeti.

Nora e ndjeu se ai mundohej të fliste prerë, sikur jephte urdhra, por zëri sepse i dilte ndryshe, më i butë. Edhe ftyra nuk ishte aq e tendosur. Nora dëgjoi Nikën që i thoshte Nimetit ta çonte te mjeku. Ajo tha edhe emrin e mjekut, por Nora nuk e kapi dot. Ishte një emër i gjatë dhe me një tingull të huaj.

— Kjo nuk rri as shtrirë, po bën ç'bën dhe del në dritare, sikur nuk u ngop me dëborë në mal!

Nora qeshte e lumtur me fjalët e Nikës dhe priste që edhe Nimeti të qeshte, por ai rrinte serioz.

— Vishu, të shkojmë te doktori! — tha ai prerë dhe ashpër.

Nora u çua instinktivisht ndenjur mbi shtrat. Nimeti e kuptoi pak vonë se duhej të dilte nga dhoma dhe i erdhi rëndë. Ai doli në korridor. Po errej dhe era që frynte nga veriu e përplaste dëborën pas xhamit të derës me një vërsħelli më të hollë dhe të mprehtë. Ajo vërtitej në rrugën para shtëpisë dhe nëpër tèrë qytetin, duke kërkuar të çarat e mureve, tavaneve, dritaret pa xama. Urisë i shtohej edhe të ftohtët. Nimeti vërtitej nëpër korridor dhe dëgjonte erën. S'kishte kaluar as edhe një vit nga Operacioni i Dimrit dhe ja ku po fillonte një dimër tjetër i ashpër. Atë e shkëputi nga mendimet kërcitja e menteshave të derës. Nora ishte bërë gati.

— Kot që të vemi te doktori. Ndoshëta kalon vetë,

— tha ajo.

Nimeti nuk iu përgjigj por zbriti shkallët. Nora e ndoqi pas. Nika i përçolli deri te rruga.

Nora rëndonte mbi dëborë dhe nuk i gjëzohej zhur-

mës së saj të butë. Ndonjë kalimtar që shkëmbehej me ta rrugës i përshëndeste me grusht. Dhe ata ia kthenin përshëndetjen të panjohurit. Në atë qytet ata njihnin shumë pak njerëz e përsëri u dukej si kur kishin kohë aty. Deri te rruga kryesore ecën pa folur. Aty kishte më shumë lëvizje. Banorët bënин shëtitje. Nora shikon te njerëzit, sidomos çiftet që shëtitnin dhe pastaj i hidhte sytë me kujdes mos e kapte Nimeti. Ai nxiton. Kushdo e kuptonte se ata të dy nuk kishin dalë për shëtitje. Nga mesi i rrugës Norës iu errën sytë dhe për pak u rrëzua.

— Ç'ke? — i tha Nimeti.

— M'u errën sytë, por më kaloi.

Ajo u përpooq të nisej por, sa hodhi dy hapat e para, ndaloj. Edhe Nimeti qëndroi.

— Nuk eci dot, — tha Nora, — më lëshojnë sytë xixa.

Nimeti vështroi njerëzit që shëtitnin me nge dhe si me inat tha:

— Mbështetu tek unë!

Nora i hodhi dorën me druajtje. Metrat e parë i bënë gati të turbulluar. Të dy habiteshin përsë të ndodhët që të turbullohen kështu. Në mal kushedi sa herë ishin mbështetur te njëri-tjetri dhe asnjëherë nuk kishin provuar një turbullim të tillë. Mos kjo ndodhët ngaqë lufta kishte mbaruar dhe ata nuk mund të sille-shin dhe të mbështeteshin te shoku-shoku si atëherë? Kjo do të ishte e palbesueshme dhe pa kuptum. Midis tyre nuk kishte ndodhur gjë. Ata ishin njëlloj shokë. Nimeti ndjeu që Nora u mbështet akoma më fort. Ai u habit kur vuri re se edhe kureshtja e njerëzve u zvogëluar kur i shihnin të dy përkrahu. Siç dukej po i mirrin për të martuar. Kjo, në vend t'i turbullonte akoma më shumë, u përhapi nëpër trup një gëzim të lehtë dhe ata të dy mbetën si të ngrirë kur u ndodhën para portës së shtëpisë së mjekut. Mbi një pllakë të bardhë ishte shkruar «Dr. Epaminonda Sojnuri. Patholog. Diplomuar në Berlin». Përtej derës prej hekuri shtrihej një rrugë e ngushtë, e cila të çonte drejt e në

verandën e shtëpisë. Në të dyja anët e rrugës ishin lulishtet, me nga një mollë në mes, mbi degët e të cilave kishte ngrirë dëborë. Rrëzë lulishteve ngrivej një bordurë çimentoje mbi të cilën në pranverë, me sa dukej, vendosnin vazot e luleve. Dëbora ishte shkelur në vende të caktuara, sikur dikush të kishte shënuar vendet nga duhej kaluar. Nën dritën e varfër të asaj mbrëmjeje, e cila kishte vetinë t'i bënte gjérat të dukeshin më të largëta sesa ishin në të vërtetë, ajo shtëpi ngjante e veçuar më tepër sesa duhej nga shtëpitë e tjera. Xhamat bojë qumështi të dyerive të verandës linin të shihej një dritë e zbehtë, që mezi depërtonte trashësinë e tyre. Edhe ajo dritë e bënte edhe më të panjohur e të ftohtë jetën që fshihte brenda. Dritaret ishin të mbyllura dhe me perde lëshuar. Ngaqë gjithçka ishte e puthitur mirë, ajo shtëpi të linte përshtypjen sikur kishte shpallur veçimin nga jeta e qytetit dhe turbullira e kohës.

Ata të dy shkëmbien nga një vështrim të hutuar dhe u ngjau sikur kishin ardhur gabimisht deri aty. Por Nimeti e mbloodi i pari veten dhe i ra derës me forcë. Trokitjen sikur e thithën xhami bojë qumështi dhe perdet e rrëzuara. Pritën. Nga brenda nuk u ndje asnjë reagim. Heshtja rëndoi mbi hapat e rregullt në dëborë. Nimeti trokiti përsëri. Këtë herë nuk e përbajti dot nervozizmin. Përsëri trokitja e tyre mbeti e shurdhët dhe distanca nga dera e hekurt deri brenda në sallon, ku regëtinte dridhëse drita, sikur u zgjat e u zgjat më në thellësi të mbrëmjes.

— Vallë, ka njeri? — tha Nora.

— Duhet të ketë, — tha Nimeti. — Gjurmët mbi dëborë janë të freskëta.

Gjurmët mbi dëborë... Nora kishte dy vjet që shkelle mbi to. Gjurmët treteashin horizonteve dimërore si një varg patash të egra... Ku u gjakosën patat e egra?... Gjurmët kishin çarë nëpër një mot të vështirë, të trazuar plot rrryma të ftohta polare... Fluturimi i tyre tretej dimrave të maleve, luginave, fshatrave... Nora shikonte gjurmët mbi dëborën e atij oborri dhe sepse ato ia bënë të huaj shtëpinë që dremiste. Nimeti trokiti përbënë të huaj shtëpinë që dremiste.

sëri fort, sikur donte ta shkatërronte derën. Dhe ata do të ishin larguar po të mos ishte ndezur drita e sallonit. Në fund u hap dera e verandës dhe në sfondin e saj u shfaq një grua e moshuar, e kërrusur. Ngaqë drita i binte prapa, gruaja dukej si një presje e kthyer mbrapsht. Ajo nxitoi duke shkelur me shkathtësi, pa prishur rregullsinë e gjurmëve mbi dëborë. Qëndroi disa metra larg derës dhe që aty pyeti:

- Kë kërkoni?
- Doktorin. Kjo shoqja është sëmurë.
- Doktori nuk bën sot vizita. Është e diel.
- Po a është në shtëpi? — pyeti Nimeti, që kishte humbur edhe pikën e fundit të durimit.

Gruaja u mendua dhe ngurroi të përgjigjej. Ajo u përtyp dhe nuk po ua ndante sytë. Ishte midis dy frikërave, midis frikës nga këta dy njerëz të panjohur dhe frikës së mjekut. Trupi i saj u mblodh akoma më shumë, sikur presja donte të shndërrohej në pikë.

- A është doktori në shtëpi apo jo? — pyeti përsëri Nimeti.

Gruaja u përtyp dhe tha:

- Po.
- Atëherë përse nuk e hap derën, ta marrë djalli!?
- Po sot është e diel dhe doktori me zonjën do të dalin për vizita te të njohurit, — tha gruaja me frikë.
- Le të dalë më vonë.
- Po të dielave doktori nuk ka vizituar kurrë të sëmurët... në këtë orë!

— Le të vizitojë sot, por hape derën...

— Sa të marr pak çelësin, — tha gruaja dhe nxitoi për të hyrë brenda. Ajo nuk shikonte ku shkelte dhe gjurmët mbi dëborë humbën rregullsinë e tyre të ftohtë dhe të çuditshme.

— C'njerez! — tha Nimeti dhe futi dorën kot në xhep. Ajo i kapi paketën e cigareve dhe ai e ndezi pa e pasur mendjen.

Gruaja u shfaq përsëri si një presje, mbi sfondin e bardhë të dëborës.

— Hyni, — tha ajo duke hapur derën me një çelës të madh. — Doktorit iu prish pak qejfi.

— Punë e madhe, — tha Nimeti dhe flaku bishtin e cigares,

Ata hynë në një korridor të gjerë dhe gjysmë të errët. Në mes ishte një tavolinë e rëndë, e zezë, me një vazo të madhe porcelani tërë figura të quditshme dragonjsh dhe lulesh. Në të dyja anët e sallonit kishte kolktukë të veshur me lëkurë të zezë. Në mur vareshin dy tablo. Njëra paraqiste Dianën në një çast pushimi buzë një burimi. Ajo ishte krejt lakuriq. Nora apo e pa i hoqi menjëherë sytë prej andej dhe i erdhi turp që kishte pranë Nimetin. Nimeti mblodhi buzët dhe Norës iu duk sikur ai do të pështynte mbi tablonë. Tabloja tjetër ishte një peisazh i trishtuar dhe i zymtë. Në cepin e një pylli, buzë një pellgu, nën kërcënimin e disa reve të dendura plot shtrëngatë, ngrihet kambanorja e një kishe të vjetër, me kryqin e shtrembëuar nga koha. Rreth kishës, të vithisura e të rrëzuara, sikur po thi-theshin vazhdimiشت nga toka, kishte varre. Ishte një mbrëmje dimri e vrenjtur, ku drurët e zhveshur ngjannin me duar lakuriq që zgjateshin drejt diellit që kishte perënduar, si klithma të një dëshpërimi të pashpresë dhe të thellë. Mbi pemën më të lashtë buzë pellgut po ulej edhe sorra e fundit. Klithma e saj përhapej mbi peisazh si një makth i pafund. Nimeti nuk e kuptonte përsë ishin vënë ato dy tablo aq të kundërtat përballe njëra-tjetrës. Për të treguar se gjëzimi i Dianës do të përfundonte mes atyre varreve që po vithiseshin, apo pér të thënë se mbi jetën e njeriut, si një ankth, vërtitet e vërtitet kënga e çjerrë e sorrave? Sido që të qe, ato dy tablo e bënin atmosferën e sallonit të padurueshme dhe cinike. Atë sallon, ku uteshin përditë të sëmurë. Gruaja e kërrusur i la vetëm dhe u zhduk në njérën prej dyerve të sallonit.

— Kot erdhëm, — tha Nora me zë të ulët.

Nimeti nuk foli dhe nuk dinte ç'të bënte pér të mposhtur inatin, që sa vinte dhe e ndiente se po e përmbante me zor. Ai nuk donte të bënte skandal. Ai e urren-

te atë sallon me ato dy tablo aq tē poshtra. Ai tha pikërisht tē poshtra. Në dhomën ku hyri gruaja nuk pipëtinte as zhurma më e vogël. Në sallon dëgjohej vetëm tiktaku i orës së madhe tē murit, lavjerrësi i së cilës lëkundej e lëkundej. Ai fshihej dhe dilte pas dy shufrave druri, që mbanin xhamin sïkur luante kukafshehtas me ata tē dy. Në fund lavjerrësi kishte një peshë tē rrumbullakët, tē nikeluuar, që ngjante si një sy i madh idioti që vetëm habitej. Qdo dalje e tij ishte një sekondë. Dhe ai dilte vazhdimit midis shufrave dhe vazhdimit habitej. Dera nga ku u largua gruaja qëndronte e mbyllur. «Ata po provojnë nervat tanë, — mendoi Nimeti. — Po hakmerren për prishjen e zakonit tē vjetër dhe tē rregullit.» Nimeti u kollit me tē madhe. Kolla e tij mbyti tiktakun e orës së murit. Kërciti dera. Doli gruaja.

— Urdhëroni, — tha ajo.

Ata hynë në një dhomë tē gjerë plot dritë, me një krevat me lëkurë tē zezë dhe me një tavolinë në mes. Në tavolinë, me duart përparrë rrinte mjeku. Ishte një burrë reth tē dyzetepesave, me syze me skelet tē bardhë, tē holli, poshtë tē cilave vërtiteshin dy sy tē vegjël dhe depërtues. Flokët i kishte krehur anash dhe ndarë me vijë. Tamam si në kartolinat italiane, ku burrat më shumë se burra ngjanin si gra. Mjeku, si u hodhi një vështrim tē shpejtë, i uli po aq shpejt sytë, duke ia mbërthyer diçkajë mbi tavolinë. Heshtje. Si në sallon. Presioni. «Ai do që ne t'i lutemi. Në këtë dhomë njerëzit kanë folur me zë tē përvuajtur dhe ilutës. Në këtë dhomë kanë sunduar pushteti i këtij njeriu me syze tē holla dhe i sëmundjes». Bile Nimetit iu duk se këto dy pushtete ishin shkrirë në një tē vetëm dhe sïkur ishte futur te sytë depërtues dhe tē ftohtë tē mjekut. Edhe gruaja qëndronte si e ngrirë. Mjeku vazhdonte tē heshtte. As Nora dhe as Nimeti nuk ishin vizituar ndonjëherë te mjeku. Ishin tē rinj dhe tē shëndetshëm. Të dy, në fillim u hutuan si mund tē hutohet një njeri që hym padashur në një institucion pa i ditur rregullat. Ata nu është dinin se kush e prishte heshtjen i pari në këto raste. Nga qëndrimi i mjekut kuptohej se heshtjen duhej ta prishnin

pacientët. Dhe ky duhej të ishte një nga rregullat e shumta të asaj shtëpie.

— Kemi ardhur për t'u vizituar, doktor, — tha Nemeti duke u afruar ngjitur me tavolinën.

Mjeku ngriti kokën. Ky nuk ishte zëri lutës i patientit apo i njeriut që shoqëronte patientin. Zëri ishte i ashpër dhe imponues. Mjeku u përpoq të sillej sikur nuk e vuri re gjaknxehtësinë e djalit me kapotë të vjetër. Ai vuri buzën në gaz, apo më mirë lëvizi buzët duke i mbledhur pak anash, nga e majta.

— Sigurisht, — tha mjeku duke iu përgjigjur me vonesë Nemetit. — Në shtëpinë e një mjeku trokitet vetëm për t'u vizituar. Bile mund të trokitet në çdo kohë, sepse sëmundja tregon edhe shpirtin egoist të njeriut.

Përsëri buzët e mjekut u mblohdhën pak anash, nga e majta.

— Nuk e di se si mund të ndikojë në gjendjen e një të sëmuri kjo pritje, — tha Nemeti. — Apo mos edhe kjo hyn në metodën tuaj të diagnostikimit.

Mjekut siç dukej i bëri përshtypje përgjigjja e Nemetit prandaj, si ngriti me gishtin tregues skeletin që i kishte rrëshqitur mbi kurrizin e hundës, tha:

— Më falni që po ju pyes, çfarë keni punuar para se të dilnit malit?

— Po ju, doktor, në q'moshë e keni filluar punën?

— Në moshën njëzet e gjashtë vjeçë, — tha mjeku, i hutuar nga pyetja e papritur dhe e çuditshme.

— Ashtu, — tha Nemeti. — Atëherë nuk e kuptoj përsë më pyesni kur nuk i kam mbushur akoma të njëzet e dy vjetët. Apo ngjaj më i madh?

— Jo, — tha mjeku i shqetësuar dhe tërroqi cepat e buzëve nga e majta.

Jashtë duhej të qe errur fare.

— Kush është prej jush i sëmuri? — pyeti mjeku përsëri me një zë autoritar. Tani ai ishte pushteti i asaj dhome.

— Unë, — tha Nora.

— Mirë, — tha mjeku. — Pavarësisht se jeni partizanë, në këtë dhomë të gjithë janë njëlloj. Këtë rregull

nuk e kam vënë unë por vetë sëmundja, që prek të mirët dhe të këqinjtë. Sa do të më paguani?

Zëri i tij Nemetit i ngjau si krrakaritje sorre.

— Nuk ju kuptoja, — tha Nemeti.

Mjeku e ndjeu se e kishte filluar keq bisedën dhe u përpinq ta zbustë përshtypjen e parë. Gjersa midis tij dhe pacientit kishte hyrë papritur habia për pagesën, diçka kishte rrëshqitur nga rregullat e para, diçka që, pavarësisht se atij nuk i pëlqente, duhej ta merrte parasysh.

— Eshfë fjala për pagesën e zakonshme pas çdo vizite, — tha mjeku. — Ju e kuptioni edhe vetë. Eshfë mjeti i vetëm me të cilin jetoj. Sikurisht juve nuk do t'ju kërkoj sa do t'i kërkoja tregtarit më të pasur të qytetit. Ju apo jeni ikthyer nga malet, nga lufta...

Mjeku heshti për të parë se ç'përshtypje lanë te Nemeti fjalët e tij. Dhe, kur pa se tjetri e vështronë si i hutuar, e gjeti të përshtatshme t'i tregonte këtij djali me kapotë të shqepur në sup se ndoshta diçka kishte ndryshuar në këto ditë, përveç rregullsisë së përjetshme të pagimit për vizitën, përveç pushtetit të parasë.

— Në goftë se nuk më paguan askush, atëherë mua më duhet të zë ndonjë qoshe te sheshi i qytetit dhe të zgjas dorën për lëmoshë. Prandaj nuk bëj ndonjë gjë të jashtëligjshme në goftë se kërkoj atë që më takon.

— E çfarë doni? — tha Nemeti, që po e humbiste durimin.

— Mos më keqkuptioni, ju lutem, me ju po sillen si me të gjithë pacientët. Në këtë dhomë të gjithë janë të barabartë si kurrkund tjetër.

— Mirë, mirë. Sa bën vizita?

Mjekun e ikapi papritur dëshira ta fyente krenarinë e këtij djali.

— Nuk e di sa keni ju. Po sikur edhe një flori të më jepnit, bereqaversën. Në këtë botë të paqëndruesh-me floriri është i pérhershëm.

— Ne nuk kemi florinj, — tha Nemeti.

— Ashtu! — mjeku u përpinq të vinte buzën në gaz.

— Po atëherë çfarë keni?

— Këtë, — tha Nimeti dhe përplasi revolen mbi tavolinë. — Dhe po nuk e shëruat do të përgjigjesh me kokë!

Mjeku nuk ia ndante sytë grykës së revoles dhe i dukej sikur nuk fliste Nimeti por ajo. Ai u përpoq të zbutë atmosferën, megjithëse e kishte vështirë të kuptonte se ç'po ndodhët në atë dhomë, ku të gjithë kishin pasur një fytyrë. Deri atëherë ai kishte pasur forcën e padukshme të vdekjes, që ishte forca më e pamposhtur. Ndërsa ky djalë u hoq mospërfillës para kësaj force të verbër dhe të pamëshirshme. Për herë të parë mjeku e kuptoi se ndodhej midis dy epokave, megjithëse vdekja kishte pasur përherë një epokë: epokën e zyrtë të harimit dhe të së panjohurës.

— Më falni, — tha mjeku, — sot nuk kam qenë mirë, më falni. Nga se ankoheni, ju lutem?

Ky ndryshim i papritur e bëri edhe më të nevertitshme fytyrën e tij. Ai filloi të shikonte sytë e Norës dhe të pyeste me hollësi se si iu shfaq sëmundja dhe çfarë shenjash kishte. Vizita vazhdoi gjatë. Më në fund mjeku u ul në tavolinë. Nën xhamat e syve lëvizte një dritë e mugët, e ftohtë. Megjithëse revolja e pengonte të rrinte lirshëm në tavolinë, ai nuk e preku me dorë. Shkroi shpejt e shpejt recetën dhe ia zgjati Nimitet.

— Nuk ka asgjë shqetësuese, — tha ai. — Do ti kalojë me kohë. Ju lutem, më falni dhe besoj se ky takim nuk do të krijojë mendim të keq përmua.

Nimeti mori recetën dhe pastaj revolen. E futi në këllëf.

— Shkojmë, — i tha Norës.

Kur po dilnin nga dhoma mjeku u tha:

— Ju lutem, të vini përsëri pas një javë.

Në sallon po i priste një grua e bëshme, me një fustan të bulkur dhe të puthitur mirë pas trupit. Në dorë mbante një servis të shtrenjtë me disa gota të kristalta pijesh dhe me filxhanë prej porcelani të holdë japonez, që avullonin. Nimeti e kuptoi se ajo kishte përgjuar prapa derës dhe për të zbutur përshtypjen që

mund të kishte lënë i shoqi donte të sillej sa më mi-rë dhe sa më e dashur. Gruaja kishte një buzëqeshje joshëse dhe dy sy ngacmues.

— Urdhëroni pini nga një konjak me kafe, — tha ajo. Kur foli gruaja përdrohhi belin e hollë dhe vi-thet.

Nimet e pa me inat dhe as që foli. Diana laku-riq buzë burimit sikur mbeti e habitur. Nimeti hapi derën e sallonit dhe doli jashtë i pari. Pas tij Nora. Ata nuk e kthyen kokën të shikonin ngurosjen e nje-rëzve të asaj shtëpie. Mjeku po i ndiqte me sy se si ata të dy, të mbështetur te njëri-tjetri dolën në rrugë dhe si humbën menjëherë në errësirën e asaj nate dhjetori. Ai nuk lëvizi nga vendi dhe as gruaja e kërrusur e as e shoqja nuk guxonin ta pyesnin, sikur i trembeshin mandatës që mund të nxirte ai. Rrinin si të mpirë dhe u dukej sikur ata të dy, që sapo ishin larguar, kishin lënë diçka kërcënuese në atë shtëpi. Mjeku se ç'foli me vete. Ishte një fjalë e rëndë, që të krijonte përshtypjen e përmbytjes dhe katastrofës. Mjeku e përsëriti fjalën e panjohur me solemnitetin e një perëndie dhe profeti. Ç'shenja e ndollën atë fjalë? Qfarë përzjeu ai në kazanin e mërisë për të nxjerrë atë fjalë? Të dyja gratë prisnin. Magjia akoma nuk ishte larguar dhe ajo fjalë akoma përzihej dhe përzihej në kazanin e së panjohurës. Mjeku sikur po e ndillte që ajo fjalë të dilte sa më parë andej nga ishte futur. Gratë nuk e kishin dëgjuar ndonjëherë atë fjalë.

«Glaukoma! Glaukoma!»

Mjeku ktheu kokën dhe u buzëqeshi.

— Glaukoma! — tha ai.

E shoqja nuk e pyeti se ç'ishte ajo fjalë, që të shoqit po i falte një kënaqësi pak të egër. Ajo fjalë nuk duhej të ishte e keqe për të dhe burrin e saj

— Do të dalim për vizitë? — pyeti ajo.

— Jo, — tha mjeku, që edhe para se të hynte në studion e tij i pëshpëriti në vesh së shoqes: — Glaukoma! Glaukoma!

Mjeku nuk e ndezi dritën. Në studion e errët emri Glaukoma kishte një tingëllim më të tmerrshëm. Ajo ishte si një copë e shkëputur nga panciri i tragjedive të natës dhe që kërkonte tërë ethe personazhet e veta, të cilat ishin zhdukur diku. Kjo e bënte edhe më të mprehtë etjen e saj. Ku është aktori që do të mishërojë Glaukomën? Aktori duhet të verbohet! Më duket sikur Shekspiri ka një mbret me emrin Glauk. Edhe në qoftë se dikush nuk e ka lexuar kurrikund këtë tragjedi, prapë ajo duhet të jetë diku në tragjeditë e humbura të Shekspirit. Megjithatë te Shekspiri duhet të jetë një mbret me emrin Glauk! Vetëm se ai nuk është i verbër. Glauk, pate fat që nu k' u ngjit prapashtesa oma. Ajo është e tmerrshme! Më e tmerrshme se çdo kurth dhe vaj i hedhur në vesh, më e tmerrshme se çdo vrasje natën në gjumë.

Mjeku vërtitej nëpër studio i shtyrë nga një stihi e tërbuar dhe e papërmbarjshme. Ajo i kishte push-tuar tërë sistemin e tij nervor dhe ai mund të reagon-te vetëm ndaj errësirës dhe tragjedisë. Në atë studio nuk kishte vend për asnjeri tjetër. Mjeku u drodh kur kujtoi se edhe aty mund të rëndonte heshtja e revolverit të përplasur mbi tavolinë, ngjitur me bllokun e recetave. «Jo, — tha mjeku, — këtu po bëhet grimi i Glaukomës, prandaj mos lejoni njeri të futet brenda! Mos ia bëni aq të ashpër grimin! Sa më të zakonshëm, së më të padukshëm! Ajo nuk do të luhet në skena dhe dekore. Larg konvencioni i hapësirës dhe i kohës. Nga tragjeditë le të mbetet i pandryshueshëm vetëm fundi. Ai nuk duhet të ndryshojë! Personazhi të cilil do ti ngjitet Glaukoma duhet të verbohet! Në vend të gjakut, Glaukoma duhet të derdhë errësirë dhe mjegull. Verbëri! Cili u end i verbër dhe i zhelosur nga qentë? Homeri? Jo, Homerin e ndoqi pas lavdia. Glaukomë, mos mbill pas lavdi! Mbill heshtjen e mjegullës dhe natës! Mbill qorrëllisjen!»

Mjeku po fliste me veten dhe shfrente tërë dufin

dhe mërinë që ndrydhi karshi njeriut që i përplasi revolen mbi tavolinë. «Nuk më ke njohur akoma, — i tha grykës së revoles, — por prit, mos u mërzit. Nuk kalohet lehtë kërcënimi yt mbi tavolinën time të punës. Nuk ta fal. Ti do të vish përsëri por këtë herë e përu-njur.» Mjeku kishte ngritur zërin më tepër sesa duhej. Kur e kapi këtë gjë, qeshi. Me siguri që e shqoja po e dëgjonte pas derës. «Nuk jam i çmendur, e dashur, jo. Vetëm kënaqem me Glaukomën. Kur ta shijosh edhe ti, unë do të tërhoqem mënjanë. Si autor që ka pasur punë vetëm kur e shkruante. Tani ajo nuk do të më përkasë më vetëm mua. Të falemnderit, Glauko-më! Ti i kapërceve të tëra parashikimet. Ti u shkë-putë tani prej meje. Nisu! Je e pavarur. Nuk më de-tyrohesh për asgjë. Nisu!»

Mjeku u përplas mbi kolktuk i dërrmuar. I dhembte koka. Më pihet një kafe. Kush e ka thënë, në ç'vit e ka thënë, për kë e ka thënë, se kur kurdiset mekanizmi i tragjedisë ai nuk pushon pa bluar eshtrat e jetës. Pra edhe mekanizmi i Glaukomës u kurdis. Ai do të pushojë kur të ketë mbjellë verbërinë dhe shuarjen e dritës së syve.»

Mjeku e mblodhi veten përsëri dhe e ndiente se nuk kishte pikë fuqie. As vetë nuk kishte menduar se fshihet një urrejtje kaq të madhe. Siç dukej ajo ishte grumbulluar pikë-pikë dhe sonte kishte gjetur të çarën e parë. Sa vite kishte që grumbullohej ajo? E ndiente veten të dërrmuar dhe të paaftë për t'u përgjigjur. Tërë gjymtyrët e tij tanë prehesin në kënaqësi. Nata ishte e zezë sterrë, megjithëse jashtë vezullonte débora e ngriрë. Mjeku u përpoq të shikonte bibliotekën, por nuk dalloi dot gjë. Nata në studio nuk fuste as më të voglën fjollë nga drita e saj. Mjeku u tremb se mos Glaukoma ishte kthyer kundër tij, ngaqë e kishte ndjellë si tepër. Gjeti me hamendje çelësin dhe ndezi driten. Mori, frymë i lehtësuar kur tërë objektet e studios zunë vendet e tyre. Në derë po trokitnin tërë frikë.

— Hyni, — tha mjeku dhe shtoi me zë të ulët,
— nuk jam Glaukoma, mos kini frikë.

Në derë u shfaq figura e shqetësuar e së shoqes.

— Eja, Ksandra, eja. Mos u tremb.

— C'keni kështu, Epamimonda!?

Atij iu duk sikur i thirrën Euripid.

— Asgjë, po ti afrohu, afrohu!

— Je zbehur shumë. Mos nuk e ndien veten mirë?

— Nuk kam asgjë.

— Të të bëj një kafe?

— Mirë, po mos më hidh në të helmin e mbretit

Glauk.

E shoqja u shqetësua edhe më shumë. Ajo nuk e kuptonte nëse i shoqi bënte shaka, si nuk e kishte pasur kurrë zakon, apo fliste përcart nga ethef.

Mjeku u qetësua plotësisht mbasi piu kafen. Në kokë nuk i mbetën as grimcat më të vogla të mendimeve që e thithën pak më parë. Ai e kishte kokën fare bosh. Cirkulacionet e trurit i dukej sikur ishin kthyer në disa rrugica boshe, të shkreta, ku nuk frynte as era më e lehtë. Donte të shtrihej dhe të dremiste. Me sy hapur. Në gjumë mund t'i shtinin zhivë në vesh. Zuri kokën me të dyja duart dhe i tha së shoqes të hapte pak dritaren. Era e padukshme e dhjetorit futi në studio déborën e ngriрe. Ai mbushej me frymë me vështrësi. Megjithatë ajri i ftohtë po ia kthjellonte mendjen. U përpoq ta qetësonte të shoqen duke i treguar përmendimet e asaj nate. Për u tërroq i trembur. Nuk donte të tradhtonte veten dhe Glaukomën. Deri atëherë nuk e kishte tradhtuar kurrë veten para së shoqes. Kjo kishte qenë një kalitje e gjatë dhe monotone.

Nga qendra, e qytetit, duke shtyrë valët e nates erdhë deri në studio një këngë e re. Ajo nuk erdhë e plotë, dhe ashtu e mangët ngjante si një klithmë që kërkonte pjesët e cunguara, nëpër natën e ftohtë. Mjeku tha se këngën e cungoi ai vëté.

*Redin borgjez do ta shkatërrojmë,
urra, urrà...*

Në barikadat...

Mjekut žunë t'i buçasin veshët dhe ai gati sa nuk thirri me zë të lartë Glaukoma. Kënga vinte dallgë-dallgë dhe mjeku, për të mos e dëgjuar, filloi ta ndante në gërma G-L-A-U-K-O-M-A. Oh, i vetëtiu atij në mendje; ti ke tetë këmbë, si oktapodi. Oktapod nga klasa e qefalopodëve! Glaukome, ti je oktapodi më i rrezikshëm. Kape gjahun dhe mbërtheje me anën e ventuzave! G-l-a-u-k-o-m-a! Tetë krahë dhe, si organe që keni zëvëndësuar këmbët, mos e harroni funksionin e vjetër lëvizës dhe zvarritës. Ç'më përpëliteni kështu në havë? Thithi ventuza dritën e syve! Që sot ajo do të jetë ushqimi juaj kryesor dhe i vetëm. Ashtu, lëviz, zvarritu, Glaukoma, oktapod nga klasa e qefalopodëve. Sytë, vetëm sytë! Që ata të mos shohin gjë. Vetëm errësirë. Mbillni errësirë, oktapod të dalë nga kufiri i dy epokave. Shuajeni kufirin, që të ketë vetëm një epokë. Atë timen. Që ata të mos keni epokë! O, oktapod, me emrin tragjik Eledona Mochata, mos dil në breg vetëm kur ka zbaticë! Prishe këtë rrëgull; se ti nuk i përket më klasës së qefalopodëve, por mua. Nuk dua zbaticë! Nuk duar, që ti të dalësh vetëm në zbaticë, o oktapod, me emrin Elektra Mëkata. Më fal, Eledona Mochata. Mbaje këtë emër, po mos dil vetëm në zbaticë! Ata nuk duhet t'i lëmë të marrin frysë. Po i lame të qetë në baticë do ta kemi keq. Për ty nuk ka më kufi midis baticës dhe zbaticës. Ashtu, Eledona Mochata, ashtu. Lëviz, zvarritu drejt syve, vetëm drejt syve! Sot ti dolë nga klasa e qefalopodëve dhe hyre në klasën time. Në jemi të një klase. Në jemi ameba. Nuk shihemi me sy, prandaj dhe jemi këq të rrezikshme dhe të tmerrshme. Lëviz dhe zvarritu! Tani për tani le, të jemi ameba të padukshme. S'ka gjë. Nesër, kur të kemi mbaruar punën, ti do t'i përkasësh përsëri klasës së qefalopodëve, Eledona, kurse unë...

Rendin borgjez do ta shkatërrojmë,
urra, urra.....

Lëviz dhe zvarritu! Lëviz dhe zvarritu! Kap! Ne nuk
kemi skelet. Trupiynë hyn me lehtesi kudo, në të çara
dhe zgavra. Në do tij kthejmë sytë në zgavra. Umë jam
qefalopod.. Nuk kam dy duar pô tetë! Lëviz dhe zvarritu!
Lëviz dhe zvarritu! Kap! Ashtu, Elektra, Mëkata, ashtu!
Ashtu, asht, ash, a...
Mjekun e shtrinë më zor në shtrat dhe kolegu i vet
neurolog mbeti i habitur nga kjo krizë e papritur e
njërit prej mjekëve më të qetë të atij qyteti. Ai i
qëndroi tërë natën në kokë dhe nuk dinte si ti shpje-
gonte përcartjet e kolegut, që pëshpëriste vazhdimisht
emra tragjedish klasikë, oktapedesh dhe emrin e së-
mundjes së rrezikshme të syve, Glaukomës.

7

Një javë më vonë mjeku Epamimonë Sojnuri ishte
plotësisht i qetë. Dhe priste të trokithin në derë pacien-
tja me shqëruesin, por nata nuk po dukeshin. Një ditë
ai i përdjalini që t'i gjithë i therrisinë komisari kur
po konfiskohet pasuria e një shtetasit italian. Mjeku ktheu
menjëherë rrugën dhe i ra ngarpazari. Pazari ishte i
shkretë dhe i trishtruar. Dyqanet kishin fulur qepenat e
tyre prej allamarie të trashë dhe të valëzuar. «Glauko-
më, i shkrepinë kokë me kënaqësi mjekut. — Glaukomë
ë qepenave të myllur». Ai jashtë të tjerël pazarin dhe
nuk i gëzohej dot svarfërisë së Shumë prej dyqaneve i
njihet mirë. «Ato kanë mall brenda Mall dhe bukë. Ato
mund t'i hapë vetëm florin. Përbuzeni poni të doni flo-
ririn». Qepenave myllur kishin trudhur buzët me për-
çmim. Ai kaloi përsëri nga tregu i drithitar. Në qoshën e
tregut dikush pombentë pazar tërën frikë me një katun-
dar. «Mos u trembni. Umë jam i heshtur si një qepen i
myllur». Kur hyri në shtëpi e shoqja ishte e mërzitur. Në

qytet Šapo kishin sjellë kufomën e Qirjako Buçit. Ai ishte vrarë dhe thoshin se edhel banda e tij ishtë shfarosur. Mjeku e ngushëlloi dukë i përkëdhëlur flokët e dendur, të zinx, që i derdheshin mbi shpatullat e plota. Një tufë flokësh, si bisht hépérke, i ishte ngjitur nga lotët faqeve. Dhe atëherë mjeku e kuptoi me dhimbje që e shoqja e kishte pasur Qirjako Buçin diçka më shumë se komshi dhe burrin e shoqes së saj më të ngushtë. Atëherë i lindi një dëshirë e egër ta torturonte të shoqen:

— Qirjako Buçinka qenë gjithmonë një derr dhe as gjë tjetër. Sigurisht një derr i fuqishëm që, për çudi, ndonjëherë u pëlqente edhe grave të zgjuara. Ai duhej të ishte zhdukur prej kohësh. E shkreta Praksithe, si zor t'i zëvendësojë njeri tjetër forcën e të ndjerit Qirjako Buçi.

Ai foli sikur po pëshpériste një lutje të zvarritur dhe kënaqeja që e shoqja mezi e mbante veten.

— T'ju bëj një kafe, e dashur?

E shoqja heshti.

— Po shkoj t'ju bëj një kafe të hidhur. Ajo do t'ju qetësojë. Ja, do ta provoni vëtë.

Aj hyri në kuzhinë. Qirjakoja duhej të kishte mbetur rrëth kufirit të qytetit. Prania e bandës së tij duhej të kishte hépérhë vëtem karakter kërcënues. Mbi dhjetorin e vittit dyzet e katër duhet të mblidhet e të shtrëngohet kërcënimi i armëve, i qepenave të myllur, i pazarit bosh. Dhjetë zogjë glaukomës. Njerëzit nuk mund të jetojnë gjatë më gjëra abstrakte. Liria! E përséri kjo nuk do të thotë se ajo është bukë. Dhësa ditë ju ka mbetur nga ky ushqim që ju po e hanissi të babëzitur? Kujdes! Mos i bjerë rendë stomakut bosh.

Mjeku zjeu kafend dhe ia çoi së shoqes. Ajo ishte qetësuar. Ata filluan të rrufisnin kafen në heshtje.

— Nuk e kuptoj, përsë tu mërzite aq shumë? — pyeti mjeku të shoqen. Ajo e vështri gjatë në sy. Vështrimi i saj gjithmonë kishte pasur pushtet mbi mjekun. Në atë çast ai e ndjeu se edhe në marrëdhëniet e tyre kishte diçka që nuk shkonte. Dhe ajo nuk kishtë përtu zhdukur kurrë.

— Prania e zotit Qirjako ishte shpresë për ne dhë kërcënimin për pushtetin e tyre, — tha ajo.

— Edhe pa praninë e zotit Qirjako ky pushtet është nën kërcënimin.

— Besoj se nuk është nën kërcënimin tënd; — tha e shoqja me cinizëm. Mjeku e përbajti vëten me zordhe i erdhi mirë që veproi kështu. Po ta kishte qëlluar, e shoqja do ta përbuzte më shumë.

— Edhe unë jام një kërcënimin.

— Gruaja për herë të parë vuri buzën në gaz.

— E di, — tha ajo. — Je një kërcënimi i egër.

Ajo vazhdonte të taljej, pór ai kishte vendosur, të mos e prishte gjakun dhe të duronte. Ajo nuk mund të kuptonte tani për tani forcën e kërcënimit të tij, pasi ishte rjohur me forcën e Qirjako Buçit. Ajo dosta kuptonte më vonë.

Mjeku u ngrit dhe hyri në studio duke e lënë të shoqen të fyer dhe të pangushëlluar. U ul në kolltuk dhe e ndjeu veten rehat. Qirjako Buçi! Mjeku ndiente neveri për kapadaillekun e Qirjako Buçit. Ishte një kapadaillek i nxitur nga boshi. Mjeku qeshi me vete! E shoqja i kishte thënë se kishte parë kufomën e Qirjakos të shtrirë mbi déborë te sheshi i qytetit. «Aialahet qdo mëngjes me déborë që të jetë në formë, i kishte thënë e shoqja. — Tani débora do të lëshojë mikrobet që do të dekompozojnë trupin e tij. Sikur të shkoja ta shihja edhe unë», — tha mjeku dhe doli në sallon Kur po vishej, e shoqja i tha:

— Ku po shkon?

Të shkoj se q'mikrobe do ta hanë trupin e zotit Qirjako, — tha ai dhë doli jashtë.

Kur mbërriti te sheshi, kufomën e Qirjako Buçit sapo e kishin hequr. Njerëzit po shpérndaheshin. Mjeku u përzje me ta për të ndjekur bisedat. Dhe në to pa se kishin diçka që nuk e kishin pasur më parë. Dhe, ngaqë nuk e duronte dót, shkoi drejt furave të bukës. Bosh. Boshi ishtë më i tmerrshëm se banda e Qirjako Buçit. Askush nuk kishte luftuar deri atëherë kundër boshit, kurse kundër njerëzve si Qirjako Buçi kishin luftuar.

Prandaj e kishin dhe më të lehtë. Ai nuk gëzohej nga fitoret e lehta. Sidomos kur këto fitore arriheshin ditët e para. Ato janë iluzore. Konkrete ishin qepenat e mbyllur me llamarinë të trashë dhe të sigurt. Ai donte të prekte me dorë rrudhat e qepenave. Iu afrua me kujdes njërsës dhe shkoi dorën mbi rrudhat e saj. Ato ishin të ftohta. Dhe mjekut i erdhë keq që nuk kishte prekur me dorë deri atëherë ndonjë gjarpër. Se edhe krahasimi do të ishte më i saktë dhe më i përpiktë. Iu kujtua kufoma e Qirjako Bugit. Ajo tani duhej të ishte bërë kallkan. Si qepenat Qirjako Buçi nuk ka në kokë asnjë mendim, qepenat kanë plot.

Kur po kthehej përmështëpi, i zuri syri pacienten me djalin që stëgjithë i thërrisinin komisar. Ajo ecet i pranë djalit. Mjeku u kënaq kur vuri, re një lloj pasigurie në hapat e saj. Verbimi nis me ritme të avashtha, po është i pashmangshëm. Verbimi i saj përmjekun nuk ishte verbimi i një njeriu por i një pushteti. «Kuturum nuk ecet gjatë», mendoi mjeku.

E shoqja nuk ishte në shtëpi. Kishte shkuar tek atatë Qirjako Buçit, përmështëpi ngushëlluar të shoqen. Mjeku nuk u mërzit nga mungesa e saj. Bile shtëpia iu duk tërësisht e tij. Në studio nxinte enciklopedia italiane e vitit 1933. Mjeku mori vëllimin e ku ishte gërmagj, dhei filloj ta shfletonte, modët e institucioneve e mbrojtjeve. G, g, gl, glauk, glaukoma. Më fund e gjeti faqen që kërkonte, dhe fillqit ta lexonte me zë.

— *Glaukoma, nga greqishtja. Sëmundje e rrezikshme e syrit, simptoma: kryesore e së cilës është ngritja e tensionit të syrit, i cili kalon deri në 80 mm të shtyllës së zhivës, (norma 18-30 mm). Nga mungesa e mjekimit ajo të çon në mënyrë të pashmangshme në verbin të plotë. Ka dy lloj glaukoma...* Po, mjeku nuk e vazhdoi leximin më poshtë. Ai e lexoit përsëri nga epara gjersa e mësoi përmendsh. Nga mungesa e mjekimit ajo të çon në mënyrë të pashmangshme në verbin. Pushteti popullor. Qepenat e mbyllur.

Në fillim zakonisht dhemb njëri sy, pastaj si kalon edhe pak kohë, infektohet edhe tjetri.

Qepenat e mbyllur. Syri i djathë. Tregut bosh. Syri i majtë. Heshtja e minierave dhe fabrikave. Të dy sytë të infektuar. Glaukoma zakonisht shkaktohet më tepër në pranverë. Gabim! Enciklopedia duhet korriguar. Glaukoma shkaktohet në çdo stinë. Në çdo stinë! Dimri. Dimri është më i favorshëm. Nga më i rrujtët, se si qëndroj Medikamentet: pilokarpin, ezerin, prozerin, etj... Gjepura, nuk ka medikament... dhe operacion. Operacioni këtë për qëllim të skrijojë rrugë të reja për lëngunë syrit. Diagnostikimi sa më i shpejtë i glaukomës ka një shumë të madhe, sepse fillimi i menjëherëshëm i mjekimit parandalon humbjen e të parit. Në studio u bë qetësi. Mjeku vazhdonte të trinte enciklopedinë italiane të vitit 1933 mbi gjunjë. Enciklopedia rendonte shumës, sal të lodhte gjunjët. Mjeku e pa si ajo po i rrëshqiste nga gjunjët, por nuk kishte ndër mend ta mbante që të mos rrëzohej.

Më në fund umbërriti dhe 31 dhjetori i vitit 1944. Nora së bashku me Nikënq ishin bërë gati të festonin imbrëmjen e. Vitit të Ri, ndhej apo prisnin të vinte. Nimetit. E kishin bërë me vjalë që: ta kalonin së bashku atë natë. Jashtë binte një dëborëe shtruar dhe e bukur. Qyteti kishte dritë. Nimetit kishte kaluar tërë ato, njerëpa gjumië. Pushteti shpërndau miell, dhen banorët përgatitën dëckat për Vitin e Ri. Shumë të dëmtuar nga lufta u shpërndanë, nëpër familje. Nora priste tënë dritoren dhe përpiquej të përfytyronit që gjimi i shtëpive. Në gjoksë i rritej, dhe i rritej një ndjenjë e ngrohtë dhe dehëse. Në kuadratin e ndriçuar nga drita që binte nga

dritarja dukej si flokëtonte dëborane vitit 1945. Nimeti po vonohej. Po edhe kjo vonesë se që kishte diçka të embël. Ajo priste.

Në dhomë dëgjohej ecejakja e Nikës, që bënte që bënte e gjente ndonjë gjë pér të rregulluar. Nora ishte veshur bukur dhe këndonte pa zë. Shikimi sikur i ishte ngushtuar dhe ilaci që i dha mjeku nuk po i bënte bënde efekt. Por, ndërsa priste Nimetin, e harroi sémundjen. Ajo ishte mbërthyer e tëra nga ankthi i bukur i pritjes së njeriut që duam. Ajo nuk e fshihet atë që ndiente pér Nimetin. Në kuadratin e dritës që binte nga dritarja flokëtonte dëborë. Tëra shtëpitë kishin dritë. Dhe atë natë, ajo dëborë ishte një dëborë e ndriçuar. Nimeti nuk po vinte. Kishte shkuar larg. Kur të hynte në shtëpi do të ishte i bardhë. Ajo do të thërriste apo ai të hynte brenda, erdhi Viti i Ri! Dhe do t'i shkundte dëborën me fshesë. Dhe do të pinin verë. Ajo do të pinte verë pér herë të parë atë natë. Nika u afroa dhe ajo te dritarja. Dhe tanë që nëpër dhomë nuk lëvizte njeri, u ndje më tepër vonesa e Nimetit.

— Sa vajti ora? — pyeti Nora.
Nika vështroi orën e vjetër të tavolinës dhe tha:
— Dhjetë e njëzet.

— Qënka shpejt akoma, — tha Nora.

Ajo e dinte që nuk ishte shpejt. Në shtëpitë e tjera festa kishte filluar me kohë. Ato prisnin. Nora e dinte se ku ishte Nimeti. Dikush kishte dashur të hidhët në erë centralin e sapondërtuar. Pse po vonohej Nimeti... Nika ndryshoi përsëri vendosjen e pjetave dhe gotave me verë. Nga larg iu duk silueta e një njeriu. Norës i rrahu zemra. Njeriu afrohet me nxitim. Nora e njoftua dhë vajti t'i hapte derën. Kur hyri në oborr, Norës i erdhi keq që ai e kishte shkundiur që më parë dëborën. Me vete kishte sjellë një brëdh të vogël. Nora ia rrëmbeu nga dora dhe harroi gjithçka, sa iu duk se më që ankthi kishte pritur pikërisht këtë brëdh të vogël dhe të njomë. I kërkoi Nikës një vazo dhe, kur u mat t'i hidhët pambuk, iu duk sikur po e shëmitonte. Brëdhë ishte i njomë, i gjelbër, i bukur.

— Gotën e parë e ngriten para se të fikeshin dritat. — E ngriten për Shqipérinë e Lirë dhe për kthimin shëndoshë të djalit të Nikës. Nika ua ktheu urimin duke u tħené se mot do të mblidheshin të katér. Kur u fikën dritat, Nora u përpinq të përfytyronte si binte tani dëbora, mes errësirës. Dhe errësira po vazhdonte gjatë. Përsët nuk i ëndezi dritat? Dëbora bintet në errësirë. Ajo nisi në një vit dhe po vazhdonte edhe në vitin tjetër. Sa shumë dëborë po bie.

— Përsët nuk i ëndezi dritat? — pyeti Nora me zëtë dridhur.

Ajo dëgjoi kërcitjen e karrigeve dhe brofjen e menjëherëshme të Nimetit. Ai e kapi përi dore.

— Nôra, mos nuk poje mirë? — pyeti ajo sot e jebur.

— Jo, mirë jâm. Po dritat duhet t'i kishin ëndezi.

Atë e kishte kapur përsëri kriza. Kjo ishte e tretë. Nuk shihte asgjë. Për të vazhdontë të ishte errësirë. «Sa shumë që zgjati». Pastaj ja ku u ca një copë mjegull dhen ajo shqoi një dritë të zbehtë. Megjithatë hapësira përsëri mbeti e turbullta, nuk ëp mund qendura.

— Mos dritë të hedhë disa spika riqatilaci? — i tha Nika.

— Jo. Më kaloit. — Nika bëz po nista kurrë sugraf

— Jo. Më kaloit. — Nika bëz po nista kurrë sugraf — op Pamja po i qarfësoj. Ajo ngriti kokën dhe pa llambëni elektrike. Pogi dukej si një dielli i turbullit dhe iqveshuni nga retë. Retë po shpërndaheshin dhe Nora daria lloji téré objektét e dhomës. Briedhi i vogël, i ngjelber, dhe dritarja pas së cilës përplasej lehtë dëbora...

— Gëzuar, — tha Nora dhe ngriti gotën e verës.

Nimeti me Nikën rrëmbyeni menjëherë gotat dhe ajo ishte çokja më e gëzuar e ásaj nate sot. Nëmijet e

Aty ngra orë një e gjysmë Nimeti tha se do të shkonte të uronte punëtorët e centralit dhe të fabrikës së miellit. Nora tha se kishte edhe ajonqejtë ventë me të dhe Nimeti pranoi. Nika ti përcollis deri jashtë.

Më gjithë kundërshtimin e tē rinjve që ajo mos dilten jashtë se mos fitohej. Nika nuk i dëgjoi. Dëbora ra ambi flokët e saj të thinjur, butë, si një urim.

Në rrugë ishtë hapur një shteg i ngushtë dëbore

nga njerëzit që shkonin për t'i uruar njëri-tjetrit. Vitin e Ri; ndërsa dëbora vazhdonte të binte. Nimetin e ndaluan disa herë. Nora nuk i njihet ata që uronin Nimetin. Veçse ajo kapte me intuitë pyetjen që ata druheshin të bënин. Dhe ajo pyetje u takonte të dyve. Mos jeni fejuar? Po njerëzit, si u shtërgnonin dorën, largoheshin pa thënë gjë. Nora ndihej e lumbur atë natë. Nimeti ishte i qeshur dhe i gëzuar si një fëmijë. Në një vend, ku ditën kishin rrëshqitur fëmijët, ai donte të provonte se nuk e kishte harruar fëmijërinë. Dhe rrëshqiti, por në mesin e kolovajzës u rrëzua dhe u zhyt i téri në dëborë. Nora nuk e mbajti dot të qeshurën. Gazi i saj mbushi téré rrugën me një gëzim të lehtë dhe kumbues. Nimeti u çua dhe shkundi dëborën që i qëngjeshur mbi pallto. Dhe kur ishin duke qeshur, u kaloi pranë një çift të moshuarish, të veshur trashë, me qyrk.

— Borgjezët, — ndërpreu gazin Nimeti. — Ata nuk kanë shkuar për të uruar por për të derdhur vrer kundëresh.

Cifti, sidomos burri, që me saldukej e njoihu Nimetin, u bë gati t'i përshtendoste, duke marrë një pozë servile. Nimeti u vrenjt dhe, si kapi për dore Norën, u largua. Burri ngriu në vend dhe lëvizi buzët pa nxjerrë dot fjalë. Noral vështroi gruan. Ishte një grua që përpinqej të dukej më e re sesa ishte dhe me një vështirim sikur donte ta përpinte Nimetin. Cifti duhej të kishin diferençë të madhe moshe midis tyre. S'kishin bërë astre hapa, kur Norës i ra në hundë era e një parfumi të lehtë, si era e karafilave kur u bie vesa e mëngjesit.

— Ata kanë ngritur dolli për vitin tonë të fundit, — tha Nimeti me inat. — Ata gjithmonë do të mendojnë se qdo vit që do të vijë do të jetë viti i fundit për ne.

Norës i erdhi keq që takimi me ciftin u kishte pri-shur harenë. Ata shkuan në fillim në central, pastaj në fabrikën e miellit. Punëtorët u dhanë nga një gotë verë dhe ata uruan. Kryepunëtori e leu me miell Norën që të kishte këmbë të mbarë për vitin që sapo kishte filluar. Ata qëndruan gjatë në fabrikën e miellit dhe

kur dolën panë se dëbora binte si më parë, me flokë
të mëdhenj dhe të shtuar.

— Ke gjumë? — e pyeti Nimeti.

— Jo. Pse, ti ke?

— As unë.

— Sa e bukur është kjo natë e Vtitit të Ri, ë, Nimet?

— Po, — tha ai.

Norës i dukej sikur për herë të parë po provonte
këtë gjë në jetën e saj. **Nora donte t'i thoshte se ajo**
natë i dukej e bukur edhe pse ishin të dy bashkë. Por
nuk mundte. Nimeti shkau dhe u mbajt pa druajtje
te krahu i saj. Qyteti po fikte dritat. Festa po mba-
ronte. Viti 45 po niste me vështirësitet e tij. Të dy e di-
nin këtë. Ata u mbështetën fort te njëri-tjetri. Ku ki-
shin ecur kështu bashkë? Në Operacionin e Dimrit...
Kërcënöheshin nga të katër anët. Edhe atëherë binte
dëborë dhe frynte erë...

Edhe pak dhe ata hynin në rrugën e shtëpisë së
Nikës.

— Nimet, të vjen keq që po mbaron Viti i Ri?

— Mos u bëj fëmijë, — tha Nimeti me të qeshur.

— Mua më vjen. Sikur të vazhdonte më gjatë dhe
ne të endeshim akoma nëpër rrugët e këtij qyteti.

— Po të duash nuk shkojmë që tani në shtëpi.

— Jo, — tha Nora, — ti duhet të flesh pak dhe Ni-
ka po na pret me siguri. Në rrugën kryesore ata u
takuan ballë për ballë me mjekun Epamimonda Sojnuri
dhe të shoqen. Ata dukeshin të lodhur. Mjeku i përshëndet-
jeti lehtë dhe u largua. E shoqja mezi e ndiqte pas
ngaçë i rrëshqitnin këpucët.

— Ktheje me kujdes kokën, — tha mjeku. — Bash-
kë po ecin?

— Bashkë, — u përgjigj gruaja e habitur. — Po pse?

— Ta them më vonë, — i pëshpëriti mjeku. — Të ecim
dhe pak dhe hidhi edhe një herë sytë nëse ecim për kra-
hu apo janë ndarë.

Mjeku me të shoqen qenë mbledhur tek i ati. Tërë
kohën mjeku bisedoi me të atin për ta fshehur flori-
rin në një vend sa më të sigurt. I ati ishte një nga

tregtarët më të mëdhenj të atij qyteti dhe ai ishte i djali i tij i vetëm. Megjithatë, apo e martoi i ati i ngriti një shtëpi të re. Floriri ishte i përbashkët. Dhe ata vendosën ta fshihnin në studion e mjekut, pas librave të mjekësisë dhe enciklopedive italiane dhe gjermane. Mjeku ishte i qetë se askush nuk dyshonte tek ai, mbasi ai kishte mbajtur qëndrim neutral. Mjeku vuri buzën në gaz me fjalën neutralitet.

Gjatë mbrëmjes mjeku i tregoi të atit se ç'i kishte ndodhur me Nimetin kur i kërkoi flori për vizitën. I ati kishte mbledhur buzet. «Duhet takt, — kishte thënë i ati. — Tani për tani ata nuk mund ta kuptojnë se në botë i qëndrueshëm është vetëm pushteti i floririt. Po pak nga pak edhe ata do ta kuptojnë dhe neve do t'na shtrijnë dorën. Dhe ne, sa më thellë ta fshehim floririn, aq më shumë ia shkurtojmë ditët pushtetit të tyre. Dhe një pushtet që kërcënöhët nga të katër anët nuk e ka të gjatë. Bromb! Për përbysjen e pushtetit të tyre! Të lumtë ajo gojë! Do ta pi me fund. Ke pirë shumë, morr burrë. Sado që të ketë pirë këtë le ta kthejë me fund, se është për vdekjen e pushtetit popullor. Bromb! Të nxjerr akoma shampanjë? Edhe pyet. Për kë ta ngremë këtë dolli? Për përbysjen e pushtetit. E ngritëm një herë. Një herë nuk është gjë fare. Bromb! Po këtë për kë do ta ngremë? Edhe këtë për përbysjen e pushtetit të brekëgrisurve. Po vetëm për këtë do të pimë sonte? Vettëm për këtë. Vetëm për këtë! Vetëm për këtë! Vettëm...

Mjekut i buçiste akoma koka nga dollitë monotone të asaj nate.

— Ktheje kokën me kujdes, akoma për krahu po ecin?

— Po.

Mjeku qeshi. «Glaukomë, edhe sa kohë të duhet për t'i ndarë përgjithmonë? Lëviz dhe zvarritu më shpejt! Thithni venduza! Kur ata të mos ecin më së bashku, kjo do të thotë se atyre u ka ardhur fundi». E shoja nuk po ua ndante sytë Nimetit dhe Norës, që kishin refuzuar të pinin kafen e saj.

— Shiko më me kujdes, i se mos dýshojnë, — tha mjeku.

— Ata as që e kthyen kokën nga ne, — tha e shoqja e mërzitur. Kur mjeku ktheu kokën, ata të dy nuk dukeshin më. Dhe për çudi, ai, sado që u përpoq t'i përfytyronte të ndarë, nuk mundi. Ata ecnin pér krahur. Po midis tyre ishte glaukoma. Dherata nuk e dinin. E dinte vëtëm mjeku. Dhe kjo ishte lumturia e fundit e asaj natë pér mjekun Epaminonda Sojnuri.⁹

I ati i mjekut Epaminonda Sojnuri, Ligor Sojnuri, rrëshqiti nga shtëpia e vet së bashku me të shoqen dhe shërbyesen e tyre memece një natë para se të dilte tatimi i jashtëzakonshëm mbi fitimet e luftës. Shërbyesa ishte e forte dhë, si cdo memece, e heshtur. Ligor Sojnuri e kishte marrë në shtëpinë e vet sapo filloi të vinte kapital. Dhe ashtu si kapitali që duhet të jetë memec pér të tjerët, po kështu duhej të ishte edhe shërbëtorja e shtëpisë së tij. Ai e kërkoi gjatë gjersa e gjeti në manastirin e një fshati të largët. Gështë e vërteta ai nuk e gjeti vetë, por një mik i vet i tregoi se si kishte parë një memece që punonte si kale në manastirin e një fshati të largët. U nis vetë pér në manastir dhe, si i dha një dorë të mirë priftit, e solli memecen në qytet. Askush nuk ia mësoi emrin dhe asaj të gjithë i thërrisinin memecja. Ligor dukej i kënaqur dhe nuk qe penduar që kishte paguar aq shumë pér të. Memecja, nuk diinte të ankohej. Dhe kur ankohej nuk e kuptonte dot askush.

Memecja ndigte pas të zotin dhe të zonjën dhe shikonte se si ata i kishte pushtuar paniku. Nuk i kishte parë kurrë aq të trembur. Ata mëzi po mbanin valixhet dhe dy teneqe. Po kalonte mesi i natës dhe të ftohtët të priste fytyrën dhe duart. Memeces i ishin

plasur duart dhe ajo filloi tē rēnkonte me një zë rrëqethës. Ligor Sojnuri iu hakërrua me inat. Memecja u třemb dhei ngritit zérin. Ajo lëshoi një klithmë që pér fat e pérpiu era. Ligor Sojnuri iu afroa dhe e kuptoi se duhej tē sillej ndryshe. I foli me tē butë dhe i pérkëdheli flokët. Memecja kérceu e llahtarisor dhe përséri lëshoi një klithmë. Klithma e saj kishte diçka nga klithma e ulkonjës. Pér herë tē parë ajo e kuptoi se mund tē trempte njerëzit e fuqishëm, si i zotë i saj. Dhe me intuitë kuptoi se në botë o kishte ndodhur diçka e madhe, o po ndodhët diçka e madhe. Ajo harroi dy teneqetë që i rëndonim. Ajo vetëm pérpiqej tē kuptonte atë që kishte ndodhur. Ndofta po ndodhët përmbyssja dhe kataklizmoi që kishte parë nëpër ikonat e manastirit. Ajo ngriti kokën lant tē shikonte bubullimat dhe zjarrin. Iu duk sikur po dëgjonte rrokullisjen e rëndë tē një mase pa formë. A mos vallë ajo natë mund tē prishtë memecllékun dhe shurdhimin e saj, sepse deri atëherë nuk kishte ndodhur ndonjë gjë që tē prishtë memecllékun dhe shurdhimin e saj. Memecja ndaloit tē thoshte një lutje që e kishte krijuar vetë, sepse asnjë lutje nuk kishte dëgjuar deri atëherë. Lutja e saj ishte shkretëtirë. Ajo dinte vetëm fjalë shkretëtire. Memecja lëvizi bùzët dhe nxori një klithmë: «Kataklizmoja», mendoi memecja dhe priti tē çahéj dheu dhe tē dilte uji i zi. Ligor Sojnuri shtangu në vend. Kush ua mori gojën tē zotërve tē saj? Kush i goditi kështu? Qielli ende nuk po villte zjarr. Memecja nuk ua ndante sytë dhe bënte disa shenja tē çuditshme, sikur ndillte shjetanin. Ajo tregonte tokën dhe qiellin. Dhe ata tē dy, si tē hipnotizuar panë tokën dhe qiellin. Po nuk dalluan gjë. C'shikonte ashtu memecja?

Nata ishte e zezë. Bënte ftohtë. Qyteti dukej më i shkretë se kurrë. Po çfarë shikonte ashtu memecja? Ligor Sojnuri u pérpoq ta shihte me dhembshuri memecen, por ajo u třemb edhe më shumë dhe tregoi më gisht qiellin. Ata tē dy, burrë e grua iu bindën gishtit tē meneces, por nuk dalluan gjë. Memecja vazhdonte pérpëlitjet e saj dhe Ligor Sojnuri u nxeh dhe iu ha-

kërrua. Memecja iu bind. Ata u nisen përsëri. Memecja mori një pamje të trishtuar, sikur po shkonte drejt fundit të botës. Deri në shtëpinë e të birit Ligori, e shoqja dhe memecja ecën të shpérndarë dhe larg njëritjetrit. Gjurmët e tyre ishin të rrëgullta mbi déborën e ngrirë. Mbi to frynte e pamëshirshme era, që fshinte çdo gjurmë.

Para shtëpisë së të birit ndaluan. Ligor Sojnuri kontrolloi mirë e mirë rrugën nga kreu në fund, priti mos zgjatej ndonjë kokë nga qoshkat e përgjumura dhe kur iu mbush mendja se askush nuk i kishte gjurmuar, iu afrua derës prej hekuri. Ajo ishte pa celës. Në shtëpi nuk kishte drithë. Por brënda errësirës së saj po i prisnin. Asnjë derë nuk ishte e myllur atë natë.

— Prit, — i tha së shoqes, që po matej të hynte brenda. — Të hyjë mëmecja e para.

— Pse?! — u habit e shoqja.

— Sepse ajo e ka këmbën më të madhe se ne të dy. Ne do të shkelim në gjurmët e saj.

Ligor Sojnuri iu afrua memeces dhe ia bëri me shenjë të hynte. Ajo nuk kishte hyrë në ndonjë shtëpi pa trokitur. Ia bëri me dorë t'i binte derës.

— Hyr, moj lugate! — i u zot Ligor Sojnuri. — Hyr!

Ai e kapi për krahu dhe si shtyu me kujdes më këmbë derën, që u hap pa zhurmë dhe lehtë, e shtyu memecen brenda. Ajo bëri dy hapa dhe ndaloj. Ligori ia bëri me shenjë të gjithë. Dhe ajo iu bind. Kur iu afrua verandës, një shpejtë e kapi për krahu dhe e futi brenda.

— Tani hyri ti dhe, sakën se shkel në gjurmë të tjera, — i tha Ligori, së shoqes.

E shoqja e bindur hyri brenda. Memecja i kishte hapat e mëdhenj dhe gruaja dukej qesharake kur capë lohej, që në atë rruginë të dukeshin vetëm një pale gjurmë, ato të memeces, a thua se gjurmët e një memeçje janë po memece. E shoqja ndaloj, për tu mbushur me frymë, në mës të rruginës. «U lodh sikur po kalon ferrin, — shfryt Ligor Sojnuri. — Edhe tre rrathë

të kanë mbetur!» E shqoja u nis duke u hedhur nëpër gjurmët e memecës sikur të kercente një valle pagane. «Tani e kam radhën ta kércej unë». Dhe, duke u përpjekur të shkelte në gjurmët e memecës, e kuptoi se ajo ishte një valle e lodhshme dhe e vështirë. Edhe po të përshkonte rrathët e ferrit do ta kishte më lehtë. Sa rrathë ka ferri? Nëntë. Ai kaloi tridhjetë e shtatë. Kur hyri në dhomë u shemb mbi kolktuk dhe nuk po mbushej dot më frymë. Të gjithë ishin aty. Ligor Sojnuri i ndiente në errësirë, e cila sikur qe ndrydhur edhe më.

— A ju pa njeri? — pyeti i biri.

— Sonte vetëm shpirtrat e këqija dalin në rrugë, — u përgjigj më inat Ligori.

— Mirë është të kthehem që tanë në shtëpinë tuaj.

— Prit të marrim veten, se na ka vajtur shpirti në fund të këmbëve. Na bëj një kafe!

— Ku ta bëj kafen? Apo të ndez dritën?

— Jo, jo, mos e ndiz. Sa do të ma sillte shpirtin në vend një kafe e fortë!

Ata heshtën. Dhe papritur të gjithë u drodhën. Memecja, e zhytur në errësirën e korridorit, lëshoi një klithmë të mprehtë, sikur kishte shkelur mbi diçka të frikshme.

— Mbylle gojën, e mallkuar!

Por memecja pushoi vetëm kur iu mbush mendja se ishte larguar ajo që e kishte trembur aq shumë.

— Ku do ta fshehësh? — pyeti Ligori të birin.

I biri nuk iu përgjigj menjëherë. «Përse nuk flet, edepsëz!» Ai nuk e kishte quajtur kurrë të birini edepsëz. Edhe që e quajti sonte, fajin e kishin nata dhe memecja, që bënte ç'bënte dhe mjaullinte në errësirë.

— E di, baba, sot në mëngjes doktor Kiçoja më shpjegoi kuptimin e shprehjes humbi si varri i kurbatit. Ishte shumë interesante. Kur vdes një kurbat, fisi i tij ia lë të vdekurin një njeriu të panjohur që ta varrosë diku. Vendin e varrimit nuk duhet ta dijë asnjë nga fisi i të vdekurit. Dhe kështu, i dashur baba, asnjë kurbat nuk e di ku është varri i të atit apo gruas, i në-

nës apó motrës, i së dashurës! Nga kjo dhe doli shprehja, humbi si varri i kurbatit. Bukur hë, baba?

— C'më përmend varret sonte, — tha i mërzitur Ligori.

— Po të vijë rasti edhe ne është mirë ta zëvendësojmë këtë shprehje me shprehjen, humbi si floriri i Ligor Sojnurit.

I biri po qeshte.

— C'm'i zbardh dhëmbët? — tha me mat Ligori.

I biri nuk u përgjigji. Jashtë era ankohej strëhevë të shtëpive dhe qosheve. Ajo hapi dhe derën e verandës. Memecja u tremb e lëshoi një kuje që i ngjethi të gjithë. Ç'të kishte sonte memecja e Ligor Sojnurit që ndillteters? Çfarë kishte ngjallur truri i saj i fjetur? Kuja e memeces mbeti në korrditor e errët si një zog që përplasej pas objekteve pa gjetur rrugën e daljes. Zogu i kujës ishte i zi.

Norën e caktuan në komisionin e caktimit të tatimit dhe fitimit. Komisioni kishte shumë punë, nga mënyrë gjesi deri vonë hatën. Tregtarët s'hiqnin dorë kollaj nga pasuria. Kishte prej tyre që i paguanin dhe bë shlyenin menjëherë tatimin, por shumica ngulte këmbë se nuk i kishte me së të paguante. Bile disa ngrinin zërin dhen protestonin, duke thënë se ligji po zhvastë popullin. Ndoshëta për herë të parë ata patën dëshiretë që sheshin popull. Një ditë djali i një tregtarisë sillej si i tërbuar në për dyqan dhe, si theu tërë xhamat, donte t'i vinte zjarrin mallit.

— Është malli im, — thërriste. Do ta bëj Shkrumb e hi! Shkrumb e hi!

— Po të të lëmë është i thësira, — i thësira.

— Me mallin tim mund të bëj si të dua!

— Tani nuk është më ytë!

Djali ngërdheshi fytyrën dhe u mat t'i hidhej Norës. I ati e kapi dhe e tërroqi pas vetes. Nuk bën kështu, bir nuk bën. Cdo gjë ka kohën e vet. Cdo gjë ka kohën e vet.

C'do, të thuash me këtë? — ndërpree Nora. Asgjë, zonjushë, asgjë. Kështu, eshtë ndërtuar kjo botë, me plot të papritura. Asgjë nuk eshtë e qëndruesh me.

— Më lër, baba, më lër! E kemi vënë me gjak këtë mall! Nuk të pikoni në zemër kur shikon si po ta grabisin hajdutët?

Nora la mënjanë blllokun e shënimëve dhe ia ngriti sytë djalit.

— Po vazhdove, të vjellësh, vrer, të hodha hekurat! — Hidhi, po ta mbajti, hidhi!

Mos ia vini re, zonjushë, kujto i vjen keq kur dikush bëhet zot në shtëpinë e tij.

— Ashtu eshtë, — tha Nora. — Dhe këtë ju e dini më mirë se kushdo tjetër.

— Bushtë! — klithi djali. — Bushtë e ndyrë!

— Merreni, — tha Nora e qetë.

Dy partizanë e kapën djalin dhe i hodhën hekurat. Djali u hutua dhe shikonte me habi hekurat që i shtrën-gonin kyçet e duarve. Shikonte hekurat pastaj të atin dhe nuk dinte ç'të bënte. Papritur lëshoi një dënesë. Partizanët e nxorën, jashtë nga dyqani dhe u nisën përmë komandë. Pas i ndoqën fëmijë. Djali ktheu kokën por i lati nuk kishte dalë te dera. I ati, mbështetur pas banakut, fshinte djersët e fitohta që e kishin mbuluar. Ai nuk foli gjatë téré kohës që vazhdoi konfiskimi. Kur i dorëzoi celësat, i tha me zë dutës Norës. — Doja të bisedoja pak me ju, zonjushë. — Mos më thërrisni zonjushë. — tha Nora dhe uq kthyte nga burri.

Më falni, e belbëzoj ai.

— Hë, flisni. Ç'keni për të më thënë? Këta janë shokët e mi, — foli ajo kur vuri re hezitimini e plakut.

— C'do të bëhet me djalin? — tha ai.

— Këtë nuk e di unë.

— Ju e këhi në dorë. Do t'ju lutem të më ndihmoni. Ai i ka nervat e shkatërruar! Dhë ju, si bije, e kuptioni se sa shqetësohet një përfundjalin që nuk e ka sagllam.

— Ai ishte krejt normal në fillim, — tha Nora e qetë.

— Jo, zonjushë! A mund të fyejë një djale normal një vajzë si jū? Ai i ka nervat e shkatërruar!

— Në qoftë se deshe të më lethoshë vetëm këtë, mos e uzgjatim kët, — tha Nora. — Ai nuk mund të fliste fidryshe, — tha përsëri, kesaj here më e qetë.

— Të mos humbasim kohë, — dhe bëri të dilte.

Kisha edhiqë dëçka. Shumë përgjigje kishin dhënë — Urdhëroj: Dëgj o kurrë dyqanët e qëndrojnë. — Ju at shpërblej së hënë kërkoni?

Nora riu ngulit sytë bufrit dhëni nuk dinte si nte fillontel të shfryntë dufin iqekishte zënëcëtësimblidhej në gjoks. Nuk e dinte edhe si po është kuptioni heshqjen e saj burri. Ajo pa se si ftyrash e burrit por shkdnë traktohej. — Më mirë, mbaj përtë shlyer tatimin! — i tha më tallje.

— Mos u shqetësoni për atë. — Ju veju i jap sa të doni.

Nora donte ta pështynte, por e mbajti vëten. Mbledhi buzet dhe u largua. Nën këmbet e saj dëbora e ngrirë kerciste lehtë. Burri nuk kishte fuqi ta ndiqte pas. Ai mbeti në pragutë dyqanit si një trung i rrëzuar. — E njejtë urrejtje, si tek i biri — mëndoi Nora. — Bile më e fortë.

Kur shkoi në shtëpi gjeti njerëz. Pranë Nikës, që i rihte në krye të dhomës së Shtruar, që Nimeti. Nora e mori më mend çkishte ndodhur. Nuk i mbajti dot lotët dhe shkoi iu hodh në qafë Nikës. Qëndroi gjatë në gjoksin e thate të saj. Trupi i Nikës mbante erë bukë. Nuk dinte çtë fliste. Kështu kishte heshtur edhe kur kishte shkuar më dy shokë të kompanisë së saj për të shpenë lajmin e vrashës së sho-

kut, të tyre. Po, ashtu në heshtje ishte kuptuar më mirë me nënën e partizanit të vrarë.

— Kur? — pyeti.

— Dje ndaj të ngrysur.

Dikush që rrimitë pranë Nikës u çua dhe i liroi vendin. Të tjerë hynë. Hynin të heshtur, duke shkelur me kujdes mbi qilim. Vinin njerëz pandërprerë. Qyteti ishte i vogël dhe lajmi që përhapur menjëherë. Atë natë e kaluan pa gjumë. Të nesërmen Nora u largua si zakonisht nga shtëpia. Ndiente një dhembje që i shtypte gjoksin. I vinte keq për Nikën, por i duhej të ikte.

Komisionet kishin shumë punë. Nëra kthehej vonë në shtëpi, por asnjëherë nuk e gjeti në gjumë Nikën. Ajo e priste mbështetur në dritare. Kur shikonte Norën, vinte buzën në gaz, për të fshehur diçka.

Norës po i vështirësohej të parët. Ai po i humbiste pak nga pak. «E kam nga lodhja, — mendonte. — Dhe nga të pagjumët.»

Një të dielë i erdhi radha dhe tregtarit Ligor Sojnuri. Ai i priste, prandaj ishte i qetë. Ngriti vetë qepenat e dyqanit dhe i la të hynin brenda. Shumica e rafiteve ishte bosh.

— Ky është tërë malli im, — tha.

— Tjetrin ku e ke futur?

Tjetër nuk kam. Po, të doni të vdes urie merrmani edhe këtë që më ka mbetur.

— Filloni, — u tha Nora anëtarëve të komisionit.

— Ju mund të keni shumë punë. Derisa, të mbaroni unë po shkoj të pi një kafe te kafeneja e Petros.

Nora nuk iu përgjigj dhe nxori bllokun. Malli që ishte nëpër rafte nuk shlyente as cerekun e tatimit. Nora ia tha këtë Ligor Sojnurit, por ai mblodhi supet.

— Këtë dhe shpirtin kam.

— Nuk na duhet shpirti yt.

— Jo, se edhe atë ju e keni në dorë.

— Qëkur kështu, or Ligor Sojnuri, e ke kuptuar

se edhe shpirtin ta kemi ne në dorë — tha një nga anëtarët e komisionit.

— Epo çoç kuptojmë edhe ne tani, — si përgjigj Ligori.

— Kjo nuk bën as sa çerekut i tatimit, — i thë përsëri Nora.

— Mos e keni vënë gabim tatimin? — i thë Ligori si naiv.

— Jo, e kemi vënë në rregull.

— Kontrolloje edhe një herë, kontrolloje!

— Mjaft u talle, — tha Nora. — Kute ke fshehum pjesën tjeter të mallit?

— Nuk kam fshehum mall, ju betohem.

— Mendohu mirë, Ligor Sojnuri, — tha një nga anëtarët e komisionit. — Në dyqanin tënd raftet thyeshin nga malli.

Thyeshin dikur, por jo tani. Tani miu thyen kokën. Mjaft u mora me tregti! Mé lodhi. Kisha kohë që mendoja të hiqja dorë. Shyqyr që fituat ju, sensi zor të hiqja dorë. Mé që futur në gjak. Dhe, përq'u hakma rrë, përvitet që më thithi i bëra rrush te kumbulla, të tëra lekët që nxora nga shitja e mallit. Tani më kanë mbetur vetëm këto rafte. Posmë, mirë. Jam rehat tani.

— Keni përtë paguar edhe tregerekun e tatimit, — tha Nora prerë.

— Skam, c'të jap më.

Mendohu mirë, — i thë Ligori.

— E c'të mendohem. Ju e shikoni dhe vetë c'më ka mbetur.

— Merreni, — tha Nora. — Kasëm, mylle dyqanin me çelës.

— Sikur ta myllja, vetë përherë të fundit? — tha Ligor Sojnuri.

— Jo, — tha Nora, dhe doline para onga dyqani gjysmë i shkretë i Ligor Sojnurit.

— Është më i përgjithshëm se përditësojmë —

— Përditësojmë, — i thë Ligori.

Që kur i arrestuan të atin, për doktorin Epaminonda Sojnuri ditët u bënë më të vështira. Ai humbi gjumin dhe priste që nga çasti në çast të trokitnin në derën e shtëpisë së tij dhe ta arrestonin, si fshehës floriri. Filloi të dyshonte te qdo njeri që e vështronte me kureshtje, te qdo zhurmë makine (shyqyr që ato ishin të pakta), te qdo trokitje në derë. Po ata nuk po vinin. Pö vonoheshin. Me sa dukej i ati heshtte. Megjithatë mjeku kishte një parandjenë se kjo heshtje nuk do të vazhdonte gjatë. «Sa mirë sikur të heshtte përgjithmonë. E ka shijuar jetën ai, tanigj do të qe mirë të heshtte.»

S'kaluanas dy javë, kur në derën e shtëpisë së tij u dëgjuan të trokitura. Mjeku u përpooq të shihte që prapa derës së verandës por njeriu që trokiste nuk dukej. Mjekull u mundua të paktën të njilte nga të trokiturat dorën e atij që trokiste, por ato treteshin shpejt. Edhe të trokiturat duhet të jenë të kodifikuara. E trokitura e babait. Jo, ai s'do të trokasë më në derë. Ai duhet të heshtë. Dhe heshtja nuk troket. E trokitura e nënës. Edhe ajo nuk duhet të hyjë. Dhe të dalë shumë në shtëpinë time, sa të stabilizohet gjendja. E trokitura e gruas. Ajo heshtë në shtëpi. E miqve, e shokëve, e patientëve.

Në derë trokitën përsëri. Trokitja ishte e dëshpëruar dhe lutëse. Megjithatë ishte e padukshme dhe e frikshme. Po të jetë ndonjë pacient do të mendojë se nuk jam në shtëpi dhe do të largohet. Sot nuk do të pres njeri. Që sot nuk kam nevójë për njerëz. E trokitura u përsërit dhe s'kishte ndër mend t'i ndahej derës. Ai vendosi të hapte derën. Ishte e ëma.

— C'kérkon kaq vonë? Mund të dyshojnë.

— Srrija dot vëtëm me memecen në shtëpi. Memecja më tremb.

— Mos u bëj e marrë. Ajo nuk di të flasë.

— Po unë nuk mund të hesht. Kam ftohtë.

Hynë në dhomën e ndenjtjes. Zjarri bubulonte.

Në, një dhomë si ajo nuk ndiheshin ngricat se janarit. Ngricat po shtrëngonin.

— Më jep diçka të mbledh veten, — tha e éma. — Ai i shtiu një gotë liker. Ajo e piu me, një frymë.

— Sikur ma solli zemrën në vend, — tha e éma. — dhe hoqi qyrkun e ngrohtë dherë trashë.

— E more vesh? Zoti Kozma vari veten, — tha ajo.

— Kozma! Po, ja po, oihna ka Hydri u sib. — Po!

— Po. Ja gjeten téré floririn e fsiehur dhe iskonfisidi kuan téré mallin. E shqja e kishte nuhatur se ai do vartë veten dhe e ruante. Por, ai edërgoi nga unë gjoja pér tē pyetur se mos kishin liruar. Ligorin dhen sa po ajo dol i nga ishtëpi vaniqveten.

— Me se? — pyeti e shoqjare mjekut. — Tu argosi?

— Me tel! — kështu e dëmtoi zëpa mësor. Nëq e dëmtoi.

— Me tel? — kështu e dëmtoi zëpa mësor. Nëq e dëmtoi.

— Po. Telit i zanë dorë dherë dñruk vuri po fare. Esidhi te hekurat e ballkonit dherë vax. Mos e kisha parë nuk do térésha trembun kaq shumë. Po, e shoqja më mori më vete sikur e ndiente tē keqen. I shkreti Kozma, kishte ngrirë dhe ishte mavjosur jetëri.

— Aman, matna, mos na tregoj më gjatë. Dhe meekaq! S'kab pér itë tha zënë gjumi natëtarë. Është më e jashtë. Tynuk do téré zërë sotë po sunë që kam kaqj net pa myllur isy? Lezatashqiqë do téré më shpifet i shkreti Kozma. Isqerit e dëmtoi zëpa mësor. Nëq e dëmtoi. — Vetë e ke fajin, që huk mësnië shtëpi, — i tha me qortim i jibiri. Isqerit e dëmtoi. — Vërtati është mësori i Përmes.

— Jo, vetëm kaq por, isapoju ktheva në shtëpi, më e mecca nuk më ndahej dherdointe tē mërrte vesh se c'kishten bërë vakin. I thirra, po ku dëgjon ajo Ngëë? Ngëë? — Pu po shqoju i thirra. — Po ku pushonte ajo Ngëë? Dhe na, lej çapëlente syri. — Mëongjethi pmishin më shumë sesa është i shkreti Kozma. S'durova dot dherdhate ju. — Shyqyr që ju kam!

— Ku do téré flesh? — e pyeti mjekut. — Zoti —

— Edhe më pyet për gjumë. Doptë rri si ku kudh, téré natën, këtu. Më shtjerë dëhe një gotë.

— Në dollap e ke téré shishen. Hajde tē shtrihem,

— I i tha së shoqes mjeku dhe doli nga dhoma. Pas tij rrëshqiti edhe e shoqja. Nëna mbeti e vetme në dhomë, e struktur pranë zjarrit, si një shpend i zi. Mjekun dhe të shogen i persekutoi për tërë natën pagjumësia e nënës.

Të nesërmen kishin dhembje koke dhe ishin të zbehëtë. Mjeku e përcollti për në shtëpi të emën. Vetë u kthyeshpejt dhe u mbyll në studio deri në drekkë dhe doli të bënte një xhiro atëherë kur zyrtarët linin punën. Bulevardi i shkurtër i atij qyteti ishte i shkretë. Edhe ata njerëz që shfaqëshin aty-këtu nxitonin. Mjeku mendoi se kishte bërë gabim që shëtiste dhe hyri në kafenenë që kishte më pranë. Emri i parë që i zuri veshi ishte emri i tregtarit të varur Kozma. Ai që e tregonte këtë varje kishte parë vetëm anën komike të saj. Mjeku për herë të parë kuptoi se edhe varja paska diçka komikë. Ai u ul te një tavolinë bosh në fund të sallës së mbushur tërë tym duhani. I zoti i kafenesë, Petroja, kishte vënë tërë ato tavolina duke shfrytëzuar qdo centimetër vend, aq sa kaméri i mezi lëvizte midis tyre. Përsëri mjekut i zuri veshi emrin e tregtarit të varur Kozma. Tani emri kishte një tingëllim tragjik, ashtu si i ka hije një varjeje. Mjeku u bë kurioz të shikonit se kush i dha tërë atë solemnitet emrit të Kozmait, por nuk guxoi të kthente kokën. Ai u kishte kthyer shpinën atyre që flisin. Mjeku u pendua që ishte treguar aq i pa kujdes shëm. Sa pa Lekon, kamerierin e dytë të kafenesë së Petros, u thartua në fytyrë. Lekoja mbahej si gjuha më e helmët e tërë kamerierëve. Bile, Petroja për këtë e mbante më punë, me gjithë ankimet e klientëve. Zakonisht kur donin të vini në lojë dikë e futnin më marifet në kafenenë e Petros dhei i shkelnin syrin Lekos. Mjeku u përpooq ta priste me buzëqëshje në shenjë armëpushimi. Lekoja dukej i lodhur.

— Paske pasur punë sot, — i tha mjeku.

— Zotit Petro, i vërtitet tatimi, ne u vërtitemi myshterinjve. Shqyr që ka filluar të pijë me dopio edhe sëra juaj. Çfarë t'ju sjell?

— Konjak.

— Sigurisht, dopie?

- Nuk po ta prish.

— Nuk po ta prisht. — Lekoja u largua. «Shyqyr», — tha mijeku. — Edhe ky bufon më, mungonte.» Diku nga mesi i kafenesë u përmend përsëri emri i tregtarit të varur Kozma. Këtë herë pa asnjë ngjyrë. Tymi i duhanit mbytte sallën. Dritaret dhe dera ishin të mbyllura mirë. Gati edhe fytyrat e njerëzve duke shini si njëpër mjegull. «Në kohë të tillë është mirë kur nuk ja dallon tjetrit, fytyrën edhe kur e ke ngjitur». Mjegulla sikur i largonte dhe i veçonte tavolinat. Mjeku nuk donte të ulej tjetërkush në tavolinën e tij. Ajo ishte si një ishull i veguar. «Robinson Kruzo, — i tha vetes, — Robinson Kruzo në ishullin Monte Kristo. Abat Faria, — kështu thirri të atin. — Hesht! Ti mos gabotë tregosh se ku gjendet thesari! Hesht! E ke në një vend të sigurt. Thesari i Ligor Sojnurit.»

Erdhi Lekoja. Ai la mbi tavolinë gotën e konjakut dhe u largua. „Kot nuk kam ardhur odo natë këtu.“ Ata që i dhanë emrit të Kozmait tingull tragjik u çuan. Të tjerët, si daktar — tha njëri prej tyre.

— Natën e mirë, doktor — tha njëri prej tyre.

— Natën e mirë.

Nga mjequlla doli një fytyrë e deformuar qe pyet:
— Ç'kemi nga yt atë?

«Mos ma prishni këtë natë me emrin e tij. Mjafton emri i Kozmait.» Mjeku bëri sikur nuk dëgjoi gjë. Fytyra e deformuar u zhduk përsëri në mjegull. «Si shtrigat te Makbethi. C'donin të më thoshin shtrigat? Ku drequin u shfaqën! Isha rehat.» Ai ngrati gotën me mërzi. Konjaku nuk po i pëlgente. Kaloi përsëri Lekoja dhe mbloodi pa folur i gotat e të porsangriturëve. U ulën të tjerë. «Do të flasin edhe këta për Kozmanë?» Të porsaulurit filluan të flisnin për shkollat që po qeleshin. Lekoja u ul në tavolinën e tyre dhe i dëgjonte në gojë. Ata vazhduan të flisnin për shkollat.

— Leko! Leko!
— C'keni?
— Të paguajmë se bu, bë ypnë
— Rrini dhe pak se do të kënageni.

— Léri shakatë, po eja se do të paguajmë!
Lekoja u ngrit.

— Leko, më sill mua një çaj, — tha mjeku.

Lekoja vuri buzën në gaz por përsëri nuk foli.
Mjeku e piu çajin por nuk i ngrihej të ikte në shtëpi. Djemtë që flisnin pér shkollat u quan. Edhe mjeku u quan pas tyre. Kur Lekoja po i kthente kusurin, mjeku ia shtyu dorën me intimitet. Ai kishte vendosur të vinte çdo mbrëmje këtu. Lekoja numëroi kusurin që i la mjeku dhe tha:

— Interesant, edhe yt atë para se ta futnin në burg u ul këtu dhe më la po aq bakshish sa edhe ti. Interesant, hë, doktor!

Mjeku nuk e kuptoi nëse Lekoja bënte shaka apo fliste seriozisht. Atij iu duk sikur nga mjegulla e tymit dolën përsëri shtrigat, të cilat heshtnin të pikëlluara. Përse heshtin shtrigat? Çfarë lexojnë pér fatin tim», gati sa nuk thirri mjeku Epaminonda Sojnuri, ndërsa Lekoja shkoi në një tavolinë tjetër, ku klientët s'kishin ndër mend të ngriheshin.

12

Mjeku Epamionda Sojnuri e priti me nënqeshje lajmin që i dha një koleg pér fejesën e Norës me Nimenin. Norën e njihnin gati të gjitha familjet e tregtarëve, të cilët nisën të shpresonin. «Kushedi e zbut ndopak gjëzimi i fejesës, ndjenja e familjes», — thoshin tani ata. Nimeni nuk e dinin ende se ç'funkcion kishite. Mjeku nënqeshi përsëri. «Sa mirë që u fejuan. Sepse edhe ndarja do të bëjë më bujë dhe do të jetë më e tmerrshme. Edhe më mirë sikur ajo të jetë me barrë.» Ai mezi priste që midis tyre të hynte përçarja, pavërisht se në fillim po dukej si një përçarje e thjeshtë familjare. Ai ndiqte çdo ditë lëvizjen e glaukomës drejt syve. Ajo duhet të avanconte dhe avanconte. «Bë-

hu epidemi. Përhapu, glaukomë dhe futu midis tyre që ata të mos njohin njëri-tjetrin». I ati heshtte. Kjo kishte rëndësi. Ai nuk shkoi dhe as që kishte ndër mend të shkonte, hëpërëhë, ta shihte të atin në burg. Kjo do të ishte një pakujdesi e pafalshme!

Kur hyri në shtëpi pa se në rruginën e ngushtët kishte hyrë dikush, «Grua», — tha ai. Në dhomën e zjarrit po e priste eëma. Ajo ishte e pikëlluar dhe e përlotur. Sapo pa të birin iu hodh në qafë.

— Epaminonda.. — tha ajo dhe nuk vazhdoi më gjatë se e mbyti ngashërimi.

— Vdiq? — tha mjeku dhe atë çast e kuptoi se e donte të atin.

— Kush?

— Babai.

— Jo, qoftë larg! — tha eëma. — Po është bërë kockë dhe lëkurë. As ha dhe as pi. Nuk e njoha fare.

— Ti ishe në burg?!

— Po.

— Dhe këtu po vjen drejt e nga burgu?

— Po.

— Po sa herë të kam thënë që të kesh kujdes! Ata mund të të ndjekin.

— Tek im bir vij, jo te ndonjë i huaj!

— Mama, — tha mjeku, — jetojmë në një kohë të tillë kur ka çaste që ti duhet të harrosh se më ke djale dhe unë se të kam nënë.

— Mos ndill të keqen, — tha eëma. — Mezi të kam.

Ajo zuri të qante me dënesë. Ai u prek. Nuk e kishte parë kurrrë të emën të qante kështu.

— Ta shihje si është bërë yt atë, Epaminonda, ta shihje.

— Epo në burg është, nuk është në verim,

I kërkojnë edhe trecerekun. Ata e dinë cdo gjë me saktësi, sikur t'i kemi pasur llogaritarë. Babai deri dje kishte ngulur këmbë se nuk kishte ç'të jepte më, po sot m'u duk sikur e kishte lëshuar keq veten. Gjeti rastin dhe më pëshpëriti që florinjtë t'i gojmë përsëri në shtëpinë tonë, gjoja sikur kanë qenë gjithmonë aty.

dhe babait iu kujtua tanë që kishte fshehir edhe diçka.
Ata do të vijnë ti marrin, kurse ti nuk prekesh fare.

— Kush do ti çojë? — pyeti mjeku.
— Unë, ti dhe memecja.

— Jo, — tha mjeku, ky do të ishte budallallëku më i madhi.

— Po, që të bëjmë, bir, se mës dua unë, se mos do yt atë.

Mjeku filloi të vërtitej nëpër sallón.

— Lë të mos tregojë, — tha ai duke u kthyer menjëherë nga eëma me një fytyrë që e trembi. — Shko që nesër dhe i thuaj që të mos tregojë!

— Po ata e dinë dhe ngulin këmbë.

— Le t'u tregojë përrallën për varrin e kurbatit.

— Cështë ky varr, bir? Përse përmend varrin?

— E di babai përrallën, e di edhe si ta tregojë.

— Po të mos paguajë tatimin do të vdesë në burg!

— Të gjithë do të vdesim një ditë, kështu që pak rëndesi ka se ku do të vdesim. Le t'u tregojë përrallën e varrit të kurbatit. Kështu i thuaj. Shkoji që nesër, dëgjon, që nesër. Sonte fli këtu. Mos dil fare. Eshtë ftohtë dhe mund të ftoshesh.

Ai hyri në dhomën e gjumit dhe i shtritë flinte. Jashtë era ankohej dégëve të zhveshura të mollëve. E nesërimja ishte një ankth i padurueshëm. I ati i dërgoi fjalë me anë të s'ëmës se po të mos e hanin edhe përrallën e varrit të kurbatit, do të tregonte se ku ishin florinjtë. Mjeku u bë si i tërbuar dhe nuk dinte si të shfrynte vrerin.

— Paska pasur shtatë shpirtra, sa të maces, — tha.

— Mës fol kështu, se e ke baba, — tha eëma e trembur.

— Po ai nuk më ka djalë? Pse do të tregojë? Apo mos do që të kalbemi të dy në burg? Më siguri. «Gjersa ia kam dhënë unë jetën, mund t'i a marr kur të dua.» Kështu mendon dhe nuk çan kokën që unë nuk kam shijuar as gjysmën e jetës. Për vete, atij nuk i ka mbetur gjë pa i marrë jetës. Vetëm shpirti im. Gjersa më ka dhënë ai.

Mjeku¹ heshti dhe vështroi të ëmën² drejt e në sy. Ajo u trembo iu prenë këmbët. «Ku të mbështetëm? — Nuk shihte gjë. — Errësirë. — Ku të mbahem që të mos rrëzohem?» Ajo bëri një hap dhe ra përtokë. Kur u përmend, pa pranë të birin me të shoqen.

— Je pak më mirë, mama? — e pyeti i biri.

— Më mirë, më mirë, — tha ajo me një zë të vdekur.

Veçse sytë e zmadhuar tej masës pyesnin akoma. «Kush e lëshoi gjëmën në shtëpinë tonë? Kush?»

«Një nga simptomat e glaukomës është zgjerimi i bëbes së syrit. Kemi dy lloj glaukomash. Glaukomenët i fllastare dhe glaukomë... Diagnostikimi sa më i shpejtë i glaukomës ka një rëndësi vendimtare, sepse fillimi i menjëherëshëm i mjekimit parandalon humbjen e të parit.» Bëbja e zmadhuar... Nëna e ka bëben e syrit të zmadhuar... Nëna e ka bëben e syrit të zmadhuar. Burrin më të egër, përveç gruas, nuk ka kush ta zbutë tjetër... Përse iu kujtuat tani kjo frazë e shkëputur nga filosofët? Mjeku veshi pallton e trashë dhe u mat të dilte. Në prag të derës ndaloj dhe tha:

— Dómethënë, po të mës e hanë përrallën e varrit të kurbatit, do të tregojë se ku janë fshehur florinjtë?

— Po, kështu më pëshpëriti.

— E dëgjove mirë apo të bënë veshët?

— Ma përsëriti disa herë. Disa herë.

Mjeku doli me rrëmbim nga dhoma, bile s'i vuri vesh as së shoqes, që e tronditur e pyeti:

— Kui po shkon kështu, Epaminonda? — Mjeku nuk shikonte ku shkelte. Në rrugicën e ngushtë të oborrit u formuan shumë gjurmë, sikur aty kishin hyrë disa njerëz. Edhe gjysmën e rrugës mjeku e bëri pa pâre se kui i hidhte hapat. Disa herë u përpoq të ecte si zakonisht, të përshëndeste si zakonisht të njohurit dhe të dëgjonte nëse endej nëpër rrugët e atij qyteti edhe atë çast si fantazmë, emri i ndonjë krimineli të vrarë apo tregtarit të varur. Pse nuk del edhe fantazma e tim eti rrugëve, kafeneve? Përse nuk po del? Jám kurioz të shoh një fantazmë!

Ai hyri, në zyrat e Mbrojtjes dhe kërkoi Nimet Mngomatën. I thanë të priste, se shoku Nimet ishte i zënë: Mjeku kapi pakujdesinë e tij të parë, nuk tha se kërkonte shokun, Nimet. Po pres. Pritja është edhe mungësi për shfajësim.

Nimet i po vonohej të dilte. Dezhurni pyeti përsëri, dikë: I thanë në se personi që kërkonte shokun Nimet nuk kishte ndonjë punë të ngutshme, le të vinte nesër.

— Doni ta takoni patjetër sonte?

— Patjetër! Shoku thotë se do ta takojë patjetër sonte... Si urdhëron... Pas një ore... Pas një ore shoku Nimet është i lirë.

Mjeku u mendua. Nuk dinte ku ta kalonte atë orë. Dhe ajo nuk ishte një orë priti jeje e zakonshme. Kishte raste kur pacientët e prisnin atë edhe një ditë. E prisnin mbështetur pas murit përballë shtëpisë së tij. Dhe kur ai shfaqej në krye të rrugës, ata çoheshin me zonë dhe e përshëndetnin. E ai u buzëqeshte i kënaqur. Tanë i dukej vetja sikur kishte dicka, nga pacientët e kjo e nervozonte, po... «Pas një ore shoku Nimet është i lirë». Ku ta kalonte këtë orë?

— A mund ta pres këtu shokun Nimet?

— Si të duash, — tha dezhurni.

Mjeku i buzëgashi dhe u uli në stol. Dezhurni vazhdonte leximin e një libri. Ishte një libër i vjetër dhe mjaft i përdorur. Me siguri ndonjë roman dashurie tragjike apo sentimentale. Pas luftës ata kanë nevojë të zbutin zemrën me romane të tillë. Mjeku u bë kurioz të lexonte titullin e librit. Po nuk guxonte ta pyeste dezhurnin.

Dezhurnin e thirrën dhe ai, para se të largohej, mbylli librin. Mjeku lexoi shpejt e shpejt titullin e librit. Kapitali. Mjeku nuk mund t'u besonte syve. «A mund ta kuptonte ky djalë i rëndomtë dramën e kapitalit?» Dhe mjekut do t'i pëlgente të tallej me djalin. Po nuk guxonte: «Cili është autor i dramës, djalosh? Shekspiri apo Eskili? Mé falni, Eskili apo Shekspiri?» Mjeku yuri

buzën në gaz. «Kur nuk i ke dëgjuar këta, si mund ta kuptosh dramën e lashtë të kapitalit?» Dezhurni u ul përsëri në tavolinë pa e parë fare injekun. Mjeku u shqetësua. Mos vallë ia kishte nuhatur mendimet? «Më mirë mos mendo fare... Sa faqe lexon në orë ky djalë?» Mjeku pa fshehurazi orën. Djali e ktheu faqen e parë si kishin kaluar njëzet minuta. «Dramat e kapitalit nuk ndodhin kurrë brenda njëzet minutave. Ato mund të ndodhin o brenda njëzet vjetve, o brenda njëzet sekondave.» Kur dezhurni kishte lexuar faqen e tretë, kishte kaluar më shumë se një orë dhe Nimeti nuk po dilte akoma.

— U mërzite? — e pyeti mjekun dezhurni.

— Jo, — tha ai, — kanë shumë punë.

— Nuk e merr me mend. Po ti ke hallin tënd që do ta takosh Nimetin apo ke hall shoqëror?

— Hall shoqëror, — u përgjigj i hutuar mjeku nga ajo pyetje jo e zakonshme.

— Shumë mirë. Që sot ne duhet të kemi vetëm halle shoqërore, ashtu si edhe prona duhet të jetë shoqërore dhe jo private. Se tërë të këqijat e botës nga malli privat i kanë ardhur.

— Ashtu është, ashtu.

— Sepse prona private... — dezhurni e ndërpren përritur fjalën. Në korridor u duk Nimeti me kapotën hedhur krahëve.

13

Mjeku u çua në këmbë dhe i doli përpëra. Nimeti ishte i lodhur. Dukej që kishte net pa fjetur mirë. Nga kjo dukej edhe më i ashpër se atë natë kur përplasi revolen mbi tavolinë. «Qenka nga ata njerëz që ashpërsinë e kanë natyrë të dytë». Megjithatë, mjeku diku kishte lexuar se njerëzit e ashpër në disa rrethana bëhen më sentimentalë se edhe sentimentalët e përjetshëm. Dhe sonte mjeku kishte vendosur ta prekte Nimetin.

— Kush më kërkoi mua? — pyeti Nimeti dezhurnin.

— Ky shoku, — u përgjigj dezhurni.

Nimet i ia nguli sytë mjekut dhe iu drejtua përsëri dezhurnit:

— Ka zjarr dhoma e pritjes?

— Jo, e fika se...

«Mos vallë mendon se po vij t'i lutem? Unë nuk kam pér t'iu lutur. Interesi është i barabartë, prandaj dhe biseda duhet të jetë midis të barabartave.» Mjeku mori zemër nga mendimet e veta dhe tha:

— Në goftë se nuk kini më punë këtu, po ju përcell deri në shtëpi. Rrugës dhe bisedojmë.

— Natën e mirë Jakup, — i tha Nimeti dezhurnit. — Për çdo rast di si të më lajmërosh.

— Mos kini merak shoku Nimet, — tha dezhurni duke e nderuar.

Nimet i futi krahët kapotës dhe sapo dolën jashtë ngriti jakën e saj. Frynte erë. «Ishallah hap kohën kjo erë», mendoi Nimeti dhe pa qielin. Ky zakon iu bë që kur dëbora bllokoi rrugët dhe pengonte furnizimin e qytetit me miell dhe dru. Ai shihte retë mos kishin pësuar ndonjë të çarë në atë monongjyrën e tyre të plumbtë, të rëndë. Jo, qiellli ishte i téré gri. Të dy, Nimeti dhe mjeku bënë një copë udhë pa folur. Në rrugë kalonte më të rrallë ndonjë njeri, që i përkulur nxitonte pér në shtëpi. Më në fund Nimeti nuk duroi dhe pyeti:

— Përse donit të më takonit?

Mjeku u gëlltit dhe mbloqhi cepat e buzëve.

— Si t'ju them, — foli ai, — ju kërkova pér diçka që na intereson të dyve. Po të mos ishte interesi reciprok nuk do të guxoja t'ju ndaloja.

Nimet i vështroi orën e dorës nën dritën e një llambë elektrike.

— Po ju dëgjoj, — tha.

— Në goftë se nuk keni fjetur, vij dhe ju takoj nesër.

— Kush tha se nuk kam fjetur?

Mjeku buzëqeshi.

- Profesioni im, — tha.
- Përse më kërkuat?
- Po i bie shkurt. Se ndoshta ju presin. Të trashë-goheni!

Nimetit tundi paksa kokën dhe s'merrte dot me mend se ku donte të dilte tjetër.

- Si e keni gruan me shëndet? — pyeti mjeku.
- Përse më kërkuat?

Mjeku e kishte mbledhur veten dhe ishte shumë i sigurt. Ai mezi po priste sa të shikonte shkrirjen e ashpërsisë, që ia jepte pushteti këtij djali.

— Kur ju pyeta për gruan, ju pyeta si çdo mjek. Tani, përvèç mjekut dua të jem edhe bir. Im atë është në burg. Burgu është një lloj verbimi. Gruaja jote është e sëmurë nga sytë. E mund të verbohet. Verbimi është edhe ai burg. Ti do që gruaja të të shërohet. Unë dua të më lirohet babai nga burgu.

- A janë këto të dyja të barabarta?
- Varet si i sheh. Për mua janë të barabarta.
- Kurse për mua, jo.

— Mundet. Veçse ti nuk e di se ç'sëmundje e kërcënnon tët shoqe, unë nuk di sa do të qëndrojë babai im mbyllur në burg.

— Të dyja do të merren vesh. S'është ndonjë zor, apo jo?

— Ndërsa unë mendoj që këto mund të merren vesh që sonte.

— Shumë mirë. Përsa i përkët sëmundjes së gruas sime nuk di të përgjigjem, se nuk jam mjek, ndërsa përsa i përkët babait tënd ai do të qëndrojë në burg derisa të shlyejë tatimin.

- Po sikur të mos e shlyejë?
- Nuk ma merr mendja. E di se i dhimbsen florinjtë, por amajeta i dhimbset më shumë. Ai shpreson se mund t'i vërë përsëri në vend humbjet. Si çdo tregtar.

Mjeku u rrudh në fytyrë. Tani ishte i sigurt se i ati do të tregonte. Kjo, në mos nesër, do të ndodhë patjetë pasnesër. Dhe ai do të akuzohej si bashkautor. Terri-

tori neutral, diiku në studion e tij, nuk do të ishte më i tillë. Ai nuk do të ishte më varri i humbur i kurbatit.

— Gruan tënde e kërcënnon glaukoma, sëmundja më e tmerrshme e syve! Glaukoma është verbëri e plotë. Vetëm unë mund ta shëroj.

— Kur e vizituat nuk na e thatë këtë. Bile ju e thjeshtuat aq shumë sëmundjen, sa asaj i erdhi rëndë që u vizitua. Mos u bëtë tani mjek?

— Jo, tani u bëra bir. Po më liruat babanë, unë jua jap me shkrim që do t'jua shëroj gruan.

Nimetin ndaloi.

— Ç'kuptim ka kjo me shkrim?

— Që do t'jua shëroj.

— Ju vetë?

— Kjo nuk ka shumë rëndësi. Unë do t'jua sjell të shëruar. Po e mjekuat akoma me acid borik, ajo ka për t'u verbuar. Dhe ndofta ju e doni tani kështu siç është, sepse jeni në fillim të martesës, po zakonisht me kohë të mërzitet një grua e rregullt e jo më një e verbër. Edhe për të kryer nevojat do ta çosh për dore, si një plakë uloke.

Nimetin u drodh dhe u zverdh. U kthyte me rrëmbim nga mjeku dhe e kapi me të dyja duart pas jakës së palltos aq fort, sa kërcitën penjtë. E shkundi disa herë dhe i erdhi ndot kur pa sqalljen e tjetrit. Mjekut i ranë syzet mbi dëborë. Buza e poshtme i dridhej. Nimetin e lëshoi. Mjeku u ul dhe mori syzet. I vuri. Rregulloi pallton. Ai nuk kishte forcë. Gjithmonë kishte pasur frikë nga dhuna. Ishte bërë mbi dyzet vjeç dhe nuk ishte rrahuar një herë. Vetëm ishte kënaqur si dekompozohej nga sëmundja edhe trupi më muskuloz. Vetëm se ishte kënaqur kur kishte parë se si i luteshin t'i shëronte njerëz që rriheshin ditë për ditë dhe që i kishin gjoksin dhe krahët e fuqishëm. Deri atëherë i ishin lutur.

— Të vërtetat mjekësore gjithmonë shkaktojnë reagime të tilla, — tha ai i qetë, sikur nuk kishte ndodhur gjë.

- Ti je një maskara që nuk e ke shokun.
- Nuk është maskara një njeri që do të shpëtojë të atin.
- Të atin maskara e shpëton vetëm një bir maskara.

Mjeku qeshi.

- Nuk po kuptohemi. T'i biem shkurt. Ne të dy duam të shpëtojmë dy të verbër. Unë 'babanë, se burgu është vërbëria e jetës, ti gruan. Ti edhe mund ta ndash, por kjo nuk do të ishte e ndershme. Sa ishte me sy...

Nimet e shtrëngoi përsëri nga jakat, po në çast u kujtua e lëshoi dhe eci përpara duke çarë dëborën e ngirrë. Mjeku u bë gati t'i thërriste të kthehej por nuk kishte fuqi. U përpoq ta ndiqte pas dhe t'i lutej, por Nimeti çante përpara. Atë e mbyti një ngashërim i brendshëm.

- Glaukoma! Glaukoma! — tha zbehtë dhe hapi i tmerruar sytë e tij.

TAKIM PAS KATËR VJETËSH

Ata rrinin në verandën e hotel «Turizmit» dhe prisnin të hapej restoranti. Ergysi shikonte majën më të lartë të të gjitha majave të Shqipërisë dhe i dukej e habitshme që e kishte aq pranë. I qe kyçur goja dhe mendonte se sa larg shtëpisë ndodhej tanë. Qyteti i vogël verior po zhytej pak nga pak nën një avull të lehtë, të bardhë. Ergysit i pëlqeu qyteti dhe përroi i shterur poshtë tij. Ai pyeti të atin dhe Petro Morava i tha se në verë përrenjtë e vegjël gjithmonë shterojnë.

- Ku bie më shumë dëborë, në Korçë apo këtu?
- pyeti përsëri Ergysi.
 - Në Korçë, -- tha Petro Morava.
 - Po këtu është maja më e lartë e tërë majave!
 - u habit Ergysi.

— Unë nuk thashë për në mal, thashë për në qytet.
Atje, — Petro Morava bëri me kokë nga maja e cila
gati dimër-verë nuk e ndante mjegullën, — ka dëborë
gjatë tërë vitit.

— Vete dot makina deri në majë?

— Jo.

— Po njeriu?

— Vete.

— Po unë a shkoj dot po të dua?

— Në majën më të lartë!

— Po.

— E përse ke qejf të shkosh?

— Nuk e di, — u përgjigj i mërzitur Ergysi. — Nuk
e di përse dua. Kam dëgjuar se është shumë zor të
ngjitesh.

— Zor është. Në dimër, kur fryn dhe bie dëborë
as që mendohet, por edhe tani...

— Përse nuk ma thua copë, që je i vogël e nuk
ngjitesh dot.

— Sepse do të mërzitesh e do të varësh turinjtë
dhe unë nuk dua të të shoh kështu.

— Po ti ma thuaj, se unë nuk kam për tu mërzitur.

Petro Morava qeshi dhe përkëdheli flokët e të birit.
Kishin dy ditë që qenë nisur nga Korça. Natën e parë
fjetën në Qafëkrrabë, kurse sonte do t'i zinte nata para
Urës së Matit.

— Po të nisem tani, kur arrij në majë? — tha Ergysi
dhe vështroi të atin në sy se mos i dredhonte pyetjes.

— Kur arrin? — tha Petro Morava dhe vështroi i
menduar majën. — Ndofta nuk arrin dot, sepse mund të
kthehet nga mesi i rrugës.

— E përse të kthehem? — pyeti Ergysi.

— Nuk e di, të keqen babai, nuk e di. Veçse s'ka
gjë më të keqe sesa të kthehet pa arritur atje për
ku je nisur.

— Po përse të kthehem? — nguli këmbë Ergysi.

— Nuk e di. Ndofta ngaqë ke qejf të nisesh vetëm
dhe jo me shokë.

Djali nuک kuptoi gjë dhe heshti. Restoranti nuک po hapej akoma. Mjegulla mbi majën më të lartë sa vente dhe zbriste më poshtë. Edhe mbi çatitë e atij qyteti të vogël në veri të Shqipërisë, po ulej nata e kthjellët verore. Aty nata duhej të ishte e freskët. Ergysi e harroi bisedën e nisur me të atin dhe po i vinte keq që nuk do të flinte atë natë aty. Ai nuk i harronte kurrë vendet ku flinte me të atin. Kurse atë qytet do ta kujtonte me një farë keqardhjeje sepse nuk kishin fjetur një natë.

— Shkojmë hamë pak bulkë, se u hap restoranti, — tha Petro Morava.

— Nuk më hahet, — tha Ergysi. Atij i kishte ikur papritur oreksi.

— Mirë, mirë, eja fut gjëkafshë në gojë se kemi tërë natën përpara.

Petro Morava eci drejt restorantit pa e kthyer kokën pas të shihte nëse po e ndiqte edhe i biri apo jo. Djali vështroi mjegullën mbi majën më të lartë dhe hodhi me përtim këmbët. Sepse i dukej se kur të dilnin nga restoranti ai nuک do ta shihte më majën më të lartë të të gjitha majave. Dhe vërtet kur dolën nga restoranti jo vetëm maja nuk dukej, por edhe malet. Kishte rënë nata. Qyteti i vogël kishte ndezur dritat dhe nëpër rrugë shëtisinin banorët e tij. Ata të dy i ranë mes për mes qytetit dhe zbritën poshtë tek agjencia, ku Petro Morava kishte lënë makinën.

— A keni një vend deri te Tre Currilat?

— Hip, — tha Petroja dhe ndezi motorin.

Ergysi nuk e pa atë që hipni në kabinë. Ai po shikonte qytetin që u zhduk menjëherë pas një kodre. Por Ergysi e solli ndër mend ashtu si e pa nga veranda e hotel «Turizmit». Sepse i ishte bërë zakon që qytetet dhe fshatrat t'i sillte ndër mend gjithmonë buzë muzgu. Vetë nuک dinte si ta shpjegonte këtë gjë. Por edhe nuک ishtë munduar ta shpjegonte. Ndofta po të ishte përpjekur mund të thoshte vetëm kaq, se pikërisht buzëmuzgu nisej për në Korçë i ati, nga fshatrat apo qytetet.

Makina ekte paralel me vendin nga ku dukej maja

më e lartë e maleve. Ergysi u përkul pak dhe pa se po dilte hiëna. Ajo kishte filluar të hahej nga perëndimi. Ergysi shikonte se si lëviznin siluetat e maleve. Nga jashtë hynte në kabinë një erë e freskët përzjerë me aromën e tokës që vaditej.

— Prej nga të kemi? — e pyeti Petro Morava pasagjerin.

— Nga një fshat përtej urës së Zerqanit, — u përgjigj pasagjeri. — Vetë punoj në Peshkopi.

— Pleqtë në fshat i ke?

— Në fshat.

— I kujton nga pak apo jo?

— Si nuk i kujtoj! U shkoj qdo të shtunë, bashkë me gruan dhe vajzën. Ajo u mis me makinën e konsumit, më parë. Po ky, yt bir është?

— Im bir.

— Do ta bësh edhe këtë shofer?

— Le të bëhet ç'të dojë, vetëm njeri i prapë mos bëhet.

Makina po ecte mes disa drurëve që dukeshin si të ngrirë nga drita e hënës. Zhurma e motorit mbytte zhurmat e natës. Në një kthesë, atje ku shkëputet rruga e sektorit, dikush zgjati dorën. Petro Morava frenoi. Njeriu vrapi para dritave dhe i doli në krah Petros.

— Për në Tiranë, — tha ai.

— Sonte nuk shkoj dot deri në Tiranë. Po të duash eja deri në Burrel.

— Thashë se ngela këtu! — tha i lehtësuar pasagjeri i ri.

— Punë e madhe, se mos do të ngelje jashtë, — tha Petroja.

— Ashtu është, po ndryshe e bën gjunin në shtëpinë tënde dhe ndryshe te një i huaj.

— Ne i presim mirë miqtë, — tha pasagjeri që hipi në Peshkopi.

— Se mos ju shava, — tha pa e kthyer kokën pasagjeri i ri. Në kabinë ra heshtja. Të katër sikur po përpinqeshin të gjenin se me ç'njerez e solli rasti të udhëtonin. Po brenda nuk kishte aq dritë sa ta vështroje

tjetrin në fytyrë. Pasagjeri që posa hipë nxori paketën e cigareve dhe ia zgjati Petros.

— Po mundohem ta lë dreqin, — tha ai.

— Ju jeni shoferi i parë që kërkon të lërë duhanin, — tha pasagjeri i porsahipur dhe sepse vuri buzën në gaz.

— Singerisht ti je Andrea Ligori, — tha pasagjeri që hipë në Peshkopi dhe u zgjat ta përqafonte. Andrea Ligori u habit dhe i dha vetëm dorën.

— O... si dukesh? — tha ai.

— Sa vjet kemi pa u parë? Katër! E, si shkojnë vitet. Si uji. Kemi mbaruar bashkë fakultetin dhe kemi tërë ato kuqitime.

— S'ia kemi kaluar aq keq, — tha Andrea Ligori.

— Sa ke këtej me shërbim?

— Sot erdha.

— Dhe po ikën sëaq shpejt! Singerisht, nuk të lë të ikësh. Do të vish nga unë sonte. Edhe pleqtë gëzohen dhe me gruan të njoh.

— Me gjithë qejf, por nuk mundem.

— Përse, — tha i mërzitur pasagjeri që hipë në Peshkopi. — Nesër është e diel dhe ti e ke pushim.

— Ndonjëherë tjetër, — tha Andrea Ligori me një ton të tillë që ta linin atë muhabet.

— Jo, jo, do të vish sonte. Edhe nata është e bukur. Rrimë në kopsht dhe po të kesh qejf e gdhijmë. Kemi katër vjet pa u parë! Si kalojnë vitet. Si uji.

— Ndonjëherë tjetër, — tha përsëri Andrea Ligori dhe të gjithë e kuptuam se atij nuk i pëlqente të qëndronte atë natë aty. Këtë më mirë se kushdo e kuptoi pasagjeri që hipë në Peshkopi dhe Petro Morava.

— Sa fëmijë ke? — e pyeti Andrea Ligori shokun e vet për të thyer heshtjen, e papritur dhe të ftohtë që ra në kabinë.

— Një vajzë. Po ti mos më pyet më se edhe unë nuk po të pyes. E lëmë kur të shkojmë në shtëpinë time. Atje bisedojmë gjerë e gjatë. Apo nuk të kënaq dhe biseda në kopsht në një natë si kjo. Rri shpesh me babanë dhe nuk e marrim vesh se si na kalon mesi i natës.

E çfarë bisedojmë, thoni ju. As vëtë nuk e dimë. Vëcse kur ngrihem i tē biem tē flemë nuk na bën zemra tē largohemi nga kopshti. Sonte ka edhe hënë dhe mollët tē clodhin.

— Edhe mua më pëlqen tē rri në oborr kur kthehem nga udhëtimi, — tha Petro Morava. — Sa tē më rritet edhe pak ky pa di unë si t'ia shtroj. Apo jo, o spurdhjak?

Ergysi u fye kur i ati i tha spurdhjak. Ai nuk foli. Por më shumë se nga fjalët e tē atit ai u mërzit nga mosha e vet. Ishte akoma i vogël që tē pérzihej në bisedat e tē rriturve. Ai u ngjesh në sedilie dhe heshti i menduar.

— Plaku mezi pret sa tē vijë e shtuna. I bën gati tē gjitha që më parë kur shkoj e gjëj në kopsht. Pa le kur i çoj edhe ndonjë mysafir! Do ta shikosh vëtë, Andrea.

— Nuk mund tē vij, — tha Andrea Ligori, këtë herë prerë dhe si i bezdisur nga tërë ato tē lutura.

— Pse mos t'i shkosh, o derëbardhë! — tha Petro Morava. — Keni katër vjet pa u parë dhe kushedi se kur mund tē takoheni përsëri.

— Dhe nuk e merr me mend se sa gjëra kemi për tē kujtuar.

— Si tē mos keni. Unë kam raste që njoh një njeri vetëm për disa orë dhe kam mall ta takoj dhe jo ju që keni bërë shkollë bashkë, — tha Petro Morava.

Andrea Ligori i dëgjonte me buzën në gaz dhe nuk po u ndërhyrte në bisedë. Dukej sikur ajo i interesonte më pak se gjithë tē tjerat. Nga larg dritërat e fshatrave lëshonin një vezullim tē ngrohtë. Ergysin e zuri malli për shokët e tij.

— Po ti a je i martuar? — i tha Petroja Andrea Ligorit.

— Jo.

— Po c'pret akoma?

— S'më mbushet mendja.

Ata ecën edhe pak dhe Ergysi pa se si Andrea

Ligori u kthye me kujdes prapa dhe i pëshpëriti pasa-gjerit që hipit në Peshkopi:

— Jo çdo dashuri është e thënë të përfundojë.

Pastaj nxori paketën dhe e ndezi. As që u bë ku-reshtar të shikonte se ç'përshtypje i bënë fjalët e tij shokut.

Pasagjeri që hipit në Peshkopi sikur u mbyll në vetvete dhe sikur u trishtua. Dhe atë natë ai nuk don-te të ishte i trishtuar. Në fshat po e priste i ati. Nata ishte e bukur, me hënë, kopshti me mollë prarohej nga drita e saj. I ati kishte nxjerrë tavolinën. Ai u mat të pyeste përdicë, po sepse u step.

— Unë dëgjova sikur ti... — tha më në fund ai.

— Llafe, — tha shpejt e shpejt Andrea Ligori. — Ajo ishte një dehje studenteske dhe asgjë tjetër. Ollga mund të ishte vajzë e mirë, por ajo nuk hiqte dorë dot nga provincialiteti i saj. Ka njerëz që kudo t'i çosh mbeten pérherë provincialë.

— Nuk ju kuptoj.

— Më mirë. Dhe as mos u përpinq ta kuptosh.

— Ne e donim të gjithë... Ajo ishte e urtë dhe e zgjuar.

Andrea Ligori u kthye me një farë nervozizmi prapa. Siç dukej këtë ia kishin thënë shumë veta.

— Mundet të jetë si thoni ju, por asnjëri nuk e njohu më mirë sesa unë. Ajo mbaroi fakultetin me atë psikologji që erdhë nga provinca.

— Ku është tan? — pyeti pasagjeri që hipit në Peshkopi me një zë të mbytur.

— Nuk e di me saktësi. Para një viti ishte arsim-tare në një fshat, pranë qytetit të saj. Ishalla e kanë afruar pranë shtëpisë këtë vit.

Petro Morava e ndjeu se bëseda për atë vajzë me emrin Ollgë e kishte ftohur takimin e dy shokëve. Mbi fytyrën e Andrea Ligorit binte drita e hënës dhe ajo dukej aq e qetë dhe aq e kënaqur. Dhe as vetë Petroja nuk e kuptoi se si atë çast përfytyroi vajzën me emrin Ollgë, diku buzë xhades duke pritur ndonjë makinë për t'u kthyer në qytet, muzgjeve të së

shtunave. Ai nuk i linte kurrë në rrugë mësueset. Bile kontrolli rrugor, një mbasdite me llohë të ftohtë, i kishte hequr latën e parë sepse kishte marrë një mësueset jashtë vendeve. Petro Morava nuk ishte mërzitur. Sikur t'ia hiqnin latën pér ndonjë gabim tjetër ai do të mërzitez shumë. Zakonisht mësueset ishin vajza të urta dhe nuk bënin zë kur shoferët mblidhnin supet pér tu shprehur keqardhjen që nuk i merrnin dot se i kishin vendet e zëna. Petroja nuk e mbante mend se që kur filloi t'i quajë mësueset bija. Ai vështroi përsëri dy shokët. Andrea Ligori kishte ndezur një cigare tjetër dhe sytë sikur i ishin zvogëluar. Pasagjeri që hipi në Peshkopi, apo hasi vështrimin e Petros i buzëqeshi si një fëmijë i zënë në faj padashur. Ai largoi menjëherë sytë dhe Petros iu duk sikur mbi shpatullat e tij kishin vënë papritur një ngarkesë të rëndë, peshën e së cilës nuk e kishte përfytyruar deri atëherë. Petroja donte ta lehtësonte nga ajo barrë.

— Domethënë plaku po të pret tani në kopsht? — tha ai.

— Më pret. A do të vish, Andrea?

— Nuk kam mundësi.

— Po ti nuk arrin dot sonte në Tiranë.

— Ku dihet. Tani është verë. Ndofta gjiej ndonjë shofer hallexhi, — tha Andrea Ligori dhe i shkeli syrin.

Për fat Petro Morava nuk e kishte mendjen aty dhe nuk e pa. Po ta kishte parë kushedi si do të nxehj. Ai nxehjej rrallë por, kur nxehjej, inati i dilte vonë. Më mirë se kushdo këtë e dinte Ergysi, që kishte mbertur i hutuar. Ai ishte i vogël dhe nuk mund të gjykonte veprimet e të rriturve, por më intuitën e fëmijës e kishte kuptuar se i ati nuk nxehjej kot. Që i ati nuk nxehjej kot e kishte dëgjuar edhe nga shoferët e tjerë. Edhe Ergysit nuk po i pëlgente Andrea Ligori. Po ta pyeste atë çast dikush përsë nuk i pëlgente Andrea Ligori, ai do të mblidhë supet. Ndofta sepse nuk po shkonte te fshati i pasagjerit tjetër. Sa pér atë vajzë me emrin Ollgë, ai nuk arrinte të përfytyronte se si i kishte ftohur ashtu të dy shokët e shkollës.

— Para një muaji isha në Tiranë dhe të kërkova,
— tha pasagjeri që hipi në Peshkopi.

— Nuk jam më në komunale. Kam kaluar në Tregtinë e Jashtme.

— Më thanë dhei më dhanë numurin e telefonit. Të mora në telefon. Në fillim m'u duk si zëri yt dhe u gëzova, po pastaj më doli një shoku yt dhe më tha se kishe ikur me shërbim në Tepelenë.

— Muajt e verës mbytemi me shërbime, — tha shpejt e shpejt Andrea Ligori sikur i trembej diçkaje.

— Nuk është gjë e keqe të udhëtosh.

— Kur e ke makinën në dispozicionin tênd. Shumë thellë është ndërtuar qyteti juaj.

— Megjithatë ai është i bukur.

— Nuk thashë se është i keq.

— Ke qenë ndonjëherë nga këto anë?

— Jo.

— Si t'u dukën?

— Të bukura.

Pasagjeri që hipi në Peshkopi sikur u ngroh nga këto fjalë dhe tha:

— Qëndro sonte. Nesër ngrihem i herët dhe të përcjell deri te rruga e makinës. Atëherë do të shohësh se sa të bukura janë këto vende.

Andrea Ligori u kthye nga shoku i fakultetit dhe i tha:

— E lëmë për njëherë tjeter, — Toni ishte i prerë dhe si zakonisht, pas një toni të tillë, mbretëroi heshqja.

— E, o derëbardhë sa shumë që lutesh. Nuk e shikon se këtij nuk i pëlqen, — tha Petro Morava.

«Po inatoset», mendoi Ergysi. Andrea Ligori vështroi i habitur Petron.

— Ç'më shikon, — tha Petroja. — Nesër pushim e ke. Keni ngrënë në një sahan për katër vjet.

— Përse ndërhyr kur nuk e di se si i kanë punët të tjerët, — tha Andrea.

— Lëre, ju të zyrave u mbytët në punë edhe të dielave!

- Ti vetëm timonin ke, prandaj flet kështu. Që sot e ndërroj zanatin tim me tëndin.
- Flet tani që e di se nuk e ndërron.
- Te Tre Currilat mbaje, — tha pasagjeri që hipi në Peshkopi.
- Mos ki merak. Edhe unë dua të pushoj pak.
- Mos vonohemi, — tha i shqetësuar Andrea Ligorii.
- Deri në Burrel do të të çoja. Të dhashë fjalën.
- Po sikur të shkonim deri në Milot.
- Kur të hipia të thashë se do të të çoja deri në Burrel. Po të të thosha se do të të çoja deri në Milot, do të të çoja.
- E, se rregullohemi rrugës.

Te Tre Currilat Petroja ndaloj makinën. Zbritën të katër. Ergysi nuk shkoi te çezma por u avit buzë xhades dhe po vështronë lumen. Hëna reflektonej në ujë dhe atij i ngjau si një varkë prej lëvozhgë arre, si ato të cilat ai lëshonte në vijën e ujit para shtëpisë së tij që formohej kur binte shi. Gryka e lumit ishte shkëmbore dhe plot drurë të gjelbër. Uji rriddhe i qetë. Ndofta qetësinë ia shtonte edhe shtresa e drithës së hënës mbi sipërfaqen e lumit. Djali mori një gur dhe e hodhi në lumë. Varka e vogël e hënës u lëkund lehtë. Pastaj u qetësua. Ergysi hodhi përsëri gurë dhe varka e vogël e hënës u lëkund përsëri lehtë. Ai mund të luan- te kështu téré natën, por po e thërriste i ati.

— Takohu me këtë shokun, — i tha i ati.

Ergysi i dha dorën dhe pasagjeri që hipia në Peshkopi e puthi. Ergysit i erdhia keq që po ndaheshin. Pastaj tjetri u përshëndet me Andrea Ligorin. Ergysi vuri re se ndarja e tyre nuk ishte ndarje shokësh.

— Libej të fala plakut, — tha Petroja.

— Falemnderit, — tha tjetri dhe u largua nëpër urë.

Kur makina iu afroa lumi, Ergysi pa përsëri varkën e vogël të hënës. «Kush mund të hipë në një varkë kaq të vogël», — tha ai.

Kur u dukën dritat e Burrelit, djalin gati po e mpo- shtë gjumi. Petro Morava nuk kishte shkëmbyer asnjë

fjalë me Andrea Ligorin. Ergysi largoi gjumin dhe mbësnteti ballin mbi xhamin e makinës. Atij i pëlqenin qytetet e vogla kur binin të flinin. Nëpër rrugët e Burrelit nuk kishte njeri. Ishte vonë.

— Hoteli është ajo ndërtesa e madhe, — tha Petro Morava.

— Nuk më çon deri në Milot, se nuk fle dot nëpër hotele.

Ergysit i bëri përshtypje mënyra sesi lutej tërë qenia e Andrea Ligorit. Në zërin dhe qëndrimin e tij ishte zhdukur ajo siguri dhe ajo vetëkënaqësi që, megjithëse ai përpiqej të mos e shfaqte, përsëri ndihej. Ergysi e urreu Andrea Ligorin. Ai ishte akoma i vogël dhe ndjenjat e tij për njerëzit ishin të prera dhe shpesh të çuditshme. Ai nuk dinte të përbuzte, por të urrente. Dhe Petro Moravës i dukej kjo gjë si shenjë e një ndershmërie. Dhe ato çaste ai sillej me të birin si të kishte pranë një të barabartë në moshë dhe në përvojë.

— Më ço, të lutem, deri në Milot. Ky hotel edhe po të ketë vende teke tanë i ka të zëna. Kushedi me kë më bie të fle në dhomë. Është dhe vapë.

Petro Morava nuk foli.

— Të paguaj më shumë, — mori zemër nga heshtja e Petros, Andrea Ligori.

— Zbrit, — tha Petro Morava, — zbrit sa më parë. Ergysi e kuptoi se i ati ishte nxehur në kulm.

— Zbrit, — tha përsëri Petro Morava. Ai po mundohet ta mbante veten.

— Po mirë... sikur...

— Zbrit! Paguaj biletën dhe...

Andrea Ligori hapi derën dhe kërceu jashtë në errësirën e ndriçuar. Petro Morava i futi marshin makinës, e cila doli nga qyteti me një vrull të egër.

«Maskarai», — tha me vete Petro Morava.

Ergysi nuk e ngacmoi. Ai e dinte se për një farë kohe, gjersa të qetësohej, nuk duhej ta pyeste për asgjë të atin. I iku gjumi fare. Ai mbështeti ballin i menduar në xhamin e ftohtë. Petro Morava shau përsëri, por këtë herë si nëpër dhëmbë. Nuk po i zbriste inati.

— E, mo, — i tha të birit, — mos do të sillesh e^{nas} me shokët si ai Andrea Ligori?

— Unë nuk iki nga Korça. Do të rri me ty, — th^{as} Ergysi serioz.

— Jo, more! — tha Petro Morava i prekur nga dashuria e të birit. — Domethënë nuk do të ikësh nga unë.

— Po, — tha i 'biri, — nuk dua.

— Se mos të ndërrohet mendja kur të rrithesh?

— Jo, — tha i biri, — nuk do të më ndërrohet mendja kur të rrithem. Dhe ti mos e bëj më këtë muhabet me mua.

Petro Morava nuk duroi dot dhe vuri buzën në gaz fshehirazi, që të mos e shihte Ergysi, se do të fyhej. Papritur para dritave të makinës rrëshqiti një dhëlpër e vogël. Ergysi u mat të thérriste por e mposhti gëzimin me zor. Sapo kishte bërë një ibisedë tepër serioze me të atin. Petro Morava e ndaloi makinën diku, buzë lumit Mat, në afërsi të Shkopetit. Rrjedha e lumiit nuk dëgjohej fare. Hëna kishte perënduar. Ata rregulluan shpejt e shpejt vendin dhe u shtrinë të flinin.

— Ai, Andrea Ligori ia kishte harruar edhe emrin shokut të tij, — tha Petroja.

— E pashë, — tha Ergysi.

— Po ti a i mban mend emrat e shokëve?

— I mbaj.

— Edhe po ua harrove një ditë emrat, mos harro t'i duash si tanë.

— Mirë, — tha Ergysi.

Petroja u trottulla, por nuk po zinte dot vend.

Kur Ergysi mendoi se të atin e kishte zënë gjumi, Petroja tha:

— Njerëz si ai Andrea Ligori nuk duhet të udhëtojnë fare.

— Po ti përse e more fare në makinë? Ta kishe lënë në rrugë.

— Se mos e kishte shkruar në ballë që ta njihja se c'njeri ishte, — tha Petro Morava sikur shfajësohej para të birit.

— Ashtu është, — i dha të drejtë i biri, — ku ta njihje ti!

ERA E JARGAVANIT ARTIFICIAL

As vetë nuk e kuptova se kur filloi të më ngacmonte era e jargavanit. Në hymë në atë qytet me autobusin e aeroportit dhe u habita kur nga xhami pak i hapur erdhi një erë që m'u duk e rjohur e që më kujtoi fëmijérinë. Dhe gjëja më e pabesueshme dhe më e çuditshme ishte pikërisht kujtimi i fëmijérise në atë qytet të huaj, ku hyja për herë të parë. Ai qytet mund të më kujtonte gjithçka, vetëm fëmijérinë jo.

Hodha sytë jashtë dritares së autobusit, se mës ngacmimi që më kujtoi fëmijérinë ishte diku, mes fu-shës së madhe dhe të trishtuar, që ndahej nga një lumë i gjërë, i turbullit dhe i qetë, por e huaj dhe e ftohtë. Fëmijëria ime kishte kaluar rrëzë një mali; në perëndim të të cilit rrëdhte një përrua i vogël, me pak ujë, që në verë shterte fare. U përpoqa ta largoja mendjen në dicka

tjetër, por ishte e pamundur. Dhe për herë të parë, pas tërë atij udhëtimi, thashë se ndofta isha lodhur dhe duhej të pushoja.

Kisha dy ditë që udhëtoja dhe veshët kishin filluar të më buçtnin. Megjithëse edhe në atë qytet nuk do të qëndrója gjatë. Ai ishte një qytet-stacion, ku do të prisja trenin, i cili nisej pas katër orësh. Autobusi u fut në disa rrugë të vjetra, dhe u ngatërrua me veturat që prisnin sinjalin jeshil të rrugës së lirë. Kryqëzimet e rrugëve ishin të shpeshta, po ashtu edhe ndalesat. E përsëri era, që më kujtonte fëmijërinë, ishte diku aty pranë meje, si një pasagjer i padukshëm. Kujtimi i fëmijërisë, — thashë me vete, — është vetëm në trurin tim dhe, ngaqë e ndien se ne po largohemi përherë dhe më shumë nga vendlindja, bëhet kaq i mprehtë. Ndofta kjo ndodh me këdo që largohet për herë të parë nga Atdheu, mendova më pas dhe sikur u qetësova.

Qyteti ishte tepër i lashtë dhe ngrivej mbi disa kodra. Ai ishte një qytet i hirtë dhe nëpër rrugët nga po kalonte autobusi kishte pak gjelbërim. Drurët e rrallë ishin gati të zhveshur. Megjithëse ndërtesar ishin solide, nuk e fshihnin dot plakjen e atij qyteti.

— Paske qenë me fat që të ra shërbimi tanë, në vjeshtë, — më kishte thënë një shok para se të nisësha, — sepse ajo zbulon më mirë se kushdo, plakjen e Evropës. «Ndoshta ka parasysh shirat», mendova dhe nuk e zgjatëm, më bisedën, se tashmë isha mësuar me batutat e çuditshme dhe të papritura të shokut tim.

Autobusi i aeroportit ndaloj pranë një kishe të vjetër, në sheshin para së cilës vërtiteshin disa pëllumba, që çukitnë tërë urë midis pllakave të gurta. Mora valixhen dhe shipiva trupin. Dita ishte me diell, Vjeshta po mbante e thatë. Pyeta, për tu siguruar më mirë se kur nisej treni dhe sikur e ndjeva veten më të lehtësuar. Treni nisej pas katër orësh. U ulë në një nga stolat bosh të lulishës përballë zyrave të agjencisë ajrore të atij shteti. Nxora paketën dhe ndezë një cigare. Dhe vështrimi im, që tanë ishte çliruar nga

diktati i trurit, ra te suvaja e kishës. Ajo vende-vende ishte e rrëzuar, kurse kambanorja dhe kupola ishin ndryshkur nga erërat dhe shirat. Te dera kryesore qe shënuar me gërmë romake shekulli kur ishte ndërtuar kisha. Nuk e di por germat romake gjithmonë më kanë ngatërruar në përcaktimin e moshës së një objekti. Ato sikur e bëjnë më të vjetër sesa është në të vërtetë një ndërtesë. Kur isha duke vrarë mendjen pér këto, pashë një plakë që mezi po ngjitej nëpér shkallët e kishës. Ajo, sa ngjiste një shkallë, ndalej pér t'u mbushur me frymë, pastaj hidhje tërë kujdes hapin tjetër duke parë se dhe sa shkallë i mbeten deri te hyrja. Po të binte shi kjo do të ishte me të vërtetë një pamje e trishtuar. «Si tablotë e piktorëve holandezë të shekullit XIX», mendova dhe menjëherë m'u kujtua shoku im. Dhe përsëri thashë se ai duhej të kishte parasysh shirat e vjeshtës kur më tha se kisha pasur fat që po udhëtoja në vjeshtë. Plaka u duk edhe më e kërrusur kur hyri te dera qendrore, harku i së cilës mbante shekujt e gdhendur me gërmë romake. Ajo humbi në brendësinë e mugët të kishës dhe unë hoqa sytë prej andej. Ashtu si tek autobusi i aeroportit edhe këtu m'u duk sikur ndjeva erën e jargavanit dhe përsëri nuk i besova nuhatjes sime. «Vetëm në vjeshtë nuk mund të çelin jargavanët», — thashë dhe u gova. Dhe, për të vërtetuar këtë, era solli para këmbëve të mia një tufë gjethesh të zverdhura rrapi. Ato po i binin bulevardit mes pér mes, sikur donin të kalonin në trotuarin përballë, pa marrë parasysh semaforët që ndiznin sytë e tyre të alarmuar. Kur tufa e gjetheve ishte gati pér t'u hedhur në trotuarin përballë, kaloi një kamion i madh dhe i vuri përparrë. Gjethet hidheshin mbi bulleard si zogj të tremburr. Ecën kështu dy-tre metra dhe u lodhën. Rrotat e makinës i ngjitën pas vetes dhe pastaj i lanë mes asfaltit. Vështrova orën dhe vendosa të nisësha pér në stacionin e trenit. Kisha në dispozicion edhe tri orë.

Ecja më nge, kur në njérën prej rrugëve të atij qyteti, që mbante emrin e një knjazi, era e jargavanit

u bë më e fortë. Ndértesat e rënda të asaj rruge nuk kishin oborr. Në qytetin tim jargavanët rriten nëpër oborre... Nën dritaren e dhomës ku u rrita nëna kishte mbjellë një jargavan bojerozë. Ai çelte herët dhe kontaktin e parë me pranverën e merrja nga vilat e çelura të jargavanit. Era e tij mbushte tërë mëngjesin dhe mbrëmjen. Dhe që atëherë ai u bë njësh me kujtimet e tjera të fëmijërisë.

Dita po thyhej. Qyteti po bëhej edhe më i hirtë e më i huaj. E vetmja gjë që tanë më ngrohte ishte era e jargavanit. Nuk u përpoqa të vrisja mendjen të gjeja se nga vinte. Për mua mjaftonte që ajo ishte e pranishme në ajrin e ftohtë të atij qyteti dhe çka ishte më e rëndësishme, se ajo më kujtonte fëmijërinë. Kisha vetëm një shqetësim, se mos ajo do të zhdukej kur të shkoja në stacionin e trenit.

Hyra në një rrugë të ngushtë dhe shumë të pjetrët. Pjerrtësinë e rrugës e vërtetonin edhe zhurmat e frenave të dorës të veturave, kur ndalonin, në pritje të dritës jeshile të semaforit. Më shumë se rrugë, ishte një rrugicë, më disa dyqane të vogla pijesh alkohlike dhe disa kinkaleri, ku mund të gjeje gjithçka të dallë mode dhe suvëni. Nuk e di po pamja e tyre e varfër më shkaktoi një ndjenjë ndrydhjeje. Një ndjenjë të tillë më ngjallte, kur isha i vogël, pazari i vjetër i qytetit tim. Pronarët e këtyre dyqaneve qëndrojnë zakonisht para derës dhe të vështrojnë me një përvuajtje, që u është bërë natyrë. Nxitova hapat dhe u gëzova që po zbrisja sepse, po të isha duke e ngjitur atë rrugë, do të më menrej fryma. Era e jargavanit këtu ishte më e pafuqishme, më e druajtur dhe më e largët, sikur e kishte hedhur rastësisht ndonjë trill filladi. Kur dola në një shesh të vogël më ngjau sikur sapo kisha kaluar një tunel. Përballë dallova stacionin e trenit. Ndértesa ishte e vjetër dhe si e braktisur. Idenë e braktisjes e jepnin dyert e shumta, të hapura, nëpërmjet të cilave dukej një pjesë e sallës gjysmë e errët dhe dritaret me ndonjë xham të thyer.

Në sallë zotëronte rrëmuja e zakonshme e stacio-

neve të mëdha, ku ndalojnë dhe nisen trena të linjave të largëta dhe trenat e periferisë. Eca drejt sportelit mbi të cilin shënohej shteti ku do të shkoja dhe pyeta se nga c'peron nisej treni. Më thanë se treni nisej nga peroni katër, në orën 17 e 55. E pyeta sportelisten nëse kishte mbërritur treni në peron, por ajo nuk ma vari fare dhe i mori paratë një gruaje, që erdhë në atë çast. U largova. Nëpër korridorin e gjatë e gjysmë të errët dëgjoje gjuhët e zhargonet më të ndryshme dhe shihje kostumet dhe modat më të ndryshme. Kur i shikoje ashtu si të hutuar, të dukej sikur kishte ndodhur ndonjë katastrofë. Njerëzit përplaseshin pas teje dhe largoheshin pa të kërkuar të falur. Më të ngeshmit rrinin nëpër stola dhe përtypeshin duke i hedhur letrat e ambalazhit ku të mundnin. Ai ishte një stacion ku nuk zbatohet asnjë rregull higjenik. «Ndoshta nga ky stacion nisen vetëm njerëzit që kanë halle dhe që çdo politesë u duket e tepërt dhe absurde. Ishallah nuk është ky çrrëgullim me orarin e trenave!»

Ora e madhe e stacionit shënonte 17 e 20. Peroni nr.4 ishte bosh. Ula valixhen përtokë dhe prita. Po errej.. Dritat nuk ishin ndezur akoma. Nga peronet fqinje po niseshin dy trena. Iшин trenat e periferisë. Edhe lokomotivat kishin mosha të ndryshme. Lokomotiva lëshoi një shtëllungë të dendur tymi që u shtri mbi tërë peronet e stacionit, si një re e zezë shiu dhe u nis duke tërhequr vagonat. Jelja e zezë e lokomotivës do të ulej pas pak mbi çatinë e ndërtësës së stacionit, mbi dritaret dhe dosjet e zyrave, mbi supet dhe bagazhet e njerëzve. Megjithatë era e jargavanit ndihej përsëri, herë e lehtë dhe herë e fortë, sikur donte të mbulonte çdo aromë tjetër.

U ktheva përsëri në peronin nr.4. Shinat e tij ishin përsëri bosh.

Para meje ndaloj një karrocë dore plot valixhe dhe dengje të lidhura fort me litarë. Pas karrocës vinte një familje. I pyeta se mos edhe ata prisnin trenin që prisja edhe unë. Më thanë se po. U qetësova.

Ora shkoi 17 e 55 dhe shinat e peronit nr.4 ishin

përsëri bosh dhe refleketonin dritat e llambave neon, që nuk ishin ndezur të gjitha. Tani duhet të vijë. Kisha dëgjuar se trenat elektrikë të linjave të largëta ishin të përpiktë në mbërritjen dhe nisjen e tyre. S'ma merr mendja që sot të isha unë ters. Para se të nisesha me shërbim kisha lexuar për krizën e energjisë dhe ngrijtjen e qirasë në atë shtet. Tani krizën e kisha pranë, në formën e një gjysmëerrësire, mbi peronet e stacionit qendror të trenave. Pasagjerët e tjerë kishin filluar të shqetësoheshin dhe të pyesnin njëri-tjetrin se mos kishin gabuar peronin. Ngaqë nuk ia shihnin mirë fytyrën njëri-tjetrit, ata, kishte raste që ngatërroheshin dhe pyesnin atë, i cili sapo kishte pyetur për vete. Nuk nxitoja dhe, ndofta isha njeriu më i qetë, në krahasim me të tjerët. Ata nxitonin, si dinë të nxitojnë vetëm njerëzit që kanë halle, duke u përplasur dhe duke u thirrur tërë inat më të ngathitëve dhe më të hutuarve. Dhe, si zakonisht, këta ishin o gra, o fëmijë. Në fytyrat e tyre kishte tension. Dhe gabimi i një treni apo mos-kapja e tij në kohë nuk ishte diçka e lehtë dhe pa tronditje për këta njerëz.

— Vini re! Vini re! Treni i linjës... që duhej të nisej nga peroni numër katër në orën 17 e 55, arrin në stacion më gjysmë ore vonesë, për shkak defekti. Treni do të niset po nga peroni numër katër në orën 18 e 55. Vini re! Vini re! Treni i...

Të gjithë e kishin dëgjuar fare mirë që herën e parë dhe përsëri po e dëgjonin me vëmendje. Kur lajmërimi i dytë mbaroi, njerëzit sikur u çliruan nga një ankth. Ishte një çlirim i përkohshëm, aq sa i duhet një fytyre të zëvendësojë maskën e ankthit me atë të mërzisë.

Vetëm fytyrat e dyshimita mbeteshin të pandryshueshme. Ató lëviznin indiferente, sikur kishin dalë për të studiuar fizionominë njerëzore të dëshpërimit dhe të mërzisë, të sharjes dhe të revoltës, të frikës dhe të mallit, të dashurisë dhe të ndarjes, të kotësisë dhe të ankthit. Jo vetëm kaq por në atë stacion, ku hynin dhe dilnin trena të linjave të shkurtra dhe të

gjata, trena të periferisë së gadishullit dhe të thellësisë së kontinentit, trena ku valixhet kontrolloheshin në kufi mos kishin brenda droga, duhan, alkool, një gjuhëtar mund të mblidhte fare mirë shprehjet idiomatike të popujve të ndryshëm për çrregullimin e orarit, një folklorist mund të inçizonte ninullat e popujve të ndryshëm, që nënët këndonin për të vënë në gjumë fëmijët të cilëve u që prishur regjimi, një regjisori mund të xhironte me kamera të fshehtë turli tipa, drama e të cilëve mund të fillonte fare mirë nga ky stacioni treni.

Futa dorën në xhep për të nxjerrë paketën e cigareve. Ajo kishte vetëm një copë. U tremba dhe u gëzova. Sikur të mos më ishte shkrepur ta ndizja atë çast, do të isha bërë derr gjatë udhëtimit. Do të udhëtoja tërë natën. Në shtetin fqinj do të mbërrija aty nga ora dymbëdhjetë e ditës. Shkova të blija cigare në lokalet e stacionit. Sapo hyra në sallë më pushtoi një ndjenjë e afërt me atë të trishtimit. Mbi ajrin e rëndë vërtitej era e jargavanit, e cila për herë të parë nuk më pëlqeu. Pavarësisht se era e jargavanit më kujtonte fëmijérinë, kishte filluar të më bezdiste. Bleva dy paketa dhe dola shpejt nga salla, por era e jargavanit më ndoqi pas, si një mace e hedhur, e dëbuar nga shtëpia, që i ngatërohet nëpër këmbë qdo kalimtari me një angullimë të dëshpëruar dhe lutëse. U futa mes njerëzve për ta shmangur atë mace që kishte formën e erës së jargavanit. Ajo në të vërtetë nuk kishte formë dhe prandaj shmangia e saj ishte gjëja më e vështirë. Ajo ishte kudo, ecte mbi kokat e njerëzve, më ajrin e rënduar të natës. Ajo u bë edhe më e bezdisshme në peronim nr.4, nga duhej të nisej treni me të cilin do të udhëtoja.

Shigjetat e orës së madhe sikur kishin ngelur. Shinat ndritnin nga lagështia e natës, duke reflektuar dritat e zbehta. Tani duhej të kishte mbërritur, mendova për trenin. Diku, në dalje të stacionit, ku kryqëzoheshin linjat, klithnin lokomotivat elektrike, me naftë dhe me qymyr, si disa qenie që i tremben gju-

mit. Ato kalonin mbi urën e madhe dhe zhdukeshin në errësirë e asnjeri prej tyre nuk po hynte në peronin nr.4.

Pasagjerët zunë të lëviznin dhe të pyësni përsëri njëri-tjetrin, kushedi për të satën herë, mos treni nisej nga ndonjë peron tjetër.

«Jo, — përgjigjeshin të tjerë, — do të lajmëronin. Ky është peroni numër katër? Po. Kështu shënon. Ku? Që këtu nuk duket. Mirë, po shkoj ta shoh vetë. Ju mos lëvizni. Mos u vono! E ku do të vonohem! Është natë dhe... Mirë, ulu mbi valixhe dhe mbaje për dore vajzën. Mos u vo...»

Tani njerëzit, që ishin vetëm disa metra larg, të ngjanin me hije, apo me silueta lëvizëse.

«Ky është peroni numër katër? Po. Ju ku do të shkoni? Në... Rri më mirë, ndofta kalon njeri që e di dhe e pyesim! Jo, jo, dua ta shoh me sytë e mi. Vetëm atyre u besoj tani. Të lutem, mos u largo! Po ç'ke kështu, xhanëm, sonte, që nuk qëndron dot vetëm? Nuk e di, sesi më duket kjo natë! Si? Nuk e di! Më mërzite me këtë frikën tënde. Më fal. Atëherë po shkoj. Jo, jo! Ej, bela, sikur je e vogël. Kur u njo-hëm ishe më e fortë. Edhe tani jam, po sonte se si ndjehem. Po vij edhe unë me ty. Po plaçkat? S'ka gjë, i mbaj unë, vetëm mos u mërzit!...»

Po sikur të mos niset? S'ka mundësi! Kjo nuk ka ndodhur kurrë. Po mirë, sikur të mos niset, ku do të vemë? Të thashë një herë që kjo nuk ka mundësi të ndodhë! Po mirë, po sikur të ndodhë sonte? Përse flet gjithmonë ters? Sepse gjithmonë më ka vajtur ters...

A ndien gjë? Çfarë? Një si erë të rëndë. Jo. Po ti çfarë ndien? Që ndiej diçka jam i sigurt, po nuk ta them dot me saktësi. Asgjë nuk ndien. Ti ke frikë. E përse të kem frikë? Sepse e ke për herë të parë. Edhe unë kështu kam pasur frikë për herë të parë. Unë nuk kam frikë. Mos m'i shit mua këto. E, mirë atëherë, kam frikë. Po të kesh frikë mos u nis fare. Bën mirë të kthehem. Ku të kthehem? Atë e di ti. Edhe ti e di

se unë nuk kam ku të kthehem, prandaj mos fol kështu. U preke? Edhe prekem. Punë e madhe!...

Përse u vonua babai? Ja, sikur ka ardhur. Ti kë një orë që më thua, ja, sikur ka ardhur dhe ai nuk po duket. Jo, nuk kam një orë që të them kështu. Ai iku i zemëruar. Jo, nuk iku i zemëruar...

Je i sigurt se do të gjejmë punë, apo mos na gënjen ai? Letrën e kam me vete. Nëma ta shoh! E ç'ë do tani? Nuk e lexon dot nën këtë dritë. S'ka gjë, fjalën punë e lexoj edhe pa dritë. Ta jap kur të nisemi, se mos e humbasësh. Të thotë se do të na presë? Jo. Po ti, e lajmërove se po nisemi? Po. Atëherë do të dalë patjetër. Edhe unë kështu mendoj, se do të dalë të na presë, patjetër.

Nuk mund të mos i dëgjoja zërat që më rrrethonin. Vetëm fytyrat nuk i shihja më qartë. Ora shkoi 18 e 55 dhe në shinat e peronit nr.4 nuk ishte ndalur asnjë tren. Vetëm era e jargavanit nuk donte të largohej. Era e jargavanit të këtushëm ishte më pikante dhe më e rëndë. Vetëm fëmijëria ime nuk do ta dërgonte erën e jargavanit të saj në një stacion të tillë, të largët, përtë mbuluar frikën e njerëzve ndaj natës. Megjithëse nuk ishte era e jargavanit të fëmijërisë sime, ajo ishte përsëri erë jargavani dhe me siguri që lidhej me fëmijërinë dhe rininë, burrërinë dhe plakjen e tërë atyre njerëzve të cilët tani prisnin në peronin nr.4 trenin që ende nuk po vinte...

— Vini re! Vini re! Treni i linjës... nuk do të niset nga peroni numër katër, por nga peroni numër tetë! Vini re! Vini re! Treni i linjës...

Ndryshe nga hera e parë, tani njerëzit nuk priten të dëgjonin përsëritjen e lajmërimit, po rrëmbyen valixhet dhe bagazhet dhe nxituan për në peronin nr.8, duke shkaktuar rrëmujën e zakonshme. Ajo ishte një rrëmijë shumëngjyrëshe dhe shumëguhëshe. Por, edhe peroni nr.8 ishte bosh.

E dëgjove mërë që tha për këtu? Po. Po ku dreqin është treni? E nga ta di unë. Mos më merr për punonjës hekurudhe? Jo. Atëherë mos më pyet për një gjë që

s'kam nga ta di. Pse nuk më le ta dëgjoja kur e përsëriten lajmërimin. Sepse e dëgjuam qartë që herën e parë... Ku e ka valixhen e zezë? Valixhen e zezë! Pse, nuk e more ti? Jo. Bobo! E zeza unë!... Ky është peroni tetë? Ju lutem, ky është peroni tetë? Tetë?...

E dëgjove mirë që niset prej këtej? Mua më duket sikur nuk tha peroni numër tetë. Po sa tha? Vetëm peroni numër tetë nuk tha. Ters! Edhe qesh. Qesh sepse ters më ka shkuar gjithmonë dhe tanë nuk çaj kokën fare. Le të niset nga çdo peron që të dojë dhe kur t'i tekët...

Babai mos pret në peronin numër katër? Jo, do të vijë këtu. Po nga ta dijë se u ndërrua peroni? Nga altoparlanti...

Sikur të mos na presë, ku do të mbytemi!...

E, të iku pak frika? Jo. E, ç'do të na hapësh punë! Kur s'të lashë! Aman, mos më lër kurrë vetëm! Kam frikë...

Edhe në peronin nr. 8 era e jargavanit qëndronte e palëvizshme mbi kokat e njerëzve. Mos vallë erën e jargavanit e ndieja, vetëm unë, dyshova pér një çast. Por nuk mund të pyesja të tjerët. Ajo do të ishte pyetja më qesharake dhe më e çuditshme mes atij shqetësimi. Këdo që të pyesja, do të mblidhë supet dhe do të më shikonte në sy, nëse tallesha apo isha njeri me manira. Prandaj heshtja ishte më e natyrshme dhe më e arsyeshme. Që të heshtja rruk e kisha vështirë, por po e ndieja se nuk e duroja dot erën e jargavanit. Bile vonesa e trenit po më nervozonte pikërisht se më detyronte të të thithja erën e jargavanit. Mes tërë atyre njerëzve, ajo ku fytyra më e qetë ishte fytyra më e dyshimtë, ajo erë sikur kishte ardhur pér të krijuar një botë krejt tjetër, pér të krijuar një përshtypje krejt iluzore, sikur asgjë nuk po ndodhë në ato çaste te peroni nr. 4 apo te peroni nr. 8, por diku, në një realitet që perceptohej mes turbullirës së ëndrrës. Ajo erë sikur donte t'i bënte të largëta shqetësimet, dialogët, frikën, ndarjen, dëshpërimin tymin e rëndë të lokomotivave, që kriза i kishte nxjerrë nga shinat rezervë. Ajo erë sikur

donte të krijonte një qiel i tij, poshtë të cilat nuk kishin asgjë të tillë, përveç parfumit me erën e jargavanit, që nuk njihte ndarjen e stinëve. Ajo i kishte bërë vitet të njihnin një stinë. Ajo ishte krijuar që njerëzit të mendonin se kishte vetëm një stinë.

— Vini re! Vini re! Treni i linjës... niset nga peroni numër gjashtë, pas pesëmbëdhjetë minutash! Vini re! Vini re! Treni i linjës... niset nga peroni numër gjashtë pas pesëmbëdhjetë minutash!

Njerëzit nuk lëvizën edhe si mbaroi lajmërimi i dytë. Ata rrinin si të ngrirë. Pastaj dikush nga fillimi i peronit u përmend dhe nxitoi për në peronin nr. 6. Pas tij u shkulën të gjithë. Treni po hynte në peron i lodhur. Ai ndaloi dhe njerëzit, duke shtyrë njëri-tjetrin, kërkonin vagonat që u duheshin. Unë mezi gjeta vagonin që shkonte në shtetin fqinj. Ai ishte i parafundit. Hyra në korridorin e vagonit dhe zura të kërkova ndonjë vend të lirë. Të gjitha kabinat ishin plot me pasagjerë. Ata që ishin ulur shikonin ata që nuk po gjenin dot vend të lirë me një farë kënaqësie përzier me një keqardhje të lehtë. Sapo i kalojë, fytyra u bëhej indiferente. Hapa i dëshpëruar derën e një kabine. Dikush ishte shtrirë duke zënë dy vende.

— Mundet? — i thashë shqip duke bërë me kokë nga vendi bosh. Isha i sigurt se më mirë do të kuptohej lëvizja e kokës sesa gjuha. Tjetri tërhoqi këmbët dhe unë hyrra brenda. Vura valixhen në vendin e bagazhevë, hoga pardesynë dhe më shumë u përplasa sesa u ulë mbi sedilien e butë, duke nxjerrë një pshërejtëmë lehtësuese. Pasagjerët, si studiuani fizionominë time, nëse kishin të bënin me një njeri të ndershëm apo të dyshimtë, u rregulluan edhe ata. Me sa kuptova, fizionomia ime s'u ngjalli dyshim.

Era e jargavanit sikur mbeti përjashta, mbi peronin nr. 6. «Shyqyr, — thashë me vete, — kur të niset treni ka për të mbetur edhe më larg dhe nuk ka për t'u ndjerë fare!» Ky mendim më hoqi mërzitjen dhe mezi prisja të nisej treni. Më priste një rrugë e gjatë në

për natë. Por mua më kanë pëlqyer gjithmonë udhëtimet e gjata dhe natën. Treni ishte elektrik dhe që pa u nisur dëgjoja trokun e tij mbi dremitjen e qyteteve të mëdha dhe të vogla, mbi atacionet e humbura, ku ai nuk ndalonte dhe mbi stacionet ku ishte i detyruar të linte vagona dhe të merrte vagona, mbi urat e lumenjve të lundrueshëm dhe mbi urat e përrenjve, mes fushave dhe maleve që prisnin të qetë dimrin, pranë fshatrave dhe shtëpive të vetmuara. Ai do të trokonte vazhdimisht, duke zgjuar për një çast peisazhe, njerëz, kontrollorët e shinave, përgjegjësit e stacioneve dhe turneve të natës, ku ai ndalonte dhe ku nuk ndalonte, do të zgjonte qentë që do t'i lehnin pas, ndërsa vetë do të vazhdonte të humbiste në tunelin e errësirës. Ai do të trokonte vazhdimisht, duke e trembur dhe ndarë natën pjesë-pjesë.

Më në fund u dëgjua një bilbil dhe pas tij fishkëllima e sirenës. Sepse sirena më ngjau e ngjirur, sikur t'i kishte grykët të acaruara. «E përsëri ti nuk mund të pushosh, — i thashë. — Ti do të fishkëllesh në çdo stacion dhe, meqenëse sonte je e vonuar, do të dëgjosh vetëm sharje.» Treni u nis duke na shkundur mirë e mirë të gjithë. Ishte një nisje më e vrullshme se e zakonshmjë. Nga dritarja shikoja se si mbetej larg ai qytet, duke u tretur në mjegullën që ngrihej nga fusha. Po ikja drejt thellësisë së kontinentit dhe çdo minutë më largonte nga ai shtet.

Në kabinë nuk fliste askush, sikur i druheshin mbarimit të bisedës. Nata ishte e gjatë dhe biseda ishte më e domosdoshme kur do të na duhej të mposhtnim gjumin. Ndeza një cigare dhe mbështeta ballin pas xhamit të trashë. Isha në një gjendje të tillë kur, megjithëse vështrimi ishte mbërthyer në një pikë, nuk shihja agjë. Përtej dritares kishte vetëm errësirë. Ndonjë dritë e largët, e zbehtë, më shumë të trishtonte me vetminë e saj sesa të ngjallte ndonjë ndjenjë tjeter. Në qoftë se je duke udhëtar ur nëpër natë në një shtet të huaj, janë pikërisht këto drita të vetmuara dhe të trishtuara që ta bëjnë atë shtet edhe më të huaj dhe të futin

në një gjendje të përhumbur. Derisa të hasësh një dritë tjetër, në mendje të ka mbetur ndriçimi i dritës së parë; diku mes fushës së përbaltur të vjeshtës. Po dritat kanë të njëjtin ndriçim, të njejtin trishtim, të njejtën monotonji. Dhe ti futesh në një gjendje përhumbjeje, nga e cila të shkund vetëm frenimi nëpër stacionet ku treni është i detyruar të ulë shpejtësinë. Një udhëtim i gjatë natën, me tren, më shumë është një dremitje me sy hapur, një mpirje e tërë sistemit nervor, i cili, me gjithatë, vazhdon regjistrimin e atyre gjëra që i marrin vlerat më vonë, kur udhëtimi ka mbetur diku larg, si klithma e një zogu të shqetësuar.

Stacioni më i afërt kù do të ndalonte treni donte edhe dy orë e gjysmë të vinte. Qepallat më rëndonin dhe nuk po e kuptoja në isha zgjuar apo flija. Vonë e ndjeva se më zuri gjumi. Kur hapa sytë, pothuaj të gjithë që ishin në kabinë, dremitnin. Vetëm djali që kisha në krah ishte zgjuar dhe shikonte nga korridori i ngjushtë i vagonit.

- E kaluam stacionin 5?... — e pyeta.
- Po, — tha ai dhe m'i nguli sytë.

Vështrova jashtë. Përsëri treni duhej të ecë mes një fushe të gjerë, pa fund. Gjumi më iku fare.

- Të vjen keq që nuk e pe? — më pyeti djali.
- Edhe më vjen.

Djali qeshi dhe tha:

— Të gjitha stacionet që do të hasim rrugës ngjasin shumë me njëri-tjetrin.

- E bëni shpesh këtë rrugë? — e pyeta.

Djali më vështroi në sy pastaj u kthyë nga korridori për të fshehur trishtimin që mbuloi sakaq sytë e tij.

- Dua ta bëj, por...

- Cfarë por?...

— Në të vërtetë dua të bëj rrugën e kundërt të kësaj nate.

— Përse? — e pyeta dhe për herë të parë u pendoval, sepse e kisha tepruar me pyetje.

— Sepse ky tren më largon nga qyteti im, nga P...

Diçka dija për qytetin P. Ishte një qytet i vjetër, buzë detit. Bile kisha dëgjuar edhe një këngë, më një titull pak të vrashdë për një këngë. «Po... qyteti i të varférve». Ishte një këngë e dhimbshme. Po këtë nuk ia thashë djalit. Edhe pa titullin e këngës në sytë e djalit kishte dhimbje. Jashtë dritareve të kabinës shtrihej nata e huaj. Ajo ishte e huaj për të dy ne. P. me natën e tij ishte shumë larg. Thoshin se aty netët nuk ishin kurrë të ftohta dhe se tani duhej të mbanin erë portokalli. Sytë e djalit u kthyen përsëri nga unë. Ishin si të mjegullt. «Kush po ia lag kështu sytë, — mendova. — Ndofta zhurma e detit.» Sepse isha i sigurt se ai e kishte shtëpinë buzë detit. Ai nxori paketën e cigareve.

— Ndize, — më tha.

E falenderova.

— Sa do të rrini jashtë? — më pyeti.

— Dy javë.

— Dy javë?!

— Po.

— Kurse unë nuk e di se kur do të kthehem përsëri. Ndoshta pas një viti, ndoshta pas dy.

— Çfarë punoni?

— Kuzhinier, në një restorant. Kam katër vjet.

Kur dëgjoval se ai kishte katër vjet, mendova t'i drejtokesha në gjuhën e atij shteti evropian, ku po shkoja me shërbim dhe ku ai kishte katër vjet. që kishte emigruar. Deri atëherë, më shumë se me anën e fjalëve qemë marrë vesh me gjeste. Gjuhën e vendit të tij shumë pak e njihja. I folat. Ai uli kokën. Kur e ngriti kishte vënë buzën rië gaz. Ishte një buzë-qeshje më e hidhur se e para.

— Vërtet kam katër vjet, por nuk di ta flas. Di aq fjalë, sa mjaftojnë për të ngrënë dhe për të fjetur. Mos mendo se kjo ndodh vetëm me mua. Kjo ngjet me tërë emigrantët.

E pashë se ai ishte i fyter. Dhe dhimbja në sy vinte

nga kjo fyerje e përhershme. Asnjëherë nuk isha ndodhur aq pranë me emigrimin. Dhe, si për të më trondit tur akoma më shumë, ndjeva erën e jargavanit. «Nga u fute, të marrtë dreqi», — thashë me vete. Emigrant i fiku cigaren dhe ndezi një tjetër. Kabina u mbush tërë tym. Po as tymi i duhanit nuk e mposhti dot erën e jargavanit. Ula pak xhamin. Ajri i ftohtë i natës u fut tërë vrull brenda. Mund të ftoheshin ata që flinin prandaj e mbylla. Përdorimi i gjuhës së shtetit drejt të cilit po shkonim, por nga i cili na ndante akoma më tepër se një gjysmë nate, vuri midis meje dhe emigrantit një mur heshtjeje që nuk dinim si ta thyenim. Ndërkohë treni hyri në një stacion të vogël.

— Si quhet ky stacion? — e pyeta.

— E kam harruar. Në fillim i dija përmendsh emrat e të gjitha stacioneve, por tanë i kam harruar. Të duhet patjetër emri i tij?

— Jo, — i thashë.

— Po të të duhet pyesim ndonjë pasagjer.

— Jo, — i thashë përsëri, — s'është nevoja.

Stacioni mbeti pas. Treni e kaloi atë pa e ulur shpejtësinë. Ishte një stacion fare i parëndësishëm.

— Ka çaste kur unë flas me vete, — tha papritur djali. Këtë herë dhimbja në zërin e tij ishte më e madhe.

Unë e vështrova i habitur.

— Flas me vete sepse nuk kam me kë të flas dhe sepse më duket sikur kam harruar të flas, sikur gjuha më është tharë dhe mpirë. Flas e flas dhe pastaj shtrihem të fle. Po nuk më merr gjumi. Ngrihem, ndez një cigare dhe përsëri flas me zë të lartë. Por ajo që më tremb është se më duket sikur nuk flas unë po dikush tjetër. Në mëngjes kam dhembje koke. Vishem me shpresë mos takoj ndonjë të njojur, që të shkëmbet dy fjalë, por midis njerëzve më mbushet mendja se jam më memec sesa në dhomën time. Njerëzit nxitojnë. Askush nuk ma ka ngenë. Më vjen të thérres. Një komshiu im, mjek, më ka këshilluar që të thérres kur më vjen për të thirrur. Por, sa bëhem gati, dikush më zë grykën dhe

më mpin gjuhën. Nuk e di po nuk ka gjë më të tmerrshme sesa të duket gjuha si e vdekur.

Ai vagon i binte gati mes për mes Gadishullit të Ballkanit dhe pastaj futej në shtetet e Evropës që rrrethonin Gadishullin. Gruaja që rinte përballë meje u zgjua. Ishte një grua e moshuar, trupvogël, me fytyrë të tharë, por me sy mjaft të gjallë dhe ekspresivë. Ajo pyeti e trembur djalin për diçka, me atë akcentin melodioz të njérës prej gjuhëve më të lashta të Mës-dheut. Gruaja e kishte fytyrën të rrahur nga era e detit, që i kishte dhënë lëkurës së saj një ngjyrë kafe në gështenjë. Djali u përpooq të vërë buzën në gaz dhe nga drita e syve të tij dukej se përpiquej ta qetësonte. Gruaja e mori veten me vonesë. Nga gjuha e tyre kapa vëtëm fjalën «fli». Djali po i thoshte gruas të flinte, por asaj e qe trembur gjumi. Djali iu lut përsëri të flinte dhe gruaja mblodhi këmbët nën vete, lëvizje fshatarake pranë vatrës së zjarrit, dhe mbylli sytë më shumë përtë mos ia prishur djalit, sesa për të fjetur. Treni ecte përmes një fushe të errët. Asnjë dritë. Po afrohej mes-nata. Gruan pak nga pak e zuri gjumi.

— Shkon të takojë të birin, — sqaroi djali duke mabërë me kokë nga gruaja që flinte. — Është emigrant, në Austri.

— Jeni nga një qytet?

— Jo, jo. Ajo është nga ishulli B. U njohëm këtu, në tren. E dini ku bie ishulli B?

— Jo, — i thashë.

— Është një ishull i vogël, i varfër. Unë kam kaluar njëherë andej. Ka shumë ullinj dhe agrume. Po ka dhe shumë të emigruar. Edhe nga shteti ku po kalojmë kanë emigruar shumë.

— E di, — i thashë.

Gruaja lëvizi dhe shalli që kishte hedhur krahëve rrëshqiti e i ra përtokë. Djali u ul dhe ia hodhi supeve. Ishte një shall i zi, i thurur me dorë.

— Ajo largohet për herë të parë nga ishulli B. Është pesëdhjetë pesë vjeçe. Gratë e ishullit B zakonisht lindin, martohen dhe vdesin në ishull. Burrat, zako-

nisht jashtë tij. Në varrezat e fshatit gjen vetëm emra grash dhe rrallë emra burrash. Vdesin në dhë të huaj. Edhe i biri si zor të kthehet më në ishull. Ajo shpreson që ai të kthehet një ditë, por unë e di se kjo nuk ka përtë ndodhur.

— Mos shkon t'i ndërrojë mendjen?

— Jo, — tha djali me keqardhje. — Shkon ta urojë përmartesën. Ka pritur trë vjet përkëtë ditë, gjersa i biri i dërgoi lekë. Tani i biri ka një fëmijë. Më vjen mirë që këtë plakë e nxori nga ishulli i saj gjëzimi.

— Ajo më tepër se e gjëzuar duket e trembur, — thashë unë.

— Tani ajo po fle, — tha djali.

Gruaja e mbledhur me shallin e zi ngjante me një shpend të struktur dhe të shqetësuar nga moti i keq. Dukej sikur nga çasti në çast do të ndodhët diçka e keqe, dhe ajo si një shpend i trembur do të hapte shallin e zi dhe do të vërtitej mbi gurët e ishullit, mbi çatitë e shtëpive, mbi dallgët që përplaseshin brigjeve, duke kërkuar një vend të sigurt. Deri atëherë nuk më kishte ndodhur që të përcaktoja relievin dhe pasigurinë e një toke, nga mënyra se si fle një njëri, ashtu si po e përcaktoja tanë relievin dhe pasigurinë e ishullit B, nga mënyra se si flinte ajo plakë, që pas pesëdhjetë e pësë vjetëve kalonte hapsirën ujore që e ndante ishullin nga kontinenti. Që kur hyra në kabinë më bëri përshtypje vështrimi i syve të saj të mëdhenj dhe të zinj; mënyra se si i dëgjonte gjuhët e ndryshme që fliteshin nëpër stacione dhe në korridorin e vagonit, aq të rëndomta përtrenat, e linjave të largëta dhe të gjata. Ajo shqetësohej kur intuita e rrahir me detin, ullirin, gurin e ishullit i thoshte se njeriu që hyri në vagon apo kaloi nëpër korridor nuk do t'i shkaktonte ndonjë të keqe asaj. Më shumë se një udhëtim ai ishte përtatë grua një dramë, një ankth, krejt të ndryshëm nga drama dhe ankthi i kaluar deri atëherë. Ajo dramë kishte kohë që kishte nisur, po fundi nuk i dihej. Gruaja që flinte ishte një nga personazhet e asaj drame e cila quhej emigrim. Fytyra e saj kishte diçka nga fa-

taliteti i ishullit, kurse fataliteti i ishullit diçka nga fataliteti i tragjedive të lashta.

— E di si i kishte shkruar i biri në letër? — shtoi emigrant. — «E dashur nënë! Dy biletat: imja dhe e gruas sime kushtojnë më shumë se bileta jote. Prandaj, të lutem, nisu. Më ka marrë malli dhe të ka marrë malli akoma më shumë. Do të të pres në stacion, së bashku me vajzën e vogël. Po s'të pëlqeu emri i saj vëri ti një emër. Një emër që të mbajë erën e ishullit tonë.»

Djali nuk e fshinte dot dhimbjen që ishte në çdo pjesë të fytyrës së tij. Ishte një dhimbje e mprehtë që i jepte vështrimit të tij një hije të veçantë, e cila të mbetej e pashlyer dhe që ndoshta nuk kisha për ta harruar kurrë. Ishte një nga mbresat më të forta që po më jepte ai tren, troku i të cilit nxitonte pa u ndalur nëpër natë, i mësuar të mbartte dramat e njërrëzve. Bile linja që ai e respektonte me rigorozitetin e një makine nuk mund të ishte veçse linja dhe itinerari i një drame. «Dy biletat: imja dhe e gruas sime kushtojnë më shumë se bileta jote. Prandaj, të lutem, nisu...» Djalit i flihej dhe po e mposhtte gjumi. Mua më qe arratisur gjumi. U ngrita sepse ndjeva përsëri erën e jargavanit të vërtitej mbi kabinën tonë.

— Ku po shkon? — më pyeti djali.

— Të pi një cigare, — i thashë.

Kisha nevojë të shkëputeshë për pak çaste dhe të çlodhja sytë. Korridori i vagonit ishte bosh. Ai të kujtonte korridorin e një hoteli pas mesnate, kur gjumi ka shuar gjithçka, duke mbuluar njërrëzit, pavarësisht nga hallet, gjëzimet dhe shqetësimet e tyre, me çarçafin uniform të heshtjes. Vagoni flinte. Nëpër kabina pasagjerët kishin shuar dritën e madhe dhe kishin ndezur vetëm dritën e kaltër, të zbehtë të gjumit. Edhe perdet i kishin lëshuar. Ula xhamin e dritares, por u detyrova ta ngrija përsëri sepse era qe e fortë dhe e ftohtë. Mbështeta ballin mbi xham. Jashtë nuk dallohej gjë prej gjëje. Vonë, nuk e di se kur u shfaq një dritë e largët. Një shtëpi në mes të fushës... Dhe për një

çast harrova se ku ndodhesha dhe ku shkoja. Ndoshta kështu do të bëja pa e ndier fare një pjesë të mirë të rrugës, sikur të mos më kishte têrhequr vëmendjen ndezja e një drite në kabinën prapa shpinës sime. Doja të mos shkëputeshë nga ajo gjendje ku më kishin futur kujtimet, por nuk munda. E ndjeva se dëshira ime për t'u kapur pas diçkaje për të kaluar orët ishte më e dobët se ngacmimi që më jepte treni. Pas dritës u ngrit dikush dhe hapi derën. Ai ishte në kanotierë. Më kaloi pranë duke shpërndarë kuterbimin e një trupi të palarë. Flokët e gjatë, të verdhë e të palarë. Dera mbeti e hapur dhe në ndenjëset e kabinës flinin dy të rinj të tjerë, kurse në dysheme ishte shtruar një dyshek, ngjyra e verdhë e të cilit, përngjante me ngjyrën e kanotierës së palarë. Në cep të dyshekut i cili dilte pak në korridor, lexova «Made in England». Përsëri ishull, mendova. Ishulli B dhe ishulli i madh. Ata nuk i bashkonte asgjë përveç këtij vagoni. Gruaja flinte e mbledhur dhe e mbuluar me shallin e zi, si ishulli B kur ndiente keqësimin e motit. Djali me kanotierë u kthye. Sytë e tij sikur digjeshin në zjarr ethesh. U fut me nxitim në kabinë duke e mbyllur derën me bërryl, sikur druhej mos ndotte duart. Dera nuk u puthit plotësisht ngaqë e pengonte dyshiku që dilte mbi shinën ku ajo rrëshqiste. Mbeti bosh një shirit i kaltër drite. Djali hapi një kuti të nikeluari, nxori një shiringë. Shiriti i kaltër nuk më lejoi të shihja me se e mbushi shiringën. Ai çoi lart majën e gjilpërës. Bebzat e syve iu zmadhuan më tepër sesa kur kalojmë nga një ambient me dritë në një ambient të errët. Bile mua m'u duk sikur sytë e atij djali nuk kishin asgjë, as të bardhë, as të kaltër, as kafe. por vetëm bebe. një bebe të zmadhuar, që ishte mbërthyer të maja e gjilpërës sikur shihte aty tmerrin apo të papriturën më të pabesueshme. Doja të mos e shihja më. Djali nguli gjilpërën në llërën e dorës dhe përsëri u habita se sa shpejt u zvogëlua bebja e syrit, duke humbur pak nga pak zjarrin e etheve. Ajo u kthye në diçka të qelqtë, të turbullt, të thatë, të hirtë, si një film i zbardhur. Djali hodhi kutinë diku dhe, si fiku dritën e madhe të

kabinës, u shtri të flinte. Shiriti i kaltër që krijonte dera e mosputhitur mirë, i tregonte trupat e tyre si pa peshë. Dhe era e rëndë e trupave të palarë dilte prej kabinës duke të goditur në hundë. Doja ta mbyllja mirë atë derë që e mbante hapur copa e dyshekut ku ishte shënuar «Made in England». Era e jargavanit që më kish-te ndjekur kudo tanë ishte zhdukur pa asnjë gjurmë e trembur nga era e rëndë e djersës dhe pluhurit. E dija se ajo do të përhapej përsëri, vecse në atë çast ajo nuk guxonte të shfaqej.

Treni ngadalësoi shpejtësinë. Po i afrohesin një stacioni të vogël. S'vonoi shumë dhe treni u nis përsëri nëpër natë. Thitha edhe një herë bishtin e cigares dhe e flaka jashtë. Ajo humbi në errësirë. Hyra në kabinë. Të gjithë flinin. Po bëj edhe unë një sy gjumë, ndofta kur të zgjohem ka aguar dhe në agim rruga nuk të duket e pafund.

Kur u zgjova gjëja e parë që më ra në sy, ashtu si isha mbështetur mbi dorën e djathtë, ishte vezullimi i dritave të një qyteti të madh që sa vinte dhe tretej në errësirën e natës. Në atë gjendje gjysmëdremiteje ai qytet më dukej sikur nuk ishte diçka reale por sikur ishte ngritur nga qelizat e zgjaura të trurit tim, nga ato qeliza që shkaktojnë zakonisht edhe ëndrrat. Pas pak kapa zhurmën më të afërt, trokun e pandalshém të trenit. Ai ecete. Ngaqë prisja të zgjohesha kur të kishte aguar dhe ngaqë pashë se kjo nuk kishte ndodhur, pata përshtypjen sikur nata dhe treni nuk do të pushonin kurrë së ecuri paralel. Trang-trang. Truk-truk. Ishte troku i trenit. Nata trokonte pa zhurmë. Nata asnjëherë nuk bën zhurmë. Nata vetëm fsheh. Trang-truk. Truk-truk. A e dëgjonte edhe qyteti që po humbiste trokun e këtij treni? «Me siguri, — thashë. — Ky tren ka marrë diçka nga ai qytet, kur ka ndalur në stacion, gjithashtu edhe i ka dhënë diçka atij nga pesha e vet.» Kjo «diçka» lidhte qytetin me trenin si lidhet përralla me jetën. Na ishte njëherë një tren që trokonte e trokonte vetëm kur ngrysej...

Qafa më ishte mpirë. Kur u ktheva nga vendi ku flinte gruaja, mbeta i habitur. As ajo as djali nuk ishin

më në kabinë. Në vendin e tyre ishte ulur një grua tjetër, pak e shëndoshë. Kabina m'u duk bosh fare. Ata kishin zbritur kur unë flija. Dhe gjumi më kishte zënë kur nuk duhej të më zinte. Më erdhi keq që nuk i kisha përcjellë të paktën deri te shkallët e atij vagoni. Ata kishin zbritur me shumë kujdes që të mos shqetësonin gjumin tim të rëndë. Dhe ngaqë po përpinqesha të përfytyroja ecjen e tyre të lehtë, më ngjau sikur gruaja nga ishulli B dhe djali nga qyteti P nuk kishin shkelur mbi dyshemenë e kabinës, por kishim flutuar me shallin e zi, të punuar me dorë. Gruaja gjatë tërë rrugës nuk kishte folur asnjë fjalë. Vetëm sytë e saj të zmadhuar shprehnin mendimet e saj. Edhe në ishull ajo grua nuk duhej të fliste shumë. Ajo grua gjithçka e shprehte me sy, edhe gëzimin, edhe afrimin e motit të keq.

Futa dorën në xhep për të nxjerrë paketën e cigareve. Kjo ishte lëvizja më e arsyeshme që mund të bëja, pas tërë atyre mendimeve, kur gruaja e shëndoshë që kishte zënë vendin e gruas nga ishulli më buzëqeshi dhe më zgjati një paketë cigare. E kundërshtova duke i zgjatur paketën time. Ajo tundi kokën duke më dhënë të kuptoja se ajo nuk e pinte duhanin. Më la në dorë paketën e bardhë të cigareve dhe më bëri me shenjë nga një shënim që ishte aty. E lexova me një frymë.

«Ju jeni shqiptari i parë që kam njojur nga afër. Më falni për dhuratën dhe mos u fyeni nga varfëria e saj. Në qoftë se duhani ju duket i fortë, kjo vjen se ai është ujitur me hidhërimin e tokës sime. Udhën e mbarë dhe u ktheft shëndosh në Atdhe!»

Kur ngrita kokën gruaja përballë më buzëqeshëtë përsëri. E falënderova. Gruaja u bë gati të fliste, por unë ktheva kokën se më pëlqente të heshtja dhe të shikoja jashtë dritares për t'u përqendruar më mirë në mendimet e shumta që më buisen në kokë. Dritat e qytetit të madh pothuaj ishin zhdukur. Në dorë vërtitja paketën e cigareve dhe nuk dija si ta shpjegoja atë dhuratë të thjeshtë me atë shënim aq të dhimbshëm. Të paktën të isha zgjuar për t'i dhënë edhe unë diçka. Dhe menjëherë m'u kujtuan mollët që kisha lart në valixhe. Ato m'i

kishte dërguar nëna nga Korça, apo mori vesh se do të nisësa për jashtë shtetit. Valixhja, apo e hapje, lëshonte erën e mollëve. Erë mollë mbanin edhe këmishët dhe pulovrat. Ishte një erë e lehtë, çlodhëse. Ajo do të më ndiqte gjatë tërë kohës së shërbimit, deri kur të zbrisja në aeroportin e Rinasit. Ndoshta ajo erë do të ishte dhurata më e mirë që mund t'i jepja djalit nga qyteti P dhe gruas nga ishulli B, të cilët kushedi me ç'tren udhëtonin tanë, të ndjekur nga era e jargavanit. Dhe ngaqë nuk e dija se në q'vende dhe vise shkonte treni i tyre, përfytyrimi im ishte statik.

— Ku zbritën? — pyeta gruan e shëndoshë.

— Atje, — tha ajo duke bërë me kokë në anë të kundërt me ecjen e trenit tonë. — Djali donte të zgjonte, por nuk e la gruaja. Dhe djali nuk të zgjoi, megjithëse e pasë që nuk donte të largohej pa të thënë diçka. Se çfarë nuk e di, por që nuk i bënин këmbët të ikte pa të thënë diçka, kjo dukej qartë. Edhe para se të dilte, qëndroi në mes të derës, me shpresë se mos zgjoheshe. Po ti flije. Dhe ai m'u lut të të jepja paketën e cigareve. Shkroi shpejt e shpejt diçka dhe iku me nxitim, sepse po nisej treni i tij. Megjithatë atij i mbeti peng që të la në gjumë.

Kjo më trishtoi akoma më tepër. Këtë gjë e vuri re edhe gruaja, e cila u mat të më thoshte diçka qetësuesë.

— I ke gjë të afërt? — më pyeti.

— Jo, — i thashë. — I njoha këtu, në tren.

— Ndofta i takon përsëri. Ishin njerëz të mirë.

— S'ma merr mendja t'i takoj më.

— Këtë të keqe kanë trenat. Të bashkojnë përkohësisht dhe të ndajnë përgjithmonë. Apo jo?

Unë mblodha supet, megjithëse e ndieja se atë djalë nuk e lidhët me mua diçka e përkohshme, si është një udhëtim me tren, por diçka e qëndrueshme, e përhershme. Dhe e vërhershme dhe e qëndrueshme mund të jetë vetëm lidhja me tokën, pjesë e së cilës je ti dhe që e mbart me vete kudo që shkon. Po këtë nuk ia thashë gruas, së cilës ashtu si edhe mua i kishte ikur gjumi. Por heshtja ime sikur e ndrydhi gruan. «Duhet ta

prish unë heshtjen që shkaktova vetë», — thashë. E pyeta se nga ishte. Ajo më tha se prindërit i kishte, në mos e kam harruar, nga pjesa perëndimore e Ukrainës. Vetë kishte lindur në një shtet tjetër. Kjo dukej edhe nga mbiemri i saj, të cilit i mbaj mend vetëm rrokjen e fundit vski. Tani banonte me të shoqin në Athinë. Ishin njojur në një kamp përqëndrimi në Austri. Kishte dy vajza të martuara dhe tani po shkonte te vëllai. Vinte rrallë sepse rruga ishte e gjatë dhe ajo po plakej, si më tha me buzën në gaz. Pastaj heshti. Sikur nuk kishte ç'ti shtonte më biografisë së saj. Mua më bëri përshtypje se, kur fliste për Atdheun, asnjëherë nuk thoshte Bashkimi Sovjetik, por Rusia. Bile kur ndërhyra, duke menduar se mos i ngatërronte pa vetëdije këto, ajo buzëqeshi trishtueshmë dhe përsëriti: Rusia. Pas saj vura edhe unë buzën në gaz. Po, tunda kokën, Rusia.

— Më fal, — tha ajo pas pak, — kam dëgjuar përvendin tuaj edhe nga burri edhe nga vajzat, por ndofta nuk jam shumë e sigurt për ato që ata më thonë dhe jo se nuk u besoj burrit dhe vajzave, por... Kam dëgjuar se Qeveria juaj ka nxjerrë një vendim për uljen e pagave të larta, që ato të punëtorit dhe të nëpunësit të mos kenë diferencë. Është e vërtetë?

— Po, — i thashë.

— Po ky vendim është zbatuar?

— Sigurisht, — i thashë i habitur.

— Më falni, që ju pyeta.

— Ju lutem.

— Edhe në Atdheun tim kanë dalë vendime të tilla, por nuk janë zbatuar. Prandaj, të më falni që ju pyeta.

Gruaja foli me dhimbje. Ajo e donte Atdheun e vet. Për të fshehur dhimbjen ajo hodhi vështrimin jashtë. Unë ndeza një cigare nga kutia që më kishte lënë djali nga qyteti P. Ndoshfa kështu si unë edhe ai tani po thithte cigare dhe vështronë natën nga dritarja e vagonit. Ndofta kështu si unë edhe ai po udhëtonte nëpër një fushë të shkretë. Duke menduar për djalin, harrova për një çast gruan, së cilës nuk do t'i harroja kurrë rrokjen e fundit të mbiemrit të saj, vski. Pjesa tjetër u

thërrmua nëpër natë. Edhe troku i trenit më dukej se përsëiste po rrökjen e saj të fundit Vski-Vski-Vski...

— Të pyeta për pagat, se para dy vjetësh na thirri mua dhe një shoqen time gruaja e ambasadorit tonë në Athinë, — tha papritur gruaja. U bëmë gati dhe shkuam. Kur shkon në ambasadën e vendit tënd në një shtet të huaj, të duket sikur ke shkuar në Atdheun tënd. Ndoshata kjo ngjet vetëm me mua, që jam e përmallur dhe ndoshta ngaqë më janë dobësuar nervat. Nuk e di. Po në ato çaste e harron se ku ngrihet ndërtesa dhe në çrrugë është ajo. E harron edhe gjuhën e huaj që flitet rreth e rrotull saj. Ti je në Atdheun tënd. Edhe gjuha e huaj që flasin kalimtarët nuk është gjuhë e vendit, por e të huajve, që kanë ardhur turistë në Atdheun tënd. Çdo gjë është e rastësishme, ndërsa e përhershme është ndjenja se ti je në tokën tënde. Kështu më ishte dukur sa herë shkoja për të nxjerrë vizën në ambasadë. Po kur na thirri gruaja e ambasadorit, e merr me mend se sa e fortë u bë kjo ndjenjë. Isha si në èndërr. Si në èndërr i ramë ziles, si në èndërr hymë brenda dhe si në èndërr shihja fytyrën e gruas së ambasadorit, me ato tiparet e bukura të grave të vendlindjes sime. Isha veshur me rrobat më të mira, kurse shoqja ime ka pesë fëmijë dhe të shoqin të sëmurë. Veshjen e shoqes sime nuk e vura re. Kjo i ra në sy gruas së ambasadorit. Ajo fliste vetëm me mua. Shoqja ime, sa vinte dhe po e ndiente veten edhe më të mjerë. Më të mjerë në tokën e vendit të saj. Sepse kështu është ambasada. Gruaja e ambasadorit i ra ziles. Na sollën kafe dhe pijë. Shoqja ime sa i vuri në buzë. Ajo gati sa nuk qante. E kishin fyer rëndë. Por përpiquej me çdo kusht të mbahej. Tërë kënaqësia e ardhjes m'u kthyte në nervozizëm dhe mezi prisja të mbaronte ceremonia, sepse gjithçka kishte hijen e ceremonisë, që të iknim. Gruaja e ambasadorit përpiquej të ishte sa më e sjellshme me mua. Si mbaruam kafen u çova. Gruaja e ambasadorit u habit dhe më tha të rrija edhe pak. I thashë se kisha tërë ato rroba për të larë. Ajo nuk kundërshtoi. Shoqja ime i dha dorën dhe doli me nxitim. Gruaja e amba-

sadorit më kapi për krahun dhe më tha se unë mund të shkoja sa herë të doja në ambasadë por s'kisha përsë të merrja me vete edhe shoqen time. Rrugës shoqja ime më tha se nuk kishte për të shkelur më në derë të ambasadës. «As unë nuk kam për të vajtur», — i thashë.

Gati një javë nuk isha në rregull. Edhe gjumin e bëja copa-copa. Burri u shqetësua dhe më pyeti nëse doja të shkoja në Atdheun tim. «Po», — e gënjeva. Preva biletë dhe u nisa. Rrugës isha e mërzitur dhe nervoze. Sikur s'po shkoja në Atdheun tim të çmallesha me vëllezërit dhe mëhallën ku u rrita, po sikur shkoja drejt një toke të panjohur, të huaj, me të cilën as vetë nuk e dija se çfarë me lidhte.

Sapo zbrita në stacion, pyeta vëllanë e madh që kishte dalë për të më pritur nëse e njihte gruan e ambassadorit tonë në Athinë.

«Jo, — më tha ai, — por mund ta gjejmë».

«Tani», — ngula këmbë unë. Vëllai u habit.

«Ç'ke kështu», — më tha.

«Ta shpjegoj më vonë», — i thashë. Morëm në telefon Ministrinë e Jashtme dhe ata na dhanë adresën ku banonte nëna e gruas së ambassadorit. «Tani u qetësove», më tha vëllai. E pashë në sy dhe qesha hidhur. «Sa do të desha që të lehtësosha kaq shpejt», — i thashë. Ai u habit, por nuk më pyeti më. Jemi kuptuar gjithmonë bashkë. Bashkë kemi qenë edhe në ilegalitet.

Të nesërmen i shkuam në shtëpi nënës së gruas së ambassadorit tonë në Athinë. Ajo sapo kishte larë rrobat dhe po i nderte në tel. Që në fillim e ndjeva se ajo ishte një grua e thjeshtë. I thashë se nga vija. Ajo fshiu duart pas përparrëses dhe më puthi, si mund të puthi një nënë që e ka fëmijën larg. Pastaj na futi me zor brenda, dhe nuk dinte ç'të bënte për të na e shpërblyer mundin. Nga e bija kishte kohë që nuk kishte marrë letra dhe ishte e përmalluar. Si qdo nënë.

«Nuk ka ardhur ndonjëherë këtu», — e pyeta me takt, që të mos e fyeja padashur.

«Ka ardhur dy herë, po ka qenë e zënë me pumë dhe s'ka pasur një minutë kohë pér t'u kthyer. Kanë shumë punë fëmijët tanë», — e justifikoi ajo me gjerësinë e nënës. Doja t'i thosha se kjo nuk ishte e drejtë dhe se e bija ka pasur kohë, ka pasur shumë kohë, por s'mund të kthehej se nuk mund të pranonte se kishte një nënë, duart e së cilës kishin shenjën e sodës së sapunit. Po ndofta ajo e dinte këtë gjë edhe pa ia thënë unë, sepse ishte nënë. Dhe si çdo nënë që fal edhe ajo e falte të bijën, pér gjithçka. Edhe pér harrimin.

U largova edhe më e mërzitur se nga selia e ambasadës Nëna e së shoqes së ambasadorit tonë në Athinë na u lut të qëndronim pér drekë, por unë isha e shqetësuar. Edhe te vëllai nuk më rrihej. Doja të kthehesha në shtëpinë time. Vëllai nguli këmbë dhe unë e shtyva udhëtimin edhe dy ditë. Nuk dola fare nga shtëpia, me gjithë këmbënguljen e vëllait pér të më shëtitur. Shkova vetëm te varri i komandantit të njësitet tonë gueril.

Ditën e fundit para se të largohesha, pér të mos e merakosur vëllanë, ia tregova shkakun e mërzitjes sime. Ai më dëgjoi dhe nuk m'u përgjigj menjëherë. Ja, si tani e kam para syve si vërtitej nëpér dhomë dhe nuk dinte nga t'ia niste. Më tha vetëm kaq, se ajo që kisha parë ishte diçka e zakonshme. Nuk harrohen vetëm prindërit, por, ajo që është më e dhimbshme, po harrohen gjaku dhe lufta. Kur më përçolli vëllai im m'u duk më i plakur se kurrë dhe unë mendova me dridhje se ndoshta kjo ishte hera e fundit që po e shihja...

Gruaja heshti. Kishte folur me një frymë. Midis nesh hyri klithma e lokomotivës. Zgjata kokën jashtë dritäres pér të parë përsë klithi aq e trembur lokomotiva por nuk dallova gjë. «Është llahtarës në gjumë,» mendova i hutuar. Kishte gati gjashtë orë që ecte nëpér natë. Diku kisha lexuar, ndoshta në leksionet e psikologjisë, se ëndrrat shkaktohen zakonisht ndaj të gdhirë. Ndofta lokomotiva ka parë ndonjë ëndërr të ligë dhe është trembur. Ndofta ka kaluar ndonjë vend të rre-

zikshëm dhe është gjëzuar. Sepse një lokomotivë, si frikën dhe gjëzimin i shpreh vetëm me klithmë, si një fis i lashtë i xhunglës.

Gruaja nuk kishte ndryshuar as edhe një pjesë të fytyrës. Kishte ngrirë tamam si një kërcyes majë tramplinit, para se të bëjë kërcimin vendimtar. U çova dhe zbrita valixhen. Nxora dy mollë. Një ia dhashë gruas. I thashë se m'i kishte dërguar nëna nga qyteti i lindjes. «Qenkan të shijshme», — tha gruaja. I thashë se qyteti im ishte i njohur për mollë. Ajo përpiquej të tregohej e qetë dhe sikur e kishte harruar atë që më tregoi pak më parë. Vetëm kur vështrimi im hasta vështrimin e saj, ajo i largonte menjëherë sytë. Pastaj, si vështronte diku në korridor apo në vendin e bagazheve, kthehej nga unë e shpërqendruar. Bile aq e hutuar ishte bërë, sa më pyeti dy herë për të njëjtin stacion, nëse e kishim kaluar apo jo. Dikush hapi derën e kabinës sonë dhe kërkoi të ndizte cigaren. I zgjata shkrepësen. Ai u largua pa më falënderuar. Kur ktheva kokën nga gruaja, ajo ishte zhytur në mendime. Thashë të mos e shqetësoja. Ajo ishte një grua e sinqertë dhe po të kishte diçka për të më thënë do të ma thoshte edhe pa e ngacmuar unë.

Lokomotiva klithi përsëri, por këtë herë në mënyrë paralajmëruese. Po hynim në stacionin e parafundit të atij shteti. Pashë orën. Mëngjesi do të na zinte në shtetin tjetër. Treni frenoi vrullshëm. Pothuaj në tërë stacionet e fundit ai frenonte kështu vrullshëm, sikur donte të shkundte njerëzit nga dremitja, sidomos ata që duhej të zbrisnin. Vendosa të numëroja se sa pasagjerë do të zbrisnin. Një, tre, shtatë. Shtatë. Hipën tetëmbëdhjetë. U mbyllën dyert e vagonave. Po treni nuk lëvizte nga vendi. «Po shpin kockat.» Përtej dritareve të trenit, para godinës së stacionit u hap një barakë. Dikush pyeti një konduktor nëse kishte kohë të shkonte të blinte diçka për të ngrënë. Konduktori pohoi me kokë. Pas pak nga treni kërcyen tre vetë dhe shkuan me vrap drejt barakës.

— A doni t'ju blej diçka, — i thashë gruas dhe bëra me kokë nga baraka.

— Falemnderit. Nuk më hahet kaq herët. Ju po të doni shkonin.

— Përtoj, — qesha unë.

Ajo vuri buzën në gaz. Treni s'kishte ndër mend të nisej së shpejti. Në qëndrimin e tij kishte diçka indiferente karshi shqetësimeve të njerëzve. As që donte t'a dinte për hallet dhe nervozizmin e tyre. Kishte ditë që i mbartte mbi vete. Tani kishte nevojë të prehej dhe të ishte i vetveter. Përsëri u hap dera e kabinës sonë. Hyri një djalë që kërkonte vend. Sapo u ul, në hundë më goditi era e fortë e jargavanit. «Dreq, — thashë, — mendova se kishe zbritur edhe ti në ndonjë stacion. Si nuk m'u ndave!» Djali zuri vend mirë e mirë dhe fjeti. Era e jargavanit mbyti tërë kabinën, si të donte të mbulonte tregimin e gruas.

— Përse nuk po niset treni? — pyeti gruaja e shqetësuar.

Rrudha supet.

Gruaja lëvizi e nervozuar, por e mblodhi veten menjëherë.

— Dua të arrij sa më parë te vëllai, — tha ajo, — ka qenë shumë keq.

— Nga se vuan? — e pyeta.

— Infarkt. Për të dytën herë.

— E kaloi?

— Kështu më shkruante e shoqja, se e kaloi, por unë parandiej atakun e tretë.

— Mos u bëni supersticioze, — i thashë.

— Jo, — tha ajo, — nuk jam supersticioze.

Infarkti i tretë i një militanti të vjetër dhe të harruar, mendova me dhimbje. Megjithëse i gjatë, ky mund të jetë vetëm titull. Pavarësisht se mund të jetë titulli nga më të gjatët deri më sot i çdo romani apo tregimi. Ajo nuk mund të jetë një frazë, thashë përsëri me inat, e një romani apo tregimi. Nuk mund të jetë! Ajo mund të jetë vetëm titulli i romanit apo i tregimit. Infarkti i tretë i një militanti të vjetër dhe të harruar...

Nga zyrat e stacionit doli një punonjës hekurudhe me fener në dorë. E tundi disa herë. Treni u nis.

— Shyqyr, — tha gruaja e lehtësuar. — Stacioni tjetër është fare pranë. Aty do të zgres për të ndërruar trenin. Treni la pas stacionin. Po kalonim nëpër një vend të populluar. Aty-këtu dukeshin drita të ndezura. Pajritur dritat u dukën mbi kokën tonë. Kishim hyrë në zonën malore të atij shteti. Ulërima e lokomotivës ishte më e fortë. «Prandaj pushoi kaq gjatë në stacion. Ka për të ngjitur tërë këtë të përpjetë.» Gruaja u çua.

— Do të zbrisni? — e pyeta.

— Po, — tha ajo.

I ula valixhen dhe u mata ta përcillja deri te dera e vagonit.

— Mos u loddhi, — tha ajo. — Ju falem nderit!

— Ju lutem, — i thashë dhe dola në korridor me valixhet në dorë.

Ata që flinin ngjitur me kabinën tonë bënin një gjumë të rëndë. Dera kishte mbetur po aq e hapur dhe «Made in England» zgjatej mbi shinë. U afroam te dera dhe pritëm. Shtëpitë dendësoshezhe kurse dritat ishin të ndezura tek-tuk.

— Ky tren e pret trenin që do të hipni ju? — e pyeta.

— Jo, — tha ajo.

— A do të rrini shumë në stacion?

— Gjysmë ore.

— S'pritkeni shumë.

— Po.

Treni hyri në stacion e ndriçuar fort. Nëpër stolat e drunjë të peronit prisnin pasagjerë. Ata që do të hipnin u çuan, të tjerët as që lëvizën nga vendi. Gruaja më mori valixhen.

— Do t'jua zgres unë, — i thashë.

— Jo, — tha ajo, — jashtë fryn erë dhe mund të ftoheni. Brenda ishte ngrirë. Treni ndaloi. Hapa derën. Gruaja sikur ngriu në vend. Edhe unë u hutova. S'dinim ç'të bënim. Kapa dorezën e derës. Ajo zbriti. Pas saj unë. Lokomotiva klithi. Ne rrnim si të ngrirë. Mes heshtjes sonë hyri përsëri lokomotiva. Gruaja më dha dorën. Treni u nis. Ia shtrëngova dorën fort.

— Të shkuara vëllait.
Nuk e di në e kuptoi këtë urim të popullit tim.
Ajo më buzëqeshi.

— Hipni, — më tha gruaja.

Ajo mbeti atje mes shinave e palëvizshme, duke më përshëndetur. Unë qëndrova edhe pak te shkallët e vagonit dhe hyra brenda. Në kabinë nuk më vihej. Nxora paketën që më kishte lënë djali dhe ndeza një cigare. Po pija shumë cigare. «Edhe këtë dhe nuk ndez më pa ngrënë mëngjes.» U mbështeta pas hekurit të nikeluar të dritares dhe thitha thellë cigaren. Nga xhami i dritares shikoja si lëviznin hijet e drurëve. Edhe pak dhe lija një shtet dhe hyja në një shtet tjetër. Kufiri duhej të ishte diku, aty pranë. Treni kapercante tërë ata kufij shtetesh me të njejtën shpejtësi, me të njëjtin trok. Sapo kujtova fjalën trok më ngjau sikur troku i atij treni përmendte vazhdimisht një frazë tragjike: infarkti i tretë... Infarkti i tretë... I një militanti... I një militanti... Të vjetër dhe të harruar... Të vjetër dhe të harruar...

Tani treni ndoshta e kishte kaluar kufirin shtetëror dhe unë ndodhesha në një shtet tjetër, ku shkoja për herë të parë. Kishte nisur të zbardhej. Udhëtonim në një hekurudhë malore. Vendosa të shkoja në kabinë. Korridorit po i dilte gjumi. Pasagjerët po zgjoheshin. Hyra në kabinë. Djali flinte akoma. Era e jargavanit dilte prej tij me të njëjtën forcë goditëse. Nuk e merrja dot me mend se si e duronte atë erë aq të fortë. Ula pak xhamin. Ajri i freskët i mëngjesit hyri në kabinë duke shpërndarë ajrin e rëndë të natës. Dita dukej e bukur. Po kalonim mes një pylli të përzier, të zverdhur nga vjeshta, me plot lirishta të gjelbra. Vilat me çatitë e pjerrëta, që të mos mbanin dëborë, ishin shpërndarë mes drurëve. Mbi xhamat e dritareve po binin rrrezet e para të diellit. Shoku im, që e kishte bërë edhe ai këtë rrugë në vjeshtë, më tha që të shihja një kështjellë, rrëzë së cilës kalonte treni. «Eshtë në krah të djathhtë, mos harro! Në krah të djathhtë!» Për fat edhe kabina jonë ndodhej në krah të djathhtë. Fillova të vështroja

me vëmendje. Ajo duhet të jetë ngritur mbi shkëmb, diku mes malit apo pyllit, ku mund të të çojë vetëm ndonjë rrugë e ngushtë, e rrezikshme dhe e mbrojtur mirë. Majave të maleve kishte mjegull. Disa lopë kullot-nin livadheve të mbajtura mirë. Kështjella nuk po dukej. «Mos e kanë ngritur mes livadheve dhe nuk e kam vënë re?» Por livadhet mund të sulmoheshin lehtë nga të katër anët. Dhe në livadhe mund të ngrejë kështjella vetëm një popull që nuk ka luftuar currë. Kisha dëgjuar se ai shtet evropian, (treni kishte lënë pas Gadishullin e Ballkanit) pretendonte të kthehej në një shtet neutral, por megjithatë kjo nuk do të thoshte se ai shtet në asnje shekull nuk kishte qenë i detyruar të ngrinte kështjella. Kjo do të ishte absurde të mendohej. Në asnje shtet të botës nuk gjen një popull që nuk ka qenë i detyruar të ngrejë kështjella. Vërtet në arkitekturën e vilave që na kalonin para syve s'kishte asgjë të ngjashme me arkitekturën e kështjellave, si kanë kullat e malësive tona të Veriut, por ishte e pamundur që ajo tokë të kishte qenë pérherë kaq e qetë, kaq paqësore. «Me siguri kanë rënë edhe mbi të mëngjese lufte». Po kështjella nuk po shfaqej gjékundi. «Mos nuk e kam parë nga mjegulla?» Po edhe kjo do të ishte absurde. Diçka, majën e një bedeni apo kullén e alarmit do ta kisha dalluar. Isha përqendruar mbi peisazhin vjeshtor të alpeve, kur dëgjova djalin që tha

- Vende të bukura!
- Shumë të bukura!

— Këto vila janë sanatoriume dhe jepen me qira. Po kalojmë nëpër një shtet turistik.

- Mos ka ndonjë kështjellë këtu pranë? — e pyeta.

— O, atë e kaluam, — tha djali. — Ti nuk ishe këtu.

Po pije cigare në korridor.

— Po si nuk e pashë. Të paktën murin rrethues duhej të ma kishte zënë syri.

— Kështjella është e vogël, megjithatë është e bukur. Ajo tërheq shumë turistë.

— Si ka mundësi të jetë kaq e vogël! — u habita unë.

- E ç'i duhej mbretit më e madhe!
— Pse, vetëm për mbretin është ngritur?
— Po, vetëm për mbretin dhe suitën e tij. Thonë se ai nuk u detyrua të mbrohej ndonjëherë në kështjellë. Ai vinte këtu vetëm kur dilte për gjah. Këto pyje kanë gjah të bollshëm. Për të vrarë një sorkadhe turistët derdhin dollarë me të dyja duart. Dhe shteti siguron një përqindje të madhe të të ardhurave nga turistët.
- Edhe me kështjellen?
— Edhe me kështjellen. Kështjellen që ti nuk e pe e kanë kthyer në hotel.
- Ashtu!?
- Përse habiteni?
- Sepse nuk më kishte vajtur mendja se edhe kështjellat mund të ktheheteshin në hotele.
- Më falni, — tha djali, — nga jeni?
- Nga Shqipëria.
- Nga Shqipëria?! Edhe ju keni pasur mbret.
- Po, kemi pasur mbret.
- Po ai, nuk ngriti ndonjë kështjellë?
- Jo, sepse s'kishte ndër mend të luftonte dhe të mbrohej. Bile, ai ua mbathi këmbëve kur vendi ynë u sulmuva nga fashistët.
- Sa keq që nuk ngriti ndonjë kështjellë! Ju keni vende të bukura, më kanë thënë.
- Edhe kështjella kemi.
- Kot, — tha djali, — kot që nuk i ktheni në hotele. Tani nuk mund të qeshja. Djali nuk vuri re gjë dhe vazhdoi:
- Të paktën në Evropë nuk ka më luftë, prandaj s'ka përse të ketë edhe kështjella.
- Ju ku po shkon? — e pyeta.
- Gënjeva gruan. I mora lek gjoja për të blerë ushqime në shtetin fqinj, por i hipë këtij treni. Këtu ka vajza të bukura dhe që i kanë qejf të huajt.
- Vend turistik, — thashë.
- Po, — përsëriti djali pa kuptuar gjë, — vend turistik.
- Mos do të shkosh edhe në kështjellë? — e pyeta.

— S'kam aq lekë. Por, po i mbloðha ndonjéherë, do tē marr ndonjë vajzë e do ta çoj edhe në kështjellë. Kushton shtrenjtë, ta marrë dreqi! — tha djali dhe nxori një shishe tē vogël. I hoqi kapakun. Në kabinë vërshoi era e jargavanit artificial.

— Do pak, — më shkeli ai syrin.

— Jo, — i thashë dhe vështrova jashtë.

Peisazhi ishte po ai. Sanatoriume, lopë, kuaj tē lidhur pas gardheve, livadhe dhe mbi majat e maleve mjegull. Për kështjellën as që më vinte keq që nuk e kisha parë. Kështjellë-hotel. Era e jargavanit artificial. Djali i hodhi edhe dy pika parfum pasaportës së tij. E futi në xhep dhe u rregullua i kënaqur në sedilie.

— Kot nuk bëheni një shtet turistik, — tha pas pak ai. — Mund tē më binte rasti tē vija edhe te ju.

— Kurrë! — i thashë tërë inat; ai vetëm hapi sytë i habitur. — Kurrë! — Por ai do tē mbetej akoma edhe më i habitur sikur ti tregoja se si vajzat tonë hidheshin nga shkëmbinjtë dhe bedenat pér tē mos i rënë në dorë tē huajit. Po nuk ia vllente. Ai nuk do tē kuptonte asgjë. Ai ishte nga një shtet i pushtuar. «Dhe mendon se në Evropë s'ka luftë.» Ai ishte pushtuar pa luftë. I mjerë, nga një shtetkështjellëhotel! Djali u bë gati tē më fliste, por unë u ngrita. Po i afrohesha stacionit ku do tē zbrisja. Ula valixhen dhe dola në korridor. U duken shtëpitë e para. Ato ishin tē rralla, si janë zakonisht shtëpitë në periferi tē qyteteve tē mëdha.

Nga larg pashë stacionin qëndror. Rregullova paradesynë dhe u bëra gati që tē zbrisja i pari, sapo treni tē ndalonë, kur nga vagoni ngjitur hyri një njeri me uniformë jeshile tē policisë së atij shteti i shoqëruar nga një punonjës hekurudhe.

— Ju lutem, pasaportën, — më tha polici.

Nxora pasaportën. Të dy u përkulën mbi emrin tim. Polici shfletoi pasaportën, vështroi vizën dhe kombësinë time dhe, si u sigurua që çdo gjë qe në rregull, u largua drejt dy pasagjerëve që rrinin te dera gati pér tē zbritur. Punonjësi i hekurudhës nuk po m'i ndante

sytë. U habita se ai nuk e fshihte emocionin që ndiente.

— Na falni, — tha ai, — kemi një sinjalizim përkontrabandë armësh, prandaj dhe ju kontrolluaam.

— S'ka gjë, — i thashë dhe u mata të hapja valixhen.

— S'ka nevojë! S'ka nevojë! — tha dhe më kapi dorën me të cilën mbaja valixhen. Ma shtrëngoi fort dhe m'u duk sikur iu lëngëzuan sytë. Dicëka donte të më thoshte por nuk mundte. Polici i thirri të nxitonte për të përfunduar sa më parë kontrollin e valixhes sime.

— Kam dëgjuar për vendin dhe për partinë tuaj — tha shpejt e shpejt punonjësi i thjeshtë i hekurudhave dhe u largua duke ndjekur pas policin për të kontrolluar valixhet e dy pasagjerëve që prisnin te dera të zbritnin.

Ndërsa largohej punonjësi i hekurudhës ktheu kokën edhe një herë dhe më buzëqeshi. Pastaj u fut brenda nё një kabinë. Treni po hynte nё peronin nr. 3 tё stacionit qéndror. Hapa derën e zbrita, dhe nuk e di sepse era e jargavanit m'u duk sikur fshihte kontrabandët e armëve që ai polic si zor ta zbulonte.

Treni, për të fituar sa të mundej minutat e vonesës, u nis menjëherë apo hipën pasagjerët. E ndoqa me sy si filloj të rrëshqasë mbi shinat e ndritshme, nën strehën e peronit nr. 3 dhe m'u duk sikur dikush po më përshëndeste nga dritarja e një vagoni. U mundova të shikoja se kush ishte ai që më përshëndeste, por nuk e dallova dot ngaqë mbi xham reflektohej drita e pastër e diellit. «Punonjësi i hekurudhës», mendova dhetura dorën i sigurt se edhe ai e shihte përshëndetjen time.

ETÉRIT, BIJTË DHE PYLLI

Orgesi erdhi nga thellësia e pyllit duke vrapuar dhe u shtri mienjëherë mbi barin që kishte filluar të thahej. Ai nuk po ngopej dot me frymë dhe ata të dy, burrë e grua panë se si ulëj dhe ngrivej kraharoni i tij i dobët. Gruaja u mat ta përkëdheltë duke ia marrë kokën në prehër, po nuk është la i shoqi. Orgesi, më shumë se i trembur dukej i pezmatuar. Këtë e kapi menjëherë burri, ndaj ia nguli sytë fytyrës së Orgesit dhe dalloi në shprehjen e saj diçka të afërt me zhgënjimin.

Në pyll po thyhej drita dhe pishat u bënë më të vjetra sesa ishin në të vërtetë. Mesdita kishte ngrirë nën diellin e gushtit dhe nuk lëvizte fare. Ndërsa në pyll frynte një erë e lehtë. Për burrin qdo gjë qe e njojur që më parë. Kur ai kishte qenë i vogël e sillte shpesh i ati. Ndërsa sot ai kishte sjellë këtu të shoqen dhe të

birin. Kishte çaste që kjo e habiste dhe i dukej e pabesueshme. Sepse i dukej vetja ende i vogël. Ndoshata nga që pylli ishte po ai i njëzet vjetve më parë, aroma po ajo e njëzet vjetve më parë dhe zhurmat e largëta po ato të njëzet vjetve më parë. Kishte diçka të përjetshme pylli, diçka të pandryshueshme. Cila ishte kjo gjë? Burri, të cilin e quanin Gjergj, nuk po e gjente dot. Dhe tha se e përjetshme ishte pikërisht thyerja e diellit të gushtit nëpër kurorat e pishave, duke i kthyer ato në disa abazhurë gjigantë, të bardhë, pa peshë. Ai ishte i sigurt se nuk ishte vetëm kjo gjë, por në atë çast nuk donte të lodhej së menduari.

Gjergji vështroi Orgesin, i cili tani ishte qetësuar, por që në sytë e tij kishte mbetur akoma, si një mjegull e bardhë, ajo shprehja e zhgënjinimit që iu shfaq kur doli me vrap nga thellësia e pyllit. Ishte një zhgënjin i thellë dhe i papritur që Orgesi nuk e fshihi dot. Vështrimi i sinqertë i tij u ngul mbi fytyrën e të atit. Orgesi përpinqej të gjente aty atë që nuk e kishte gjetur në thellësinë e pyllit. Burri nuk e përballoi dot atë vështrim dhe u mat të bënte shaka, por e përmbajti veten. Orgesi do të prekej dhe mund të qante. Aq i tronditut ishte. E, megjithatë, Gjergjit nuk do t'i vinte mirë që Orgesi t'i thoshte se tërë atë zhgënjin ia kishte shkaktuar pylli. Gjergji e donte pyllin. Edhe i ati e kishte dashur pyllin, ndaj kishte dëshirë që edhe Orgesi ta donte atë. Ai e dinte se në këtë dashuri kishte diçka të madhe, të heshtur, të thellë, të cilën vetëm mund ta ndieje, sepse ishte e vështirë ta shprehje. Ai kishte menduar gjithmonë për të gjetur se ç'fshihej pas kësaj dashurie, por gjithmonë e kishin mbuluar kujtimet e viteve të largëta. Ato nuk e linin të mendonte i qetë. I kujtohej kur së bashku me të atin kërkonin luleshtrydhe nëpër shpatet plot fier, që rrightheshin nga dielli. I ati i tregonte për jetën e tij, për Luftën... I kujtohej gjëzimi që kishte ndier kur pa ketrin e parë që kërcente nga dega në degë... Kur e kishte parë ketrin e parë?... I kujtohej e éma duke i përkëdhelur flokët dhe duke i treguar me dorë varrezat e fshatit në këmbë të pyllit me pisha. Aty nëna

kishte gjyshin e saj. Pastaj i kujtohej përsëri i ati dhe tregimi i tij:

Ne kishim ditë që udhëtonim nëpër pyll. Ishte Lufta e Parë. Isha i vogël. Ishim nisur nga Babica e Vlorës për te një kushëri i largët në Dishnicë të Korçës. Më këmbë. Nuk i kisha mbushur të dhjetat. Babai herë pas here më mbante në shpinë. Në pyll ecja vete. Nëna sa vinte dhe dobësohej. E zuri tifoja. Babai na mbante me shpresë. Por edhe pylli sikur na e hiqte lodhjen. Ecnim. Mua më dukej sikur Dishnica ishte fshati më i largët i botës. Ajo nuk po na afrohej fare. Ecnim. Arritëm në Makërz të Vithkuqit. Aty nëna u këput. Të nesërmen vdiq. E varrosëm të katër: babai, vëllai motra dhe unë. «Nuk do ta lëmë këtu», — tha babai. Ai po qante. «Kur do të vijmë ta marrim?» — tha motra. «Kuschedi. Mbajeni mend mirë këtë vend, që të mos e harrojmë», — tha babai. Ishte një lëndinë e vogël e rrethuar me pisha. Kur u larguam, lëndina të tilla pamë kudo. Po neve na dukej sikur lëndinën ku varrosëm nënën nuk do ta harronim kurË. Sepse njeriu nuk i harron lehtë vendet ku është mbuluar dashuria e tij. Varri i nënës ishte i thjeshtë, shumë i thjeshtë. Mbi të ra dëbora e parë, shiu i parë, mbiu bari i parë dhe e pa edhe njeriu i parë, dhe kuschedi se q'ka menduar. Ai varr kishte një dhimbje të madhe brenda.

Unë rrithesh. Babai kishte halle. Ne nuk e harronim lëndinën e vogël, mes pyllit me pisha të Makrëzës. E shihnim në èndërr. Shkuam pas tre vjetësh. Nuk e gjetëm dot. E ngatërruam vendin. Pylli ishte i rëndë dhe i ngrysur. Sikur i vinte keq që nuk fliste dot. Vetëm ai e dinte se ku ishte varri i nënës. Edhe zhurma e tij më ngjante me një ngashërim burri. Atë e kishte kapur ngashërimi sepse nuk fliste dot. AUUU! AUUU! Babai u dëshpërua dhe tërë rrugës nuk foli asnje fjalë. Unë edhe në gjumë për disa javë rresht dëgjoja au-në e dhimbshme të pyllit.

Edhe pranverën tjetër ne nuk e gjetëm dot lén-dinën. Pylli i përzier kishte shpërthyer në gjethe dhe toka kullonte. Në i humbëm përfundimisht shpresat. Por babai na tha: «S'ka gjë. Ajo është në pyllin me pisha të Makrëzës së Vithkuqit.» Dhe gjithmonë pylli me pisha më kujton nënën.

Burri e kishte dëgjuar vetëm një herë këtë histori nga i ati dhe e mbante mend fare mirë. E kishte dëgjuar kur qe i vogël. Dhe ndjeu dhimbje. Kur u rrit e kuptoi se dhimbja e kishte lidhur me pyllin. Ajo nuk ishte vetëm dhimbja e tij. Ajo ishte dhimbje brezash. Dhe burri tha se njeriu lidhet me tokën vetëm kur dhimbjet janë dhimbje brezash. Dhe e donte pyllin. Dhe donte që edhe i biri ta donte pyllin. Prandaj e kishte sjellë sot këtu.

Orgesi ishte qetësuar dhe shikonte thellësinë e pyllit. Burri i përkëdhelte flokët. Orgesi u përpooq të buzëqeshte. Përkëdhelja e të atit e kishte prekur. Ai u mat të fliste, po ngaqë kishte frikë se mos qante nga zhgënjenimi që i kishte dhënë thellësia e pyllit, ngjeshi kokën në prehër të së ëmës. Gjergji ia nguli sytë dhe përsëri iu kujtua diçka. Sot atij qdo gjë i kujtonte diçka. Kujtimet ishim si erërat që frynin në pyll. Secila kishte aromën e saj. Por ato treteshin pak nga pak dhe atë e pushtonte kujtimi i nënës së tij. Nëna, e thinjur, e rritur pranë këtij pylli me mallin e përhershëm për erën e pishave dhe ujin e burimeve.

— Jo vetëm mua por të gjitha vërsnikëve të mia na pëlqente Çezma e Floririt. Përse? Ku ta di unë e shkretat! Fshati ynë kishte burime edhe më të ftohta, edhe më të bukura. Po ja që vetëm Çezma e Floririt na e bënte zemrën të na rrihte si e shkalluar. Ne shkonim shpesh aty. Kot fare. Uji rriddhete dhe humbiste poshtë në përrua. Në dimër binte dëborë e madhe dhe burimi

mbulohej krejt. Mbetej vetëm një e çarë që neve vajzave na dukej si sy. Ne shikonim vjeten tonë tek ai sy i madh. Ishim çupa. Kur vinte pranvera, neve nuk na rrihej pa shkuar një herë nga burimi, sidomos kur errej. Nën ujë feksnin disa gurë të verdhë. Së më shumë yje të kishte qielli, aq më shumë feksnin gurët poshtë ujit të burimit. Pa le kur kishte hënë. Gurët sikur shtoheshin e sikur kërcenin përpjetë, tamam si peshq. Thoshin se ata ishin lotët e hënës. Dhe ne besonim. Ishim çupa. Dhe në atë moshë çupëzeza beson çdo gjë. Po ç'e ka ngacmuar hënën që të qajë, habiteshim ne. Askush nuk dëntë si të na përgjigjej. Para se të largoheshim pinim ujë. Dhe për habi, uji sikur kishte tjetër shije dhe se ç'të jepte një zjarrllék në gjoks. Ne ktheheshim në shtëpi si të shastisura. Përse kishte derdhur lot hëna dhe përsë na jepte atë zjarrllék në gjoks uji i burimit? Edhe në gjumë nuk na linte rehat që të flinim. Por ama asnijëres nuk ia tregonim. Sepse na vinte turp.

Dhe kështu derisa më fejuan me tët atë. Dhe yt atë ishte djalë i ndershëm. Kur u bëra pënë, i thashë të më conte në fshat. Ai nuk ma prishi. Yt atë nuk ma ka prishur kurrë. Më çoi. Shkova drejt e të Çerma e Florrit. Ajo nuk kishte ndryshuar. Rridhte e rridhte dhe uji humbiste poshtë në përrua. Lotët e hënës nuk ishin shteruar akoma. M'u mblodh një lëmsh në gjoks. «Ç'ke?» — më pyeti yt atë. «Asgjë», — i thashë. Por unë nuk mund ta gënjeja dot. Dhe i thashë se më kishte marrë shumë malli për burimin. «Përse nuk më ke thënë më parë të të sillja?» — më tha yt atë. «Më vinte turp», — iu përgjigja. «Nga unë?» — u habit yt atë. Që nga ajo ditë më sillte çdo vit këtu. Dhe nuk e di, po sikur na shtohej përherë dashuria. Këtë yt atë e kuptonte, se ishte burrë i ndershëm.

Gjengji e kishte dëgjuar një herë këtë nga nëna e tij dhe e mbante mend fare mirë. E kishte dëgjuar kur ishte djalë. Dhe kishte ndier tërë poezinë e saj.

Dhe e kuptoi se kjo dashuri e lidhi më fort me burimin buzë pyllit me pisha. Dhe përsëri tha se njerëzit lidhen me tokën e tyre vetëm kur dridhjet poetike të zemrës janë dridhje që kanë kaluar nga brezi në brez. Ndaj e donte pyllin. Dhe donte që edhe i biri ta donte pyllin. Prandaj e kishte sjellë sot këtu.

Orgesi ia ngulli sytë të atit dhe i tha:

- Baba, unë shkova shumë thellë në pyll.
- Dhe nuk kishte fare frikë, — ndërhyri e éma.
- Jo, — tha Orgesi. — Baba, por edhe aty pylli ishte njëloj si këtu.

Gjergji s'ia ndante sytë të birit.

- Po si të ishte? — tha ai.
- Aty nuk kishte as ujq, as arinj, as sorkadhe. Ishte po aq qetë sa këtu.

Gjergji nuk iu përgjigj në çast. Ai e mori me mend se Orgesi nuk e kishte pasur të lehtë rrugën drejt thellësisë së pyllit. Në atë rrugë Orgesit iu desh të lufkonte me frikën dhe përfytyrimin e tij pér pyllin. Dhe pér moshën e tij kjo luftë nuk mund të kalonte pa lënë gjurmë. Ai kishte imposhtur frikën, por kjo nuk i ishte shpërblyer ashtu si e kishte menduar. Dhe ndjeu atë zhgënjim që nuk e fshehu dot para prindërve.

- Po sikur të të dilte përparrari, q'do të bëje?
- e pyeti Orgesin pas pak.
- Do ta vrisja, — tha djali.
- E pastaj?
- E pastaj... E pastaj... asgjë. Po ky nuk është pyll i vërtetë, gjersa nuk ka kafshë të egra. Ky është pyll i bùtë.

Gjergjit i erdhi pér të qeshur.

- Jo, — i thà, — ky është pyll i vërtetë.
- Ky nuk është pyll i vërtetë, — kundërshtoi jo pa imat Orgesi. — Po ta dija se do të më sillje në një pyll të butë si ky, nuk do të via fare.
- Xhan i mamit, po ky është pyll i vërtetë.
- Jo, — ngulmoi Orgesi. — Unë shkova shumë thellë

dhe nuk pashë asnjë kafshë të egër. Në pyllin e vërtetë jetojnë kafshët e egra.

— Ato janë trembur nga ti, — tha burri.

— Vetém lepujt tremben, e jo arinjtë.

— Ariu po fle, — tha burri.

— Po ujku?

— Edhe ujku.

— Po dhelpra dinake?

— Edhe dhelpra.

Orgesi u mendua.

— Jo, — tha ai pas pak, — gjersa këtu tërë kafshët flenë, ky nuk është pyll i vërtetë. Kafshët e egra ditën kërkojnë ushqim.

— Kur të vijmë herën tjetër, do t'i shohësh, — tha Gjergji me buzën në gaz.

— Unë nuk vij më këtu, — tha i vendosur Orgesi.

Po Gjergji e donte pyllin dhe donte që edhe i biri ta donte atë. Ai e dinte se zhgënjimi në moshën e të birit linte gjurmë. Dhe Gjergji do të mërzitezj sikur i biri të mos e donte atë pyll.

— Ky është pyll i vërtetë dhe ti do ta duash këtë,

— tha Gjergji.

Orgesi u hutua edhe më tepër dhe tha:

— Përse do ta dua këtë pyll?

Burri qeshi dhe e përkëdheli.

— Sepse e dua unë, — tha ai. — Dhe ti e do shumë babanë tënd, apo jo?

— Po, — tha Orgesi i hutuar, — unë të dua shumë.

Dhe papritur hovi përpjete dhe përqafoi fort të atin.

— Babi, po pse në këtë pyll nuk ka kafshë të egra?

Burri ia mori fytyrën me të dyja duart dhe ia nguli serioz sytë të birit.

— Ka, Orges, ka. Ato duhet të jenë fshehur diku prej teje. Po ky pyll ka diçka tjetër më të madhe, që ti nuk e kuption dot tani.

— Përse nuk e kuptoj dot tani? — tha Orgesi pa e fshehur dëshpërimin.

- Sepse je i vogël.
— S'ka gjë që jam i vogël dhe nuk e kuptoj, po ti ma thuaj, — u lut Orgesi.

Gjergji heshtि i menduar. Ai nuk mund t'i thoshte asgjë përvèç asaj që njeriu lidhet me token e vet përmes dhimbjes dhe dashurisë. Kjo ishte një lidhje e natyrshme, e thjeshtë, e përjetshme, ashtu si ishte dhe ai, pyll i natyrshëm, i thjeshtë dhe i përjetshëm. Dhe ai nuk donte t'i thoshte asgjë tjeter vèçse edhe ajo ditë do të futej pa u kuptuar në dashurinë e tij per token dhe prindërit. Po, Gjergji e indiente se nuk do t'ia thoshte dot aq thjeshtë, sa ta kuptonte i biri. Ndërsa i biri po priste. Sa më shumë që të heshtë i ati, aq më tepër ai do të dyshonte te pylli. Dhe nga gjithçka kjo do të ishte më e dhimbshme për Gjergjin. Mbi pyll ushtoi echoja e një këngë të largët dhe më afér zilja e një mushke. Dikush po kalonte përskaj pishave. Dielli ishte ulur, më në perëndim. Rrezet futeshin në pyll duke shqetësuar jetën e tij. Pishat zune te fërshëllenin. Gjergji u prek nga ky gjallërum i pyllit, i fundit për atë ditë, para se ai të zhytej mën velin e müzgut. Ai nuk i ishte përgjigjur akoma të birit. Orgesi po priste. Dhe Gjergji tha se, sido që t'ia shprehte lidhjen me pyllin, i biri do ta kuptonte. Dhe i tregoi për gjyshin e tij, pastaj për të atin dhe të emën. Pastaj për veten e tij... Kur mbaroi, Orgesi e vështronte i menduar dhe nuk fliste. Atij nuk i durohej sa të dëgjonte se ç'do të thoshte i biri. Por Orgesi vetëm mendohej dhe nuk kishte ndër mend të fliste.

- E, a t'u mbush mendja se ky pyll është i vërtetë?
— tha burri. Djali përsëri nuk u përgjigj. — Ja, më thuaj ti, do ta donte gjyshi dhe babai yt një gjë që nuk është e vërtetë?

— Jo, — tha Orgesi. — Por unë doja të ndodhite ndonjë gjë sot. Kurse këtu është kaq qetë.

— Jo, — tha burri, — diçka po ndodh. Ti nuk e kupton dot. Edhe unë nuk e kam kuptuar kur isha në moshën tënde.

— Po mirë, ç'po ndodh?

— Që ti po lidhesh më shumë me këtë pyll dhe më mua. Kur të bëhesh burrë dhe të vish këtu, ti patjetër do ta kujtosh këtë ditë. Dhe do t'i thuash djalit tënd. «Edhe mua më ka sjellë këtu, kur isha i vogël, babai.» Dhe atëherë do ta kuptosh atë që nuk e kupton dot sot. Prandaj tanë mos e vra shumë mendjen. Mirë?

— Mirë, — tha Orgesi.

Po Gjergji ishte i sigurt se ajo bisedë do ta shqetësonte për një kohë të gjatë të birin. Ata qëndruan edhe pak dhe, kur dielli perëndoi, u nisën të zbrisnin për në fshat. Atë natë do të flinin në hotelin e vogël të fshatit. Koha u freskua mjaft, por Orgesi nuk kishte të ftohtë ndaj, kur e ëma i hodhi trikon, ai e hoqi.

— Vishe, se mos ftohesh, — nguli këmbë ajo.

— Nuk sëmurem, — tha Orgesi dhe ktheu kokën pas.

— Atje është pylli, baba?

— Atje, — tha burri.

Drurët nuk dukeshin. Dukej vetëm një bllok i dendur, i errët. Orgesi vështronë i menduar.

— Ai tanë po fle, — tha pas pak ai.

— Po fle. Edhe ti, sapo të shkojmë në hotel, do të shtrihesh të flesh.

— Unë nuk kam gjumë, — tha Orgesi me vështrimin andej nga duhej të ishte pylli.

Dane Kuqoja (mbiemrin e tij e kishin zhdukur prej kohësh ngjyra e flokëve dhe pikat e fytërës), si i shkoi lajmërimit të fundit pëllëmbën e dorës pér të dytën herë, bëri dy hapa prapa pér të parë si e kishtë ngjitur. Ato ditë binte shi e frynte erë dhe ndodhë që lajmërimet, po të mos ishin ngjitur mirë, shkuleshin nga vendi e merrnin rrökullimën nëpër rrugët e qytetit. Kur vërtiteshin nëpër ajër dukeshin si disa shpendë ogurzinj, të sheshtë, pa kokë dhe krahë, kërcë-nues dhe të frikshëm. Prandaj vetë Dania, që u trembej më shumë se kushdo lajmërimeve të shkulura, po harxhonte ato ditë zamkën pa kursim. Mbasit u sığurua se lajmërimeve nuk kishte ç'tu bënte era e përzier me shi, mori kovën dhe u largua i qetë.

MËSUESI I MUZIKËS

Dane Kuqoja (mbiemrin e tij e kishin zhdukur prej kohësh ngjyra e flokëve dhe pikat e fytërës), si i shkoi lajmërimit të fundit pëllëmbën e dorës pér të dytën herë, bëri dy hapa prapa pér të parë si e kishtë ngjitur. Ato ditë binte shi e frynte erë dhe ndodhë që lajmërimet, po të mos ishin ngjitur mirë, shkuleshin nga vendi e merrnin rrökullimën nëpër rrugët e qytetit. Kur vërtiteshin nëpër ajër dukeshin si disa shpendë ogurzinj, të sheshtë, pa kokë dhe krahë, kërcë-nues dhe të frikshëm. Prandaj vetë Dania, që u trembej më shumë se kushdo lajmërimeve të shkulura, po harxhonte ato ditë zamkën pa kursim. Mbasit u sığurua se lajmërimeve nuk kishte ç'tu bënte era e përzier me shi, mori kovën dhe u largua i qetë.

Dhe, si zakonisht, menjëherë pas tij filluan të mbli-dheshin njerëz për të lexuar se kush kishte vdekur. Disa shprehnin habi, disa keqardhje, disa qëndronin indiferentë, kurse disave nuk kuptohej se ç'përshtypje u kishte lënë vdekja e filan banori, që kishte prekur thellë gruan, nënën... Pikërisht para asaj tabele të rëndomtë, qyteti shprehte dhembjen e tij, indiferentizmin e tij dhe rrallë edhe kënaqësinë e tij. Ajo tabelë e rrëthuar me katër dërrasa të lyera shpejt e shpejt me të zezë, ishte si një ekran bardhë e zi, ku shfaqeji i njëjtë film i vjetër dhe i lashtë sa vetë jeta mbi tokë.

Mësuesi i muzikës, Mersin Lika, sapo pa Dane Kuqon që po largohej nga vendi i lajmërimeve të vdekjeve, ndërroi rrugë. Dikur, ndoshta një vit më parë, ai do ta quante të habitshme atë ndjenjë midis ankthit dhe frikës që i ngjallte tabela e lajmërimeve të vdekjeve. Sepse do të ishte absurde që ai të mos pranonte ekzistencën e vdekjes. Po, qëkur iu sëmur vajza e tij, mësuesi Mersin Lika kishte filluar të mendonte se vdekja ishte nga gjërat më absurde. Ai kishte nisur të mendonte kështu që nga ai çast kur ajo kërcënoi edhe jetën e vaizës së tij.

Dane Kuqoja i kaloi pranë dhe mësuesi i muzikës u gëzua që tjetri, i zhytur në hallet e veta, nuk e vuri re. Mësuesi qëndroi larg tabelës dhe lexoi emrat dhe moshën. Atë ditë varroshen katër njerëz, tre plet dhe një grua. Vetëm njëri prej tyre kishte mbushur të shtatëdhjetat, po, kur mësuesi solli në mendje moshën e së bijës, ata iu dukën të moshuar. Kjo sikur ia zbuti gjendjen e rëndë që kishte kur doli nga Ashtëpia për në pazarin e bagëtive.

Ktheu qoshen e parë dhe mori rrugën që të nxirrit Jashtë qytetit. Erërat që fyrin ishin të ngrohta. Ato vinin nga deti. Dikush i quajti erërat e luleve, dikush erërat e gjethit. Drurët së shpejti do të shpërthenin lulet dhe gjethet. Erërat vërtitnin mbi qytet aromën e barit. Dëbora shkrinte maleve. Ditën e Verës, që qyteti e festonoste dy herë, më një mars të krishterët dhe më trembëdhjetë myslimanët, ndryshtë nga vitet e tjera, këtë ra-

dhë e zuri dëbora. Po pastaj fryshtat e ngrohta dhe dëbora shkruan brenda ditës. Tani era do të shpërthente lulet dhe gjethin.

Mësuesi i muzikës harroi për një çast hallet dhe eci pa asnje mendim në kokë. Kur u përpoq të kujtonte se ç'po mendonte atë çast dhe kur e gjeti veten bosh, u mërzit. Ndjeu një depresion të thellë që ia shkaktonte sëmundja e vajzës. La pas shtëpinë e fundit dhe dalloj nga larg pazarin e bagëtive. Kishte ardhur herët. Në shesh qengjat rrjinin të tulatur dhe të mbledhur kokë më kokë sikur betoheshin të qëndronin bashkë deri në çastin e fundit. Tulatja e tyre ka filluar që kur i kanë futur nëpër kosha, tha mësuesi i muzikës.

S'vonoj dhe u dukën blerësit, që vërtiteshin midis bagëtive, provonin majmérinë e tyre dhe, kur nuk binin dakord për çmimin, largoheshin duke thënë të njëjtat fjalë, se katundarët do të bëheshin pishman që nuk ua kishin shitur atyre, mbasi askush nuk do t'u jepte më shumë sesa kishin dhënë ata. Katundarët vinin dorën në zemër dhe seç pëshpëritnin pa zë. Mësuesi i muzikës kishte gati një muaj që e shihte këtë skenë. Ai vinte këtu të blinte shpretkat e bagëtive të therura për vajzën që vuante nga anemia. Dikush ia jepte, dikush jo. Kur e refuzonin, mësuesi i muzikës ndiente një dhimbje therëse në zemër. Por përpiaej ta mbante veten. Në një gjendje të tillë e kishte gjetur një ditë Azbi Kasapi. Mësuesi i ishte havur dhe Azbi Kasapi e kishte ndihmuar duke i siguruar një pjesë të mirë të shpretkave nga bagëtitë aëtheri.

Atë ditë Azbi Kasapi nuk kishte ardhur. Mësuesi e kërkoi me sy kudo dhe kur nuk e pa u mërzit, sepse kjo iu duk si një shenjë e keqe. U mbështet pas trungut të një plepi dhe priti. Dikush e përshtëndet dhe ai ia ktheu përshtëndetien me vonësë. Më të rrallë blihej ndonjë aengj, i cili si kapej pas këmbëve, lëshonte një blégërimë të gjatë dhe rrëqethëse. «Ndofta vetëm mua më duket kaq rrëqethëse», mendoi mësuesi i muzikës. E, megjithëse i vinte keq, ai kishte ardhur këtu për

t'u marrë shpërkën, gjaku i së cilës i bënte mirë së bërjës. Ai nuk e shpjegonte dot këtë dyzim të ndjenjave të tij. Sa më shumë shpërtka të gjente, aq më shumë qengja do të qenë therur.

— Mirëmëngjes, profesor! Paske ardhur herët sot, — i tha Azbi Kasapi.

— Mirëmëngjes, Azbi, — u çel mësuesi i muzikës.

— Si e ke vajzën?

— Keq.

— Kështu është ndërtuar kjo botë jallane, — tha duke mbledhur supet Azbiu. — Si duket sot pazari?

— Sikur nuk po blejnë si të dielën e shkuar.

— Ka rënë leku, profesor, ka rënë. Për vete a gjete punë?

— Akoma jo.

— Ej, taksirat që të ka gjetur dhe ty, or profesor. Po mos u mérzit. Ç'nuq e ka zënë njeriun e shkretë dhe nuk e ka kapërcyer.

— Ashtu është, — tha mësuesi i muzikës.

Ai e kishte pasur të vështirë në fillim të komunikonte me Azbiun. Bile i ishte dukur se s'do të mund të komunikonte asnjëherë. Ç'mund të bisedonin bashkë? Për muzikën? Kishte vënë buzën në gaz nga ky mendim: Po, mbasi e njohu mirë, ai e kuptoi se me Azbiun mund të bisedonte për jetën. Bile ai merrte zemër nga mënyra sesi e konceptonte jetën Azbiu. «Jeta është luftë, profesor.» Edhe mësuesi e dinte këtë por, ndërsa ai po e provonte tani, Azbiu e kishte provuar që ditën e parë të lindjes.

«Dhe kishte jetuar. Ndërsa unë...» mësuesit i dukej sikur qe tërhequr sa po e kishte nisur këtë luftë.

2

Mersin Lika ishte mësues muzike i së vetmes shkolle, të atij qyteti. Ishte njeri i rregullt, i qetë. Banorët thoshin se jetonte vetëm me muzikën. Ai e donte mu-

zikën. Kishte èndërruar të bëhej kompozitor, po shpejt e kuptoi se nuk kishte të dhëna për tu bërë i tillë. E pranoi jo pa dhimbje mungesen e talentit. Dhimbja e tij vazhdoi gjatë. Kjo ë mbylli në vete. U bë më i heshtur. Ngaqë nuk ia tregoi kujt brengën e vet, kolegët habiteshin me ndryshimin e tij. Ndoshta do të habiteshin më shumë sikur t'ua tregonte. Dhe heshtte. Pastaj u martua. E shoqja i lindi një vajzë dhe pas dy vjetësh djale. Dhe ai dalngadalë po e harronte se dikur kishte èndërruar të bëhej kompozitor. Nga èndrra e tij ruajti dashurinë për muzikën. Ajo mbushi çdo boshillék që la heqja dore nga kompozimi. Dhe filloi ta studionte më thëllë muzikën. Për habinë e tij, tanë i dukej sikur po e kuptonte më mirë. Në shkollë shpregonë tèrë pasioni. Dhe mësuesin e dëgjonim me vëmendjë, dhe ata nxënës që në disa lëndë kryesore ishin aq zhurmëmëdhenj. Po mësuesi thoshte se kjo nuk i përkiste atij por muzikës. Muzikës së vërtetë. Duke jetuar vëtëm me muzikën nuk shihte se po e mbëshfillte veten me diçka mjegullore dhe po i largohej jetës. Hallet e familjes i kalonte lehitë. E shoqja ishte grua e urtë, që e donte shumë dhe e kishte marrë mbi vete barren e shtëpisë. Fëmijët, po edhe ata të urtë. Dhe kështu vazhdoi deri kur hyri prilli i vitit 1939.

Pikerisht në ato ditë ai ndjeu se donte diçka më tepër se muzikën. Dhe kjo nuk ishte familja e tij, nuk ishin fëmijët e tij, nuk ishte fruga nga shkolla në shtëpi, të cilën kishte kaq vite që e përshkonte, nuk ishte çelja e luleve rozë të mollëve në kopshtin e vogël, para drithareve të dhomave, nuk ishte as dridhja e kujtimeve të fëmijërisë, nuk ishte as... Ai e ndiente se mungesa e saj nuk do të pengonte çeljen e luleve rozë të mollëve, rënien e déborës së parë, nisjen e zogjve shtegtarë nga njëri vis te tjetri. Ai e ndiente se jeta do të vazhdonte. Por ato ditë prilli ai kuptoi se gjithçka do të ndryshonte dhe do të humbiste ngadalë pjesë nga gjaku i saj. Dhe muzika do të humbiste me dhimbje, duke lënë vijat e pentagramit të braktisura nga

notat, si tela që ndryshken nën reshjet e pafundme të dimrit. Dhe kjo vinte nga pushtimi.

Thoshin se mbreti kishte kaluar edhe nga ai qytet i vogël në rrugën drejt arratisjes. Kishte nga ata që ngulnin këmbë se e kishin parë ngjeshur pas sedilies dhe u qe dukur si i trembur. Po sytë, ngulnin këmbë ata që dégjonin, sytë si i kishte? Vërtet, sytë si i kishte? Dhe ata që e kishin parë, mendoheshin disa çaste pér të kujtuar sa më mirë kalimin e shpejtë të mbretit nëpër rrugën kryesore të atij qyteti dhe nuk dinin si t'i përcaktonin sytë. Silkur nuk kishte sy atë çast, thoshin gati të gjithë. Si nuk kishte? S'ka mundësi të ketë qenë pa sy! Ai gjithmonë ka qenë më sy. E, mór Kico, ti ia pe apo jo sytë? Nuk ia pashë. Edhe unë. Unë e di fare mirë që ai ka pasur sy. Bile në Vjenë ia kanë lëvduar shumë sytë. Ndofta ka pasur, por atë ditë, ndaj të ngrysur, ia kishte marrë nata që po binte. Tamam. Edhe mua kështu më ngjau, sikur ia kishte thithur nata. Edhe fjalë mbret ka dicëka nga nata, mendoi mësuesi i muzikës. Se çfarë konkretisht kishte nga nata fjalë mbret ai nuk po e përcaktonte dot.

Dhe vetëm pas disa ditësh, kur autokolonat e gjata me ushtarë italianë i ranë mes pér mes qytetit, ai e gjeti se q'kishte nga nata fjalë mbret. Kishte heshtjen e dëshpëruar të pushkëve të qorrura nga ikja fshehurazi e një mbreti, që populli nuk dalloj dot, kur ai u kaloi pranë, ngjeshur pas sedilies, nëse kishte sý apo jo.

Mësuesi i muzikës filloi ato ditë studimin e këngëve të krahinës së tij. Rrinte me orë të tëra duke i riprohuar me mënd pér të zberthyer dhe kapur filozofinë e tyre. Sepse e dinte që këngët nuk lindin kët. Kur ravigjëzonte mendimin e tyre, herë të thatë dhe herë naiv, herë kryeneç dhe herë të qetë, herë të ngrysur dhe herë çapkën, herë të trishtuar dhe të brengosur, herë rebel dhe të panënshtruar, mësuesi gjëzohej si fëmijë. Nuk e kishte studiuar kurrë aq thellë muzikën e krahinës së tij, sa atë vit. Dhe dicëka therëse e përshtkonte herë pas here. Tërë këtë muzikë do të përpinqeshin ta zhduknin. Atë çast iu kujtua afrimi i fjalës mbret me fjalën

natë. Mund të vijë një kohë që dikush të pyesë: Si i kishte sytë ky popull? Dhe s'ka heshtje më të tmerrshme se heshtja pas kësaj pyetjeje. Si e kishte shpirtin ky popull? Se këngët janë shpirti i një populli. Dhe s'ka heshtje më tronditëse, sesa heshtja pas kësaj pyetjeje.

Zuri t'i këndonte me nxënësit këngët e krahinës. Në fillim nuk i thamë gjë. E ai atë donte, që ta linin të qetë. Vecse kishte një parandjenjë se kështu nuk do të vazhdonte gjatë. Ndaj përpiqej me mish e me shpirt që ta shfrytëzonte sa të ishte e mundur më shumë atë kohë. Koha dhe ai sikur ishin vënë në garë.

Një ditë, një nxënës nga fshati përtëj malit i solli një këngë të re. Në këngë bëhej fjalë për një fshatar me emrin Xhemil Bregu që italianët e kishin vrarë mbi arën e tij, kur po niste mbjelljet e vjeshtës. Xhemili kishte hequr vetëm një brazdë në arë. Dhe në atë brazdë ishte mbjellë një këngë. Sepse në arë nuk mund të mbillej dot fara. Mbi arë do të mbinin kazerma e ushtarëve. Qetë me sytë e tyre të mëdhenj, ku pásqyroheskin retë dhe shiu që nisi të vesonte, shikonin Xhemilin e shtrirë mbi brazdë, sikur donte të pushtonitë diçka të dhimbshme.

Ndërsa nxënësi e këndonte, mësuesi e hodhi në letër e më të në xhep u nis për në shtëpi. Ecte e i dukej sikur po mbartte fshatarin Xhemil, i cili diontë të mbledhite e të mbledhët në grusht arën e tij, që pastaj ta shtrydhët dhe të nxirrte prej saj një... këngë. Të paktën ajo nuk do të humbiste.

E shtëna e parë e atentatit të parë më atë qytet u dëgjuat ndaj të gdhirë. Qyteti ishte i vogël e i mbledhur dhe qdo banori fu duk sikur ajo e shtënë u dëgjuua para pragut të shtëpisë së tij. Dikush guxoi dhe hapi derën, por nuk pa gjë. Rruga ishte e qetë dhe ajo e shtënë kishte prishur para kohe drëmitjen e saj. Mësuesi doli

jashtë. Edhe rruga e tij ishte e qetë. Mollët, ndonjë degë e të cilave kapércente avllinë, kishin çelur dhe lëkundeshin lehtë, nën erën e mëngjesit. Aroma e tyre pak si e athët përhapej duke ndjellë nuhatjen e bletëve.

Në shkollë mësuesi mori vesh se që vrarë një toger italian. «Për të askush nuk do të ngrejë këngë», — tha mësuesi dhe iu kujtua Xhemil Bregu. Po atë ditë nga drejtori i shkollës mori urdhër të mos zhvillohej ora e muzikës. Mësuesi hyri në klasë dhe nuk dinte ç'të thoshte. «Filloi, — mendoi mësuesi. — Sot kaq, nesër mbi vijat e pentagramit do të ulen, si disa zogj pa ngjyrë, pa pendë, pa mish, dhe gjak, notat e këngëve të huaja.» Ato do të vinin nga larg, duke sjellë erën e vendit nga u nisën, shijen e ajrit që kishin çarë, njelmësinë e detit mbi të cilën kishin fluturuar dhe një tokë krejt të huaj, një botë krejt të huaj. Ato do të uleshin mbi vijat e pentagramit, të këngëve të kësaj tolke dhe do të përpinqeshin t'i rrëzonin ato. Dhe mësuesi përfytyroi qartë, përpjekjet e pushtuesit që fillonin ja, me këtë heshtje të detyruar. Mësuesi i muzikës po habitej me mendimet e veta. Ai shikonte jashtë dritares dhe i dukej sikur gjithçka përpiquej ta ruante krismën e mëngjesit. Ajo krismë ishte në platinjen dhe ngrirjen e gjethive, në njollat e diellit mbi tjegullat e shtëpive, në ecjen e njerezve, të rrallë dhe në sytë e nxënësve që sot dukej se kërkonin dicka prej tij. Dhe mësuesi e ndjeu se nuk duhej ndenjur ashtu, pa folur. Po çfarë t'u thoshte. Dhe për herë të parë ndjeu se ndoshta ata nxënës dinin, më shumë se ai për kohën që jetonin.

Trokiti dera dhe në klasë hyri nëndrejtori...

Ai kishte ardhur në atë qytet të vogël para një viti, nga Tirana. Dukej një burrë i qetë dhe hiqej hallexhi. Kishte hequr shumë në jetë, po tanë dukei sikur po mëkëmbej. Flinte, në një shtëpi të vogël, në hyrje të qytetit. E veja e Sotir Fecollarit, që kishte shkuar përgjithmonë tek e bija, në Durrës, ia kishte shitur me këste. Për dy muaj shtëpia bëhej e tij. Thoshte se së shpejti do të sillte këtu edhe të shoqen me katër fëmijët. Shoqërohej gati me këdo. Edhe në ka-

fene shkonte rrregullisht. «Vij pér tē shkëmbyer dy fjalë, se nuk rrighet vetëm me katër muret e shtëpisë.» Porosiste një gotë me shurup trëndafili, tē cilin qyteti e kishte si piye tradicionale. Me gôtën bosh përparrar rrinte téré natën dhe më shumë dëgjonte sesa fliste. Kishte raste që ndokush harrohej pas tē pirit dhe nuk shihte nëse ia mbanëtë xhepi. Kur kafexhiu bënte llogarinë dhe tjetri nuk kishte me se ta paguante, nëndrejtori ruste doren në xhepin e tij. «M'i jep kur tē kesh,» — thoshte. Ai paguante pa zhurmë. «Po ti, më i uruar, ç'taksirat ke. Ke një qerre me kalamaj e je edhe jabankshi — i delte tē pirët tjetrit. «Kur tē ardhka kaq keq, përsë nuk pi sa tē mban xhepi, — nxehet kafexhiu. «Mos e shaj, or Nuçi, se kuschedi ç'hall ka.» «Le tē piye raki, por jo trutë, zoti mësues.» «Nesër do t'jua sjell børxhin mësues.» «Tani tē doli e pira, hë?» Tjetri largohet nga kafeneja i vrapë dhe i dërrmuar sikur e kishin rrahitur. «Dëgjo, mos m'i sill në shkollë dhe mos u nxito. Kur tē kesh.» Tjetri e vështronitë më sy e ato fjalë e vrissnit dhe e kerrusnit akoma më shumë.

Në shtëpi nuk i hynte njeri. Nga kjo ajo dukej edhe më e vetmuar. Një shtëpi pa grua është gjithmonë më e vetmuar...

Nëndrejtori u hodhi një sy klasës dhe nxënësve. Mësuesi i muzikës priste. Nëndrejtori e kapi pér krahë dhe e tërhoqi mënjanë. — Di ndonjë këngë italiane që këndohet në rast zie? — e pyeti me zë tē ulët.

— Jo, — u habit mësuesi i muzikës. — Po përsë duhet?

— Ta këndojnë sot nxënësit, kur tē përcillet trupi i togerit tē vrapë. Thonë se italianët i përcjellin me këngë tē përzishme.

— Nuk di ndonjë këngë tē tillë.

— Punë dreqi. Duhej tē kishit menduar pér ta futur më program.

— E përsë duhet kjo?

— Pér qdo rast. Po ndonjë këngë shqiptare që shkon pér këtë rast a di?

«Xhemil Bregu dhe kënga e tij», mendoi mësuesi i muzikës.

— Jo, — tha me zë.

— Nuk di ti apo nuk ka vërtet?

— Nuk ka. Ka disa, po ato nuk mund të këndohen sot.

— Pse, çfarë thonë ato këngë që s'mund të këndohen sot?

— Në ato këngë thuhet se ç'deshe që erdhe në tokën tonë, or dushman, apo për të lënë kockat.

— Jo, jo, — tha nëndrejtori, — këto nuk bëjnë.

Ai doli jashtë. Klasa u ngrit më këmbë. Mësuesi i muzikës qëndroi dhe pak me sytë nga dritarja e i la të lirë nxënësit. Coi regjistrin në sekretari dhe shkoi në shtëpi. Para zyrave të nënprefekturës pa një makinë të zezë. Makina që do të conte togerim në Durrës. Rreth zyrave kishte heshtje. «Po populli ynë nuk ka këngë për përcjelljen e trupave të ushtarëve të huaj të vrarë? Jo. Cudi! Ka për atë që i vrau këta ushtarë të huaj. Nuk na duhen ato. Përse ushtria, kur erdhi këtu, nuk solli me vete edhe këngë vaj? Sepse asnjë ushtri nuk do të mendojë për vdekjen e ushtarëve të saj. Megjithatë duhet të kishte sjellë që të mos ndodhemi si sot, të heshtur...» Të heshtur... Diku populli tanë po ngrinte një këngë për atë që vrau togerim. Por atë nuk e njihnin të tërë. Vetëm kur të dilte kënga. Si të mbinte nga tokë.

Eshtrat e togerit u përcollën po atë ditë, aty nga mesdita. Thoshin se togeri ishte nga një familje e pasur, dhe me influence në Itali.

— Eshtrë fillimi, prandaj edhe i cojnë, — i tha mësuesit në mbrëmje komshiu i tij, Skënder Naçi. — Sepse do të vijë një kohë që ata nuk do të munden t'u hapin një gropë një gisht të thellë e jo më t'i cojnë në Itali. — Mësuesi e përfytyroi qartë këtë skenë duke dëgjuar Skënder Naçin. «Kjo ka ndodhur me qdo ushtri që ka ardhur këtu, pra do të ndodhë edhe me këta. Nuk ka si të ndodhë ndryshe. Janë disa gjëra që mbeten të përjetshme në përsëritjen e tyre.»

Të nesërmien në mëngjes u internuan pesëmbëdhjetë

burra dhe të rinj dhe u pushkatuan tre komunistë, që kishin dy muaj në burg. Banorët e harruan togerin dhe flisnin vetëm për të internuarit dhe të pushkatuarit. Mësuesi njihet disa prej tyre.

Ai shkoi në shkollë dhe orën e parë shpjegoi përmbytjen e këngës për Xhemil Bregun. Këtë e bëri edhe në dy klasat e tjera. Erdhi përsëri nëndrejtori dhe e udhëzoi të këndohej diçka e gjuar atë mëngjes. Shkolla ishte në mes të qytetit dhe kënga mund të përhapjej e të dëgjohej kudo. Kur mësuesi tha se ndoshta përnjë farë kohe nuk do të këndoheshin dot këngët e gjëzuara, nëndrejtori ishte habitur. «Po vjen pranvera, mësues, këndoni një këngë për ardhjen e saj.» — tha jo pa inat nëndrejtori. «Kënga nuk e njeh dhe nuk e respekton me atë rigorozitet që zbaton natyra, ndërrimin e stinëve. Ajo ka ligjet e saj. Një këngë për pranverën mund të këndohet fare mirë në dimër dhe jo në pranverë», — iu përgjigj mësuesi. Nëndrejtori tha se ai sot po fliste gjëra pa kuptim dhe të habitshme. «Tani në këngë ka vjeshtë,» — vazhdoi mësuesi i muzikës. Dhe apo tha këtë, iu duk sikur jashtë me të vërtetë po binte shi, të cilin era e përplaste me forcë pas xhamave dhe mureve të shkollës. Nëndrejtori u largua duke lënë në klasë diçka të ftohtë dhe kërcënuese.

Një muaj më vonë në rrugën automobilistike u bë një përlleshje, ku u vranë njëmbëdhjetë ushtarë italianë. Trupat e tyre i varrosën përsëri me ceremoni.

— Kanë akoma kohë edhe për ceremonira edhe përfjalime, — tha Skënder Naçi.

Të nesërmen e betejës, një nxënës i dha një këngë për ata që e bënë betejën. Mësuesi e letoi këngën kur mbeti vetëm. Kënga e re kishte diçka që nuk e kishte kënga për Xhemil Bregun. Hakmarrjen. Prandaj nuk mund të shpjegohej dot në klasë dhe të këndohej me zë të lartë. Kështu mendoi mësuesi, po u habit kur edhe disa nxënës të klasave të ndryshme, pa u marrë vesh me njeri-tjetrin, i sollën të njejtën këngë. Pra ajo këngë ishte përhapur vetvetiu, si era.

Në tetor mësuesit iu sëmurr e bija. Mjeku i qyqtetit, mbasi e vizitoi, tha se ajo vuante nga anemia dhe kishte nevojë për gjak dhe se organizmi i saj ishte i pambrojtur karshi sëmundjeve që mund të shfaqeshin në qytet. Mësuesi u trondit.

- E dua shumë dhe mund të sakrifikoj gjithçka.
- E di, — tha mjeku. — Kura do të jetë e gjatë.
- Rëndësi ka që t'i bëjë efekt.
- Për këtë as mos ki dyshim.
- Kur duhet t'ia fillojmë?
- Mirë është që sot.
- Falemnderit!
- Do ta kem vetë kujdës.
- Po të përcjell, se nisi shi.
- Kthehu, ja ku është shtëpia ime. Qyteti ynë është i vogël dhe e ka këtë të mirë, që nuk të lodh shumë për të shkuar te njëri-tjetri. Kthehu.
- Jo, jo po të përcjell.
- S'ka nevojë, mor Mersin, sikur u njohëm sot. Për çdo të papritur më trokit pa druajtje.
- Për gati dy muaj mësuesi i muzikës jetoi vetëm me sëmundjen e së bijës. Mezi priste të mbaronte mësimi dhe nxitonë për në shtëpi. Ngjarjet, që sa vinin dhe bë-heshin më dramatike, arrinin te mësuesi të largëta, fragmente që i kishte hedhur tek ai rastësia. Këto ia sillte zakonisht Skënderi si dhe mjeku që vinte shpesh për të vizituar të bijën. Ajo po bëhej më mirë.

— Megjithatë, — këmbëngulte mjeku, — ajo ka nevojë për gjak,

«Gjak». Mësuesi e përsëriste me vete këtë fjalë si një fjalë të panjohur dhe të vështirë. «Nevojë për gjak... Kush ka nevojë për gjak?... Vajza ime ka nevojë për gjak?... Kush ka nevojë për gjak?... Vajza ime... Sot kudo po derdhet gjaku i bijave dhe bijve më të mirë të...» Mësuesi e mblidhët veten me vonesë. Nuk i besohej se sëmundja e vajzës do ta gllabëronte aq tepër. E megjithatë ajo ka nevojë për

gjak.. Sot lipset që të kuptohet mirë, se liria fitohet vetëm me gjak.. Liria i ka rrënjet në gjak!

Dhe, në një nga ditët mësuesi, u kthye në shtëpi me idenë se gjithçka kishte nevojë për gjak. Gjaku nuk ishte më një lëng i kuq që vërtitej dhe rrridhte vetëm në damarët e njeriut, por edhe në damarët e tokës, të bukës, në rrënjet e emrave konkretë dhe abstrakte. Vijat e pentagramit ishin si damarë... Hyri në dhomë dhë ia mori kokën vajzës në duar e e përkëdheli. Ajo ia nguli sytë dhe i buzëqeshi.

— Jam më mirë dhe koka, nuk më dhemb si më parë. Ti, baba, jé hequr shumë nga meraku.

— Nuk jam hequr. Të duket ty, sepse e do shumë babanë tënd.

— Mos po bie déborë jashtë?

— Jo, kur po vija nga shkolla, nuk po binte.

— Nuk e di përsë m'u duk sikur po binte déborë jashtë.

Mësuesi iu afroa dritäres.

— Vërtet po bie déborë. Sa shpejt, filloi siyjet.

— Dëbora e parë është përherë më e bukura, apo jo, baba? Bie dëbora flokë-flokë...

Dimri ishte i ashpër dhe me erëra të fitohta që frynin vazhdimisht nga Veriu. Ato e ngrinin déborën në një re tymi të bardhë dhe e vërtitnin në një valle kaotike, duke e përplasur pas mureve dhe drurëve, oxhaqeve dhe hapësirës së heshtur e të tulatur. Dëbora mbuloi edhe rradhigjet, që mjeku ia rekamandoi mësuesit për vajzën.

Mjekun e arrestuan krejt papritur, kur po dilte nga spitali. Thanë se kishte shëruar partizanë të plagosur dhe kishte dërguar ilaçe në mal. Ai ishte patologu i vetëm i atij qyteti. Qyteti mbeti pa patolog. Nga kjo mësuesit iu duk qyteti edhe më i humbur, i vetmuar dhe i pasigurt. Ndoshta kështu duken të gjithë ato qytete që mbeten pa mjek. Apo kështu u duket vetëm atyre që kanë të sémurë në shtëpi. Mësuesi nuk dinte si të përgjigjej. Megjithëse e ndiente se në përcaktimin e qytetit kishte futur diçka më tepër nga vetja. Kjo sepsejeta e vajzës së tij kishte pranë pasigurinë. Jeta e saj nuk kishte

mbrojtës. Të vetmin mbrojtës e futën në burg dhe ndof-
ta nesër ai...

Ai qytet nuk ishte më një qytet i qetë. Edhe netët
nuk ishin të qeta, Pushtuesi ishte egërsuar. Dhe, për
netët, pushtuesi kishte nxjerrë urdhër të posaçëm. Ur-
dhri donte që netët të ishin të urta, të ishin të ngri-
ra, të heshtura... Shpesh në shtëpitë e periferisë leh-
nin qentë. Qentë nuk i njihnin ligjet. Edhe në rrugën
e mësuesit trokisinin dyert e shtëpive. Trokitja ishte
e kujdeshshme. Pastaj hapej dera dhe rruga bëhej përsëri
e qetë. Mësuesi priste që të trokisinin edhe në shtëpinë
e tij. Dhe ai...

Ai vazhdonte të jepte mësim muzikë në të vetmen
shkollë të qytetit. Nxënësit qenë pakësuar. Aty-këtu
kishte vende bosh nëpër banka. Mësuesi e dinte se ku
ishin ata që kishin lënë bankën bosh. Shpesh, kur
shpjegonte, e kishte kapur veten se po u fliste pikërisht
bankave bosh. Ato e kishin detyruar që ai të mos
e respektonte aspak programin e mësimit. Ai kishte kohë
që tjetër temë mësimi shënonë në regjistër dhe tjetër
temë zhvillonte. Nëndrejtori i kishte shkuar disa herë
për kontroll dhe ishte larguar i pakënaqur.

— Kam mësuar se dikur ke dashur të bëhesh kompo-
zitor, — i tha një ditë nëndrejtori.

— Kush e paska mbajtur mend kaq mirë atë që
unë e kam harruar, — tha mësuesi i habitur. Ai e kishte
harruar se dikur kishte dashur të bëhej kompozitor.

— S'ka rëndësi kush e ka mbajtur mend. Mjafton
që ti ke dashur të bëhesh kompozitor, apo jo?

— Po.

— A nuk mund ta ringjallësh tanë këtë èndërr?

— Zor, — tha mësuesi, — është e pamundur. Tani
është tepër vonë.

— Mua nuk më duket aq e zorshme.

— Mundet.

— Si mundet?

— Sepse nuk ke dashur të bëhesh ndonjëherë kompo-
zitor dhe sepse nuk ke ndier dhimbje kur ke kuptuar
se për këtë të mungon talenti.

— Llafe. Po të paktën a mund të bisedosh me disa kolegë që ti po përpinqesh të kompozosh diçka, ta zëmë një këngë pér... Më mirë mës e përcakto pér kë po e kompozon këngën.

Mësuesi nuk po e kuptonte se ku donte të dilte nëndrejtori.

— E si mund të them pér diçka që nuk kam ndër mend të bëj?

— Fare thjesht: Jú vetëm do të thoni se po kompozoni një këngë.

— Jo, — tha mësuesi, që ndjeu diçka të keqë në këmbënguljen e nëndrejtorit. — Nuk mundem.

— Megjithatë mendohuni. Në këtë botë asgjë nuk është e pamundur.

Mësuesi doli në rrugë si i shastisur. Dielli, që reflektohej, mbi débore të vriste sytë. Ai shkoi në shtëpi dhe tërë kohën qëndroi i heshtur.

Pas një javë në pushimin midis orës së dytë dhe së tretës atë e kapi në korridor mësuesi i matematikës.

— Dëgjova se po kompozon një këngë, — tha ai.

Mësuesi i muzikës qëndroi si i ngrrirë.

— Kush të tha?

— E dëgjova sot në mëngjes kur po vija pér më shkollë. Me siguri donjë ngacmim i fortë, gjersa po i rikthehesh një pasioni të harruar.

Mësuesi i muzikës heshti. Kolegu i tij u largua sepse në korridor kishte korente ere.

Gati të gjithë koleget e tij ia kishin thënë po atë ditë, jo pa habi, të njejtën gjë. Ndërsa nëndrejtori atë ditë vetëm sa i kishte buqeqeshur nga kreu i tavolinës dhe pastaj kishte ulur kokën mbi regjistrat e grumbulluar...

Kur po kthehej në shtëpi e ndaloj Nuçi Tika, që vërs shiste zarzavate, kurse në dimer molle dhe i tha se kishte dëgjuar se mësuesi po bënte një këngë që do të ishte mburrja e qytetit tonë dhe që do të merrte dhënë.

— Ku e dëgjove këtë?

— Në kafenën e Llazit.

— Nga kush?

— Ishin shumë dhe nuk u mor vesh se kush e tha i pari. Disa e kishin dëgjuar më parë. Po askush nuk e dinte përse bënte fjälë këngë. Përse po e bën këngën, o mësues?

— Nuk e mban mend se kush e tha i pari që unë po bëj një këngë?

— Jo. E, përse e vret mendjen kot, o mësues, se kush e tha i pari! Ishallah na bën ndonjë këngë të mirë, pa...

Mësuesi u largua i heshtur, duke dëgjuar rënkinin e dëborës nën këmbët e tij. Dhe sepse i ngjau që, vjen një ditë kur njeriu dëgjon rënkinin e diçkaje të harruar dhe të zgjuar guditërisht nga diçka po e pa-njohur. Kërcitja e dëborës ishte e thatë. Si kërcitja e një lënde pa jetë. Edhe kur po flinte, mësuesit iu duk sikur dëgjonte kërcitjen e diçkaje që nuk ishte dëborë, por ëndërr. Ai u ngrit i shqetësuar nga shtrati dhe shkoi në dritare. Nata ishte e ftohtë. Mbi rrugë era ngrinte lart kokrrizat e dëborës. Ndonjëra prej tyre shkëputëj gabimisht dhe godiste xhamin e dritares dhe pastaj binte përsëri poshtë si e plagosur.

5

Aty nga fundi i janarit, në qytet ra një grip i fortë. Mësuesi i muzikës u shqetësua shumë se mos gripi prek-te edhe të bijën. Ai u shqetësua aq shumë, sa që, po të qe e mundur, nuk do të lejonte të hynte në dhomë as edhe një pikë ajri. Ai dridhej kur shikonte që era gjente ndonjë të çarë në dritare dhe lëkundte perdet. Mësuesit i dukej sikur perden e lëkundnin mikrobet. Sa mikrobe përban një pikë ajër? Vonë e kuptonte se shqetësohej kot dhe pa kuptim dhe priste, me një ndje-një të mugët, atë që do të ndodhë dhe që ai nu kishte ç't'i bënte. Mësuesi e dinte se, po ta zinte gripi vajzën e tij anemike, ajo kishte për të vuajtur dhe, në qoftë se gripi

ishte me tē vërtetë aq i fortë, sa thoshnin njerëzit zor se e përballon. Dhe si pér ironi tē téré kujdesjeve vajzën e tij e zuri gripi, pikërisht kur mësuesi e fjeti mëndjen se ai kishte shkuar. Vajza pati temperaturë dhë natën foli përqart. Fjalët ishin tē shkëputura, tē palidhura, tē zvargura. Ato ishin tē loddhura. Si zogj tē mbetur prapa nga tufa shtegtarë dhe që fluturojnë tē dësh-péruar ngaqë e dinë së nuk kanë përoti arritur kurri shokët e tyre. Po kishte fjalë që shkëputeshin në mes si zogj tē vrarë, tē dërrmuar nga loddhja. Mësuesi i qëndroi dy mët mbinkokë pa vënë gjumë në sy. Në shkollë ishte si i hutuar. Nëndrejtori e pyeti disa herë përsë ishtet aq i vrarë dhe i loddhur. Po mësuesi heshtte, sepse donte që ai njëri tē mos e merrte vesh shqetësimin e tij. Natën e tretë temperatura e vajzës ra pak. Para se tē shkonte në shkollë mësuesi i tha së shoqes që tia vinte edhe një herë termometrin.

— Po ajo po fle si qengj. Gjynah ta zgjoj, — foli e shoqja. — Mirë. — Ai hapi derën dhe dolë më rrugë. Dëbora ishte zbutur. Qielli i hirtë, heshtja dhe qetësia e tij trëgonin se pasdite do tē binte sërisht dëborë. Njeriu i parë që takoi ishte nëndrejtori.

— Sa orë mësim keni sot, zoti Mërsin?

— Katër, — tha mësuesi i muzikës, i hutuar nga mirë sjellja dhe dashuria e nëndrejtorit.

— Mbasi tē imbaroni mësimin mos u largoni pa më takuar.

— Nuk mund tē ma thoni që tanë, sepse duhet tē kthehem menjëherë në shtëpi?

— Keni ndonjë hall?

Mësuesi nuk u përgjigji.

— Biseda jonë mund tē zgjatë një minutë ose... E ke vetë në dorë.

Nëndrejtori u largua. Në ecjen e tij mësuesi sikur pa diçka enigmatike. Në përgjithësi nëndrejtori se ç'kishte diçka misterioze. «Ndoshta ngajeta që bën larg familjes», mendoi mësuesi. Orët iu dukën tē gjata. Që

kur iu sëmur e bija orët i dukeshin të gjata. Për takimin që i kishte lënë nëndrejtori harroi fare. Ai la regjistrin dhe po shkonte për në shtëpi, kur e kapi një nxënës.

— Zoti mësues, ju kërkon nëndrejtori, — tha nxënësi duke marë fryshtë me vështirësi nga vrapi.

Mësuesi u kthyte menjëherë.

— Si dita kuuptoj këtë, zoti Mersin, mungesë takti, mosrespekt, apo thjesht harresë, — tha nëndrejtori pa e fshehur inatin.

— Më falim, kam... —

— E di, keni vajzën sëmurë. Sot është ditë e tretë. Se një vanemike i kapërcen me vështirësi gripet si ky që ra në qytetin tonë, prandaj dhe nuk po jua vë re.

Mësuesi u habit nga ky mirinformim. Nëndrejtori e vuri re habinë e mësuesit dhe, si e la për ca çaste ashtu të hutuar, vazhdoi:

— Nuk dua t'ju vonoj shumë, zoti Mersin, sepse jam dhe vetë prind dhe e di se c'do të thotë ta kesh fëmijën sëmurë. Aq më shumë kur kjo fëmijë është vajzë. Unë kam dobësi më tepër përvajzën sesa për djalin. Përse? — nëndrejtori mblohdhi supet. — Ndoshata se ato janë krijesat që nuk e përballojnë dot jetën njëlloj si djemtë. Ndoshata se më shumë se cdo krijesë tjetër në botë fatin e tyre nuk e kanë ato vetë në dorë por të tjerët. Sidomos prindërit. Apo e kam gabim?

Mësuesi nuk ia ndante sytë dhe nuk fliste.

— Me kë t'ju krahasoj fatin e vajzës? — Nëndrejtori i ktheu kurrizin mësuesit të muzikës dhe shkoi te dritarja. Në zyrë ra heshtja. Mësuesi po priste. Nëndrejtori mendohej duke vështruar jashtë. — Me kë t'ju krahasoj fatin e vajzës? Me kë t'ju krahasoj? — tha pa u kthyer nëndrejtori. — Hë! E gjeta! — Nëndrejtori u kthyte menjëherë nga mësuesi, fë cilët e gjitha kjo po i dukej si një teatër kot. — Zoti Mersin, e keni vënë re, sigurisht që e keni vënë, re, kur bie déborë e rrallë. A e keni ndjekur ndonjëherë fatin e flokut të déborës? Sigurisht që e keni ndjekur. A keni parë se fati i këtij floku varet nga vendi ku bie? Sigurisht që e

keni parë. Floku mund të bjerë në një vend, të thatë dhe të mos shkrijë. Po mund të bjerë edhe në ndonjë pellg me ujë dhe të shkrijë në çast, sikur të mos ketë ekzistuar. Sigurisht që keni parë dhe jeni trish-tuar. Edhe unë trishtohem kur flokët e dëborës bien në ujë dhe shkrihen. Po nga se varet rënia në vend, të thatë apo të lagur? Kjo varet nga shumë faktorë, po faktori kryesor mua më duket se është era. Nga fryshto-ajto, q'drejtmi ka. Drejtimi i erës së fortë. Njeriu ka një të mirë të madhe në krahasim me flokun e dëborës. Ai e drejton vetë jetën, që ajo të mbijë dhe të zërë vend, të sigurt. Kështu që dhe prindit po, të dojë, vajzen e hedh, në vend të thatë, po, të dojë, në hedh në pellg me ujë. Apo nuk është kështu?

Nuk ju kuptoj, tha me naivitet: mësuesi i muzikës.

Kot sa përmuhabët! A, po; harrova se juve nuk ju pritet sa të shkoni në shtëpi, dhe të pyesni për temperaturën e vajzes. Më falni. Duke qenë përvete larg familjes, u çmësova me hallet e prindit. Këq, shumë keq. Jeta i mësokë njeriut shumë gjëra. Edhe për atë që ai kishte menduar se ishte e pamundur. Asgjë nuk është e pamundur në këtë jetë, zoti Mersin, asgjë.

Nëndrejtori nxori paketen e cigareve dhe ia zgjati mësuesit të muzikës. Tjetri tundi kokën. Nuk e pinte.

— Thonë se duhami sjellka tërë ato sëmundje. E megjithatë njeriu e pi. E guditshme, ë? Njeriu, që më shumë se çdo gjë urren vdekjen, e përgatit yetë atë. Ja kjo cigare ndofta më shkurton një ditë, një javë, një muaj, një vit dhe ndoshta tërë jetën time. Po unë nuk dua të vdes. Prandaj po heq dorë nga duhami. — Nëndrejtori hodhi përtokë cigaren dhe e shkeli me këmbë.

— Kështu që i shtova vetë një ditë, një javë, një muaj, një vit dhe, me një fjalë, i shtova jetës sime jetën. E thjeshtë fare, zoti Mersin. — Ai shkeli përsëri cigaren dhe e vështroi pa ia ndarë sytë mësuesit të muzikës. Vështrimi i tij ishte i ftotë. Ai tha papritur: — E kompozuat këngën që ju porosita?

— Jo, — tha mësuesi i muzikës, i cili kish të menduar se nëndrejtori nuk do ta kapte më për këtë gjë.

— Si jo?

— Të thashë që atëherë se kjo ishte e pamundur. Po të ishte e mundur do të kisha kompozuar edhe më parë.

— Si më parë?

— Atëherë kur isha i ri e mendoja se kisha talent dhe mund të bëhesha kompozitor, bile i madh, kurse tani... më duket absurditet.

— E cila gjë nuk e ka dhe absurditetin me vete? Atë e has aq shumë në jetë, sa nuk është më i tillë, por diçka e zakonshme. Edhe kompozimi yt nuk është absurditet, por diçka e zakonshme.

— Nuk mundem, — tha përsëri mësuesi i muzikës.

— Mirë, mirë, — tha nëndrejtori, — po të paktën a u përpoqë t'u thoshe dy-tre vetave se po mundoheshe të kompozoje, një këngë?

— Si mund t'u thosha për diçka që nuk kisha ndërmend ta bëja!

— Në bisedë e sipër. Kjo ishte shumë e thjeshtë.

— Jo, — tha mësuesi i muzikës, — nuk i kam thënë njeriu, megjithëse më kanë kapur dhe më kanë pyetur se kur do ta dëgjojnë këngën time.

— Dhe ti si u je përgjigjur?

— Asnjëherë nuk do ta dëgjoni.

— E përsë iu përgjigje kështu?

— Sepse hiçi nuk dëgjohet, zoti nëndrejtor, — e humbi durimin mësuesi i muzikës, që po i dukej vetja si më hetuesi.

Nëndrejtori e vuri re këtë dhe mbloodi buzët në një qeshje ku kishte mbërthyer ironinë dhe cinizmin dhe, si u përtyp nëpër dhëmbë, mori përsëri pamjen e parë.

— Vetëm vdekja nuk dëgjohet, zoti Mersin, kurse hiçi po. Vetëm kur hiçi bashkohet me vdekjen jo vetëm nuk dëgjohet, po merr vlerën e tij të plotë. Besoj se këta ta kanë mësuar vitet e jetës? Mua të paktën ma kanë mësuar.

— Nuk ju kuptoj se ku doni të dilni, zoti nëndrejtor.

— Nëndrejtori nuk iu përgjigj dhe shkoi drejt kasafortës. Nxori nga xhepi një tufë çelësash, gjeti atë që i duhej, dhe hapi derën e rëndë, e cila lëshoi një rënkim, të çjerrë. Kapi një dosje dhe e hodhi mbi tavolinë. Pastaj, duke mbyllur kasafortën, tha: — Ja edhe kënga, zoti Mersin. Merre, merre!

Mësuesi i muzikës u afroa me një ndjenjë druaj-teje, sikur nën kapakët e thjeshtë të dosjes të fshihej një mynxyrë që, nën vëprimin e dritës, do të shpërtonte energjinë e saj. Ai hapi dosjen dhe pa partiturën e një këngë. Mynxyra këtë herë kishte formën e një këngë. Ai nuk po i lexonte dot notat e partitura. Ato lëviznin në mënyrë kaotike, si disa mikrobe para synit zmadhues të mikroskopit. Aty bashkoheshin, aty përplaseshin dhe aty ndaheshin. Lëvizja e tyre kishte diçka të kobshme. Mësuesi e mbloodi veten dhe levoi në cep të partitura. Himm për ushtrinë e pathyeshme italiane. Ai filloi ta lexonte partiturën pa zë. Ju duk një këngë, e fryrë. Në qdo notë euphoria ishte shtrirë si mbi një kolltuk të rehatshëm. Mësuesi u përnpoq të mos buzëqeshte. Ishte i sigurt se ai himn festiv kishte brenda disfatën e një ushtrie. Tragjedinë e një ushtri. Dhe ai përfytyroi zvarrijtjen e atij himni pas ushtarëve, që në ato caste e urrenin më tepër se qdo gjë, fushave me baltë dhe maleve pa shtigje, të lodhur dhe të rraskapitur nga disfata. Interezant, qdo ushtri pushtuese duhet të ketë edhe himnin e disfatës. Si nuk u ka shkuar ndër mend kjo? Ndoshta një himn, të tillë mund, të përpinqej ta kompozonte.

— C'po mendoni, zoti Mersin? — tha nëndrejtori i nervozuar nga heshtja e gjatë e mësuesit të muzikës.

— Asgjë, zoti nëndrejtor, asgjë. As vetë nuk di si ta shpjegoj por, sikur me të vërtetë të kishte mbetur tek unë pa u zbuluar goftë edhe një fije talenti, unë do ta harxhoja atë me gjithë qejf, për himnin e disfatës.

— Zoti Mersin a e kontrolloni veten kur flisni?

Mësuesi i muzikës vuri buzën në gaz.

— E ç'duhet tërë kjo komedi, zoti nëndrejtor?

Nëndrejtori mblodhi buzët dhe e vështroi në sy, si të habitej që kishte akoma naivë në këtë botë. Ai ndezi cigaren dhe e thithi thellë. Eci nga cepi i dhomës te tjetri. Ndaloj.

— Kjo nuk është aspak komedi, — tha ai.

Mësuesi i muzikës futi partiturën e himnit në dosje.

— Kush e ka kompozuar? — tha ai duke bërë më kokë nga dosja.

— Ju, — u përgjigj i qetë nëndrejtori.

— Unë?!

— Përse habiteni? Ju keni punuar për këtë himn muaj me radhë. Ai ju ka prishur gjumin dhe nuk ju ka lënë të qetë net të tëra, gjersa më në fund e mbaruat. Vlerat e këtij himni mund të jenë më të pakta sesa vlerat e mirënjohjes. Këtu qëndron edhe bukuria e himnit. Në sinjeritetin e tij dhe pasigurinë profesionale. Apo e kam gabim? — Nëndrejtori i tha këto aq shpejt, sa mësuesit iu duk si një nxënës që e ka mësuar mësimin përmendsh.

— Përse e kompozova unë dhe jo një tjetër?

— Sepse ju jeni një mësues i thjeshtë, nga një qytet i humbur i Shqipërisë. Sepse ju kishit èndërruar të kompozonit diçkë, po nuk ju frymëzonte gjë. Pastaj erdhi ushtria italiane dhe ju i dhatë fund torturës. Ky himn mund të jetë kompozimi i parë dhe i fundit juaj... por kjo ka pak rëndësi.

— Po arsyeha tjetër cila ishte që unë kompozova këtë himn?

— Arsyet janë të shumta. Po ato le t'ua lëmë atyre që e kanë zanat t'i zbulojnë edhe atje ku nuk janë, për shembull gazetarëve. Sepse kompozimi yt nuk do të kalojë në heshtje.

— Po unë prandaj dhe e kompozova, që të mos kalojë në heshtje, apo jo?

Nëndrejtori e vështroi në sy mësuesin e muzikës për të kuptuar nëse tallej apo e kishte seriozisht. Mësuesi ishte i qetë.

- Gjërat që kanë vlerë, është vështirë t'i harrosh.
- Ky himn nuk ka pikë vlere.
- Jua thashë që në fillim, Bukuria e këtij himni qëndron në atë që është bërë nga një shqiptar. Sigurisht ai nuk do të bëhet himni i ushtrisë italiane. Ai do të shërbejë si shembull mirënjoheje e popullit tonë ndaj ushtrisë italiane.
- Nuk është menduar keq. Po unë për vete do të isha dakord të kompozoja himnin e disfates.

— Mos kjo lidhet me gjendjen shpirterore që ju ka krijuar sëmundja e vajzës tua?

Mësuesi i muzikës është drodh. Ato çaste kishte harruar vajzen. Tërë ato ditë ai kishte harruar shumë gjëra, por jo vajzen. Bile as që mund ta përfytyronte se mund të kishte çaste që do ta harronte. Ai e ndjeu se ajo bisedë që nisi aq lehtë nuk do të kishte një fund, të tillë. Mbështetje fundi i saj ishte edhe më i rëndësishëm sesa shëndeti i vajzës. Sepse ajo bisedë kishte diçka që nuk i përkiste vetëm atij po dhe vajzë së tij. Mësuesi kapi turbull, seriozitetin që duhej të kishte, ky fund. Hodhi sytë jashtë. Qetesinë e atij qyteti të vogël e prishë zëri i ndonjë fëmije. Qetesia ishte e thelle dhe mbi të pas pak do të binte muzgu. Në një kohë të tillë qyteti dukej me të vërtetë i vogël dhe i humbur. Mësuesi ishte i bindur se atë qytet e njihnin shumë pak. Edhe në hartë, e Shqipërisë ai figuronte i druajtur. Dhe mund të vinte një cast që emri i tij të përmendej në gazetat më të mëdha, të Italisë si qyteti ku nga një mësues i thjeshtë muzikë lindi një himn. Qyteti do të përshtakuhej hollësisht, bile mund të bëhej edhe më i humbur sesa ishte... Mirënjoja e një qyteti ndaj ushtrisë së pathyeshme italiane... Mirënjoja e një kombi ndaj ushtrisë së pathyeshme italiane... Mësuesi përfytyroi qarte faqet e gazetave, me titujt e bujshëm... Kompozitori i parë i një qyteti të humbur të Shqipërisë. Kompozimi i tij i parë: Himn për.... Qyteti që kishte vetëm disa sazexhinj injorantë nxori kompozitorin e saj të parë... Ai mund të bëhej edhe kompozitor kombëtar... Një ushtri që çon qytetërimin, që

zgjon një popull nga injoranca e shekujve, është një ushtri e lavdishme...

Në dritare u ul një harabel. Ai vështroi i shqetësuar brenda, sikur kërkonte dikë që s'e kishte gjetur kurrikund, lëvizi kokën shpejt e shpejt dhe u largua. Por ai qytet mund të mbetej i struktur edhe në harresë, i druajtur nga emrat e bujshëm të qyteteve të mëdha. Dhe do të ishte më i natyrshëm në harresën e tij. Dhe do të ishte më i ndershëm në harresën e tij. Në ato çaste mësuesi i muzikës e kuptoi se sa shumë e donte qytetin e tij dhe sa fort ishte lidhur me të. Kjo nuk ishte një lidhje e thjeshtë dhe e zakonshme me vitet e fëmijërisë, me rrugën dhe mëhallën, me njerëzit që i takon disa herë ditën, me stinët që ia njeh aq mirë, me zhurmat dhe trokitjet e natës, me kollën kronike të komshiut që vuan nga mushkëritë, me mollët që çelin lule rozë në të hyrë të prillit, me shium që rrökullisej tërë potere ullukëve, me erën që fryn dritareve të zëna me perde të punuara me grep nga nëna apo gruaja, me ndjenjën e parë të prindit që solli në jetë një fëmijë, me... Kjo nuk është një lidhje e thjeshtë me qytetin tënd. Para syve të mësuesit nuk ngrihej më qyteti i tij, por reliivi i tokës së tij, ai reliiev aq i prekshëm dhe aq i natyrshëm. Ja malet, luginat bûzë lumenjve, fushat... E kafenjta, e gjelbra, e kaltra... Ato ishin ngjyrat e maleve të tij, luginave, fushave, deteve, liqeneve, lumenjve... Në ndonjë hartë ishte harruar qyteti i tij... Në ndonjë tjetër figuronte mikroskopik, i qetë në mëngjeset dhe mbrëmjet e tij. Nëndrejtori po fliste i nervozuar, por mësuesi i muzikës nuk e dëgjonte. Ai ndodhej larg asaj zyre të ftohtë.

— Në qoftë se tami nuk pranoni se e keni kompozuar ju këtë himn, me siguri do të pendoheni më vonë.

— Deri më sot gjithçka e kam bërë vetë, zoti nën-drejtor dhe nuk kam përsë ta qortoj veten. Ndërsa të pranoj të bëj timen diçka që s'më takon, kjo më duket e rëndë dhe e pafalshime. Pastaj nuk dua që dita e sotme të më rëndojoj për tërë jetën.

— Sentimentalizma provincialësh.

- Ndoshta, — tha i qetë mësuesi i muzikës.
- Në qoftë se ti nuk pranon, vëtë, të detyrojmë ne.
 - Kush ne?! — tha mësuesi, të cilat i bëri përshtypje theksimi i këtij përemri nga nëndrejtori.
 - Është më mirë që të mos e dish tanit për tanit,
 - tha nëndrejtori.
 - Unë nuk pranoj.
 - Mund të di arsyen?!
 - Sentimentalizëm, provincialësh.
 - Zoti Mersin, është e udhës që të kuptohemi me të mirë. Ne mund të hapim fjalë se këngën e keni kompozuar ju, po për arsyen tē ndryshme nuk keni qejf t'ju dalë emri.
 - Këtë nuk dō ta bëni.
 - Atë që është në dorën tonë nede bëjmë pa t'ju pyetur. Dhëni mos u habitni kur t'ju urojnë për këngën.
 - Kjo nuk ka për tē ndodhur kurrit. Nëndrejtori futi dosjen në kasafortë. Mësuesi i muzikës u mat të dilte.
 - Kur t'ju urojnë për këngën mos u hutoni, i dashur koleg, — tha nëndrejtori duke kërcitur tuffen e çelësave.
 - Askush nuk ka përtë më uruar, — tha mësuesi i muzikës dhë doli nga zyra. Nëndrejtori e ndoqi pas.
 - Shiko, se mos bëni diçka të nxituar, — ushtoi zëri i tij në korridorin bosh.
- Mësuesi i muzikës nuk e ktheu kokën pas. Jashtë dëbora i vranë sytë me bardhësinë e saj. Atij iu duk si-kur doli nga një errësirë e rëndë, shtypëse. Pas një kohe që kishte humbur rrjedhën e saj. Nxitoi. Në shtëpi hyri me vrull dhe shkoi drejt e te shtrati i së-bijës. Filloj ta puthte. Vajza kishte temperaturë. Këtë bëndjeu nga duart e saj që përkëdhelnin faqet e tij. Ai kishte i sigurt se edhe ajo fëmijë e pafashme kishte kaluar së bashku me të, para/pak minutash; disa çaste që shpesht i jepin vulën tërë jetës. Nuk donte të mendonte se ç'do

të ndodhët më pas. Ai tanë për tanë mendonte vetëm atë që kishte kapërcyer.

Kështu ai jetoi dy ditë. Gjatë këtyre dy ditëve nëndrejtori e thërriste qdo pushim në zyrë dhe e pyeste nëse kishte ndërruar mendje.

— Kjo është hera e fundit që po bisedojmë, — tha nëndrejtori, kur mësuesit e tjerë ishin larguar.

— Për mua biseda e fundit qe ajo para dy ditëve. — tha i qetë mësuesi i muzikës dhe vështroi jashtë. Për habitin e tij, strehët kishin filluar të pikonin. Thua të kishte ardhur aq papritur pranvera? Por jo, ajo ishte një zbutje e përkohshme, siç ndodhët ndonjëherë gjatë diçmrit, kur ndonjë rrymë e ngrohetë mesdhetare, mbasi ka kapërcyer barrierën e maleve, mbërrin deri në atë qytet të vogël. Në mbrëmje do të vërshonin përsëri rrymat e ftohta dhe do ta ngrinin déborën e shkrirë. Nata do ta pastronte qiellin dhe të ftohtët do të qe më i madh sesa në netët me qill të mbetur. Megjithatë zhurma e pikave të strehëve e ngrohu dhe iu dukën sikur të ishin zilet e para të pranverës.

— Kur them biseda e fundit, kam pàràsysh se ç'të papritura mund të ngjasin pas saj, — tha nëndrejtori dhe hapi kasafortën. — Dhe... jo gjithmonë të papriturat janë të këndshme.

— Besoj se nuk ka të papritura më të habitshme se sa ajo dë më propozuat, — tha mësuesi i muzikës.

— Ndërsa unë themi se ka. — Nëndrejtori vuri buzën në gaz dhe hapi dosjen. Notat e himnit ngjanin me disa brumbuj që lëviznin si të shastisur. — Prandaj të bëhem më realistë. Unë nuk arrij ta kuptoj se si ka ende idealistë që nuk pranojnë diçka që u sjell vetëm fitim. Isha unë që propozova për ju, sepse kam pasur

respekt si pér një njeri tē paryeshém, më tē cilin do tē merreshim vesh...»

— Kurrë! — tha mësuesi. — kurrë! Sikur edhe tē vdes!

— Nuk e kam ditur se skampëbëj me një hero! Vdekja? Sa mirë që makujuat vetë! Kisha harruan se ekzistonte vdekja.

— Nuk e di se c'do tē përfitonit nga vdekja imë?

— Ne shumë, ndërsa ju... Në dō tē hapnim fjalë se mësuesin e muzikës Mersin Lika e vrani partizanët sepse kishte kompozuar një himn, ku shprehte mirënjojen e téré popullit shqiptar pér ushtrimë e pathyeshme italiane. Por mësuesi, i cili e kishte nuanatur më kohë kërcënimin e partizanëve, e përballoi atë me vetëmohim dhe kishte marrë tē téra masat që himni tē dilte në dritë. Kjo do ta përhapë më shpejt, himnin... Sepse shpesh vdekja zbulon gjenitë.

— Ashtu! — tha mësuesi i muzikës. — Bëmëni që tanë se më vonë nuk do ta kini këtë mundësi. Mirupafshim.

Në korridor e arriti nëndrejtori. E kapi pér krahun.

— Asnjë fjalë pér sa biseduam, asnjë!

Mësuesi liron krahun, dhe u bë gati, ta pështyntë por ndërrroi mendje. Tanë që nëndrejtori kishte treguar fytyrën e vërtetë, zai nuk ria kishte më frikë, por ndiente një neveri si pér një qenie tē pështirë. Mësuesi eci drejt derës, së madhe.

— Asnjë fjalë, edhe kjo dontë jetë më tē mirën tuaj.

Në zërin e nëndrejtorit mësuesi i muzikës ndjeu dëshpërimin.

Mësuesi deli në sheshin e shkollës. Strehët, vazhdonin tē pikoni. Dëbora ishtë zbutur, si tē ishin ditët e para tē pranverës. Ai shkoi në shtëpi dhe u shtri, tē çlodhej. Zjarri i sobës ndillte gjumë, Vajza u quan nga krevati dhe iu afroa. Mësuesi pa këmbët e saj, tē dobëta, tē zbehta, gati tē tejdukshme. «Si ngjyrë e fytyrës». Vëtëm sytë kishin -zjarr. Sytë e një njeriu me temperaturë.

— Sa e ke sot temperaturën?

— Aq sa në mëngjes. Sot fjeta më rehat. Pashë edhe një ëndërr, që e harrova apo u zgjova. Ishte një ëndërr e bukur dhe më vjen plasje që e harrova. E kam vënë re, baba, që ëndrrat e bukura harrohen më shumë sesa ëndrrat e liga. Ato edhe të duash t'i harrosh nuk i harron dot. Dhe të prishin tërë ditën. Po sot pashë një ëndërr të bukur, sikur... Sa keq. Ja më vjen në majë të gjuhës dhe fap, humbet. Po s'ka gjë, ajo më çlodhi.

— Shtrihu, mës e sheh përsëri.
— Unë nuk dua ta shoh përsëri atë ëndërr. Dua të shoh ndonjë tjetër, më të bukur dhe që të mos e harroj.

— Mirë, mirë. Shtrihu! Ja edhe strehët nuk po pikojnë më. Po ngrin fuji.

Vajza u shtri dhe nuk po ia ndante sytë t'et. Mësuesi ishtë i sigurt se ajo dikça kishte nuhatur. Megjithatë ai nuk do t'i tregonte gjë. Sa të merrite rrögën do të dërgonte lekë te një kushëri i largët që jetonte në një cytet të madhe t'i gjente ilaqe. Qyteti i tyre kishte një farmaci të varfér. Bile ajo nuk ishte fare farmaci. Përtë gjetur ilaqe njerëzit shkonin në qytetin branë, që kishte dy farmaci të mëdha. Gjer më sot kishte përdorur ato që i kishte falur mijeku. «Sa të marr rrögën do t'i dërgoj lekë kushërit e ai do të m'i gjejë ilaqët.»

Vajzën e zuri gjumi. Mësuesi i muzikës e ba dhe ndjeu një dashuri akoma edhe më të madhe. As vetë nuk e kuptonte përsë i shtohej dashuria kur e shihte të bijën duke fjetur. Mësuesi lëvizzi pak perden dhe na aie-llin e largët plot yje të vogla. Ashtu i largët qelli ishte edhe më i madh, edhe më i pakapashëm. Era e kishte pastruar nga retë e hirta. Era i kishte operuar ciellit perden e syve. Në rrugë dikush ecte rëndë. Dëbora bënte krap-krup, sikur shpinte gjymtyrët e ngrira. Hanat u tretën pas pak. Qetësi. Yje. Qelli i largët, i pamasë.. Ai hoi dorën dhe perdja mbuloi qellin dhe yjet. Ziarri digjet në sobë. Vajzën e kishte mbërthyer gjumi. Gruaja thurte me shtiza një fanellë leshi. Mësuesi i pa

me vëmendje të gjitha këto dhe iu duk e pabesueshme se mund ta vrisnin vetëm pse qe treguar i ndershëm. Dhe ai tha me vete se në një natë si kjo, të qetë, diku me siguri kryhet një vrasje e pabesë. Ka njerez që son te shohim për herë të fundit qiellini. Vetëm sepse janë të ndershëm. Kjo ishte padrejtësi më e madhe që mund të bëhej në një natë si kjo. Kaq mendoi mësuesi i muzikës. Dhe kaq ishte e mjaftueshme për të. Ai nuk donte të mendonte se ç'ntind të ndodhjet nesër. Ai ishte i lumtur që i gëzohej kësaj nate me ndershëmérinë e tij.

— Ma, dha nëndrejtori këtë letër për ty, — tha xha Gaqi dhe i zgjati letrën. Ai po priste duke e vështruar mësuesin e muzikës në sy, i cili, si mbaroi së lexuari letrën, nuk dinte ç'të thoshte. Sikur në natë, letër ishte mbyllur gjëma. I paskam sjellë gjëmën, mendoi pastriesi i vjetër i shkollës dhe fshiu sytë që i lotonin prej të ftohtit të hidhur.

- C'të shkruan? — pyeti ajo.
 - Që të mos paraqitem më në punë, hëpërhe.
 - Po pse?
- Mësuesi i muzikës mbledhi supet.
 - Po ti ke edhe fëmijë, — tha pastriesi i vjetër.
 - Do të bëj si do të bëj edhe unë!
 - Sikur të vije ta sqaroje vetë njëherë?
 - Eshtë e koto. Po tio eja të pish një kafe.
 - Letra eshtë e prerë? — tha pastriesi i vjetër, që nuk e kishte dëgjuar fitesën e mësuesit të muzikës.
 - E prerë.

— Mos ke bërë ndonjë gjë që të përjashtojnë nga puna?

— Jo.

— Po, përsëndodhni këto gjëra, mor Mersin?

Mësuesi i muzikës e vështroi në sy pastruesin e vjetër të shkollës dhe për herë të parë ndjeu se nuk dinte ta shpjegonte aq mirë, sa tjetri ta kuptonte. Ai e ndiente se nuk qe vetëm ndershmëria e tij shkaku i atyre që ndodhnin, por ishte edhe diçka, tjetër, më e thellë. Cfarë?! Ende s'e kishte të qartë: që pas ndershmërisë qëndrojnë njerëzit dhe se këta njerëz u nënshtronen dhe u binden disa rregullave të vendosura prej kohësh, se edhe këto rregulla të lashta kanë nevojë të mbushen me kuptime të reja, sepse asnjëherë ndershmëria nuk ka qenë e ngurtë, por ka lëvizur e lëvizur duke kërkuar përsosjen e saj. Dhe përsosjen e bënin njerëzit. Dhe mësuesi i muzikës e ndiente se nuk i kishte shtuar asgjë ndershmërisë së lashtë të njeriut për tokën e tij. Ai vetëm e kishte pohuar atë. Tërë këto nuk ia tha xha Gaqit. Xha Gaqit i tha vetëm kaq.

— Po, jetojmë më një kohë kur njeriu duhet të jetë më shumë se kurrë i ndershëm, xha Gaqi.

Pastruesi i vjetër tundi kokën.

— A do të hysh të pish një kafe? — e ftroi përsëri mësuesi i muzikës.

— Jo, — tha pastruesi i vjetër, — tani duhet të nxitoj për t'i rënë ziles.

— Kur të duash eja pa druajtje, — tha mësuesi dhe i dha dorën.

— Si t'i them atij? Sepse më porositi të rri e të marr përgjigje.

— Thuaji vetëm kaq: kurrë!

— Kurrë?!

— Po, kurrë!

Mësuesi i muzikës qëndroi te dera gjersa pastruesi i vjetër i shkollës kapërceu qoshen e rrugës. Hyri brenda: «Ai ma ka frikën, — mendoi mësuesi i muzikës, — ai ma ka frikën dhe do të më urrejë për tërë jetën».

Në letër nëndrejtori kishte shkruar lehtë, në cep, si një shënim të vjetër dhetë hairuar: *Hesht!* Kuptimin e atij kërcënimi, edinte vetëm ai dhë kush e kishte bërë. Mësuesi futi letrën në sirtar dhe i tha së shoqë se atë ditë nuk kishte mësim. Doli jashtë qytetit, sepse kishte nevojë për të qënë vetëm për vëtëm me mendimet e tij. Hapësira e bardhë e dimrit kishte ndrydhur benda koracës së saj prej dëbore qdo zhurmë. Nën atë kocë ishte tokë me jetën e saj, me lëvizjet rrymat, damarët, rrënjet. Nën të ishin bari dhe gruri. Nën të ishin të rënët dhetë vdekurit. Mësuesi i muzikës tha se ai ishte i qetë para tyre. Sepse ka çaste kur njeriu e mëdien veten fajtor edhe para grunit, barit, rrënjeve, ashtu si mund ta ndiejë veten të ndershëm.

Ishte larguar mjaft nga qyteti. Po e cte në një rrugë të rrahuar fshati. Mbi dëborë kishte gjurmë njerëzish dhe bagëtish që kishin zbritur në qytet. Mësuesi i muzikës po mendonte se ç'punë duhej të niste për të jetuar. Nuk dinte ndonjë zanat.

Kur u kthye në shtëpi sofa ishte e hengritur dhe askush nuk kishte futur një lugë të gojë. Ai hengri me oreks. Në mbrëmje erdhi Skënder Nagi. Mësuesi ia tregoi të gjitha. Skënder Nagi tha:

— Maskarai! — Dhe përsëriti, — Maskarai!

Dhe iku papritur. Në mesnatë vajza foli përcart. Ata i qëndruan te koka. Erdhi e shqja e Skënder Naçit. Ajo tha:

— Ia morët ilaçet? — — dhe menjëherë kafshoi gjuhën. — Të dielën dil përsëri nga pazarit i bagëtive dhe bli shpretka të qengjave të therur. Ajo ka gjak. Njerëzit ta dinë hallin.

...Të dielën e parë e pati të vështirë. I dukej sikur kërkonte lëmoshë. Ai bleu tri shpretka. Ia skuqi pak dhe iandha së bijës. Gjaku i shpretkës... Ai ishte gjaku... Të dielën e dytë u njoh me Azbi Kasapin apo

më mirë e njoju Azbi Kasapi. Ai ia dha një pjesë të shpretkave të qengjave që theri. Gjaku i shpretkës si...

Duke pritur të dielën, ajo sikur i përpinte ditët e tjera. E diela sikur e përmiblodhi muajin në katër ditë. Ai nuk shikonte ditët e tjera. Ai priste të dielën. Skënder Naçi i shpeshoi vizitat. I fliste për luftën. Por mësuesi, sado që e dëgjonte me vëmendje, kishte vetëm një shqetësim, e diela nuk vinte aq shpejt. Skënder Naçi nuk e humbiste durimin. Ai ishte njeri i qetë.

Nëndrejtori gati përditë i dërgonte nxënës të ndryshëm për të pyetur për shëndetin e vajzës.

— I thoni nëndrejtorit se ajo është shëndoshë e mirë, si nuk ka qenë asnjëherë! — u thoshte ai nxënësve...

8

...Po kalonte ora dhjetë dhe s'po dukej njeri. Azbi Kasapi ishte i mërzitur. Ata prisnin të vinin blerësit, që nuk po dukeshin.

— Keq e paskemi sot, profesor, — tha Azbi Kasapi.

Mësuesi u drodh.

— Pse, Azbi? — Ai fliste më tym, i hutuar.

— S'qenka pazar i mbarë.

Fshatarët rrinin të mërzitur dhe pinin duhan. Azbi pa dikë që bleu një qengj dhe vrapi. Mësuesi e ndoqi pas.

— Ta ther, — Azbi u mat të kapte qengjin.

— Nuk do ta ther sot, — tha burri.

— Ta ther pa lekë, vetëm më jep shpretkën.

— Nuk do ta ther sot, — tha burri dhe u largua.

Të dy, mësuesi i muzikës dhe Azbi Kasapi mbeten të heshtur.

— S'ke ç'bën, — tha Azbi. — Ishallah vjen njeri tjetër.

Era po bëhej më e fortë dhe retë kishin filluar të uleshin.

— Do të bjerë shi, — Azbiu vështroi lart. Edhe mësuesi vështroi retë. Ata u endën edhe dy orë. Askush nuk po blinte atë ditë. Era frynte. Ajo nuk i lin te retë të shkarkonin shiun. Fshatarët prisnin si të ngrirë, me syltë nga rruga e qytetit. Aty era ngrinte pluhur dhe letra... Shiu filloj pas pak me pika të mëdha. Azbiu pa fshatarët që po bëheshin gati të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Iu afroa një qengji dhe e kapi.

— Sa e mban?

Fshatari dha paazarin. Ata diskutuan gjatë, ndërsa shiu bëhej edhe më i dendur. Ata nuk po binin dakkord. Mësuesit i kishte ngrirë në dorë qesja ku fuste shpërkat. Më në fund Azbiu futi dorën në xhep. Ai nxori lekët dhe ia dha fshatarit.

— Eja, profesor, — i thirri Azbiu, që po e conte qengjin te vendi ku i therte. E theri shpejt e shpejt qengjin, e ropi dhe i zgjati mësuesit të muzikës shpërkën.

— Boll është për sot, nesër kësмет. Unë po shkoj mos e shes mishin te myshterinjtë. Mos u mërzit, profesor. — tha Azbiu dhe nxitoi drejt rrugës së qytetit.

Mësuesi kishte mbetur me shpërkën në dorë. E futi në qese. Fshatarët e kishin boshatisur sheshin e pazarit. U largua edhe ai. Shiu po binte si me gjyma, po ai nuk e ndiente. Në rrugët e shtrembra të qytetit vetëm ai e cte aq më rrengje dhe aq i pambrojtur. Në qese kishte shpërkën e vetme të asaj dite. Gjaku i shpërkës... Kallimtarët e vështronin të habitur. Ai nuk i vinte re. Nuk shikonte as shiun, as njerëzit. Ai ishte nën pushtetin e së vetmes shpërkë që kishte për atë ditë. Tani edhe ajo duhej të ishte lagur nga shiu. Në mënyrë krejt të pavetëdijshme e futi nën xhaketë për ta mbrrojtur. Pastaj u pendua. Qesja ishte skuqur nga gjaku. Megjithatë gjakun që i duhej së bijës shpërkë e ruante në dejet e saj. Atë ajo nuk ka për ta lëshuar. Era e vërtitte shiun duke e përplasur pas fasadave të shtëpisive, pemëve dhe avllive. Ullukët derdhnin me zhurmën e

tyre karakteristike ujin e mbledhur tjegullave. Anës mureve rriddhnin rrëkera të turbullta. Në njërën prej tyre mësuesi i muzikës pëq një lajmërim vdekjeje, që Dane Kuqoja e kishte ngjitur me aq merak në mëngjes. Dania nuk e kishte parashikuar se do të binte shi. Fletë e zezë humbi nën ujin e turbullt. Mësuesi i muzikës e qortoi vëten që u jepte rëndësi edhe gjërave të kota. Pa e kuptuar po bëhej fatalist. Deri atëherë nuk e kishte qortuar vëten për veprimet që kishte bërë. Edhe tani, që jeta e vajzës sime varët nga sasia e gjakut që i jep shpretkë, nuk duhet ta qortoj vëten. Po fillova të qortoj vëten, kjo do të thotë se u thevë. Ai shtrëngoi shpretkën dhe nxitoi, pastaj nxitimi u kthye në vrap dhe kur u gjend në shtëpi ishte si i çliruar nga një brengë e rëndë. Shiu përplasej pas xhamavë. Era po dobësohej. Tani shiu do të bjerë më i qetë. Mësuesi i muzikës hoqi rrrobat dhe u ndërrua:

- Pse qëndrove kur e pe se po niste shiu, baba?
- Vajza e shikonte tërë mall dhe dashuri. — Tani jam më mirë. Sot nuk kam pasur fare temperaturë.
- Vetëm një shpretkë të gjetë, — tha mësuesi i muzikës.
- S'ka gjë. Edhe të mos kishe sjellë unë nuk do të mërzitesha kaq, sa tani që je qullur.
- Të të bëj një ponç me raki, — tha e shoqja.
- Mirë.

Në dhomë u dëgjuat zhurma e xhezves që kërciti mbi sobë.

— Pije me një frysë, që të, të djegë. Kështu kishte qenë përherë e shoqja. E urtë dhe e kujdeshshme. Edhe kur i kishte treguar shkakun përsë e kishin përjashtuar nga puna, ajo nuk foli, po kur qenë shtrirë për të fjetur i kapi dorën dhe ia përkëdheli tërë dhiimbsuri. Ndjesinë e asaj përkëdheljeje ai e kishte gjithmonë me vete. «Ndjesia e njeriut që na do. Ndjesia që nuk do të na ndahet kurrë. Ndjesia e njeriut që ndan me ne çdo gjë. Ndjesia e gruas që na do përherë të ndershëm»...

— A erdhi njeri, kur nuk isha unë? — Mësuesi i muzikës la gotën në tavolinë.

— Erdhi një burrë. E kishte dërguar ai. — E shoqja nuk thoshte më nëndrejtori, por ai.

— C'donte?

— Të kishte parë në pazar. Ai i kishte thënë burrit që të të thoshte se gjaku i shpretkës nuk bën çudira.

— Tjetër?

— Se po të duash ta takosh e gjen në shtëpi deri në orën dy. Pas kësaj ore nuk të pret se do të flejë.

— Kush ishte ky burrë? E njoh unë?

— S'e di. Unë nuk e kisha parë ndonjëherë. Ndoshta është i ardhur. Kur fliste kishte sy të këqinj dhe të pabesë. Nuk më pëlqeu fare.

«Ai ma ka frikën, — mendoi mësuesi i muzikës. — Ai ma ka frikën prandaj më kërcënnon me turli njerëz. Ai nuk më zhduk dot sepse kjo do ta zbulonte para të tjerëve. Ai nuk më zhduk dot sepse trembet.» Mësuesi i muzikës vështroi jashtë. Shiu vazhdonte të binte i qetë. «Nga kush trembet?» Ai nuk dinte si t'i përgjigjej atë çast kësaj pyetjeje. Ndjeu një dridhje të embël dhe një valë të ngrohtë që i pushtoi gjoksin. Ishte dridhja dhe ngrohtësia që ndien njeriu kur nuk është i vetmuar. Ai nuk i njihte ata që nëndrejtori ua kishte frikën.

— Na shtro të hamë, — tha sikur në shtëpi të kishte mysafirë.

— Sa të marrin edhe një valë fasulet.

— Mirë, — tha mësuesi i muzikës, — le të presim sa të marrin edhe një valë fasulet. Ai u ngjesh pas sobës dhe të nxehjtët po ia hiqte pak nga pak lodhjen dhe të ftohtët që shiu ia kishte futur deri në kockë. Mësuesit po i vinte gjumë. Ai nuk e kuptoi kush e zgjoi uria apo e shoqja. Hapi sytë dhe pa se jashtë kishte filluar të errej. Shiu ishte ralluar, por bubullimat e largëta ndiqnin njëra-tjetrën. Mësuesit ato iu dukën si zhurma e karrocave të shiut nëpër kalldrëmin e prishur të reve. Karvani ishte i lodhur nga udhëtimi i gjatë. Udhëtimit po i vinte fundi tanë, në kufijtë e asaj dite, që po mbyllej me një shi të rrallë, të lo-

dhur dhe të trishtuar. Në dhomë nuk dëgjohej asnë zhurmë. Ai u ngrit mbi bërryla dhe pa se e shoqja po dremiste. Edhe e bija po flinte. Djalin, që kur kishte mbetur pa punë, ia kishte marrë i vëllai. Ai largoi me kujdes batanijen dhe shkoi te dollapi i bukës.

— Mersin, u çove? — tha e shoqja.

— Mos u ço. E bëj gati vetë tavolinën. Ti hëngre?

— Po. Më erdhi keq të të prishja gjumin.

— Mirë bëre. — Mësuesit ia ngacmoi akoma më tepër oreksin éra e fasuleve. Ai hanët dhe nuk ndiente të ngopur. E shoqja e shikonte në gojë, si të ishte fëmijë.

— Përse më shikon kështu, Kasiani?

— Ku ta di unë, e zeza. Nuk po na ndahen hallet. — Mos u mërzit. Do ta gjej edhe unë një punë. Mësuesi mori pjatën e palarë të fasuleve dhe doli jashtë te tollumbi. Ishte një gjysmerrësirë e shkaktuar më shumë nga koha e vrenjtur sesa nga ora e mbrëmjes. Degët e mollës kullonin, kurse lëkura e saj ndriste lehtë. Bubullimat kishin reshtur duke lënë në hapësirë një qetësi të quditshme dhe të ngrirë, aq sa dëgjohej edhe rënia e pikave të rralla pilocave të oborrit. Edhe mëhallat kishte rënë në qetësi. Mësuesit të muzikës nuk i bëhej të hynte brenda. Ai e ndiente veiten të çlodhur.

— Eja, se mos ftohesh. — E shoqja kishte dalë në dritat...

— Erdha.

Ai hyri brenda, ndezi driten, mori një libër dhe u pënpoq të përqëndrohej në lexim. Vajza u mbështet mbi parvazin e dritäres dhe shikonte e huimbur jashtë, si po binte pa u ndjerë edhe një natë. Dhe papritur u dëgjuan të shtëna. Mësuesi u çua dhe hapi kanatin e dritäres. Të shtënat u përsëritën por këtë herë ato ndryshonin nga të parat. Ato vinin nga periferia. Mësuesi i muzikës ishte i sigurt pér këtë. Pastaj të shtënat u futën brenda në qytet dhe heshtën. E gjithë kjo ndodhi aq shpejt, sa mësuesit të muzikës iu duk sikur i bënë veshët.

Çatitë rrëzonin pikat e fundit të shiut. Ai mbylli dritaren.

— Nga u dëgjuan? — pyeti e shoqja.

— Nga shtëpia e atij.

Gruaja ia nguli sytë.

— Mos t'u duk ty ashtu?

— Jo, — tha mësuesi.

E shoqja seç foli nën zë. Ai pa vetëm lëvizjen e buzëve të saj. Ndoshëta kanë qëlluar pikërisht mbi atë. Kjo fjali u end nëpër kokën e tij e paplotë. Ai e ndiente se ajo fjali ishte gjysmëpohuese dhe gjysmëpyetëse. Veçse ato nuk ishin krisma të thjeshta. Ato sikur po qëllonin diçka edhe brenda tij. Dhe mësuesi i muzikës po përpinqej të gjente se ç'kishte ai me vete që kishin nevojë edhe për ato të shtëna. Ai mund të jetonte i ndershëm edhe ashtu siç kishte jetuar deri atëherë. E megjithatë ndjeu se ndershëmëria e tij kishte nevojë edhe për ato të shtëna. Atëherë fjalia e tij nuk përpinqej kot nëpër dy gjysmat e saj. Vetëm atëherë ajo gjente vetvete në bashkimin e atyre dy gjysmave. Mësuesi vështroi të shoqen dhe vajzen. Ato përpinqeshin t'i buzëqeshnin. Ai iu afroa dhe i përkëdheli flokët së shoqes. Mendimet e asaj nate sikur e kishin afruar më tepër.

— Kush të ketë qenë? — tha e shoqja.

— Nuk e di, — tha mësuesi i muzikës. — Edhe unë do të doja të dija se kush qëlloi.

— Baba, — tha vajza. — Po trokasim në derë.

Ata mbajtëm yesh. Në derë u dëgjuan trokitje të lehta dhe të kujdeshshme.

— Kush të jetë? — tha e shoqja.

Mësuesi nuk priti por nxitoi jashtë. Doli me vrapi në oborr, i hoqi hekurin derës dhe pë e hapur mirë të gjithë derën hynë brenda dy njerëz. Ia vuri përsëri derës hekurin dhe po shikonitë me vëmendje ata që hymë. I njobhu. I kishte pasur nxënës. Njëri quhej Pirro, kurse tjetrit ia kishte harruar emrin. Ai që ia kishte ha-

rruar emrin shtrëngonte fort, duke shtrembüuar fytyrën, dorën, e majtë.

— Hyni brenda, — tha mësuesi i muzikës, — hyni shpejt.

— Na falni, profesor, por...

— Më vonë, më vonë. — Dhe mësuesi i muzikës eci i pari drejt korridorit. Ata hynë me druajtje në dhomë dhe nuk dinin se ku të uleshin.

— Ju bezdisëm, — tha Pirroja.

— Çështë ajo! — tha e shoqja e mësuesit të muzikës që i kishte mbledhur veten.

Ata u ulën. Dhe përsëri askush nuk diinte si ta prishtë heshtjen. Në rrugë u dëgjuan hapa. Nxitonin përdiku nëpër natë. Të gjithë mbajtën vesh. Hapat u larguan dhe rruga ra përsëri në qetësi.

— Profesor, të n'a falni, por nuk do të qëndrojme shumë, — tha Pirroja.

— Rrini sa të doni, — tha mësuesi i muzikës. — Ndoshfa tanë është e vështirë të lëvizësh nëpër qytet.

— Po edhe ju...

— Cfarë ne?

— Nuk duam të rrezikoni.

— Përse nuk doni të rrezikojmë?

Pirroja, ngaqë nuk diinte si të përgjigjej, vuri buzën në gaz. E shoqja e mësuesit të muzikës i ishte afruar djalit tjetër dhe po i shikonte gjakun që i rriddhë që poshtë pëllëmbës së dorës.

— Qenke plagosur, — tha ajo. — Dale të ta laj me raki.

Djali hoqi xhaketën. Mësuesi i muzikës pa gjakun që vazhdonte të skuqte këmishën e djalit. Gjaku i...

— Mos u bëni merak, ja ai pushoi, — tha djali.

— S'ka gjë, rakia vetëm mirë i bën.

Ajo ia pastroi gjakun dhe ia lidhi krahan.

— Plumbin brenda e ke? — pyeti mësuesi.

— Jo.

Pirroja u afroa te dritarja dhe vështroi jashtë.

— Mësues, — tha ai, — ne sonte vramë nëndrejtoren.

— Ishte spiun dhe kishte filluar të dëmtonte punën tonë.

— E mora me mend, — tha mësuesi.

Pirroja uli perden dhe tha:

— Sikur të dilnim tani, Zalo.

— Mirë.

— Sonte do të qëndroni këtu, — tha mësuesi i muzikës dhe sepse në ato çaste po i pëlqente që zërit ti jepte tonin e mësuesit. Por nuk mundej.

Në rrugë u dëgjuan përsëri hapa.

— Profesor, — tha Zaloja, — po të na gjejnë këtu nuk do të keni vetëm ju pasoja por edhe gruaja dhe vajza juaj.

— E di. Por kjo muk do të thotë që ju të ikni nga shtëpia ime. Pastaj nuk ma merr mendja që të keni harruar se dikur kam qenë mësuesi juaj, apo jo?

— Nuk kemi harruar, — tha Pirroja.

— Faleminderit, — tha mësuesi i muzikës.

Të katër, e shoqja, e bija dhe të dy nxënësit e pamë se ai ishte i prekur. Nga jashtë hyri vërshellima e ëmbël e erës. Kishte nisur të frynte një erë e ngrohtë, që lëkundte lehtë degët e mollës.

VJESHTA NË NJË QYTET TË MADH

Gjëja më e çuditshme dhe më e pabesueshme ishte që në atë qytet të huaj një fytyrë të të dukej si e njo-hur... Po kaloja rrugën nr. 5 për të prerë sa më afër hotelit, kur u ndesha ballë për ballë me atë. Ishte një burrë me sy të mëdhenj, të lëngshëm, ku reflektohej ngjyra e verdhë dhe e kaltër e një reklami makinash. Germat e firmës ndizeshin njëra pas tjetrës dhe nga kjo të krijohej ideja sikur në sytë e tij shfaqej filmi më absurd dhe më pa subjekt që mund të qe xhiruar deri në atë kohë. I kalova përbri dhe pashë që ai u bë gati të më fliste, por nuk mundi sepse rryma e njerëzve më rrëmbeu me vete dhe unë qeshë i detyruar të ecja përparrë dhe të zija vend në shkallët vetëzbritëse. Kur ktheva kokën pas nuk e pashë më. Dhe mendova se atë fytyrë

ndofta e bëri të njohur dëshira ime për të takuar një njeri.

Njerëzit shpërndaheshin nëpër korridoret e shumtata të kalimit nëntokësor duke përplasur takat pas pllakave të mermerta. Unë mora majtas. Shkalla yetëngjitur ishte prishur dhe nuk punonte. Kur dola sipër ndesha me ftyrën e menduar të njërit prej princëve, të atij qyteti, të derdhur në bronz. Princi shihet poshtë këmbëve sikur kërkonte të gjente diçka që sapo i kishte humbur. «Dhe sonte nuk ke për ta gjetur atë që kërkoni», — i thashë princit. Mbi piedestalin e tij pëllumbat kishin bërë tërë ato glasa. Fare pranë këmbëve më kaloi tramvaji i Sheshit Qendror. «Mos u bëj humbameno pas princave, në s'do të përfundosh nën rrotat e tramvajit», — thashë dhe më erdhi për të qeshur. Dhe ajo ishte ora kur rrugët kishin ngarkesen maksimale. Njerëzit nxitonin. Në atë qytet njërit sikur kishin harruar të ecnin ngadalë. Përshtypjen e nxitimit ta krijonte gjithqka, që nga ndezja dhe fikja e reklamave, shpejtësia e veturave dhe kampbanat e tramvajeve. Unë isha i ngeshëm.

Hyra në rrugën anësore ku ka zakonisht dyqane, të vogla apo pijetore të kategorisë së fundit. Mbi qytet po binte mjegulla. Kisha një javë aty dhe pérherë, me një përpikméri të çuditshme, sa vinte ora shtatë, dritat e rrugëve visheshin nga mjegulla. Ai qytet mbante shumë mjegull. Këtë gjë ma pati pohuar dhe sportelisti i hotelit ku filia: «Mjegulla nuk i ndahet qytetit tonë përgati tetë muaj». Unë pata thënë se kjo duhej të ishte diçka e lodhshme dhe e padurueshme. Sportelisti kishte mbledhur supet e më kishte, thënë se tashmë ishin mësuar të jetonin në mjegull. As vetë nuk e kuptova se si truri im polli imazhin e tërë atyre kullave dhe kambanoreve të kishave që kisha hasur gjatë udhëtimit, sapo dëgjova fjalën mjegull. Edhe atë mbrëmje mjegulla po më jepte dhimbje koke. Dhe e harrova ftyrën që para pak çastesh m'u duk si e njohur.

Dyqanet ishin mbyllur. Hapur qëndronin restorantet, dyqanet e bukës, klubet e natës dhe kinematografi. Pothuajse në çdo shtyllë, si një panterë e zezë e gatshme përtu

hedhur mbi prenë e vet, ishte ngjitur reklami i një filmi me titull «Mister Billon». Po edhe mbi të po ulej ngadalë dhe e pamëshirshme mjegulla. «I shkreti Mister Billon, që je i detyruar ta kalosh tërë këtë natë të ftohtë i mbérthyer në shtyllë», — thashë dhe vura re se padashur isha larguar nga rruga e zakonshme që bëja për t'u kthyer në hotel. Mora majtas dhe gati sa nuk lëshova një thirrje habie. Përsëri fytyra e njojur. Tani ajo më buzëqeshët ngrohtë. Nga sytë, ku shquhej një nostalgji e thellë, e mora me mend se edhe ai ishte i huaj në atë qytet. Gati të gjithë të huajt që punonin në atë qytet dallohen nga sytë e trishtuar dhe plot nostal-gji.

— Mirëmbërëma, — më tha me një anglishtë të pasigunt.

Ia ktheva pëershëndetjen në anglisht me të njejtën pasiguri. Ai buzëqeshi dhe më tha se do ta kishim vë-shtirë të komunikonim me një gjuhë që asnjeri prej nesh nuk e zotëronte mirë. Më doli në krah të majtë dhe e ndjeva se ishte i emocionuar aq, sa nuk dinte nga ta niste bisedën.

— Kisha kohë që prisja të takohesha me një njeri nga vendi juaj, — më tha. — Dhe asnjerë nuk e humbá besimin.

Sot, duke udhëtuar lexova në tren për çeljen e panairit të librit dhe pjesëmarrjen e vendit tuaj në të. Zbrita menjëherë në këtë qytet, megjithëse biletën e kisha prerë për një Atdheun tim dhe erdha drejt e në pavionin tuaj. Ju ishit i zënë me vizitorët dhe unë nuk ju shqetësova. Shfletova disa libra dhe po prisja sa të mbeteshit vetëm. Por pavioni juaj nuk mbeti asnjerëherë bosh. Dhe mua kjo më gëzonte. Një interes të tillë nuk e vija rë në pavionet e tjera, aq sa ata më ngjanë si të mjerë. Kur mbaroi orari i vizitave të ndoqa pas dhe, sa u mata të të flisja, ju zbritët në kalimin nëntokësor.

Atëherë e kuptova përsë m'u duk e njojur ajo fytyrë. Por ngaqë atë ditë në pavionin tonë kishin ardhur shumë vizitorë, ishte e pamundur t'i mbaja mend të tëra fytyrat e tyre. Veçse tani po më kujtohej fare mirë

ky burrë, kur erdhi në pavion dhe në fillim mbeti si i hutuar para titujve të librave dhe si pastaj mori broshuren «Teoria dhe praktika e revolucionit» e u harrua në një qoshk me të në dorë. Por kjo gjë kishte ndodhur edhe me vizitorë të tjera. Kështu që ngatërrimi i fytyrave të tyre ishte diçka e natyrshme.

Nuk e di por ai burrë m'u bë i afërt në atë qytet të huaj, në zemër të Evropës Qendrore, kur kishte rënë mjegullë e ftohtë e mbërëmjes dhe era rrökulliste trotuareve gjethet e zverdhura të drurëve me një tri-shtim të fshehtë. Sepse të krijohej përshtypja sikur ai qytet përpiquej të fshihte diçka ngajeta e tij. Kjo dukej që nga nxitim i njerëzve, ndezja dhe fikja mekanike e semaforëve, rënia e mjegullës dhe ngjeshja e jakës së palltove dhe pardesuve sa më ngjitur fytyrës.

— A pimë një kafe, — m'u lut ai. — Refuzimi im, më shumë se fyterje do ti shkakton te dhimbje, prandaj pranova.

— Di unë një kafene, — i thashë. — Është një kafene pranë hotelit që nuk frekuentohet shumë dhe ku mund të bisedosh i qetë. — Mirë, — tha ai.

Qëndrova të orientohesha. Për fat mjegulla nuk e kishte mbuluar akoma dritën e verdhë të stacionit të trënit, e cila më ndihmonte përtë gjetur hotelin. U kthyem majtas, kapercyem një rrugë kryesore dhe u kthyem përsëri djathjas. Mjegulla sa vinte dhe po e dobësonte dritën e verdhë të stacionit të trenit dhe unë nxitoja të gjeja sa më parë kafenënë, e cila ndodhej pranë tij dhe hotelit. Burri vinte pas meje dhe ndofta ishte i kënaqur që unë nuk po e gjeja aq shpejt kafenënë. Në sytë e tij bojë kafe kishte një gëzim të giltër, fëmijëror, të cilin mund ta shqetësoni edhe era më e lëhtë. Vitez e emigrimit e kishin bërë më të ndjeshëm, aq sa vëndin e atij gëzimi mund ta zimin menjëherë vuajtja dhe dhembja e njeriut të fyer. Ecja na pengonte të flisnim sepse më shumë se me fjalë merreshim vesh me gjeste. Ndalova! Drita e verdhë e stacionit të trenit as afrohej dhe as largohej.

- Ta marrë dreqi! — shava me zë.
- Ç'ke? — më tha burri.
- U ngatërrova, — i thashë.
- S'ka gjë, në kafenenë e parë që të hasim, ulemi.
- Po ajo është një kafene e qetë, tamam për ne të dy, që s'duam të ma shqetësojë mjeri dhe që nuk e dimë mirë anglishten.

Ai qeshi.

- Punë e madhe! Edhe pa asnje gjuhë ti do të më kuptoje mirë.

— I biem majtas? — i thashë.

— Si të duash.

Hymë më një rrugë të ndriçuar më zbehtë se rrugët e tjera. Që në fillim nga dritat e kuqe në portokalli dhe blu në gushëpëllumbi ajo rrugë m'u duk sikur kishte plagë prej të cilave rrithet një gjak me një ngjyrë të çuditshme. Vështrova burrin. Edhe ai ishte hutuar. Megjithatë ecën drejt. Dy gra, në të cilat ndihej tualeti i dëshpëruar për të imposhtur moshën, ma vështruan me ca sy lutës, të ftohtë dhe të thatë. Për herë të parë po shikoja sy aq të thatë, aq të mpirë, aq të ngurtësuar, si dy fusha hokeji mbi akull.

Sa më shumë që hynim në atë rrugë, aq më tepër dritat e saj më ngjanin me rrjedhën e një gjaku që kishte humbur ngjyrën. Edhe emrat e lokaleve kishin diçka nga humbja e klorofilit, si ato lulet që i mbajmë për një kohë të gjatë në errësirë dhe që kërçellin e kanë të dobët, të tejdukshëm. «Kabare», «Klub nate», «Grand Prix», «L'Italia», «Dolly», «Pik Dam», «Broduei», «Sex Shop», «Sex Gags», «Tam-tam», «Mini-Sex-Shop». Në dyert e tyre të dyshimta, si hyrje shpellash, trinin burra që të ftonin të hyje brenda, të cilët flisnin në gjuhë të ndryshme. Edhe gjuha e tyre kishte diçka nga humbja e klorofilit. Gjuha e natës...

— Kthehem, të lutem! — më tha burri.

Ai ishte zbehur dhe vështrimi i ishte bërë më i përvuajtur. Më kapi për krahu. Dridhej.

— Eja, tē lutem! Bëmë gabim që hymë nē këtë rrugë.

— Më fal, por nuk e dija, — i thashë.

— S'ke përsë më kërkon tē falur. Edhe pa kaluar këtej ne tē dy, kjo rrugë ekziston.

Ftuesit, apo u afroheshe, ngrimin zërin dhe ngjesh-nin nē fytyrë një buzëqeshje tē pështirë. Po kalonim para tërë atyre thirrjeve pa lëng, si para disa kufomave që i kishin lënë tē dekompozoheshin nē sipërfaqe. Emrat e lokaleve ndizeshin dhe fikeshin nē intervale tē ndryshme. «Pik Dam»! Shuhu-ndizu. «Tain-Tain»! Shuhu-ndizu! «Broduei»! Edhe një plagë! Mjegull. «Broduei»! Edhe një plagë! Mjegull. Dhimbje. Errësirë. Thirrje që nuk shpërthenin dot. Thirrje që mbyteshin. Rru-ga rënkonte pa zë. Rrugë që ishte e dënuar tē jetonte vetëm natën. Rrugë që apo zbardhej vdiste. Burri po më ndiqte i lodhur dhe i dërrmuar. Ndaloj.

— Eja, — i thashë.

Por ai nuk më dëgjoi. Ftuesi e çoi edhe më zërin dhe na tregoi derën me një buzëqeshje tē ndyrë, ndjellëse.

— Eja, — i thashë përsëri, por ai nuk lëvizi.

Shikonte vitrinën dhe dridhej.

— Ç'ke? — u shqetësova unë.

— Ndonfta ndonjëra prej tyre është viga qyteti im, nga mëhallat imë, — tha ai duke më treguar fotografitë e femrave lakuriq tē atij lokalit.

Ftuesi la derën dhe na u afrua me paturpësi. Ai i foli burrit në gjuhën e tij. Burri ngriu për një çast me kokën ulur, pastaj e kapi ftuesin për jake dhe u mat ta godiste. E zura për krahu dhe e tërhoqa.

— Mos bëj skandal, — i thashë. — Nuk ka faj ai.

— E di që nuk ka faj ai, ta marrë dreqi, e di,

— dhe gati sa nuk qau. Sapo dolëm nga rruga, na ra nësy reklami i një firme makinash dhe më tej, pa e fshe-hur vetëkënaqësinë, që nuk ia mposhitte dot as mjegulla, reklami «Ig Metall».

— Më fal, por nuk e dija se gjendej ajo rrugë, — i thashë përsëri.

— S'ka gjë. Ke qenë ndonjëherë në atdheun tim? — më pyeti papritur.

— Jo, — i thashë.

— Ja sonite pe pjesën, më të dhimbshme edhe të tij.

Kishim hyrë në rrugën ku ndodhej kafeneja. Burri heshtte.

Nuk isha i aftë ta ngushëllaja dhe u gëzova që kafenë e kishim përballë. Hymë. Zumë vend pranë xhamillëkut të rrugës. Xhamat kishin zënë një cipë avulli. Nuk dimë si tia nisnim bisedës. Kur u tashkuam menduan se nuk do ta kishim kaq vështirë. Por nuk mund të shkëputesh aq shpejt nga përshtypja e asaj rruge.

Nxora paketën dhe i zgjata një cigare. Ai e mori duke më falënderuar. Dhe qeshi trishtueshmë. Dhembja në sy, karakteristikë për çdo emigrant, iu theksua akoma më shumë dhe, ndofta, nuk do t'i ndahej për tërë kohën që do t'ë rrnim bashkë.

— Mezi prisja të takoja një njeri nga vendi juaj, — më tha përsëri. — Dhe asnjëherë nuk e humba besimin. Të falem ndër që pranovë të pish një kafe me mua.

— Mos më falëndero kaq shumë, — i thashë duke qeshur.

— Ke të drejtë. Po, a ke biseduar me një njeri-kafshë? Jo! Pra unë jam njeriu i parë kafshë me të cilini po bisedon. — Dojë t'i thosha diçka që të zbuste gjendjen e rëndë që u krijua, por edhe unë isha i trondituri. Ai dukej njeri me sedëri dhe kishte mundësi që fjalët e mia t'i merrte si ngushëllimi dhe mund të fyhei. Ndërsa unë as që kisha ndër mend ta fyeja. Dhe sa të sqaroheshim, me anglishten tonë të çalë, mund të ngatërholeshim më këq. Prandaj e lëshë të shfrente. Gjithçka që e ziente përibrenda.

— A dallon tek unë diçka prej kafshe? — më pyeti krejt papritur.

— Jo, — i thashë i hutuar.

— Shikomë mirë!

— Mos këmbëngulni kot, — i thashë me të qeshur.

— Ke tē drejtë tē mos e kapësh, — tha ai pas pak!
— Dhe kjo mua më glodh. E megjithatë, para se tē largoresha nga atdheu im pér këtu, agjentët e shoqëri-ve punëdhënëse më hapën gojën dhe më kontrolluan dhëmbët. Si kuajve. Aty ndjeva dhimbjen më tē madhe. M'u duk sikur humba gjithçka dhe me mua mund tē silleshin si tē donin. Hipëm në një tren dhe pas tri ditësh sosëm këtu. Nënshkruam një kontratë pér një vit. Nuk e njoha firmën time. M'u duk si gjurmë kali mbi baltë. Punonim nga dympëdhjetë orë pér tē fituar ndonjë lek më shumë pér t'ia dërguar familjes. Truri lodhej aq shumë, sa nuk mund tē mendonte pér gjë tjeter pér veçse pér bukë dhe gjumë. Dhe s'ka gjë më tē tmerrshme pér trurin e njeriut, sesa kur mendon vetëm pér bukë dhe gjumë. Kështu mendon vetëm truri i një kafshe. Dhe mos mendoni se jam i vetëm. Jemi plot bashkatzdhetarë që rropatemi në këtë dhë tē huaj. A e kupton se ç'do tē thotë kjo pér Atdheun? — gati sa nuk thirri i dëshpëruar.

— Po, — i thashë, — tē kuptoj,

— E dija se do tē më kuptoje,

— Veçse nuk di tē ngushëlloj, — i thashë dhe mbloq dha supet pa mundur tē vazhdoj më teja.

— Doni tē më ngushëlloni. Por, po tē kisha nevojë pér ngushëllim, nuk do tē tē ndalja e ndoshta tanë do tē isha duke udhëtar me tren. Nuk duartë më ngushëllojë njeri. S'ka gjë më fyese sesa ngushëllimi pér diçka që s'mund tē ngushëllohesh!

Hesh tëm. Para xhamit vazhdonin tē shfaqeshin vatura që ecnin me shpejtësi dhe njerëz, tē cilët i nënë shtröheshin ndezjes automatike tē semaforëve.

Ai m'u lut tē porositnim edhe diçka tjeter. Pranovël me kusht që porosinë ta bëja unë. Ai qeshi. I thashë se ç'dëshironte.

— Kafe.

— Mirë, po pimë përsëri kafe. Këtu kafen nuk e bëj- në tē fortë, — i thashë. — Qenkausi lëng gështenjash.

— Cfarë?

— Lëng gështenjash. Ai nuk i njihte gështenjat dhe

unë nuk dija si t'ia shpjegoja. M'u kujtuan shitésit e shumtë të gështenjave me tezgat e tyre në qoshe të rrugëve dhe tabelat e thjeshta që vinin mbi to. — Moron, — i thashë.

— Hë, qeshi dhe përséri, — lëng moron.

Edhe unë qesha. Deri atëherë anglishtja jonë na kishte ngatërruar vetëm me gështenjat. Dhe kjo ishte një ngatërrresë e këndshme. Kamerieri na solli kafet.

— Ti me siguri që i ke bërë vetes pyetjen, — përsë më ndali ky njeri në këtë qytet të madh dhe të huaj, — tha ai dhe më vështroi në sy.

Unë nuk u përgjigja.

— Ti je komunist? — më pyeti.

— Po, — iu përgjigja.

— Ndërsa unë kam qenë dikur, po partia ime degjeneroi. Ajo degjeneronte me orë dhe shokët e mi nuk ishin më shokët e mi dhe partia ime nuk ishte më partia ime. Ne u çoroditëm. E ndjenim rrënimin po nuk orientoheshim dot. E tmerrshme! Rrënimi thellohej. Sekretarët ngrinin vila. E di, sekretari i partisë së qytetit tonë në një rrugë kishte disa vila. Nuk e di se sa mund të ketë ngritur tani. Kjo do të thoshte se partia ime nuk ishte më partia ime. Ajo largohej qdo ditë dhe heshtte. Kurse neve na shikonin dhëmbët. Ik! Dy dhëmballë të prishura! S'bën! Ky s'ka fuqi të punojë! Partia heshtte. Një parti që hesht eshtë një kërmë e pakallur. Kur e kuptuam këtë ne shkuam, jo të gjithë, dhe dorëzuan teserën. Sekretari nuk e prishi gjakun. «Po, t'ju ndërrrohet mendja, ejani përséri, partia e ka zemrën të gjerë, — na tha. — Dhe ne ju pranojmë». Po ne nuk u kthyem më. Ne u larguam. Të dërrmuar në shpirt. Kishim vite që luftonim. Po partia e kishte harruar luftën dhe sakrificën tonë. Edhe unë u përpoqë të harroja. Po përherë e më shumë po e ndieja veten të dobët. Isha si një gjethë e shkëputur nga pema dhe që era mund ta rrokulliste si të donte. Veçse mua nuk më kishte rrëzuar vjeshta, por degjenerimi i partisë sime. Dhe kështu do ta kisha ngrysur jetën time, e cila kishte në trup plumbat e fashistëve dhe entuziazmin e Rezistencës. Ato i ki-

shtë dhe s'mund t'i mohonte, me gjithëse unë kisha humbur diçka të madhe. Diçka që nuk mund të humbet dy herë. Por edhe në se unë u zhgënjeva kjo nuk do të thoshte se ideal i im ishte zhdukur. Ai jetonte brenda trupit të revolucionit, i cili është gjaku i tokës. Këtë e kuptova kur njëzet e ndershëm të vendit tim iu kundërvunë partisë sime. Disa i pushkatuan, disa janë në burg. Gjaku i tyre u fut në gjakun e tokës. Dhe gjaku i tokës është gjaku i revolucionit. Aty ishte dhe një pjesë e gjakut tim të parë, i cili përsëri lëvizte brenda meje, por unë nuk e ndieja. Dhe e ndjeva kur u njoha me Partinë tënde. Dhe tanë e ndiej si më troket damarëve gjaku im i parë, që nuk donte t'ia dinte nga degjenerimi i partisë sime.

Burri përplasi grushtin mbi tavolinë. Filxhanët e kafes u përplasën më njëri-tjetrin dhe bënë zhurmë. Nga tavolinat pranë kthyen kokën disa klientë.

— Ata mendojnë se u deha, — tha ai, — kurse unë tanë jam më esëll se kurrë. Më esëll se kurrë!

Ai e ngriti zërin edhe më fort, që ta dëgjonin, por askush nga ata që pinin nuk do ta kuptonte përsë ai ishte sonte më esëll se kurrë. Ai e mblodhi veten.

— Unë po kthehem për më Atdhe. Para një javë mora kontakt me marksistë-leninistët e vendit tim dhe iu luta të më pranonin në Partinë e tyre. Ata më thanë të kthehesha në Atdhe. Preva biletë menjëherë dhe u nisa. Por, kur lexova në gazetë lajmin për pjesëmarrjen e vendit tuaj në panair, vendosa t'ju takoj. Doja të shprehja mirënjojen time edhe të shokëve të mi për Partinë tuaj. Veç nuk e di a do të më besojnë shokët e rindj. Ti si thua?

— Me siguri, — i thashë.

— Falemnderit. Mos ma prish, sikur të porosis edhe diçka. Është për lindjen time. Mirë?

— Mirë.

Porositëm nga një gotë uiski.

— Gëzuar, — i thashë kur na i solli kamerieri.

— Gëzuar, — tha dhe ai.

Ai vështroi jashtë. Dhimbja në sy i ishte zhdu-

kur. Në lokal hynë dy policë me radio dore. Ata hodhën vështrimin mbi tavolinat duke rrudhur buzët. Në tavolinën tonë vështrimi i tyre qëndroi më gjatë. Pastaj dolën të heshtur, ashtu si hynë.

— Vërtiten dhe vërtiten, — tha emigrant, që nuk ishte më emigrant. — Kamerier, të paguajmë!

Dolém. Mjegulla ishte bërë më e dendur. Reklamat nuk lexoheshin dot. Ato vetëm se i jepnin mjegullës ngjyra të ndryshme. Po pavarësisht nga kjo, ajo mbetej përsëri mjegull. Lëvizja kishte rënë. Qyteti kishte mbyllur dyert e rënda, gati hermetike. Zgjuar rrinin sytë magjikë të semaforëve dhe reklamat e bujshme. Në dyqanet e mëdha nuk flinin ekranet dhe kamerat televizive, të cilat rrulloheshin dhe rrulloheshin duke vëzhguar ambientet si disa gen turgjatë, që gojën dhe sytë i kanë në të njëjtin vend.

— Do të rrija téré natën me ju, por duhet të nissem me trenin e mesnatës, — më tha burri.

— Në ç'orë niset treni?

— Në njëmbëdhjetë.

Ora e stacionit të trenit shënonte njëmbëdhjetë pa njëzet.

— Duhet të nxitosh, — i thashë, — nuk ke dhe shumë kohë.

S'kishim ç'të thoshim më atë çast. Ai më dha dorën dhe nxitoi. Në ecjen e tij nuk ishte më nxitimi i zakonshëm i banorëve, të atij qyteti, që vetëm nguteshin, sikur kishin frikë se nuk do të arrinin me kohë pér atje ku ishin nisur. Nxitimi i tij kishte një shtytje tjetër, forcën e së cilës në atë çast e dija vetëm unë.

and the first time I have seen it. It is a very large tree, and the trunk is about 10 feet in diameter. The bark is smooth and grey, and the leaves are large and green. The flowers are white and fragrant, and the fruit is a small, round, yellowish-orange. The tree is growing in a clearing in the forest, and there are other trees and bushes around it. The ground is covered with fallen leaves and pine needles. The sky is clear and blue, and the sun is shining brightly. The overall impression is one of a peaceful and natural environment.

Kishin dítë që në mëngjes pellgjet e cekëta gjitheshin të mbuluara me një cipë të hollë akulli si këmisha prej dhjami, që kasapëtua ngjisnin në kurriz qengjave të therur dhe nuk na besohej se kishtë ardhur dimri. Jos ai nuk e kishte kohën por mëti atë vit po mbante i mbarë dhe dielli kishtë një ngrohetësi, që të futej thellë, në të tërë gjymtyrët. Nevena vinte keq të ndaheshim prej tij. Sapo jepej sinjal i pushimit, ne zinim ndonjë rrëzë që e thekta dielli dhe shtriheshim të merrnim një sy gjumë. Mjeku i brigadës kishte merak se mos ftosheshim. Po në e donim diellin e atij nëntori. Vetëm ai nuk nă sëmur, thoshim. Mjeku na tregon te njollat që na bëheshin në bërryl apo në këmbë dhe thoshte se ato fshihnin reumatizmin. Reumatizmi është si tradhtia. Ai futet në

për gjymtyrë dhe shkon drejt kyçeve për t'i ndryshkur. Kur ngriheshim dhe niseshim për në marshim, gati të gjithë bëheshim pishman, që nuk ia kishim dëgjuar fjalën. Por, në qoftë se pushimi tjetër binte kur nuk kishte perënduar alkoma, e harronim porosinë e mjekut dhe shtriheshim përsëri. Secili donte që atë diell ta thithë sa më shumë trupi, që ta kishim për fërë dimrin, i cili do të çatiste nga çasti në çast. Zakonisht, unë ecja në fund të kompanisë. Kishim lënë pas pishat e Voskopojës dhe po zbrisnim poshtë, në Mokër. Era e ftohtë më futej në trup, e ftohtë, e thatë. Vetëm po të përgjoje me vëmendje do të dëgjoje se si fishkallente ajo nëpër halat e gjelbra të pishave. I njihja ato vise dhe, sa herë që më kishte rënë rasti të kaloja andej, i kisha parë ashtu të heshtura, të qeta, sikur prisnin diçka që ishte ndarë prej kohësh nga dremitja e tyre e lashtë. Qetësia e pyllit të shtinte në trup një gjendje të tillë, që pa e kuptuar e shihje veten të mbetur nga kujtimet. Dhe nuk merrej vesh në ecje ti, apo kujtimet.

U futëm në një grykë të zhveshur. Andej nuk kisha shkelur kurrë. Peisazhi ishte i shkretë dhe nuk dukej ndonjë shenjë jete. Kushedi ikur do të binim në fshatin e parë. Pushimin kishim më shumë se një orë që e kishim bërë. Ndofta ne do të marshonim derisa të errej fare. Mbi majat e maleve endeshin disa re të hirta. Ato kishin kohë që vërtiteshin dhe nuk zbrisnin më poshtë. Toka ishte e ngrirë dhe tërë gjurmë kali. Siç dukej, nëpër atë rrugë fshatarët shkonin pér dru. Gjurmët ishin të vjetra. Para dy javësh në atë zonë ishin zhvilluar luftime. Diku aty afér duhej të ishte vrarë Mevlani, me të cilin dola partizan në një ditë. Ne qëndruam bashkë dy muaj, pastaj Mevlinan e quan në një brigadë tjetër. Ndërsa tanë duhet të jetë diku këtu afér, në varrezat e fshatit.

Pasi kapërcyem grykën, para nesh sikur u hapën horizontet dhe sikur dita i zgjeroi kufijtë e saj. Ne pamë pllajën e madhe, që shtrihet e gjerë me disa fshatra rrësht, njëri pas tjetrit. Në mes të pllajës rriddhët De-

voll. Ai ishte i turbullt dhe i vrullshëm. Dikush tha se në malet e Moravës duhej të kishte rënë shi i përzier me dëborë. Ne do të ndiqnim rrjedhën e lumit, për të dalë në Shqipërinë e Mesme.

— Te fshati i parë dō të pushojmë, — tha komandanti. — Asnjëri të mos hyjë brenda! Do të rrimë tok, buzë lumit.

Sapo arritëm buzë lumit, hoqa pajimet dhe lava fytyrën. Pastaj u ula mbi një gur të zi dhe ndeza një cigare. Ndoshët ngaqë po e pijà buzë lumit, ndoshët ngaqë në varrezat e fshatit, mbi kodrën përballë, tanë flinte edhe Mevlani, unë kujtojë ditët kur dolën partizanë. Pas pak, fare pranë, pas një shkëmbi pashë një fjollë tymi. Mendova të afrohesha e të ngrohesha pa. U afrova mëngadalë dhe pashë një gruau që po ngacmonte zjarrin d'he mbi zjarr po zjente një kazan. Menjéherë m'u kuttua nëna ime. Kur më thoshte se do të shkonte në lumë për të larë velenxat dhe rrobat, unë mezi prisja të nise-shim dhe tërë ditën rrija në ujë. Kur mbaroheshin shkarpat shkoja e mblidhja në malin pranë. Pastaj nëna shtronte pecetën e madhe mbi ndonjë shkëmb të sheshtë dhe unë haja e s'ndieja të ngopur.

— Si u ngrysët? — i thashë gruas.

Ajo u kthyte dhe unë mbetë i habitur. Gruaja ishte Silla. E njihja mirë atë dhe jetën e saj. Ishte një jetë e rëndë, së cilës nuk i sheh asgjë përvçe së keqes. Dhe Silla e përballonte jetën me një dashuri, që shumë veta nuk e kuptionin dhe nuk dinin si ta shpjegonin. Disa thoshin se ashtu mund të jetojë vetëm një femër, kur bëhet nënë. Ndonjë, që kishte më shumë shkollë, thoshte se jëta e Sillës tregon pajtimin e njériut me fatin e tij, aq sa arrin të gjejë lumturi edhe në vuajtje. Sigurisht që këto fjalë më shumë i hutonin sesa u shpjegonin dicka atyre që i dëgjonin. Ndonjë tjetër shtonte se njériu ishte më i fortë se druri, guri dhe balta. Se guri do të ishte thërrmuar, druri kalbur, kurse balta do të ishte plasaritur dhe kthyer në pluhur.

Silla e dinte se për të flisnin shumë, por nuk ishte

kureshtare t'i mësonte ato që thuheshin për të. Ajo përballoi martesën e parë me një burrë të sëmurë dhe të madh në moshë. I vëllai, i cili u bë shkas për këtë martesë, kur erdhi dita e dasmës, për të mos i dhënë gjë së motrës, u hoq sikur nuk ishte dakord me këtë martesë. Silla u martua pa gjë. Burri ishte i urtë. Ai vdiq pas katër vjetësh. Silla mbeti me dy fëmijë. Ajo vazhdoi jetën e saj. Rriste fëmijët. Dhe atëherë për herë të parë dikush tha se jeta e femrës është mëmësia. Ai kishte parasysh Sillën. Thënia u pranua nga të gjithë. Ku u tha ajo? Kjo nuk ka rëndësi. Rëndësi ka fakti se njërejtëzit nëpërmjet Sillës përpinqeshin, të gjenin kuptimin e jetës.

Pastaj, një ditë, të gjithë panë Sillën pas një mushke dhe një kali. Mbi kalë kishte hipur dy fëmijët e saj, kurse mbi mushkë shtëpinë e saj. Mushkën e tërhiqte një burrë i panjohur. Silla ekte dhe shikonte rrugën, shtëpitë dhe njerëzit. Mushka, kali, burri, dy fëmijët dhe Silla u zhdukën përtëj horizontit të asaj dite si këtë pikë lëvizëse. Për martesën e saj u fol dy ditë. Njëri thoshte se Silla ishte martuar me një burrë të ve me tre fëmijë, në një fshat të Skraparit. Tjetri thoshte se i shoqi ishte nga Mokra. I treti përmblidhët mendimet e dy të parëve, duke thënë se nuk kishte rëndësi fare vendi, rëndësi kishte jeta që e priste tanë e tutje Sillën. Dhe jeta e saj nuk kishte për të qenë më e bukur tanë që u martua. Ai e shikonte më të rëndë dhe më të errët. Dhe, duke u ndarë, burrat thoshin se nuk ia ylente të jetë si Silla. Atë jetë e bënин vetëm qentë.

Pak nga pak Silla u harrua ashtu si harrohet shtegtimi mbi fshat netve të vjeshtës, i zogjve të ndryshëm. Askush nuk është i zotit ta ndjekë shtegtimin e tyre. Ai është i largët, i huaj. Në mendje, shumë-shumë të mbenët vetëm klithmat e shtegtarëve që thérresin njëri-tjetrin mos humbasin rrugëve të akullta të dimrit.

Lajmet për Sillën sa vinin dhe rralloheshin. Ato ishin të shkurtra, si shkëndijat e një zjarri që, sa shkëputeshin, shuheshin. Për disa ajo mbeti pika e katërt,

pas mushkës, kalit dhe burrit, që tretej në kufirin e ditës dhe të krahinës. Dhe si qdo objekti, që largësia ia humbet tiparet, për të fituar diçka të përhershme, të shkrirë njësh me gjithçka që e trethon, Silla, kishte lënë në kujtimet e njerëzve vuajtjen, sakrificën dhe pikëpyetjen e madhe, të dashurisë së njeriut për jetën. Për mua që isha fëmijë, kur ajo u largua,jeta e saj dhe ajo vetë kishte diçka nga përrallat dhe proverbat...

Dhe ja tani e kisha përballë, të thinjur, duke larë rrobat buzë lumi. Nuk e përcaktoja dot, ndryshimin që kishte pësuar. Më dukej sikur kështu kishte qenë gjithmonë, përderisa e njoha. I dhashë dorën dhe i thashë se isha djali i madh i Llukës. Ajo më puthi dhe nuk çmallej dot. Më pyeti pér të gjithë. Më dëgjonte pa m'i ndarë sytë. Dhe unë e kuptova se sa shumë ishte lidhur me jetën e parë. Kur i thosha se filan plak kishte vdekur, ajo seç pëshpëriste pa zë. Si mbarova unë nisa ta pyesja pér jetën e saj. Ajo më tha se ge martuar me një burrë të ve, me tre fëmijë. Dy unë dhe tre ai, pesë. Pastaj na lindën edhe dy të tjerë, dy vajza. Shtatë. I kam të shtatë, shkojnë shumë mirë me njëri-tjetrin. Burri m'u vra nga italianët. Ishte i sémurë, por u ngrit nga dysheku dhe shkoi. Luftoi dhe u vra. Ishte një burrë trim, i ndershëm dhe që i donte me tërë shpirt fëmijët. Djalin e madh e kam partiżan. E kanë kaluar në një brigadë të re, se në c'brigadë, nuk e di.

Heshtëm. Pranë kazanit kishte një fanellë, të porsanisur dhe një pecetë ku kishte mbështjellë bukën. Ajo hapi peceten dhe më dha bukën.

— Jo, — i thashë, — sapo kam ngrënë.

— Merre me vete.

— Kam.

— E di që ke, po merre dhe këtë. Kuschedi c'rrugë tē gjatë do të bëni. Dhe rruga do bukë.

— Jo, — e kundërshtova, — nuk e marr!

Sepse isha i sigurt, që me atë copë bukë, ajo kallonte tërë ditën. As vëtë nuk e kuptoja pse isha kaq i sigurt në mendimet e mia. Shkova, mëra, cantën time dhe i tregova copën e bukës. Ajo nuk u bind. Ma futi

me zor dhe copën e saj. Pranova. Atë grua ishte e kotë ta kundërshtoje. Ndofta një njeri me jetë si të Sillës gjithmonë është vështirë ta kundërshtosh.

- Po unë, ç'të të jap? — i thashë.
- Asgjë. — tha ajo. — Ti nuk ke se ç'të më japësh. Dhe me të vërtetë, unë nuk kisha se ç't'i jepja.
- Ajo mori fanellën hodhi fijen e leshtë në qafë dhe filloj të punojë.
 - Po ia bëj tim biri, — tha.
 - Atij që ke partizan?
 - Jo, të dytit, e kam zhveshur. Shokët po bëheshin gati të niseshin.
 - Po ikni? — tha Silla.
 - Po, — i thashë, — po ikim.
 - Mirë bëni. Kjo luftë duhet të mbarojë sa më parë.
 - Do të mbarojë, — i thashë, — dhe ty do të të kthehet yt bir.
 - Nuk e kam fjalën tek im bir.
- U uña pak për ta përqafuar. Ajo më puthi në ballë. Duart e saj më përkëdhelën shpinën.
 - Sa hollë qenke veshur! — më tha.
 - I ri unë, — bëra shaka. — Le që u mësova dhe nuk dua t'ia di.
 - Sivjet kemi dimër të egër.
 - Nga lajthitë! — qesha unë.
 - Edhe nga lajthitë edhe nga gjymtyrët e pleqve. Ato therin. Pastaj andej nga po shkoni ju, thonë se dimri është i hidhur.
 - Nuk e di.

Ajo më shkopsiti këmishën dhe pa gjoksin tim të dobët. Mua më erdhi turp që isha aq i dobët. Dhe ajo përsëri tha:

- Sa hollë qenke veshur!
- Edhe dimrin e kašuar kështu e shtyva.
- Kompania ishte rrështuar. Mua nuk më bëhej të ndahesha nga Silla. Do të udhëtonim për tërë natën. Nën këmbët tonë, toka e shkriftuar nga dielli do të ngrinte

ngadalë-ngadalë. Në mëngjes pellgjet e vogla do të zinin cipën e hollë të akullit, si këmisha prej dhjami e qengjave të therur. Dhe për herë të parë e ndjeva se isha veshur hollë. Këmisha që kishte endur dielli në trupin tonë, nuk do të na ruante gjatë nga të ftohtët.

— Po iki, Silla, dhe mirë mibetsh! M...
— Shiko mibas shokëve, xhan! — thashë.

Rregullova pajimet dhe u nisa me vrapi. Kompania po nisej. Ktheva dhë një herë kokën dhe pashë Sillën. Ajo më tundi dorën. Tymi që lëshointe zjärr i ishte i lehtë dhe i rrallë. Pastaj u nisa më me vrull dhe Silla më humbi nga sytë.

Gjatë tërë natës ne ecëm dhe Silla nuk m'u nda nga mendja. Ecëmi të dy. Toka kërciste nën këmbët tonë. Po ngrinte. Në mëngjes ndaluam në një korije me dushqe. Ishim pranë zonave të pushtuara. Aty do të qëndronim për tërë ditën. Do të niseshim përsëri kur të ngrysej. Dita ishte e vrenjtur dhe frynte një erë e ftohtë që na e shponte trupin. Dielli as që dukej të dilte. Poshtë korijes rriddhë lumi, më i vrullshëm dhe më i turbullt se një ditë më parë. Dhe përsëri dikush tha se, me siguri, në Moravë vazhdonte të binte shi i përzier me déborë. Pastaj kisha vënë re se s'ka vend më të ftohtë në dimër, sesa një korije buzë një lumi. Të ftohtin e shtonte më shumë lagështia dhe mjegulla, që nuk u ndahej asnjë çast brigjeve, dhe grykave. Zjarr nuk ndiznim dot. Këputa degë, rregullova një si biçim kasolleje dhe u shtriva... Më zuri pak gjumi. Kur u zgjova, ishte mesditë. Po mjegulla dhe të ftohtët ishte rritur. Po fillonin orët më të vështira për t'i shtyrë, orët kur nuk mund t'i shmangesh dot të ftohitit të lagësht. Ai të futet nëpër trup pa e ndier. Mbë kokë kisha gjethet e zverdhura të dushqeve. Më shumë se të verdha, ato kishin një ngjyrë balte të zbardhur. U vërtita dhe mbloðha këmbët. «Sikur të më zërë përsëri gjumi». Dhe vërtet, ai më zuri pas pak. Më quan kur nuk ishte errur mirë.

— Do nisemi! — më thanë.

— Shyqyr! — thashë dhe brofa në këmbë. Ecnim shpejt. Kështu ecëm tri orë. Pastaj ndaluam në një fshat

të vogël. Aty do të prisnim urdhrin, për të vazhduar apo jo më tej rrugën. Komparia jonë u vendos në një shtëpi në të dalë të fshatit. Unë me disa shokë u futëm në haurin bosh dhe ndezëm zjarr. Të nxehjtët na futej, në trup, nxora bukën e Sillës dhe e ndava. M'u kujtua Silla buzë lumi dhe s'di pse u preka. Tani ajo duhet të ketë rënë të flejë mes fëmijëve. Buka na shijoi. Pak nga pak po më qepeshin sytë. Ishte një dremitje e ëmbël. U rregullova mirë dhe fjétá. Zjarri më ngrohte shpinën.

Nuk e di sa orë fjeta, vecse kur më zgjuan e ndjeja veten të ngopur me gjumë. Shokët flinin përreth zjarrit, i cili ishte bërë prush. Prush dushku, që mban për téré natën; pa u fikur. Sadriu i përkulur mbi mua përpiquej të më zgjonte.

— Tani, — i thashë dhe u shtriqë.

— C'gjumë të rendë që paske, a derëbardhë!

— Gjumë pranë zjarrit, — ia ktheva. — Pse mos kam gjë rojën?

— Jo! — më tha Sadriu. — Të kërkon një grua.

— Një grua?!

Në atë fshat të largët, ku ndahet kufiri i Shqipërisë së Mesme me atë Juglindore, gjëja më e habitshme përmua ishte pikërisht kjo grua. Nuk njihja njeri në ato anë. «Thua nëna, e shtyrë nga malli, kishte ndjekur brigadën, gjersa e kishte arritur në këtë fshat?» Kjo gjë edhe kishte ndodhur, po nëna ime ishte e dobët pastaj të ftohtët e ashpër të natës. Ajo nuk do të mund të na ndiqte dot as deri në mes të rrugës, sepse me siguri që kishte për të mbetur në ndonjë rrëzë. Megjithatë kush mund të thotë se i njeh forcat që fsheh një nënë? U çova mie vrull dhe hodha xhaketën krahëve.

— Ku është? — i thashë Sadriut.

— Te gardhi i shtëpisë.

— Përse nuk e fute brenda?

— Nuk dëgjonte. Po pres këtu, më tha.

— Si është nga trupi?

— Vallahi, nuk e vura re mirë. Eshtë mesi i natës.

Dola nga haúri dhe të ftohtët e asaj nate më rrë-

gethi. Qielli ishte i kthjellët dhe plot yje. Pikërisht kur nata është kaq e kthjellët dhe temperatura ulet shumë, ngricat shtrëngojnë poret e tokës. Shtëpia me haure ndodhej në një rrëpirë, që e rrihnin erërat e veriut. Rrëshqita dhei u vrava në këllk. Çdo gjë flinte. Nga larg vinte zhurma e lumit. Me siguri në pranverë shtëpia me haure mbulohej nga gjelbërimi e aroma e gjethit dhe e barite e së bashku me zhurmat e largëta, po aq ngacmuese të netetë ngrohta, e bënин atë një vend të këndshëm e romantik.

— Këtej, — më tha Sadriu.

Endoqa pas dhe për herë të parë dallova hijen e një njeriu që lëvizti. U afrova dhe zemra më rrahu fort. Vetëm zemra nuk urdhërohet në këto raste.

— Eja, moj nënë! — i thirri Sadriu.

Gruaja hapi lesën dhe hyri. Gjëja e parë u që shqova ishte se ajo grua, nuk ishte nëna imë. Asaj do t'ia njihja edhe hijen.

— Të zgjova nga gjumi, xhan, — tha gruaja dhe unë mbeta si i ngirë.

Ishte Silla. Ajo më kapi kokën me të dyja duart dhe më puthi. S'flisja dot. Edhe ajo. S'dija si ta pyesja. Ajo më përkëdheli përsëri flokët.

— Ke pasur ftohtë? — më pyeti.

— Pak.

— Je veshur hollë, xhan. Prandaj dhe erdha. Të solla këtë fanellë, ta veshësh. Dimri është i gjatë dhe akoma nuk ka nisur mirë.

Silla shpështolli një mësallë dhe nxori fanellën. Megjithëse drita qe e paktë, unë dallova fanellën që ajo po punonte buzë lumit.

— Po përsë u lodhe deri këtu, moj Silla?

— Ç'është ajo fjalë. Do të të mbajë ngrohtë.

— U mësova ta shtyj dimrin edhe hollë. Dhe ti ke tërë ata fëmijë. Vishua atyre, — i thashë me gjysmë zëri.

— Jo, xhan! Ata janë brenda. Ti je jashtë. Mos ma thyei zemrën. Shko vishë dhe hajde të të shoh se si të rri. Shko, shko, se po të pres këtu.

Nuk e kundërshtoja dot. U nisa drejt haurit. Ecja si i dehur. E mora me mend se ç'kishte bërë Silla apo isha ndarë nga ajo buzë lumit. Kishte mbledhur rrobat, kishte hedhur në kurriz kazanin dhe kishte nxituar për në shtëpi. Kishtë mbaruar për tërë natën fanellen prej leshi e në mëngjes ishte nisur për të kerkuar brigadën. E nuk kishte pyetur për natë, të ftohtët dhe rrugën. Vesha shpejt e shpejt fanellën dhe dola. Silla po bisedonte me Sadriun.

— Si të rri?

— Mirë, — i thashë, — si të më kishe marrë mësë.

— Mos më gënje, se kam shtizat me vete. Po të të shtrëngojë e prish dhe ta bëj pas trupit.

— Jo, jo, më rri tamam, — i thashë.

— Ashtu. Atëhërë po iki, bir, — tha Silla dhe më puthi. Puthi edhe Sadriun. Unë nuk po e merrja dot vreten nga hutimi. Ajo rregulloi shallin e zi dhe u largua. Si kishte bërë disa hapa e mblodha veten dhe vravova. E kapa për supesh dhe e futa në gjji.

— Qëndro sonte këtu, — i thashë. — Fshati yt është larg që këtej.

— Nuk rri dot. Më presin.

— Po përse u lodhe kaq shumë, moj Silla, — i thashë si me qortim.

— Mos e thuaj atë fjälë, xhan. Shyqyr që të goditi pas trupit. Po ti shko e shtrihu. Fli. Nesër mund të bësh rrugë të gjatë dhe mund të ndeshesh me dushmanin.

— Po të përcjell edhe pak. — Dhe padashur shtova:

— Sa rrugë që ke për të bërë!

— Nuk më gjen gjë.

E përcolla deri në të dalë të fshatit. Atë natë, mund të ecja krahas Sillës deri në fund të botës e të mos lodhesha. Por ajo ndaloj dhe m'u kithye:

— Tani shko fli!

Më puthi në ballë. Ajo iku. Më humbi menjëherë nga sytë. Unë s'lëviza nga vendi. Gjumë s'kisha. Në trup ndieja ngrohtësinë e fanellës. Më shumë se prej leshi, ajo ishte thurur me sakrificën dhe dashurinë e një nëne